



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin me objekt “Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH”, në shtatë drejtori vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT (Auditim Tematik)

“Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH”

**në Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës:
Tirana Jug, Tirana Veri, Tirana Rurale I, Tirana Rurale II,
Kamëz – Vorë, Shkodër, Durrës**

Tiranë, janar 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
I.1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	3
I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
I.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	8
II. HYRJE	9
1. Objektivat e auditimit.....	9
2. Qëllimi i auditimit	9
3. Identifikimi i çështjes	9
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
5. Përgjegjësitë e audituesve	10
6. Kriteret e vlerësimit.....	10
7. Standardet e auditimit.....	10
8. Metodologjia e auditimit	10
9. Dokumentimi i auditimit	10
III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT	11
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	11
2. Përshkrimi sipas subjekteve dhe drejtimeve të auditimit	11
Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Tirana Jug:.....	11
Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Tirana Veri:	26
Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Tirana Rurale I:	44
Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Tirana Rurale II:.....	61
Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Kamëz - Vorë:	91
Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Shkodër:	112
Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Durrës:.....	116
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME	133

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të nenit 15, shkronja j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, të Programit të Auditimit nr. 421/2, datë 15.04.2025, nga data 21.04.2025 deri 30.05.2025, u krye auditimi mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, hartimin e plan-veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e legjislacionit, marrjen e masave organizative, të masave disiplinore dhe të zhdëmtimit, të rekomanduara në përfundimet e auditimeve të KLSH-së në shtatë drejtori vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës: Tirana Jug, Tirana Veri, Tirana Rurale I, Tirana Rurale II, Kamëz – Vorë, Shkodër, Durrës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer auditimet e përputhshmërisë dhe auditimet tematik për zbatimin e rekomandimeve (në DV ASHK Kamëz – Vorë nuk është kryer auditim tematik për zbatimin e rekomandimeve), ku të dhënat e programeve të auditimeve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	DV ASHK	Të dhënat e programit të auditimit të përputhshmërisë		Të dhënat e programit të auditimit të zbatimit të rekomandimeve	
		Nr. prot	Datë	Nr. prot	Datë
1	Tirana Jug	652/1	30.09.2022	908/3	10.07.2024
2	Tirana Veri	651/1	18.07.2022	908/3	10.07.2024
3	Tirana Rurale I	241/1	03.03.2022	37/5	11.01.2024
4	Tirana Rurale II	242/1	03.03.2022	37/5	11.01.2024
5	Kamëz - Vorë	1139/1	18.12.2022	Nuk është kryer	
6	Shkodër	1221/1	22.11.2021	37/5	11.01.2024
7	Durrës	202/1	03.03.2022	37/5	11.01.2024

Referuar auditimeve të përputhshmërisë në këto subjekte, janë rekomanduar gjithsej 359 masa (Tirana Jug: 47; Tirana Veri: 49; Tirana Rurale I: 52; Tirana Rurale II: 78; Kamëz-Vorë: 50; Shkodër: 42; Durrës: 41). Referuar auditimeve tematik për zbatimin e rekomandimeve në këto subjekte (përveç DV ASHK Kamëz – Vorë, për të cilën nuk është kryer auditim i mëparshëm për zbatimin e rekomandimeve), është konstatuar se janë pranuar gjithsej **303 nga 309 rekomandime** ose **98%**. Zbatueshmëria e rekomandimeve të lëna nga KLSH në këto subjekte ka qenë: 66 rekomandime të zbatuara ose 21.3%; 29 rekomandime në proces zbatimi ose 9.4%; 21 rekomandime në proces zbatimi ose 6.8%; 193 rekomandime të pazbatuar ose 62.5%.

Referuar auditimit tematik “Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH”, është rikërkuar zbatimi i 300 rekomandimeve (në këtë vlerë janë përfshirë dhe rekomandimet e lëna nga KLSH gjatë auditimit të përputhshmërisë në DV ASHK Kamëz - Vorë). Sipas llojit të masave dhe statusit të zbatimit të rekomandimeve, është konstatuar se:

- **Masa për përmirësimet / ndryshimet legjislacioni:** Janë rekomanduar dy masa, të cilat janë pranuar, por nuk janë zbatuar.

- **Masa organizative:** Nga 135 masa të rekomanduara, të cilat janë pranuar të gjitha, janë zbatuar 25 masa ose 18.5%, janë zbatuar pjesërisht 20 masa ose 14.8%, janë në proces zbatimi 13 masa ose 9.6%, ndërsa 77 masa ose 57.1% nuk janë zbatuar;

- **Masa për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet:** Nga 21 masa të rekomanduara, të cilat janë pranuar të gjitha, është zbatuar 1 masë ose 4.7%, 4 masa janë zbatuar pjesërisht ose 19%, 16 masa nuk janë zbatuar ose 76.3%;

- **Masa disiplinore:** Nga 142 masa të rekomanduara, të cilat janë pranuar të gjitha, është zbatuar 1 masë ose 0.7%, ndërsa 141 masa ose 99.3% nuk janë zbatuar.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me moszbatimin e procedurave të legalizimit të objekteve informale, duke mos zbatuar distancat nga rrugët, legalizimi i objekteve me materiale jo të qëndrueshme, legalizimi i objekteve në zona të ndaluara për ndërtime referuar Planit të Përgjithshëm Vendor, pasi janë legalizuar në zona të përcaktuara për arsim, janë legalizuar objekte me funksion banim në zona të përcaktuara për zhvillim industrial, etj.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore në DV ASHK Tirana Jug:

- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug të bëjë ndryshimet e të dhënave të kalimit të pronësisë mbi 3-fishin e sipërfaqes së bazës të ndërtimit, duke kthyer një sipërfaqe prej 1105.6 m², parcelë ndërtimore tej kufirit ligjor në gjendjen juridike “*Shtet*”. Sektori i kadastrës të pasqyrojë në seksionin e pronësisë së kartelës të pasurive të paluajtshme, aktin e ndryshimit të lejes së legalizimit për sipërfaqen e parcelës ndërtimore mbi 3-fishin e sipërfaqes të bazës të ndërtimit.
- Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrorë kontrollin administrativ dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e Vendimit të Legalizimit nr. 2625600, datë 22.2.2019. Gjithashtu, për pasurinë e regjistruar sipas këtij vendimi, të merret masë për të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procedurave të vlerësimit për shfuqizimin e vendimit.
- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug, të rikthejë formularin e lejes së legalizimit nr. 124853, datë 11.12.2019 për objektin: “*Godinë banimi 3 kat*”, në sipërfaqen fillestare të miratuar për parcelës ndërtimore në 255 m², bazuar në genplanin fillestar të miratuar nga sektori i hartografisë dhe nga Sektori i Çështjeve të Pronësisë, për sipërfaqen e parcelës ndërtimore 255 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 85 m².
- Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrorë kontrollin administrativ dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e vendimit të legalizimit nr. 2625593, datë 21.02.2019; nr. 127080, datë 24.11.2020; nr. 24768, datë 22.11.2019; nr. 123162, datë 10.07.2019 dhe lejen e legalizimit me nr. 124704, datë 25.9.2019. Gjithashtu, për pasurinë e regjistruar sipas këtyre vendimeve të merret masë për të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procedurave të vlerësimit për shfuqizimin e vendimit.
- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK, të fillojë kontrollin administrativ, duke proceduar me anulimin e lejeve të legalizimit nr. 124633, datë 14.08.2019, për pasurinë nr. 400/1277 në ZK 8190 dhe lejen e legalizimit nr. 122544, datë 22.07.2019, për pasurinë nr. 11/585, në ZK 8190.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore në DV ASHK Tirana Veri:

- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për parcelat ndërtimore prej 198,282 m² të pajisur me leje legalizimi të objektit, për të mundësuar

brenda afateve ligjore likuidimin të vleftës përkatëse prej 385,201,173.8 lekë të parcelave ndërtimore.

- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri të marrë masa dhe të përgatisë plane konkrete, për të shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas zonave informale dhe brenda afateve të përcaktuara ligjorisht, duke mundësuar afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë duke rritur edhe transparencën për publikun.
- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrë masa të rivlerësojë procedurat e legalizimit për objektet informale të pajisura me leje legalizimi në 25 raste për lejet e legalizimit me nr. 14233233; datë 21.09.2020; nr. 1233650, datë 27.10.2020; nr. 1233779, datë 26.11.2020; nr. 1231532, datë 24.10.2019; nr. 1233257, datë 22.09.2020; nr. 1231678, datë 27.11.2019; vendimi për legalizim nr. 18043, datë 30.10.2020; vendimi për legalizim nr. 689, datë 02.04.2021; nr. 1234089, datë 23.12.2020; nr. 1232708, datë 26.06.2020; nr. 1234113, datë 24.12.2020; nr. 1231159, datë 29.05.2019; vendimit të legalizimit nr. 1566, datë 29.07.2021; nr. 931, datë 16.04.2021; vendimi i legalizimit nr. 53 datë 27.01.2021; etj. Në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit. Gjithashtu, për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi apo Vendimeve të legalizimit konstatuar të lëshuara me shkelje në 25 raste, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore në DV ASHK Tirana Rurale I:

- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të ushtrojë kontroll administrativ me grup pune dhe në bazë të nenin 18, të marrë masa për skualifikimin e objekteve informal të pajisura me leje legalizimi në 5 raste. Gjithashtu, për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje, në 5 raste, të marrë masa për të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.
- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit nr. 13, datë 02.06.2021; nr. 2625589, datë 20.02.2019; nr. 138115, datë 22.01.2019; nr. 139335, datë 25.02.2020. Për pasuritë nr. 58/10/1, ZK 3976; nr. 11/204/1, ZK 3976; nr. 80/329/1, ZK 3976; nr. 195/817, ZK 2460; e regjistruar sipas lejes së legalizimit, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.
- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejes së legalizimit nr. 139581, datë 05.06.2020. Për pasurinë nr. 5/14, vol. 9, faqe 14, ZK 3550, e regjistruar sipas lejes së legalizimit sipas referencës nr. 00001643, datë 13.10.2020, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.
- Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, për të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 113/11, vol. 6, faqe 63 dhe pasurinë nr. 91/27, vol. 5, faqe 226, ZK 2735, duke njoftuar njëkohësisht poseduesin e këtyre pasurive, deri në kthimin me status në pronësi “Shtet” të sipërfaqeve 2000 m² dhe 1400 m².
- Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të kërkojë informacion nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve në vlerën

totale 24,425,900 lekë, si taksa urbanistike që rrjedhin nga përfitimi i lejeve të ndërtimit nga 6 subjektet si më sipër, si dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara, sipas lejeve të legalizimit të mësipërme, deri në marrjen e konfirmimit nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga lejet e ndërtimit të përfituara nga këto subjekte.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore në DV ASHK Tirana Rurale II:

- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të rivlerësojë procedurat e legalizimit për objektet informale të pajisura me leje legalizimi në 16 raste, dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 16 raste, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.
- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, në përputhje me nenin 76 “*Kontrolli administrativ*” të ushtrijë kontrollin administrativ dhe në bazë të nenin 18 të marrë masa për skualifikimin e objekteve informal të pajisura me leje legalizimi në 14 raste. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 14 raste të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.
- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Njësitë Administrative të Vetëqeverisjes Vendore për rastet e mësipërme të përcaktohen saktë pozicioni i objekteve të legalizuara në lidhje planet e përgjithshme e të detajuar vendore, si dhe të plotësohet dosjet e objekteve të legalizuara me dokumentacionin e kërkuar ligjor. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 4 raste të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.
- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë që vijnë nga ndarja e pasurisë nr. 431/1, vol. nr. 10, faqe 168, që rrjedhin nga kontrata e privatizimit nr. 2717/722, datë 22.05.1999, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor, të konstatuar në mungesë.
- Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Rurale II, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të kërkojë informacion nga institucionet shtetërore përkatëse, lidhur me shlyerjen e detyrimeve në vlerën totale 51,414,000 lekë, si detyrim financiar, që rrjedh nga qiraja për truallin në pronësi shtet, i cili me procedurë legalizimi ka kaluar në pronësi të shoqërisë “K. D.” ShPK. Gjithashtu të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara, sipas lejeve të legalizimit të mësipërme, që rezultojnë të pa tjetërsuara nga shoqëria ndërtuese, deri në marrjen e konfirmimit zyrtar nga institucionet përkatëse, lidhur me shlyerjen e detyrimeve të mësipërme.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore në DV ASHK Kamëz - Vorë:

- Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamëz - Vorë në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrë masa e të propozojë ndryshime ligjore në VKM nr. 827, datë 30.9.2020 “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim*”, lidhur me përcaktimin e nivelit tavan të sipërfaqes së truallit funksional nga 300 m² - 500 m², duke patur si prioritet përcaktimet ligjore për konceptin e truallit funksional, me qëllim shmangien e zaptimeve të pasurive shtetërore dhe abuzimeve të

mundshme në këtë drejtim.

- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë të marrë masa për kufizimin e pasurisë me nr. 800/10, me sipërfaqe 1085 m², deri në korrigjimin e konfigurimit të pasurisë, në përputhje me konturet e pasurisë së origjinës.
- Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë, bazuar në shkeljet e konstatuara të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 133/34, volum 17, faqe 86, arë me sipërfaqe 5100 m² dhe pasurinë nr. 304/5, volum 6, faqe 141, arë me sipërfaqe 310 m², deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.
- Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë, bazuar në shkeljet e konstatuara, të marrë masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit për pasuritë: nr. 113/16-G1-G3 dhe nr. 113/16-G7-G8, regjistruar në vol. 58, faqe 25 - 27 dhe faqe 31 - 32, si dhe mbi pasurinë truall me sipërfaqe 5325 m², mbi të cilin është ndërtuar objekti, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.
- Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa, që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfituar më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”).

Paraqitja e rekomandimeve kryesore në DV ASHK Shkodër:

- DV ASHK Shkodër të marrë masa për të anuluar vendimin nr. 23, datë 30.01.2020, në emër të bashkëpronarëve T., me sipërfaqe ndërtimi 238 m² dhe sipërfaqe truall funksional 238 m², duke i orientuar qytetarët që për objektin përkatës t’i nënshtrohet procedurave të privatizimit përmes Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
- Drejtori i DV ASHK Shkodër, duhet të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për të kryer verifikimet përkatëse, duke bashkëpunuar edhe me institucionet e tjera shtetërore, nëse për 517 objektet (të evidentuar nga institucionet e tjera si ndërtime pa leje, sipas aneksit përkatës bashkëngjitur raportit përfundimtar të përputhshmërisë në Aneksin nr. 1) janë bërë vetëdeklarimet për përfshirjen në procesin e legalizimit. Nëse këto subjekte kanë bërë vetëdeklarimin për legalizim të ndërtimeve informale, atëherë të merren masat për verifikimin në terren dhe ndjekjen e procedurës së legalizimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar në lidhje me kualifikimin apo skualifikimin e këtyre objekteve nga legalizimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore në DV ASHK Durrës:

- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës për rastet e mësipërme të marrë masa për të plotësuar dosjen me deklaratat përkatëse sipas përcaktimeve ligjore, në të kundërt, të korrigjojë sipërfaqen e parcelës ndërtimore për objektet e mësipërme duke i zbritur sipërfaqes totale truallin e llogaritur mbi tre-fishin e bazës ndërtimore.
- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, për rastet e mësipërme, të vendosë masë kufizimi sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit dhe të pasqyrojë këto veprime në kartelat (regjistrat) e pasurive të paluajtshme.
- DV ASHK Durrës të marrë masa për korrigjimin e zërit kadastral për çertifikatën e lëshuar ndaj personit të tretë, nga ‘arë’ në ‘kënetë’, për sipërfaqen 3003 m², duke i plotësuar kartelat përkatëse me shënimin e kufizimit dhe rikthyer në gjendjen fillestare regjistrimin e pasurive në emër të z. N. M.
- DV ASHK Durrës të marrë masa për korrigjimin e sipërfaqeve të regjistruara me vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, nr. 10-2018-2311 (820), për pjesët që mbartin mospërputhje me sipërfaqet e kartelave, duke zbritur edhe sipërfaqet shtesë mbi

sipërfaqen e përcaktuar në këtë vendim, si dhe të bëjë shënimin në seksionin përkatës të kartelave se për këtë çështje është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Nga auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2024”, mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet e INTOSAI-t, Manualet e Auditimit të KLSH-së, u konstatua se, niveli i zbatimit të rekomandimeve në 7 (shtatë) institucionet, konkretisht: Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Jug, Tirana Veri, Tirana Rurale I, Tirana Rurale II, Kamëz – Vorë, Shkodër, Durrës, paraqitet si vijon:

Lidhur me detyrimin ligjor të subjekteve të audituara për të raportuar në KLSH rreth hartimit të programit të tyre për të zbatuar rekomandimet e lëna, brenda afatit 20 ditor ka rezultuar se:

- Asnjë prej shtatë DV ASHK-ve nuk ka respektuar afatin 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15, shkronja j) të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Lidhur me detyrimin ligjor të subjekteve të audituara për të raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna brenda afatit 6 mujor ka rezultuar se:

- Asnjë prej shtatë DV ASHK-ve nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Referuar auditimeve të përputhshmërisë në këto subjekte, janë rekomanduar gjithsej 359 masa (Tirana Jug: 47; Tirana Veri: 49; Tirana Rurale I: 52; Tirana Rurale II: 78; Kamëz-Vorë: 50; Shkodër: 42; Durrës: 41). Referuar auditimeve tematik për zbatimin e rekomandimeve në këto subjekte (përveç DV ASHK Kamëz – Vorë, për të cilën nuk është kryer auditim i mëparshëm për zbatimin e rekomandimeve), është konstatuar se janë pranuar gjithsej **303 nga 309 rekomandime** ose **98%**. Zbatueshmëria e rekomandimeve të lëna nga KLSH në këto subjekte ka qenë: 66 rekomandime të zbatuara ose 21.3%; 29 rekomandime në proces zbatimi ose 9.4%; 21 rekomandime në proces zbatimi ose 6.8%; 193 rekomandime të pazbatuar ose 62.5%.

Referuar auditimit tematik “Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH”, është rikërkuar zbatimi i 300 rekomandimeve (në këtë vlerë janë përfshirë dhe rekomandimet e lëna nga KLSH gjatë auditimit të përputhshmërisë në DV ASHK Kamëz - Vorë). Sipas llojit të masave dhe statusit të zbatimit të rekomandimeve, është konstatuar se:

- **Masa për përmirësime / ndryshime legjislacioni:** Janë rekomanduar dy masa, të cilat janë pranuar, por nuk janë zbatuar.

- **Masa organizative:** Nga 135 masa të rekomanduara, të cilat janë pranuar të gjitha, janë zbatuar 25 masa ose 18.5%, janë zbatuar pjesërisht 20 masa ose 14.8%, janë në proces zbatimi 13 masa ose 9.6%, ndërsa 77 masa ose 57.1% nuk janë zbatuar;

- **Masa për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet:** Nga 21 masa të rekomanduara, të cilat janë pranuar të gjitha, është zbatuar 1 masë ose 4.7%, 4 masa janë zbatuar pjesërisht ose 19%, 16 masa nuk janë zbatuar ose 76.3%;

- **Masa disiplinore:** Nga 142 masa të rekomanduara, të cilat janë pranuar të gjitha, është zbatuar 1 masë ose 0.7%, ndërsa 141 masa ose 99.3% nuk janë zbatuar.

II. HYRJE

Mbështetur në ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 421/2 prot., datë 15.04.2025, nga data 21.04.2025 deri 30.05.2025, në Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug, Tirana Veri, Tirana Rurale I, Tirana Rurale II, Kamëz – Vorë, Shkodër, Durrës, KLSH kreu auditimin tematik me objekt “Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH”.

Përbërja e grupit të auditimit:

1. P. Xh. / *Përgjegjës grupi*
2. O. L. / *auditues*
3. F. Ç. / *auditues*
4. R. F. / *auditues*
5. Sh. H. / *auditues*
6. A. V. / *audituese*

Nga grupi i auditimit u përgatitën Raportet Përfundimtare të Auditimit për secilin DV ASHK, ndërsa një kopje përmbledhëse i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DP ASHK) dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

1. Objektivat e auditimit

Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug, Tirana Veri, Tirana Rurale I, Tirana Rurale II, Kamëz – Vorë, Shkodër, Durrës, si dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësisë publike.

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan-veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet administrative përkatëse (urdhurat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit ekonomik ose gjobave të vendosura.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të shtatë DV ASHK-ve dhe përgjegjësive që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punës në drejtim të regjistrimit dhe legalizimit të pronave, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve. Për këtë arsye, zbatimi i rekomandimeve ka një rëndësi të veçantë në identifikimin e masave që ka marrë institucioni përkatës për eliminimin e mangësive të konstatuara në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese dhe punonjësit e shtatë Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim, mbajnë përgjegjësi në lidhje me zbatimin e procedurës së regjistrimit të titujve të pronësisë dhe legalizimit, në

përputhje me ligjet që trajtojnë çështjet e pronësisë dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, duke planifikuar e kryer auditimin, me qëllim arritjen e nivelit të sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, miratuar me Vendimin nr. 07, datë 17.01.2024, të Kryetarit të KLSH-së;
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së;
- Manuali i auditimit të përputhshmërisë, miratuar me Vendimin nr. 245, datë 29.12.2022, të Kryetarit të KLSH-së;
- Manuali i auditimit financiar, miratuar me Vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH-së;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI);
- Udhëzuesit e INTOSAI-t.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodot e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

- Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
- Verifikimi i Urdhrave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur një akt-verifikim në secilën prej drejtorive vendore, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e shtatë Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

DV ASHK Tirana Jug, Tirana Veri, Tirana Rurale I, Tirana Rurale II, Kamëz – Vorë, Shkodër, Durrës janë persona juridik, publik, jobuxhetor, në varësi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe kanë për detyrë regjistrimin e titujve të pronësisë dhe legalizimin e objekteve informale të ndërtuara në territorin brenda juridiksionit të Drejtorisë, si dhe kalimin e pronësisë të pronave, në bazë të kushteve të përcaktuara nga ligji nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe ligji nr. 20/20, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Komplexiteti i trajtimit të pronës ka të bëjë me natyrën ekonomike, sociale si dhe juridike dhe që konsiderohet si një element bazik shtetformues, por në terësinë e të cilës ndërthuren edhe të drejtat private e publike. Trajtimi i pronës përbën një detyrim publik nga njëra anë (në aspektin e evidentimit dhe regjistrimit) dhe nga ana tjetër një të drejtë private (në aspektin e përfitimit).

Fushëveprimi i këtij auditimi përfshin procedurat e ndjekura nga shtatë Drejtoritë Vendore të ASHK, lidhur me ecurinë dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve që janë lënë në auditimet e mëparshme, për shkeljet e konstatuara për aktivitetin e kryer në lidhje me: zbatimin e procedurave në dhënien e lejeve të legalizimit; regjistrimin e pasurive, në zbatim të akteve administrative lëshuar nga organet që e kanë në kompetencë dhe vendimeve të gjykatave të formës së prerë.

2. Përshkrimi sipas subjekteve dhe drejttimeve të auditimit

Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Tirana Jug:

2.1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, sipas Programit të Auditimit 652/1 prot., datë 30.09.2022, janë rekomanduar për zbatim 47 rekomandime gjithsej, nga këto: 29 rekomandime për masa organizative dhe janë rekomanduar masa disiplinore për 18 punonjës.

Në vijim, referuar raportit përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2023, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug”, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024, është konstatuar se:

- Masa organizative: Është rikërkuar zbatimi i 29 rekomandimeve, janë pranuar të 29 masat, nga ku 8 rekomandime janë zbatuar, 10 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 11 rekomandime rezultojnë të pazbatuara;

- Masa disiplinore: Është rikërkuar zbatimi i 18 masave disiplinore, nga të cilat: masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 12 punonjës dhe masa disiplinore “Zgjidhje të kontratës së punës” për 6 punonjës.

Nga informacioni i marrë në DV ASHK Tirana Jug rezulton se rekomandimi për masat disiplinore i është përcjellë për kompetencë Drejtorisë së Përgjithshme, nga e cila nuk është dërguar shkresë për vënien në dijeni lidhur me masat e propozuara nga KLSH. Nuk ka asnjë njoftim lidhur me marrjen e masave disiplinore.

Në vijim, në mënyrë të përmbledhur është paraqitur ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, referuar auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2023, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug”, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024:

Tabela nr. 1: Statusi i zbatimit të rekomandimeve, referuar auditimit me nr. 908/3, datë 10.07.2024

Lloji i masës	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	29	8	5	3	13
Disiplinore	18	-	-	-	18
Totali	47	8	5	3	31

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, referuar raportit përfundimtar të auditimit me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2023, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug”, përcjellë me shkresën “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024, ka rezultuar se **subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje** brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, gërma j), ku cilësohet se:

KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Në lidhje me raportimin që DV ASHK Tirana Jug duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, ku cilësohet se:

Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

grupi i auditimit nuk mund të shprehet pasi jemi brenda afatit 6-mujor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit (dërguar me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, datë 04.03.2025, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024, me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2023, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug”).

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësime ligjore, atëherë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, sipas Programit të Auditimit 652/1 prot., datë 30.09.2022, janë rekomanduar për zbatim 29 rekomandime për masa organizative.

Referuar raportit përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2023, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug”, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024, është konstatuar se, nga 29 rekomandime për masa organizative, janë pranuar 29 prej tyre (pranueshmëria e rekomandimeve ka qenë në masën 100%), nga ku: **i.** 8 rekomandime janë zbatuar; **ii.** 5 rekomandime janë zbatuar pjesërisht; **iii.** 3 rekomandime janë zbatuar në proces zbatimi; **iv.** 13 rekomandime rezultojnë pazbatuar.

Grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim rekomandimet për masat organizative të cilat, janë zbatuar pjesërisht (4 rekomandime), ato që janë në proces zbatimi (3 rekomandime) dhe ato që nuk janë zbatuar (13 rekomandime), paraqitur si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Në 8 raste është tejkuluar kufiri ligjor i sipërfaqes së parcelës ndërtimore mbi 3-fishin e sipërfaqes së bazës së ndërtimit për objekte “Social ekonomike”.

Nr.	Emri Mbiemri	Zona kadastrale	Sip. ndërtimi m ²	Sip. parcelës	Diferenca
1	Z. S.	8270	25 m ²	124 m ²	49 m ²
2	B. D.	8220	65.9 m ²	500 m ²	302.3 m ²
3	A. G.	8180	28 m ²	150.1 m ²	66.1 m ²
4	T. Xh.	8170	86.6 m ²	363 m ²	103.2 m ²
5	S. D.	8190	82.3 m ²	335.4 m ²	88.5 m ²
6	A. M.	8170	59 m ²	350 m ²	173 m ²
7	I. K.	8220	35.5 m ²	333 m ²	226.5 m ²
8	Sh. F.	8170	30 m ²	187 m ²	97 m ²

(Më hollësisht trajtuar në pikën A/3, nga faqe 20 deri në faqe 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të bëjë ndryshimet e të dhënave të kalimit të pronësisë mbi 3-fishin e sipërfaqes të bazës të ndërtimit, duke kthyer një sipërfaqe prej 1105.6 m², parcelë ndërtimore tej kufirit ligjor në gjendjen juridike “Shtet”. Sektori i kadastrës të pasqyrojë në seksionin e pronësisë së kartelës të pasurive të paluajtshme, aktin e ndryshimit të lejes së legalizimit për sipërfaqen e parcelës ndërtimore mbi 3-fishin e sipërfaqes të bazës të ndërtimit.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: Ashtu sikurse është sqaruar në observacionin e dërguar nga specialistët, rekomandimi i sipërcituar është i pazbatuar nga ana e DV ASHK Tiranë Jug, pasi në zbatim të pikës c neni 17 të Ligjit 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin...” i ndryshuar, citohet se pavarësisht funksionit të ndërtimit pa leje përcaktuar në pikën a dhe b të nenit 17, për shkak të përmasave ose planvendosjes së parcelës ndërtimore, krijohen sipërfaqe të lira që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me VKM. Kalimi i këtyre parcelave kryhet nëse poseduesi i ndërtimit pa leje shpreh vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim, ose në rastet ku kjo kërkesë nuk është paraqitur, me pranimin e faturave dhe pagesës së parcelës ndërtimore sipas cmimit të referencës subjekti në heshtje ka rënë dakord. Këto sipërfaqe parcelash ndërtimore të listuara nga ju në tabelën më sipër, janë rrëgjistruar në rregjistrat e pasurive të paluajtshme dhe në disa raste janë kryer transaksione mbi pasurinë.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Jug, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3 prot., datë 10.07.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Jug nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pazbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Jug, ka kualifikuar ndërtimin informal dhe ka miratuar me vendim nr. 2625600, datë 22.2.2019 për leje legalizimi, objektin “*Godinë e kombinuar 5 kate*”, mbi pasuri në pronësi të të tretëve, ku referuar Vendimit të KKT-së nr. 1, datë 14.4.2017 “*Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendorë, Bashkia Tiranë*”, rezulton se objekti informal, i paraqitur për legalizim bën pjesë në njësinë strukturore TR/112-PDV, e cila parashikon ndërtime 8 (tetë) kate, veprime këto në kundërshtim me nenin 35, pika 1 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”, të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën A/3, nga faqe 20 deri në faqe 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrisë kontrollin administrativ dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e Vendimit të Legalizimit nr. 2625600, datë 22.2.2019. Gjithashtu për pasurinë e regjistruar sipas këtij vendimi të merret masë për të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procedurave të vlerësimit për shfuqizimin e vendimit.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: DV ASHK- Tiranë Jug, nuk mund të vijojë me anulimin e lejes së legalizimit pasi nuk bie në kundërshtim më nenin 35 pika 1 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”. Nëpërmjet Deklaratës Noteriale nr. 40 rep., nr. 11/1 kol., datë 22.01.2019 Kryegjyshata Botërore Bektashiane në cilësinë e pronarit të pasurisë mbi të cilën pozicionohet ndërtimi pa leje, deklaroi se autorizon Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Tiranë të kryejë procedurat e nevojshme për legalizimin e ndërtimit pa leje. Në vijim të deklaratës së administruar është vijuar me hartimin e dokumentacionit tekniko ligjor dhe emetimin e lejes së legalizimit.

Koment nga grupi i auditimit: Në zbatim të rekomandimit, DV ASHK Tirana Jug është mjaftuar vetëm me komente, por nuk ka marrë asnjë masë për ushtrimin e kontrollit administrativ për vlerësimin e procedurave për shfuqizimin e Vendimit të Legalizimit nr. 2625600, datë 22.02.2019, si dhe për nxjerrjen e urdhër kufizimit deri në përfundimin e procedurave të vlerësimit për shfuqizimin e vendimit.

Statusi: I pazbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Mbi formularin e vendimit nr. 124853, datë 11.12.2019 për leje legalizimi, i miratuar për objektin: “*Godinë banimi 3 kat*”, me posedues R. D., është bërë korrigjim me korrektor duke e ndryshuar sipërfaqen e parcelës nga 255 m² në 540 m², veprime në kundërshtim me nenin 27 dhe 28 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”, të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën A/3, nga faqe 20 deri në faqe 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të rikthejë formularin e lejes së legalizimit nr. 124853, datë 11.12.2019 për objektin: “*Godinë banimi 3 kat*”, në sipërfaqen fillestare të miratuar për parcelës ndërtimore në 255 m², bazuar në genplanin fillestar të miratuar nga sektori i hartografisë dhe nga Sektori i Çështjeve të Pronësisë, për sipërfaqen e parcelës ndërtimore 255 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 85 m².

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: Ashtu sikurse është sqaruar në observacionin e dërguar nga specialistët, rekomandimi i sipërcituar është i pazbatuar nga ana e DV ASHK Tiranë Jug, pasi në zbatim të pikës c neni 17 të Ligjit 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin...” i ndryshuar, citohet se pavarësisht funksionit të ndërtimit pa leje përcaktuar në pikën a dhe b të nenit 17, për shkak të përmasave ose planvendosjes së parcelës ndërtimore, krijohen sipërfaqe të lira që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me VKM. Kalimi i këtyre parcelave kryhet nëse poseduesi i ndërtimit pa leje shpreh vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim, ose në rastet ku kjo kërkesë nuk është paraqitur. Poseduesi i ndërtimit pa leje ka depozituar deklaratë noteriale se është dakort të paguaj me cmim tregu të gjithë sipërfaqen e parcelës që posedon.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Jug, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3 prot., datë 10.07.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Jug nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pazbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Jug, ka kualifikuar ndërtimin informal dhe ka miratuar lejen e legalizimit, pa pasur më parë një konfirmim nga Bashkia Tiranë, në lidhje me miratimin dhe realizimin e projektit “Rikualifikimi i Sheshit ‘Italia’”, Tiranë, si dhe pa pasur një konfirmim nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Këshilli Shkencor, në lidhje me zonat dhe objektet e shpallura me Status Mbrojte sipas ligjit, në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” dhe në kundërshtim me pikën 1/c të VKM-së nr. 280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtim pa leje”. Mbas 3 muajve nga miratimi i lejes së ndërtimit, është miratuar Vendimi nr. 431, datë 26.6.2019 “Shpronësimi për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i Sheshit ‘Italia’”, Tiranë, në shumën e përgjithshme 107,402,334 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën A/3, nga faqe 17 deri në faqe 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të marrë masa në vijimësi, për të gjitha rastet për përjashtim nga legalizimi, ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje që cenojnë veprat kryesore të infrastrukturës publike, akset rrugore kombëtare, territorin e institucioneve publike, integritetin e monumenteve të kulturës etj.

Në vijimësi

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: Shqyrtimi i fakteve dhe argumentave ligjorë të dërguara në observacion për praktikën në fjalë nxjerr në përfundimin se nuk është shkelur asnjë ligj apo akt nënligjor. Veprimtaria e DV ASHK Tiranë Jug është në përputhje të plotë me kriteret dhe procedurat e kërkuara nga ligji, fakt i cili vërtetohet edhe nga vendimi i formës prerë të datës 16.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vendimin nr. 10, datë 14.01.2014 të Gjykatës së Lartë. DV ASHK Tiranë Jug vijon trajtimin e praktikave të legalizimit në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Koment nga grupi i auditimit: Referuar komentit, rekomandimi nuk mund të konsiderohet i zbatuar, pasi DV ASHK Tirana Jug në përgjigjen e saj nuk ka paraqitur masa konkrete të marra në vijimësi, në përputhje me rekomandimin e auditimit. Deklarimi se “nuk është shkelur asnjë ligj apo akt nënligjor” dhe referimi te vendimet gjyqësore lidhet me një rast të vetëm të

shqyrtuar dhe nuk përbën përgjigje mbi zbatimin në përgjithësi të rekomandimit për rastet e ngjashme në të ardhmen.

Statusi: I Pazbatuar

5. Gjetje nga auditimi: ALUIZNI-t Tirana Jug ka miratuar me vendim nr. 122082, datë 03.06.2019 për leje legalizimi për objektin: “*Godinë shërbimi 1 kat*”, me posedues B. D., ZK 8180, nr. pasurie 1/894, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 500 m², me sipërfaqe ndërtimi 151.8 m², ku provohet se objekti është ndërtuar përpara datës 10.08.1991 dhe i regjistruar në volumin 32, faqe 141, me sipërfaqe 135.7 m², çfarë do të thotë se objektet e ndërtuara para vitit 1991 dhe i regjistruar nuk konsiderohen ndërtime informale që të përfshihet në procedurat e legalizimit, veprime këto në kundërshtim me pikën 1 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”, i ndryshuar. Rezulton e provuar ekzistenca e ndërtimit me sipërfaqe ndërtimi 151m², nisur nga Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit edhe fotografimi ajror, sipas radhës, duke filluar nga ai i vitit 1994 e deri në vitet 1999, 2001 dhe në fund, atë të vitit 2007. (*Më hollësisht trajtuar në pikën A/3, nga faqe 20 deri në faqe 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Të gjithë ndërtimet që janë të ndërtuara para datës 10.08.1991 të mos konsiderohen ndërtime informale dhe të mos përfshihet në procedurat e legalizimit, por DV ASHK Tirana Jug të miratoj kërkesat për kalimin e pronësisë të objektit pa titull pronësie me truallin funksional dhe oborret në përdorim për ndërtimet të ndërtuara para datës 10.08.1991.

Në vijimësi

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: *Ashtu sikurse është sqaruar në observacionin e dërguar mbi subjektin vetëdeklarues B. D. është trajtuar nga ALUIZNI Tirana Jug me legalizim të ndërtimit pa leje dhe jo si ndërtim përpara datës 10.08.1991 pasi vetë subjekti ka depozituar deklaratë personale në të cilën shpreh se objektin e vjetër e ka prishur dhe mbi të ka ndërtuar një objekt të ri pa leje të cilin e ka deklaruar për legalizim në vitin 2014. DV ASHK Tirana Jug trajton në vijim praktikën e administruara sipas rekomandimit të sipërcituar.*

Koment nga grupi i auditimit: Për shkak të numrit të lartë të aplikimeve për legalizim të objekteve informale, si dhe problematikave të sistemit, numri i aplikimeve për legalizim, për objekte të ndërtuar para datës 10.08.1991 ka qenë i ulët. Për këtë arsye, grupi i auditimit nuk mund të shprehet nëse ky rekomandim është zbatuar në vijimësi ose jo. Si rrjedhim, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: Zbatuar pjesërisht

6. Gjetje nga auditimi: Në 5 raste (lejet e legalizimit me: nr. 2625593, datë 21.02.2019; nr. 127080, datë 24.11.2020; nr. 24768, datë 22.11.2019; nr. 123162, datë 10.07.2019; nr. 124704, datë 25.9.2019), DV ASHK Tirana Jug ka legalizuar ndërtimet informal të ndërtuar me konstrukcion metalik me materiale provizore të paqëndrueshme (me vetratë xhami duralumin nga tre anët e objektit) dhe jo të lidhura me sistemin e tokës (themelet), ku struktura nuk plotëson kushtet për regjistrim, në kundërshtim me pikën 1, shkronja “b” të VKM-së nr. 280, datë 01.04.2015 “*Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtim pa leje*”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën A/3, nga faqe 20 deri në faqe 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrisë kontrollin administrativ dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e vendimeve të legalizimit nr. 2625593, datë 21.02.2019; nr. 127080, datë 24.11.2020; nr. 24768, datë 22.11.2019; nr. 123162, datë 10.07.2019 dhe lejes së legalizimit nr. 124704, datë 25.09.2019.

Gjithashtu për pasurinë e regjistruar sipas këtyre vendimeve të merret masë për të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procedurave të vlerësimit për shfuqizimin e vendimit.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: Rekomandimi mbi shfuqizimin e lejeve të legalizimit nuk është zbatuar nga DV ASHK Tiranë Jug pasi subjektet kanë depozituar akt ekspertiza mbi qëndrueshmërinë e ndërtimeve pa leje respektive nga ekspert të licensuar për qëndrueshmërinë konstruktive të ndërtimeve pa leje. Pasi janë pajisur me leje legalizimi subjektet poseduese të ndërtimeve pa leje kanë vijuar me rregjistrimin e pasurive në rregjistrat e pasurive të paluajtshme.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Jug, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3 prot., datë 10.07.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Jug nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pazbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast (Vendimi nr. 48, datë 26.01.2021) është legalizuar pjesërisht një objekt jashtë afatit, me pretendimin se sipërfaqja e legalizuar e objektit është në ortofoton e vitit 2015 në geoportalin ASIG, por nga verifikimi i imazheve të këtij objekti në Google Earth rezulton se në vitin 2016 objekti ka qenë provizor, i ndërtuar me dru, kallama dhe llamarinë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën A/3, nga faqe 20 deri në faqe 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrisë kontrollin administrativ dhe në referencë të akteve ligjore e nënljgore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e Vendimit të Legalizimit nr. 48, datë 26.01.2021. Gjithashtu për pasurinë e regjistruar sipas këtij vendimi të merret masë për të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procedurave të vlerësimit për shfuqizimin e vendimit.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: Ashtu sikurse është sqaruar në observacionin e dërguar rekomandimi mbi shfuqizimin e Vendimit nr. 48, datë 26.01.2021 për legalizimin e ndërtimit pa leje, nuk është kryer pasi nuk i është nënshtruar i gjithë objekti procedurave të legalizimit sipas proces verbalit të konstatimit të terren, por planimetria është punuar më e vogël se matjet faktike pasi është përfshirë vetëm konstruksioni me blloqe betoni i qëndrueshëm dhe nuk është përfshirë në legalizim pjesën me konstruksion druri të objektit. Parcela ndërtimore është punuar në tejkallim të trefishit të bazës pasi objekti faktik me konstruksionin e drurit është më i madh dhe parcela është shfrytëzuar në funksion të objektit të shërbimit, kjo sipas pikës 3/b të nenit 22 të Ligjit 20/2020 se 3-fishin e bazës së objektit pa përcaktuar kufi 500 m² pasi, për objekte me bazë 3-fishi i të cilave e kalon sipërfaqen 500m² drejtoria vendore ka të drejtë ta punojë sipas gjendjes faktike edhe pse parcela mund ta tejkalojë sipërfaqen 500 m². Gjithashtu në bazë të pikës 3/c neni 22 të ligjit 20/2020 citohet se, kur për shkak të përmasave ose planvendosjes së parcelës ndërtimore krijohën sipërfaqe të lira që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, miratuar me VKM. Përsa i përket imazheve dixhitale të Google Earth jo gjithmonë japin fotografime të qarta ndaj për këtë arsye verifikimet nga sektori përkatës kryhen në bazë të Geoportalit ASIG në të cilin duket qartë egzistenca e mbulesës së objektit. Në dosjen fizike administrohet gjithashtu deklaratë personale sipas sipas nenit 27, të ligjit 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar,

në të cilën poseduesi mer përsipër përgjegjësinë për cilësinë e punimeve të kryera në objekt si dhe cdo pasojë që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Subjekti ka vijuar me rregjistrimin e pasurisë në rregjistrin e pasurive të paluajtshme.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Jug, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3 prot., datë 10.07.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Jug nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pazbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se në shumicën e rasteve të shqyrtuara, procesverbalet e verifikimit në terren nuk janë plotësuar saktësisht në të gjithë elementët që parashikon formati i miratuar. Konkretisht në paragrafin e pasurive kufitare, nuk janë saktësuar me përshkrim, numër pasurie dhe identitet të pronarit, pasuritë kufitare, por janë përdorur vetëm numrat e pasurive, si dhe nuk janë pasqyruar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Manualin “*Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike të objektit që legalizohet*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 “*Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën A/3, nga faqe 20 deri në faqe 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të marrë masa që në vijim të plotësojë “*Proces verbalin e verifikimit në terren të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje*”, me të dhënat e kërkuara edhe me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij. Për rastet kur këto të dhëna identifikohen si numra pasurie, të bëhet verifikimi në sistemet apo hartat e DV ASHK për plotësimin e saktë të kufitarëve.

Në vijimësi

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: DV ASHK Tirana Jug bazuar në rekomandimin e sipërcituar ka vijuar dhe është në proces të plotësimit të gjithë të dhënave në proces verbalit e verifikimit në terren.

Koment nga grupi i auditimit: Për shkak të numrit të lartë të aplikimeve për legalizim të objekteve informale, si dhe problematikave të sistemit, numri i aplikimeve të shqyrtuara ka qenë i ulët. Për këtë arsye, grupi i auditimit nuk mund të shprehet nëse ky rekomandim është zbatuar në vijimësi ose jo. Si rrjedhim, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: Zbatuar pjesërisht

12. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast objekti ndodhet shumë pranë rrjetit rrugor të kategorisë D, ndërkohë që ka ngritur mure rrethues buzë trotuarit, elementë të cilët nuk janë pasqyruar nga specialistët e verifikimit në terren, as në procesverbal dhe as në skicat e hartuara. Nga matjet e kryera në hartën ASIG, rezulton se objekti nuk respekton distancën prej të paktën 20 m për këtë kategori rruge.

Po kështu, në 1 rast konstatohet se është vijuar me procesin e legalizimit të objektit informal edhe pse me shkresën nr. 6798/1, datë 18.02.2019, titullari i Drejtorisë së Planifikimit të Punëve Publike pranë Bashkisë Tiranë, informon DV ASHK Tirana Jug se për zonën në fjalë dhe koordinatave të objektit, kjo Bashki ka miratuar projektin me objekt “*Ndërtimi i rrugëve Fuat Toptani-3 Vëllezërit Kondi-rruga e Elbasanit-Varrezat e Dëshmorëve*”. Për këtë zonë, Bashkia Tiranë ka dërguar edhe Planin e Detajuar Vendor, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 46053, datë 13.12.2018, në paraqitjen grafike të të cilit evidentohet edhe vizualisht, prekja e këtij objekti nga rruga e projektuar. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me

nenin 27 të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të kodit rrugor të RSH”; Kreu I, pika gj) të VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”. (Më hollësisht trajtuar në pikën A/3, nga faqe 20 deri në faqe 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK, të fillojë kontrollin administrativ, duke proceduar me anulimin e lejeve të legalizimit nr. 124633, datë 14.08.2019, për pasurinë nr. 400/1277 në ZK 8190 dhe lejen e legalizimit nr. 122544, datë 22.07.2019, për pasurinë nr. 11/585, në ZK 8190.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: DV ASHK Tirana Jug nuk mund të vijojë me anulimin e lejeve të legalizimit, ndodhur në kushtet se këto akte janë rregjistruar në rregjistrin e pasurive të paluajtshme dhe janë pajisur me certifikatë pronësie.

Koment nga grupi i auditimit: DV ASHK Tirana Jug nuk ka marrë asnjë masë për të rakorduar/bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK, për fillimin e kontrollit administrative, për të proceduar me anulimin e lejeve të legalizimit me nr. 124633, datë 14.08.2019, për pasurinë nr. 400/1277 në ZK 8190 dhe lejen e legalizimit nr. 122544, datë 22.07.2019, për pasurinë nr. 11/585, në ZK 8190.

Statusi: I pazbatuar

14. Gjetje nga auditimi: DV ASHK Tirana Jug në të gjitha rastet gjatë procedurave të kualifikimit, ka tejkalar çdo afat ligjor nga miratimi i “Kualifikimit i ndërtimit informal” deri në momentin e dhënies së lejes së legalizimit, në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 21 të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën A/3, nga faqe 20 deri në faqe 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, të marrë masa, që për çdo rast moskualifikimi, ose kualifikimi për legalizim, të dalë me vendim për legalizimin ose jo të ndërtimit pa leje, brenda afatin ligjor.

Në vijimësi

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: DV ASHK Tirana Jug, ka trajtuar dhe ka dalë me vendim për praktikën të cilat kanë kualifikim ose moskualifikim dhe është në proces përmblylje të këtyre praktikave të cilat administrohen në arkivën fizike.

Koment nga grupi i auditimit: Për shkak të numrit të lartë të aplikimeve për legalizim të objekteve informale, si dhe problematikave të sistemit, numri i aplikimeve të shqyrtuara ka qenë i ulët. Për këtë arsye, grupi i auditimit nuk mund të shprehet nëse ky rekomandim është zbatuar në vijimësi ose jo. Si rrjedhim, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: Zbatuar pjesërisht

15. Gjetje nga auditimi: Me deklaratën e datës 06.09.2006, protokolluar pranë Njesisë së Urbanistikës së NjQV nr. 2 dhe me nënshkrimin e përfaqësuesit të NjQV, F. B. deklaroi se ka kryer shtesë kati 35 m² mbi objektin e ndërtuar me leje ndërtimi miratuar me Vendim të KRRT nr. 47, datë 29.04.1991. Vendim i cili i referohet legalizimit të objektit dhe jo shtesës, në një kohë që objekti ka qenë ekzistues dhe me titull pronësie regjistruar në Regjistrin Hipotekor në vitin 1993. Ky fakt pasqyrohet edhe në genplanin e hartuar DV ASHK, i cili në mënyrë grafike pasqyron legalizimin për të gjithë objektin prej 121.5 m², ndërkohë që shtesa është vetëm 35 m². Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për

legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar; VKM nr. 442, datë 18.07.2018 “Për kalimin në pronësi të objektit të ngritur para datës 10.08.1991 dhe truallit të tij funksional”. (Më hollësisht trajtuar në pikën A/4, nga faqe 65 deri në faqe 74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug, të marrë masa për anulimin e legalizimit me Vendim nr. 269, datë 16.03.2021, duke ri shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës dhe qartësuar faktin nëse pjesa ekzistuese e objektit me leje ndërtimi i takon legalizimit sipas VKM nr. 442, datë 18.07.2018 “Për kalimin në pronësi të objektit të ngritur para datës 10.08.1991 dhe truallit të tij funksional” dhe në përfundim të vijojë me procedurat e legalizimit vetëm për shtesën mbi objekt me leje.

Brenda 30.05.2023

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: Ashtu sikurse është sqaruar në observacionin e dërguar rekomandimi mbi anulimin e lejes së legalizimit në favor të subjektit F. B. nuk është kryer pasi subjekti ka plotësuar vetëdeklarimin në vitin 2014 duke cekuar të treja opsionet të pasqyruara në deklaratë, përkatësisht objekt, shtesë në lartësi dhe shtesë anësore. Nga informacioni i gjendjes juridike të parcelës rezulton “Truall” në pronësi “Shtet” pa objekt të rregjistruar ndaj DV ASHK Tiranë Jug nuk mund të vijojë me anulimin e lejes së legalizimit pasi nuk ka informacion teknik ose juridik për objekt të ndërtuar me leje ndërtimi dhe nuk figuron e pajisur me certifikatë pronësie ndaj ka trajtuar të gjithë objektin duke e përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit 20/2020.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Jug, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3 prot., datë 10.07.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Jug nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pazbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste nga DV ASHK Tirana Jug, janë marrë vendime “Për miratimin e kërkesës për kalimin e pronësisë të objektit pa titull pronësie me truallin funksional”, ku ndërtimet janë të ndërtuara mbas datës 10.08.1991, në kundërshtim me nenin 4, pika 14 të ligjit 20/20 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe konkretisht, vendimi nr. 40, datë 29.05.2020 në emër të poseduesit z. T. Gj., me sipërfaqe e truallit funksional 227.8 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 45.5 m² pasuria nr. 6/419 ZK 8260 dhe vendimi nr. 131, datë 05.02.2021 në emër të poseduesit I. L., me sipërfaqe e truallit funksional 141 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 42 m² ZK 8260. (Më hollësisht trajtuar në pikën A/4, nga faqe 65 deri në faqe 74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrorë kontrollin administrativ dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e vendimit nr. 40, datë 29.05.2020 dhe nr. 131, datë 05.02.2021. Gjithashtu për pasurinë e regjistruar sipas këtij vendimi të merret masë për të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procedurave të vlerësimit për shfuqizimin e vendimit.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: Përsa i përket vendimit nr. 40, datë 29.05.2020 në emër të poseduesit T. Gj. dhe vendimit nr. 131, datë 05.02.2021 në emër të poseduesit I. L. nuk është vijuar me anulim pasi çështja është duke u shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit dhe ende nuk ka marrë formë të prere. Mbi vendimet e poseduesve T. Gj. dhe I. L. është vijuar konfort pikës 20 të VKM-së 827/2020 ku nëpërmjet hartave të vëna në dispozicion nga AQTN provohet se objektet janë ndërtuar përpara vitit 1991.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Jug, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3 prot., datë 10.07.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Jug nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pazbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Në 5 raste nga DV ASHK Tirana Jug janë marrë vendime për miratimin e kërkesës për kalimin e pronësisë të objektit pa titull pronësie me truallin funksional, ku në dosje nuk janë administruar kërkesa për publikimin e aplikimeve, kthim përgjigje nga Njësia Bashkiake mbi mbarimin e afishimit, kërkesa drejtuar poseduesit të ndërtimit për regjistrim të lejes së regjistrimit e pasurive të paluajtshme, veprime këto në kundërshtim me Urdhrin nr. 37, datë 19.06.2016 “*Për miratimin e planveprimit...*”, si dhe për 2 raste janë shkelur afatet për kërkimin e informacioneve duke shkelur afatet e përcaktuara për kryerjen e veprimeve. (*Më hollësisht trajtuar në pikën A/4, nga faqe 65 deri në faqe 74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

17.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të plotësojë 5 dosjet me mungesë të dokumenteve që duhej të ishin administruar në dosje. Si dhe të marrë masa për mirë organizimin e grupeve të punës në funksion të përballimit të fluksit të aplikimeve sipas afateve dhe prioriteteve të secilës hallkë të procedurave të ndjekura deri në përmbylljen e regjistrimit të pronësisë, duke shmangur zvarritjen e procesit.

Menjëherë në vijimësi

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: *Mbi 5 rastet e konstatuara se nga DV ASHK Tirana Jug janë marrë vendime për miratimin e kërkesës për kalimin e pronësisë të objektit pa titull pronësie me truall funksional dhe në dosje nuk është administruar dokumentacioni i nevojshëm, është sqaruar në observacion se dokumentacioni i administruar është i plotë.*

Koment nga grupi i auditimit: Referuar komentit, rekomandimi nuk mund të konsiderohet i zbatuar plotësisht, pasi mungon dokumentimi i plotësimi të dosjeve. DV ASHK Tirana Jug pretendon në mënyrë të përgjithshme se “dokumentacioni është i plotë”, por nuk ka paraqitur prova konkrete që vërtetojnë plotësimin e pesë dosjeve me dokumentacionin që ishte identifikuar si i munguar (si: kërkesa për publikim, vërtetimi i afishimit, kërkesa për regjistrim të lejes, etj.). Në mungesë të këtyre provave, pjesa e parë e rekomandimit nuk mund të konsiderohet e zbatuar. Në lidhje me pjesën e dytë të rekomandimit, që kërkon marrjen e masave për përmirësimin e organizimit të grupeve të punës dhe respektimin e afateve, nuk është raportuar asnjë masë konkrete (si riorganizim strukturor, përmirësim të fluksit, rishpërndarje ngarkesash, hartim planveprimi apo urdhër të brendshëm për menaxhimin e afateve). Për rrjedhojë, kjo pjesë e rekomandimit nuk është zbatuar. Nga sa më sipër, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: Zbatuar pjesërisht

19. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 257, datë 05.11.2018, S. M. ka paraqitur kërkesën për kalimin e pronësisë së objektit të ndërtuar para datës 10.08.1991, së bashku me truallin funksional, të ndodhur në pasurinë nr. 2/307/2 në ZK 8190. Në dosje administrohet fotokopje e dokumentit “Vërtetim pronësie” i datës 24.02.1977, në favor të R. M. (bashkëshorti i aplikantes, referuar certifikatës familjare), i cili bën fjalë për një shtëpi në rrugën Mihal Grameno. Nga auditimi rezulton se certifikata familjare përmban përbërjen familjare të datës 31.12.2009 me kryefamiljar R. M., ndërkohë që Vendimi nr. 49, datë 13.07.2020 për kalimin në pronësi të objektit dhe truallit funksional është bërë vetëm në emër të aplikantes S. M.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me pikën 16 të VKM nr. 442, datë 18.07.2018 “Për kalimin në pronësi të objektit të ngritur para datës 10.08.1991 dhe truallit të tij funksional”. (Më hollësisht trajtuar në pikën A/4, nga faqe 65 deri në faqe 74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të marrë masa për rishqyrtimin e dokumentacionit dhe certifikatës familjare për rastin e S. M., duke anuluar Vendimin nr. 49, datë 13.07.2020 për kalimin në pronësi të objektit vetëm ndaj aplikantes dhe marrjen e Vendimit në zbatim të regjimit pasuror martesor.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: Vendimi nr. 49, datë 13.07.2020 është emetuar në bazë të VKM-së nr. 442 e cila nuk e përcakton vendosjen e bashkëshortit/es përfitues në vendim. Vendimi jepet në mbështetje të dispozitave të Kodit të Familjes për regjimet martesore.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Jug, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3 prot., datë 10.07.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Jug nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pazbatuar

20. Gjetje nga auditimi: Pasuria nr. 3/527 në pronësi “Shtet” regjistruar në vol. 34, faqe 126 me sipërfaqe 86 m² e miratuar si parcelë ndërtimore në emër të subjektit A. G., e regjistruar si bashkim pasurie në pasurinë nr. 3/360, volumi 43, faqe 121, është tej kufirit ligjor të sipërfaqes së parcelës ndërtimore, duke tejkaluar kufirin ligjor të sipërfaqes së parcelës ndërtimore mbi 3-fishin e sipërfaqes bazë të ndërtimit, në kundërshtim me nenin 17, pika 1/b të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën B/3, në faqe 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, me urdhër të brendshëm të urdhërojë sektorin e kadastrës, kthimin në gjendjen e mëparshëm pasurinë nr. 3/527, regjistruar në vol. 34, faqe 126, me sipërfaqe 86 m² ZK 8180. në pronësi “Shtet”.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: Në zbatim të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, një pasuri në pronësi shtet e cila kalon në pronësi të një subjekti përfitues nëpërmjet leje legalizimi dhe më tej e rregjistruar në rregjistrin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të kthehet në gjendjen e mëparshme, vecanërisht nëse për të administrohet Vendim Gjykatë i formës së prerë.

Koment nga grupi i auditimit: Në zbatimin e këtij rekomandimi, Drejtori i DV ASHK Tirana Jug nuk ka marrë asnjë masë dhe nuk ka nxjerrë asnjë urdhër, drejtuar sektorit të kadastrës, për kthimin në gjendjen e mëparshme të pasurisë nr. 3/527, regjistruar në vol. 34, faqe 126, me sipërfaqe 86 m² ZK 8180. në pronësi “Shtet”.

Statusi: I pazbatuar

23. Gjetje nga auditimi: Në 7 raste nga punonjësit e Sektorit të Kadastrës pranë DV ASHK-së, janë tejkaluar afatet ligjore për shërbimet kadastrale edhe pse dokumentacioni tekniko-ligjor në dosjen e aplikuesit janë në përputhje të plotë me kërkesat e parashikuara në ligji, veprime këto në kundërshtim me pikën 3 të nenit 29 ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”. (Më hollësisht trajtuar në pikën B/6, nga faqe 93 deri në faqe 99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1. Rekomandimi: Drejtorja Vendore ASHK Tirana Jug, të marrë masa për mirë organizimin e detyrave sipas sektorëve, për administrimin, trajtimin dhe dhënien e zgjidhjeve apo përgjigjeve ndaj kërkesave të qytetarëve brenda afateve të parashikuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: DV ASHK Tiranë Jug i ka dhënë prioritet kërkesave të administruara nga qytetarët brenda afateve të parashikuara duke dhënë shërbimin e kërkuar.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi i bërë në DV ASHK Tirana Jug, në prani të punonjësit znj. G. D., rezulton se kjo Drejtori i është referuar këtij rekomandimi, duke i dhënë prioritet kërkesave të administruara nga qytetarët brenda afateve të parashikuara, duke ju dhënë shërbimin e kërkuar.

Statusi: Zbatuar

24. Gjetje nga auditimi: Rreth 30% të rasteve, dokumentacioni i referencave që janë skanuar nga sektori që mbulon arkivin e referencave, nuk janë transferuar në llogarinë File-Server 192.168.1.16, çfarë do të thotë se edhe auditimi i referenca për zbatimin e procedurave ligjore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ka qenë e pa mundur të realizohet nga grupi i auditimit.

24.1. Rekomandimi: Nga sektori i Kadastrës pranë DV ASHK-së, pas mbylljes të procedurës së regjistrimit për çdo kërkesë për shërbimet kadastrale, të behet skanimi i gjithë dokumentacionit dhe të transferohet në llogarinë File - Server 192.168.1.16.

Në vijimësi

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: Nga DV ASHK- Tiranë Jug, është vijuar me caktimin e punonjësve përgjegjës për skanimin e referencave të mbetura pa transferuar në llogarinë File-Server 192.168.1.16.

Koment nga grupi i auditimit: Rezulton se punohet për skanimin e referencave, por procesi vazhdon dhe nuk është përfunduar akoma.

Statusi: Në proces zbatimi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje për procedurat e ndjekura për regjistrimin e objekteve me leje legalizimi në ZK 8190, rezultuan mangësi në dosjet e trajtuara si vijon: Në të gjitha rastet inventari i dosjes nuk përmban nënshkrimin e arkivistit apo marrësit në dorëzim të inventarit dhe as të titullarit të DV ASHK;

Në 6 raste, për dosjet e kaluara nga sektori i legalizimit tek ai i regjistrimit, nuk administrohen në dosje shkresa e dërgimit të dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim dhe as certifikata e gjendjes familjare të poseduesit;

Në 2 raste, veprimet në kartelat e pasurive kur ka lindur nevoja për ndarje pasurie nga procesi i legalizimit, janë kryer pa dalë fillimisht Urdheri përkatës i titullarit, për ndarjen e pasurive dhe mënyrën si do të vepohet. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me pikën 10 të VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës ndërmjet ALUIZNIT dhe ZVRPP dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”; Rregullore e Brendshme e funksionimit; “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën B/6, nga faqe 93 deri në faqe 99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1. Rekomandimi: Në funksion të garantimit të transparencës, Titullari i DV ASHK dhe specialistët përkatës, të marrin masa për përmbushjen e të gjithë hallkave hierarkike konfirmuese për mbylljen dhe inventarizimin e dosjeve që trajtohen, si dhe përcjelljen e tyre në vijim nëpërmjet shkresave përcjellëse përkatëse nga titullari dhe dokumentacionit të plotë që kërkohet nga kuadri ligjor, duke bërë të mundur kështu edhe evidentimin e afateve të dërgimit dhe punimit të dosjeve nga një sektor në tjetrin.

Në vijimësi

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: DV ASHK Tiranë Jug i ka dhënë prioritet rekomandimit të sipërcituar dhe është vijuar me plotësimin e dokumentacionit i cili rezulton në mungesë në

praktikat e konstatuara dhe është hartuar urdhër nr. 410, datë 07.04.2025, mbi caktimin e punonjësve përgjegjës për monitorimin dhe realizimin nga ana teknike të procesit të inventarizimit dhe arshivimit.

Koment nga grupi i auditimit: DV ASHK Tirana Jug, ka vijuar me zbatimin e këtij rekomandimi, duke hartuar edhe urdhrin përkatës dhe punohet për plotësimin e dokumentacionit për procesin e inventarizimit dhe arshivimit.

Statusi: Në proces zbatimi

26. Gjetje nga auditimi: Me Urdhër të brendshëm nr. 177, datë 03.05.2007 të ish-Regjistruarit është korigjuar sipërfaqja nga 717 m² “Përrua” me nr. pasurie 5/140 regjistruar në vol.16, faqe 110, në sipërfaqe 156 m² (përrua) ZK 8160, Nga korigjimi i kufijve dhe i sipërfaqes me urdhrin e sipër cituar, pasuria nr. 5/155 me sip. trualli 900 m² regjistruar në vol.16, faqe 123, behet me sip. trualli 2215 m², në emër të z. I. S., veprim ky në kundërshtim me nenin 24/a të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar dhe në kundërshtim me pikën 9.2 të Kreut IV, të Rregullores së Brendshme të Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme Nr. 184, datë 08.04.1999. (Më hollësisht trajtuar në pikën C, nga faqe 102 deri në faqe 112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

26.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tiranë Jug, të nxjerrë urdhër të brendshëm “Për korigjimin e hartës kadastrale dhe kartelës së pasurisë së paluajtshme”, për pasurinë nr. 5/155 me sip.trualli 2215 m², regjistruar në vol.16, faqe 123, në dy pasuri, njëra pasuri me sipërfaqe 717 m² në llojin e pasurisë “Përrua” në pronësi “Shtet” dhe sipërfaqja tjetër prej 1498 m² në llojin e pasurisë “Truall” të kaloj në pronësi të “Të tretëve”.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: Mbi Urdhërin nr. 177 dt.03.05.2007, për korigjimin e kufijve dhe sipërfaqen e pasurive ku ndër të tjera për pasuritë nr. 5/14 dhe nr. 5/155. Sqarojmë se me urdhërin nr. 145 datë 11.04.1997 pasuria nr. 5/155 ka kaluar në favor të shtetit. Me referencën nr. 7481 është kaluar në emër të L. R., dhe me kontratën nr. 2615/122 datë 15.07.2004 ka kaluar në emër të blerësit I. S. Me referencën 16639 datë 01.12.2016 ka vijuar me regjistrimin e kontratës nr. 187/121 datë 17.11.2016 në favor të I. S. dhe A. C. Me referencën nr. 16922 datë 26.01.2017 është regjistruar kontrata e shitjes nr. 202/123 datë 18.11.2016 në emër të bashkëpronarëve I. S., A. C. dhe F. S. Ndodhur në këto kushte duke qenë se janë kryer disa transaksione ndër vite, pasuria nuk mund të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Jug, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3 prot., datë 10.07.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Jug nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pazbatuar

29. Gjetje nga auditimi: Në DV ASHK Tiranë Jug ka parcela ndërtimore të objekteve informale të pajisur me leje legalizimi të cilat janë akoma në pritje të VKM ku nuk kanë likuiduar taksën e parcelave ndërtimore, në vlerë 323,212,164.91 lekë + bono privatizimi.

29.1. Rekomandimi: DV ASHK Tiranë Jug në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për dosjet e objekteve informale të pajisur me leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin të vlerës përkatëse të parcelave ndërtimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment nga DV ASHK Tirana Jug: *DV ASHK Tiranë Jug ka marrë masa dhe është në proces duke trajtuar të gjitha dosjet e administruara në arkivën fizike për të cilat nuk është hartuar materiali tekniko ligjor për shpronësimin e pronarëve dhe kalimin e pronësisë në favor të përfituesve të objekteve të legalizuara.*

Koment nga grupi i auditimit: DV ASHK Tirana Jug vijon me trajtimin e dosjeve në arkivën fizike për dosjet e objekteve informale të pajisur me leje legalizimi të objektit, çështje që vijnë në proces, sipas rasteve të administruara.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nuk janë rekomanduar masa për shpërblim dëmi ekonomik, si rrjedhojë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar.

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nuk janë rekomanduar masa për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet, si rrjedhojë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar.

2.6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Në total, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar 18 masa disiplinore, nga të cilat: *“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”* për 12 punonjës; *“Zgjidhje të kontratës së punës”*, për 6 punonjës si më poshtë vijon:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, Kreun IV, neni 11, gërma d) dhe e), nenet 37, 144, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, shfuqizuar me ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 *“Për Kadastrën”* dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë: *“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”* për 12 punonjës; *“Zgjidhje të kontratës së punës”*, për 6 punonjës

Komenti i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DP ASHK nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Statusi: Pa zbatuar

Tabela nr. 2: Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Lloji i masës	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	20	1	5	2	12
Disiplinore	18	-	-	-	18
Totali	38	1	5	2	30

Burimi i të dhënave: DV ASHK Tirana Jug

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, janë paraqitur observacionet e dërguara nga DV ASHK Tirana Jug me shkresën me nr. 2916/4 prot., datë 30.12.2025 dhe nr. 7900/2 prot., datë 30.12.2025, administruara në KLSH me nr. 421/17 prot., datë 05.01.2026 dhe nr. 421/18 prot., datë 05.01.2026.

Pretendimet e subjektit dhe qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i pretendimeve të paraqitura mbi Projekt Raportin e Auditimit rezulton se observacionet e dërguara nuk kanë të bëjnë me ecurinë e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve dërguar me shkresën nr. 421/7 prot., datë 27.11.2025. Konstatohet se qëndrimet e paraqitura lidhen me akt-konstatime të cilat nuk janë mbajtur nga grupi i auditimit për zbatimin e rekomandimeve, ndërkohë që qëndrimi juaj nuk është mbi statusin dhe ecurinë e rekomandimeve konkrete të paraqitura në PRA me shkresën e cituar më sipër.

Sa më lart, nuk janë paraqitur observacione që lidhen me ecurinë dhe statusin e rekomandimeve, për të cilat grupi i auditimit të vlerësojë dhe të mbajë një qëndrim nëse pranohen ose jo.

🚦 Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Tirana Veri:

2.1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, me nr. 651/23 prot., datë 10.05.2023, sipas Programit të Auditimit 651/1 prot., datë 18.07.2022, janë rekomanduar për zbatim 49 rekomandime gjithsej, nga këto: 21 rekomandime për masa organizative, 4 rekomandime për përdorim e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet, si dhe janë rekomanduar masa disiplinore për 24 punonjës.

Në vijim, nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 908/17 prot., datë 04.03.2025, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2023, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri”, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024, nga i cili është konstatuar se:

- Masa organizative: Është rikërkuar zbatimi i 18 masave organizative, nga të cilat janë pranuar të 18 masa, nga ku 10 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 8 rekomandime rezultojnë të pazbatuara;

- Masa për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet: është rikërkuar zbatimi i 4 rekomandime, nga të cilat nuk është zbatuar asnjë;

- Masa disiplinore: Janë rekomanduar në total 24 masa, nga të cilat masa disiplinore “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 5 punonjës; “Vërejtje” për 19 punonjës, të cilat rezultojnë të pazbatuara.

Në vijim, në mënyrë të përmbledhur është paraqitur ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, referuar auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri”, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024:

Tabela nr. 1: Statusi i zbatimit të rekomandimeve, referuar auditimit me nr. 908/3, datë 10.07.2024

Lloji i masës	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	18	-	10	-	8
3E	4	-	-	-	4
Disiplinore	24	-	-	-	24
Totali	46	-	10	-	36

Shënim: Vlera totale monetare e rekomandimeve (të cilat nuk janë zbatuar) për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e pronës publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të pronës publike është **51,185,500 lekë**.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, referuar raportit përfundimtar të auditimit me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri”, përcjellë me shkresën “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 908/17 prot., datë 04.03.2025, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, gërma j), ku cilësohet se:

KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Në lidhje me raportimin që DV ASHK Tirana Veri duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, ku cilësohet se:

Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

grupi i auditimit nuk mund të shprehet pasi jemi brenda afatit 6-mujor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit (dërguar me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 908/17 prot., datë 04.03.2025, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024, me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2023, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri”).

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësime ligjore, atëherë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, me nr. 651/23 prot., datë 10.05.2023, sipas Programit të Auditimit 651/1 prot., datë 18.07.2022, janë lënë për zbatim 21 rekomandime për masa organizative.

Referuar raportit përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri”, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 11.01.2024, është konstatuar se, nga 21 rekomandime për masa organizative, janë pranuar 21 prej tyre, nga ku:

- 3 rekomandime janë zbatuar;
- 11 rekomandime janë zbatuar pjesërisht;
- 7 rekomandime rezultojnë e pazbatuara.

Grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim rekomandimet për masat organizative të cilat janë zbatuar pjesërisht (njëmbëdhjetë rekomandime) dhe ato që nuk janë zbatuar (shtatë rekomandime), të cilat janë si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri (ish- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana Veri për periudhën objekt auditimi, janë lëshuar 5771 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Nga 2629 leje legalizimi të lëshuara, për parcela ndërtimore në total prej 602,019 m² lejet e legalizimit janë me shënimin “Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”, nisur nga çmimet e tokës truall për këto zona, sipas Vendimit të KM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe për sipërfaqet e parcelave ndërtimore, rezulton një shumë që duhej paguar prej subjekteve informale prej 1,169,541,626.7 lekë, nga të cilat **për parcela ndërtimore në total prej 198,282 m² nuk rezulton e paguar vlera prej 385,201,173.8 lekë.** Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17, pika 5, si dhe ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020. (Më hollësisht trajtuar në faqet 33-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për parcelat ndërtimore prej 198,282 m² të pajisur me leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin të vleftës përkatëse prej 385,201,173.8 lekë të parcelave ndërtimore.

Brenda datës 30.06.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
--

Statusi: I pazbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në 10 raste, dokumenti “Proces verbali i verifikimit në terren” dhe 3 raste “Akt evidentimi në terren i të dhënave të ndërtimit pa leje/shtesë në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë, vetëm me numrin pasurie pa përshkrim, duke mos përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës, ndërsa Skicat fushore pasqyrojnë përmasat e objektit informal. Veprime në

kundërshtim me Manualin “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen plan, planimetri)”. VKM nr. 1178, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 33-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri të marrë masa për 10 rastet e konstatuara e në vijim, për të plotësuar “Proces verbalin e verifikimit në terren të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, dhe 3 raste akt evidentimi në terren me të dhënat e kërkuara edhe me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij. Në rastin e mos plotësimit, të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë të Kadastrës Shtetërore për objektet informale të pajisura me leje legalizimi për të filluar procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit.

Menjëherë e në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
--

Statusi: I pazbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga ish Drejtoria Vendore Tirana Veri; në 7 raste, nuk është respektuar afati 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren veprim në kundërshtim me: pikën 8 të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 i ndryshuar, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar; VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”; në 4 raste nuk është respektuar **afati 30 ditor** për lëshimin e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit; në 2 raste: Vendimi për legalizimin me nr. 2462, datë 29.12.2021; Vendimi për legalizimin nr. 801, datë **09.04.2021, është marrë pa u evidentuar më pare ne terren** veprim në kundërshtim me legjislacionin në fuqi: VKM nr. 1178, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje” Kreu II Pika 5. (Më hollësisht trajtuar në faqet 33-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri të marrë masa dhe të përgatisë plane konkrete, për të shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas zonave informale dhe brenda afateve të përcaktuara ligjërisht, duke mundësuar afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë duke rritur edhe transparencën për publikun.

Në vijimësi

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
--

Statusi: I pazbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, rezultoi: Në 35 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi:

- Në 7 raste, janë kryer legalizime të objekteve sipas lejeve të legalizimit me: nr. 14233233, datë 21.09.2020; nr. 1233650, datë 27.10.2020; nr. 1233779, datë 26.11.2020; nr. 1231532, datë 24.10.2019; nr. 1233257, datë 22.09.2020; nr. 1231678, datë 27.11.2019; dhe vendimet

për legalizim: nr. 18043, datë 30.10.2020; nr. 689, datë 02.04.2021; **pa respektuar distancat nga rrugët dhe mbi rrugët e projektuara në Planin e Përgjithshëm Vendor**, në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 18 dhe VKM nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”; VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”; Vendimit të legalizimit nr. 689, datë 02.04.2021, rezulton se **objekti pjesërisht është ndërtuar me materiale të paqëndrueshme** dhe nuk është i lidhur pazgjydhshmërisht me tokën.

-**Në 4 raste**, janë kryer legalizime të objekteve sipas lejeve të legalizimit: nr. 1234089, datë 23.12.2020; nr. 1232708, datë 26.06.2020; nr. 1234113, datë 24.12.2020; nr. 1231159, datë 29.05.19; ku rezulton se objekti i legalizuar ndodhet brenda rrugës në studim, referuar PPV të Bashkisë Tiranë, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin nr. 1, datë 14.04.2017, i ndryshuar, ndërsa nuk ka asnjë shkresë apo konfirmimin nga Bashkia Tiranë.

- **Në 1 rast**, sipas lejes së legalizimit: nr. 1233318, datë 25.09.2020; është dhënë në zonën studimore në të cilën përfshihet dhe ndërtimi i legalizuar ku ka të përcaktuar: zonë “**IE Industri dhe Ekonomi**”, dhe ka të ndaluara ndërtime të tjera,

-**Në 1 rast**, sipas Vendimit të Legalizimit nr. 1566, datë 29.07.2021, rezulton se **është legalizuar kati i dytë i objektit, i cili rezulton i papërfunduar**.

-**Në 7 raste** është kryer legalizim i objektit informal sipas vendimit për legalizimin me: nr. 931, datë 16.04.2021, (Vendimi nr. 1822, datë 15.09.2021 për regjistrimin e bashkëpronarëve sipas aktit të trashëgimisë); nr. 53 datë 27.01.2021; nr. 1707, datë 03.08.2021; nr. 1574, datë 29.07.2021; nr. 1509, datë 27.07.2021; nr. 2259, datë 23.11.2021; nr. 2320, datë 09.12.2021; janë **përfshirë në procesin e legalizimit edhe objektet ekzistues**, është kryer legalizimi i objektit informal, ku referuar dokumentacionit gjendje në dosje dhe pamjeve nga ASIG, rezulton se është ndërtuar mbi objekt ekzistues, ndërsa nga aplikuesi nuk është bërë deklaratë për prishjen e objektit të mëparshëm. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 4.

- **Në 1 rast**, sipas vendimit të legalizimit nr. 1234206, datë 30.12.2020, rezulton se është legalizuar objekt me funksion social ekonomik, sipërfaqja e parcelës ndërtimore është miratuar më tepër se 3 fishi i bazës së objektit, duke miratuar më tepër sipërfaqen **552 m²** (1290 m²-738 m² (246*3), si dhe vendimi i legalizimit të miratuar nuk është afishuar paraprakisht në një ambient publik.

- **Në 9 raste** është kryer legalizim i objektit informal sipas lejeve të legalizimit me: nr. 1233093, datë 25.08.2020; nr. 1233652, datë 28.10.2020; nr. 1233630, datë 23.10.2020; nr. 1231861, datë 20.01.2020; nr. 17902, datë 16.09.2020; nr. 1412, datë 30.06.2021, nr. 2392, datë 21.12.2021; nr. 1271, datë 31.05.2021; nr. 1908, datë 21.12.2021. Sipas dokumentacionit disponibël në dosje, rezulton se objekti se objekti ndodhen **nën linjën e interkonjeksionit** dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte pezulluar dhe shkualifikuar për mos distancë nga linja. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar; Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016) “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”; VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.

- Në 2 rast është kryer legalizim i objektit informal në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 29 “Trajtimi i veçantë” konkretisht sipas:

- Lejes së legalizimit me nr. 1232237, datë 27.03.2020, ku objekti shtrihet në pasurinë nr. 1/1565, vol. 24, faqe 48 të ZK 8340 pronë private dhe për objektin informal në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte pezulluar dhe shkualifikuar për mos zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor miratuar me Vendimin KKT nr. 1, datë 23.10.2019 edhe në përputhje me Planin e Detajuar Vendor, pasi zona është e studiuar në Njësinë Strukturore TR/253, përcaktohen ndërtime me lartësi 18 m;

- Vendimit të legalizimit me nr. 1667, datë 19.08.2021, janë legalizuar 2 objekte, ku rezulton se objekti me sipërfaqe më të vogël (32.8 m²), ndodhet në zonë të përcaktuar për ndërtime 8 kate, ndërsa objekti ndodhet plotësisht në truall të tretëve.

- Në 2 raste, janë kryer legalizime të objekteve sipas vendimit të legalizimit nr. 1302, datë 03.06.2021 dhe vendimit të legalizimit nr. 1303 datë 03.06.2021, ku referuar dokumentacionit disponibël në dosje dhe referuar pamjeve të ASIG dhe Google Earth, rezulton se një pjesë e objektit të legalizuar me vendimin nr. 1303 (sipërfaqe 94 m²) dhe objekti 2 kat nëntokë legalizuar me vendimin nr. 1303, rezulton të jenë ndërtuar pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa pjesë e dosjes nuk ndodhet ndonjë dokument tjetër që saktësojë apo vërtetojë periudhën e ndërtimit të objektit. (Më hollësisht trajtuar në faqet 33-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrë masa të rivlerësojë procedurat e legalizimit për objektet informale të pajisura me leje legalizimi në 25 raste; lejet e legalizimit me nr. 14233233; datë 21.09.2020; nr. 1233650, datë 27.10.2020; nr. 1233779, datë 26.11.2020; nr. 1231532, datë 24.10.2019; nr. 1233257, datë 22.09.2020; nr. 1231678, datë 27.11.2019; nr. 18043, datë 30.10.2020; nr. 689, datë 02.04.2021; nr. 1234089, datë 23.12.2020; nr. 1232708, datë 26.06.2020; nr. 1234113, datë 24.12.2020; nr. 1231159, datë 29.05.2019; nr. 1566, datë 29.07.2021; nr. 931, datë 16.04.2021; nr. 53 datë 27.01.2021; nr. 1234206, datë 30.12.2020; nr. 1233093, datë 25.08.2020; nr. 1412, datë 30.06.2021; nr. 2392, datë 21.12.2021; nr. 1271, datë 31.05.2021; nr. 1908, datë 21.12.2021; nr. 1232237, datë 27.03.2020; nr. 1667 datë 19.08.2021; nr. 1302, datë 03.06.2021; nr. 1303 datë 03.06.2021. Në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi apo Vendimeve të legalizimit konstatuar të lëshuara me shkelje në 25 raste, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Deri më 30.09.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

4.2. Rekomandimi : Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa të njoftojë qytetarët përfitues të lejeve të legalizimit, për të paraqitur deklaratat e shembjes së objektit dhe plotësimin e dosjeve përkatëse. Gjithashtu në vijimësi të procedura e legalizimit ti referohet përcaktimeve në hartën e Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar.

Deri më 30.09.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, rezultoi; Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se:

- **Në 4 raste**, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi: Për periudhën objekt auditimi, është miratuar legalizimi i objekteve informale me vendim për legalizim me nr. 2454, datë 28.12.2021; Vendim për legalizim me nr. 2462, datë 29.12.2021; Vendim për legalizim me nr. 53 datë 27.01.2021; leje legalizimi me nr. 1230997, datë 31.01.2019; rezulton të jetë miratuar kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore me sipërfaqe mbi 3-fishin, dhe mbi 500 m², ku rezulton se duhet të miratohej kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore me sipërfaqe **më tepër për 659.4 m²**.

- **Në 7 raste** është miratuar legalizimi i objekteve informale (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”) dhe ka miratuar kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore për sipërfaqen totale prej 2764.1 m², ndërsa duke ju referuar kriterit të trefishit të sipërfaqes së bazës së objektit, duhet të miratohej sipërfaqja totale prej 1408.5 m², veprime që kanë sjellë përfitim të padrejtë nga zotëruesit e lejeve të legalizimit përkatëse, për **sipërfaqen totale prej 1355.6 m²** [2764.1(sip. e miratuar)-1408.5(sip. takuese)]. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17, pika 1, ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 22, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në faqet 33-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfituar më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme (sipas 4 Vendimeve të legalizimit dhe tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”, në 7 raste).

Brenda datës 30.09.20234

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit, rezultoi se, sipas vendimit nr. 17717, datë 15.06.2020 “Për kualifikimin për legalizim të objektit me leje ndërtimi në posedim “U. ShPK. + Lista e bashkëpronarëve”, është kryer legalizimi i shtesës në objekt me leje ndërtimi, nga ku u konstatua se: Nga rakordimi i pagesave për taksën e infrastrukturës me listën e dërguar nga Drejtoria Vendore Tirana Veri konstatohet se nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave e Tarifave vendore Bashkia Tiranë nuk është llogaritur e arkëtuar taksa e infrastrukturës për 1,703.85 m² ndërtim, përkatësisht për 9 njësi, për rreth 273,570 lekë (1703.85 m² x 32,112 lekë/m² Kosto Ndërtimi x 0.5 % Taksa Infrastrukturës) dhe nuk ka asnjë dokumentacion shkresor mbi rikërkimin e arkëtimit të këtyre detyrimeve në përputhje e zbatim të pikës 15, të VKM nr. 19, datë 11.01.2017. (Më hollësisht trajtuar në faqet 33-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa për të njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave e Tarifave Vendore Bashkia Tiranë dhe bëjë konfirmimin për pagesën e diferencës së detyrimeve të taksës së infrastrukturës për rreth 273,570 lekë nga subjekti “U. ShPK + Lista e bashkëpronarëve”.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për transaksionet dhe veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me privatizim, rezultoi se janë kryer veprime me shkelje dhe parregullsi, konkretisht, me referencë nr. 19454, datë 05.02.2021, është lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë nr. 12/117 volum 13, faqe 9, truall sipërfaqe 5488 m², e cila nga subjekti Banka e Bashkuar e Shqipërisë është tjetërsuar me kontratë shitje me referencë nr. 3894, viti 2004. Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga dokumentacioni që ndodhet në dosjen me referencë nr. 3700, ku rezulton se me VKM nr. 363, datë 08.08.1994, është miratuar kapitali i palës shqiptare si pjesë e kapitalit të shoqërinë aksionare, të krijuar me Bankën A. I. dhe me kontratën datë 15.11.1994, Ministria e Bujqësisë i ka kaluar në pronësi BKT (si përfaqësuese e shtetit, e cila në vitin 2000 është zëvendësuar nga Ministria e Financave së cilës i kanë kaluar aksionet), vlerën 40 % të aksioneve që përbëhet nga: Vlera e mjeteve kryesore 62,782,000 lekë dhe Vlera e truallit me sipërfaqe 13.9 ha prej 166,800,000 lekë (kjo sipërfaqe më pas është zvogëluar në 13.2 ha, pasi janë zbatuar projekte rrugësh). Regjistrimi fillestar i pasurisë është kryer në volum 11, faqe 129 trualli me sipërfaqe 131967 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 27847 m², me pronar Banka A. Sh. I. Më pas kjo pasuri është ndarë në 3 pasuri: nr. 12/48, volum 11 faqe 130; nr. 12/49, volum 11 faqe 131; nr. 12/50, volum 11 faqe 130 dhe me procesverbalin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme datë 19.08.2003, (ku pala e shtetit Ministria e Financave), është miratuar shitja e sipërfaqes së truallit prej 45268 m² (ish Pularia Laprakë), ndërsa më pas është vijuar me ndarjen dhe tjetërsimin e të gjithë pasurisë, veprime këto të kryera në periudhën viti 2000 deri në vitin 2005. Rezulton se mungon dokumentacioni që evidenton privatizimin e 40 % të aksioneve apo shitjen e tyre, që kanë kaluar nga shteti tek Banka e B. A., e cila rezulton plotësisht me aktivitet privat, duke mos evidentuar procedurën e tjetërsimit të pronës së shtetit truall me sipërfaqe sipërfaqe 131967 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 27847 m². Veprimet e mësipërme janë kryer ne kundërshtim me: ligjin nr. 111, datë 07.02. 2019 “Për Kadastrën” dhe pikën 5 të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”, Rregullore nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 104-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të kërkojë informacion nga institucionet përkatëse, lidhur me procedurën e privatizimit të pronës së shtetit truall me sipërfaqe 131967 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 27847 m².

Brenda datës 30.06.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
--

Statusi: I pazbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për transaksionet dhe veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me privatizim, rezultoi se janë kryer veprime me shkelje dhe parregullsi, konkretisht me referencë nr. 18728, datë 18.09.2020, me kontratë shitje është tjetërsuar pasuria nr. 1/608-Nd, ndërtesë me sipërfaqe 1230 m² dhe pasuria nr. 1/611-Nd, ndërtesë me sipërfaqe 1570 m². Origjina e këtyre pasurive rrjedh nga privatizimi, sipas kontratës së shitjes datë 04.10.1993, lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Privatizimit (shitësi) dhe qytetarit P. S. (blerësi), nëpërmjet kësaj kontrate është privatizuar objekti “Reparti pllakave” që përbëhet nga 2 pjesë me sipërfaqe përkatëse 625 m² (25 x 25) m dhe 1600 m² (40 x 40) m, ndërsa trualli nuk është privatizuar dhe rezulton në pronësi shtet. Pas kalimit në sistem regjistrimi fillestar, me referencë nr. 13580, datë 15.11.2016, rezulton e regjistruar në volum

52, faqe 115, pasuria nr. 1/611-Nd ndërtesë me sipërfaqe 1570 m², dhe në volum 52 faqe 116, pasurinë nr. 1/608-Nd, ndërtesë me sipërfaqe 1230 m². Rezulton se regjistrimi fillestar i këtyre pasurive është kryer me shkelje ligjore, pasi **është regjistruar më tepër se sa përfituar me dokument pronësie truall me sipërfaqe 615 m²**. Gjithashtu është kryer transaksioni i pasurive duke mos kërkuar më parë paraqitjen e dokumentacionit që vërteton shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga përdorimi i truallit në pronësi shtet, apo marrjen përsipër të këtij detyrimi nga blerësi, që për periudhën 10 vjeçare(2010-2020), **llogaritet në vlerën 16,800,000 lekë**. Veprimet e mësipërme janë kryer ne kundërshtim me: nenin 25/a të ligjit nr. 33, datë 20.03.2012, i ndryshuar me ligjin nr. 111, datë 07.02. 2019 “Për Kadastrën”, ligjin nr. 10270, datë 22.04.2010, i shfuqizuar me ligjin nr. 20/20, datë 05.03.2020, neni 73; Regullore nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 104-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të vendosë urdhër kufizimi mbi pasuritë që rezultojnë të regjistruara në emër të qytetarit P. S., deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për **pasurinë ndërtesë me sipërfaqe 615 m²**, si dhe paraqitjen e dokumentacionit që vërteton shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga përdorimi i truallit në pronësi shtet, apo marrjen përsipër të këtij detyrimi nga blerësi, **në vlerën 16,800,000 lekë**.

Brenda datës 30.09.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për transaksionet dhe veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me privatizim, rezultoi se janë kryer veprime me shkelje dhe parregullsi, konkretisht, me referencë nr. 20229, datë 15.06.2021, është regjistruar, pasuria nr. 12/307, volum 59, faqe 213, truall me sipërfaqe 1275.25 m² në bashkëpronësi të 15 bashkëpronarëve, krijuar nga bashkimi i 3 pasurive: pasuria nr. 12/17, volum 8, faqe 208, truall me sipërfaqe 707.15 m² ndërtesë me sipërfaqe 596.8 m², pasuria nr. 12/250, volum 33, faqe 156, truall me sipërfaqe 297 m²; pasuria nr. 12/251, volum 33, faqe 157, truall me sipërfaqe 271 m²; Origjina e këtyre pasurive rrjedh nga : Pasuria nr. 12/17, volum 8, faqe 208, rrjedh nga privatizimi i banesës 2 kat sipas apartamenteve individuale që ka zotëruar secila familje, sëbashku me truallin që zë objekti në total me sipërfaqe 596.8 m², regjistruar me referencë nr. 18555 dhe nr. 18610, e cila më pas është korrigjuar në sipërfaqen 707.25 m²; Pasuria nr. 12/250, volum 33, faqe 156, truall me sipërfaqe 297 m² dhe pasuria nr. 12/251, volum 33, faqe 157, truall me sipërfaqe 271 m², janë regjistruar me kontratë shitje nr. 1194 Rep. , 808/2 Kol. , datë 26.06.2020, palë shitëse Bashkia Tiranë (Drejtorja e Përgjithshme e Objekteve Publike) dhe palë blerëse 8 familjet bashkëpronarë.

Rezulton se në mungesë të dokumentacionit të fitimit të pronësisë **është regjistruar më tepër se sa përfituar me dokument pronësie trualli me sipërfaqe 110.5 m² (707.25-596.7)**.

Gjithashtu është regjistruar **trualli me sipërfaqe 568 m²**, me palë shitëse Bashkinë Tiranë, e cila ka dalë jashtë kompetencave të saj dhe nuk e zotëron pasurinë me dokument pronësie, për rrjedhojë akti konsiderohet absolutisht i pavlefshëm. Zbatimi i gabuar i procedurës së privatizimit të truallit, ka sjellë përfitim të padrejtë nga blerësit, **në vlerën 15,364,600 lekë**. **Veprime në kundërshtim me:** nenin 195, ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për kodin civil në Republikën e Shqipërisë”, neni 25/a të ligjit nr. 33, datë 20.03.2012, i ndryshuar, ligji nr. 111, datë 07.02. 2019 “Për Kadastrën”, ligji nr. 20/20, datë 05.03.2020, neni 73.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 104-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të vendosë urdhër kufizimi mbi pasurinë pasuria nr. 12/307, volum 59,

faqe 213, e formuar nga bashkimi i pasurive: nr. 12/17, volum 8, faqe 208, nr. 12/250, volum 33, faqe 156, nr. 12/251, volum 33, faqe 157, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjorë të fitimit të drejtës së pronësisë, në të kundërt **truall me sipërfaqe 678.5 m² (110+568.5), të kthehet në pronësi “Shtet”.**

Brenda datës 30.09.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për transaksionet dhe veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me Vendime të Komisionit të Kthimit të Pronave, rezultoi se janë kryer veprime me shkelje dhe parregullsi, konkretisht; me referencë nr. 17913 datë 04.02.2020, është regjistruar pasuria nr. 8/1022 volum 59, faqe 36, truall me sipërfaqe 7645.5 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 3540 m², kontratë shitje nr. 294 Rep. , 42 Kol. , datë 15.01.2020, lidhur ndërmjet Drejtorisë së Trajtimit të Pronës Publike (shitësi) dhe bashkëpronarëve “Gj.”(blerësi) për privatizimin e objekteve të ish Uzinës Tirana, me të drejtë parablerje si ish pronarë të truallit. **Origjina e pasurisë rrjedh nga vendimet e komisionit: Vendimi i KKP-së nr. 125, datë 26.06.1995, Vendimi i KKP-së nr. 126, datë 26.06.1995, Vendimi i KKP-së nr. 125, datë 26.06.1995 dhe Vendimi nr. 394, datë 31.07.2006, të Agjencisë së Kthimit të Pronave. Rezulton se këto vendime shprehen për kompensim të truallit, të regjistruar më pas me kontratë privatizimi, pasi konsiderohet i zënë më ndërtime(ish Uzina Tirana), ndërsa nga ASHK nuk është kërkuar informacion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, lidhur përfshirjen ose jo në skemën e kompensimit të pronarëve, për të shmangur mundësinë e përfitimit të dyfishtë nga ish pronarët. Veprime në kundërshtim me: ligjin nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999 “Për punën në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, ndryshuar me nr. 7, datë 07.01.2000. (Më hollësisht trajtuar në faqet 104-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)**

10.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, për truallin me sipërfaqe 7645.5 m², që i përket pasurisë nr. 8/1022, volum 59, faqe 36, të kërkojë konfirmim zyrtar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, lidhur me përfshirjen ose jo në skemën e kompensimit të pronarëve.

Brenda datës 30.06.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për transaksionet dhe veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me leje ndërtimi, rezultoi se janë kryer veprime me shkelje dhe parregullsi, konkretisht; me referencë nr. 2627, datë 26.12.2019 është regjistruar kontratë sipërmarrje nr. 7223/2835, datë 19.11.2019, për vendparkim, në objektin që ndërtohet me leje ndërtimi nr. S-25836/8. Pjesë e truallit të miratuar për zhvillim është edhe **pasuria nr. 7/143**, truall me sipërfaqe 500 m² volum 10 faqe 61, përfituar sipas dokumentacionit me referencë nr. 3309, lëshuar certifikatë pronësie datë 17.02.2015. Referuar dokumentacionit të origjinës që ndodhet **në dosjen me referencë 3309**, rezulton se pasuria ka si origjinë një vendim për miratim leje ndërtimi me nr. 2981, datë 24.01.1991 miratuar nga Komiteti Ekzekutiv Rajoni nr. 3, Tiranë; sipas të cilit, rezulton se është ndërtuar objekti me sipërfaqe 68 m², i ndarë në 2 pasuri: me sipërfaqe 21 m², e tjetërsuar dhe e adoptuar në lokal dhe pjesa e mbetur me sipërfaqe 47 m² apartament në pronësi të përfituesit të lejes së ndërtimit. Rezulton se në mungesë të dokumentacionit të fitimit të pronësisë **është regjistruar truall me sipërfaqe**

500 m², ndërsa nga punonjësit e ish ZVRPP-së janë kryer veprime duke mos verifikuar dokumentacioni i origjinës së pronës. Veprime në kundërshtim me nenin 25/b të ligjit nr. 33, datë 20.03.2012, i ndryshuar dhe shfuqizuar me ligjin nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 104-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të vendosë urdhër kufizimi mbi pasurinë nr. 7/143, truall me sipërfaqe 500 m², volum 10, faqe 61, dhe ndërtesë me sipërfaqe 64 m², deri në plotësimin e dokumentacionit ligjorë të fitimit të drejtës së pronësisë.

Brenda datës 30.06.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri rezultoi se: Në 2 raste janë regjistruar objekte informale sipas lejeve të legalizimit nga ku referuar dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, u konstatua se:

- Me Ref. 08451, datë 29.06.2019, është regjistruar pasuria nr. 1/1667, vol. 30, fq. 87, ZK 3340 me sipërfaqe 144.8 m² ndërtesë dhe sipërfaqe parcele ndërtimore 484 m². Objekti ndodhen në buzë të rrugës

- Me referencë nr. 009144, datë 07.07.2020, është regjistruar pasuria nr. 2/974, Ndërtesë 103 m², në vol. 32, faqe 68, ZK 8340. Objekti ndodhet brenda zonës me indeks TR/584, e cila është përcaktuar si zonë për ndërtime deri në 3 kate, ndërsa objekti i legalizuar është 5 kate. Gjithashtu objekti i legalizuar nuk plotëson kriterin e largësisë nga trupi i rrugës. Veprime në kundërshtim me nenet 23, 27, 53, të Ligjit nr. 111/2019 “Për Kadastrën”; VKM nr. 519, datë 31.10.1994, “Për miratimin e kartelës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar;

- Pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”,

- Kreu VI, pika 3- Pranimi dokumenteve për regjistrim, nën-pika 3.1 dhe 3.2, si dhe pika 5.1 dhe 5.2 të Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 104-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit në përputhje me nenin 76 të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020. Për pasurinë e regjistruar, sipas lejeve të legalizimit nr.pas. 1/1667, vol. 30, fq. 87, ZK 3340; nr. 2/974, Nd vol. 32, faqe 68, ZK 8340, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 30.06.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të Vendimeve Gjyqësore dhe administrimi i dokumentacionit të rivlerësimit të pasurive, nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, u konstatua se: Në 1 rast është regjistruar me Vendim Gjyqësor “vërtetim fakti juridik” pasuria nr. 3/189 ND, Ndërtesë 180 m², në vol. 53, faqe 118, ZK 8330, “Shtëpi banimi 3-kat ku secili kat është nga 180 m².” Në

kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil” i ndryshuar neni 193. Në kartelën e pasurisë nr. 3/189ND, Vol 53, faqe 118, ZK 8330 në seksionin “D” ka të shënuar rivlerësimin e pasurisë sipas dokumentacionit me referencë nr. 16819, datë 05.07.2021, por nuk administrohet dokumentacioni ligjor. Veprime në kundërshtim me nenin 193, i ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil” i ndryshuar; nenet 20, 23, 24, të Ligjit nr. 111/2019 “Për Kadastrën”; Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë financave me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me nr. 2727, datë 4.2.2020 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit”; ligjin nr. 90/2019, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” i ndryshuar; ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 , “Për arkivat” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 104-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa që: Të administrojë dokumentacionin e rivlerësimit të pasurisë nr. 3/189 ND; Të vendosë kufizimin për pasurinë nr. 3/189 ND, në vol. 53, faqe 118, ZK 8330, deri në posedimin zyrtar të Vendimit Gjyqësor (të administruar kopje) në referencën 013703, ZK 8330; Në bazë të dokumentacionit të administruar të veprave në ndryshimin e përmbajtjes së regjistrimit për këtë pasuri.

Brenda datës 30.09.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të administrimit të dokumentacionit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri u konstatua se: Në 1 rast nuk administrohet dokumentacioni sipas fletës së inventarit të cituar në ref. nr. 39638, datë 05.07.2021, ZK 8330, nr. pasurisë 1/386, vol. 10, faqe. 243, që s’ka lidhje me aplikimin bashkëlidhur, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 , “Për arkivat” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 104-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa të vendosë kufizimin për pasurinë nr. 1/386 vol 10, faqe 243 ZK 8330, deri në administrimin e dokumentacionit sipas inventarit të referencës nr. 39638, datë 05.07.2021.

Brenda datës 30.06.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ankesës së shtetasit F. R. për zbatimin e procedurave të regjistrimit fillestar nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri (ish- ZVRPP Tiranë) u konstatua se: Është regjistruar pasuria nr. 6/21 në Vol. 25, faqe 15 në ZK 8350 “Ndërtesë” për 87 m², dhe “Truall” për 227 m² sipas referencës nr. 06821, datë 11.10.2011 dhe referencë nr. 07192, datë 19.04.2012, mbi një pronë të regjistruar më parë në Regjistrin Hipotekor me nr. 319, datë 08.06.1972 “Një shtëpi në rrugën “Ali Bej”, në pronësi të H. R., Q. R., H. R., F. R. dhe R. K.”, sipas Vendimit i trashëgimisë nr. 830, datë 23.05.1972 dhe truall që gjendet i regjistruar me nr. 1271, datë 30.10.1920, si dhe regjistruar një shtëpi në rrugën “Ali Bej” në pronësi të “H. e vëllezërit R.” me nr. 592 në hipotekë konfirmuar nga AQSH, faqe 678, viti 1945 R.106/1, duke përjashtuar bashkëpronarët e ligjshëm vërtetuar me dokumentacion ligjor si Vërtetim Hipotekor, dokumentacion arkivor dhe Vendim Gjykate “Për pjesëtim pasurie”, veprime në kundërshtim me nenin 10 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, i

ndryshuar si dhe nenet 23 dhe 37 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në faqet 127-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa të vendosë kufizimin për pasurinë nr. 1/386 vol 10, faqe 243 ZK 8330, deri në administrimin e dokumentacionit sipas inventarit të referencës nr. 39638, datë 05.07.2021.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ankesës së znj. H. H. u konstatua se: në 1 rast është regjistruar ndërtesa me nr. Pasurie. 1/11/ND+1-1; 1/11/ND+1-2; 1/11/ND+1-3; 1/11/ND+1-4, në Vol. 16, faqe 234, 235, 236, 237 në ZK 8130 “Apartamente” përkatësisht 153.15,152.8, 152.8, 152.8 m².

Dokumentacioni: “Për llogaritjen e çmimit të truallit në territorin e Rajonit nr. 1”, ku është përcaktuar Çmimi i truallit për 32,000 lekë, administruar në Referencën nr. 04600; si dhe Urdhër Pagesa nr. 226/13L, datë 20.04.1992 nga Rajoni nr. 1, për çmimin e truallit prej 32,000 lekë administruar në ankesën e znj. H. H., rezulton se mungon dokumenti financiar që vërteton shlyerjen e vlerës së përcaktuar të truallit.

Me referencën nr. 04600, datë 10.05.2011, janë kryer veprime duke ndarë pasurinë ndërtese në mungesë të marrëdhënieve me truallin, ndërsa nga punonjësit e ish ZVRPP nuk është njoftuar qytetari për të paraqitur dokumentacionin përkatës për regjistrimin e truallit të pretenduar, sipas përcaktimeve në Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 127-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa të njoftojë subjektin për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar ligjor, për regjistrimin e truallit. Në të kundërt të njoftohet qytetari të aplikojë për regjistrimin e pronës së pretenduar në zbatim të procedurave të përcaktuara në nenin 61/b dhe nenin nr. 63, pika 1/a të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020, si dhe VKM nr. 329, datë 22.05.2019.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ankesës së G. Q. për regjistrim e njësive individuale sipas përfituesve në pallat me leje ndërtimi pa u administruar dokumentacioni ligjor i lejes së ndërtimit dhe pa marrëdhënie me truallin u konstatua se: Në arkivën digjitale e dokumentare të DV ASHK Tirana Veri nuk administrohet dokumentacioni i kërkuar ligjor në përputhje e zbatim të ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” neni 46 “regjistrimi i lejes së ndërtimit” dhe neni 48 “Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja”, për regjistrimin e Lejes së ndërtimi nr. 757, datë 03.08.2000 dhe Vendimin e KRRRT nr. 4520, datë 29.06.2000 “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij” për z. E. M. “Godinë banimi 3-4-5 kate me bodrum”

Nga DV ASHK Tirana Veri janë kryer regjistrimin e njësive individuale të pallatit nr. 32 rruga “Riza Cerova” pa administruar zyrtarisht dokumentacionin e lejes së ndërtimit nr. 757, datë 03.08.2000, si dhe janë regjistruar njësitë individuale pa marrëdhënie me truallin. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 46

“Regjistrimi i lejes së ndërtimit” dhe neni 48 “Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja” (Më hollësisht trajtuar në faqet 127-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor për regjistrimin e lejes së ndërtimit nr. 757, datë 03.08.2000 duke plotësuar kartelën e pasurisë nr. 5/366 vol. 19, faqe 163, ZK 8370 dhe pasqyruar marrëdhëniet me truallin të ndërtesës dhe njësive individuale.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nuk janë rekomanduar masa për shpërblim dëmi ekonomik, si rrjedhojë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar.

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, me nr. 651/23 prot., datë 10.05.2023, sipas Programit të Auditimit 651/1 prot., datë 18.07.2022, janë rekomanduar për zbatim 4 rekomandime për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet, për shumën 51,185,500 lekë.

Referuar raportit përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri”, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024, është konstatuar se, nga 4 rekomandime për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet, janë pranuar 4 prej tyre (pranueshmëria e rekomandimeve ka qenë në masën 100%), nga ku:

- 4 rekomandime rezultojnë të pazbatuara.

Grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim rekomandimet për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet, të cilat nuk janë zbatuar, duke shqyrtuar argumentat e DV ASHK Tirana Veri, të cilat janë si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, **në 4 raste** rezultoi se nuk janë zbatuar kërkesat ligjore, pasi në një akt legalizimi është përfshirë më shumë se një objekt, duke shmangur detyrimet që rrjedhin nga procedurat e legalizimit, konkretisht:

- Me Leje Legalizimi nr. 1233597 datë 30.10.2020, është miratuar parcela ndërtimore me sipërfaqe 120 m², sipërfaqja e ndërtimit (baza e objektit) është 19 m², duke e përcaktuar si objekt të parë për legalizim të përfituar nga poseduesi, por në fakt referuar regjistrin të lejeve të miratuara periudha vitet 2019-2021, rezulton se poseduesi i objektit të legalizuar, është përfitues si pjesë e trungut familjar edhe për lejen e legalizimit nr. 1231252, datë 20.03.2019. Në këto kushte, qytetari e ka objekt të dytë objektin e legalizuar me lejen nr. nr. 1233597 datë

30.10.2020, ndërsa konsiderimi si objekt i parë, ka sjellë favorizim lidhur me detyrimet që rrjedhin nga legalizimi i tij, konkretisht: taksa e infrastrukturës duhet të llogaritet (për objektin nr. 2) **në vlerën 30.507 lekë** [19 m^2 (sip. ndërtimi) * 32113 lekë/m^2 (çmimi referencës) * 5 % (taksa vendore)] dhe vlera e parcelës ndërtimore parcela ndërtimore prej 120 m^2 , që i përket objektit nr. 2 **është 3,506,300 lekë** [$120 * 29219 \text{ lekë/m}^2$ (çmimi/m² duke zbritur pagesën e bërë)], që **përbëjnë shkelje të disiplinës financiare, si e ardhur e munguar në buxhet;**

- Me Vendimin e Legalizimit me nr. 167, datë 11.02.2021, janë legalizuar 2 objekte, parcela ndërtimore me sipërfaqe 305 m^2 , sipërfaqja e ndërtimit (baza e objektit të banimit) është 111.4 m^2 , ndërsa sipërfaqja e ndërtimit (baza e objektit social ekonomik) është 44.2 m^2 . Në vitin 2010 procedura e likuidimit të parcelës ndërtimore është bërë me çmim favorizues për sipërfaqen 252 m^2 , gjithashtu në vitin 2010 është bërë edhe likuidimi i taksës së infrastrukturës për të 2 objektet. Rezulton se megjithëse në dosje janë bërë dy vetëdeklarime, legalizimi është bërë me një akt duke e konsideruar si objekt i vetëm, kjo ka sjellë favorizim lidhur me detyrimet që rrjedhin duke mos e konsideruar si objekt i dytë, ku vlera e parcelës ndërtimore (objekti social ekonomik) prej 132.6 m^2 , **llogaritet në shumën 4,139,600 lekë** që **përbëjnë shkelje të disiplinës financiare, si ardhur e munguar në buxhet**

- Me Vendimin e Legalizimit me nr. 2358 datë 15.12.2021 ka miratuar legalizimin e “Objektit me funksion banimi 1 kat dhe objekti me funksion social ekonomik 1 kat”, parcela ndërtimore me sipërfaqe 500 m^2 , sipërfaqja e bazës së objektit të banimit është 100.3 m^2 , ndërsa baza e objektit social ekonomik është 32.5 m^2 . Procedura e likuidimit të parcelës ndërtimore është bërë me çmim favorizues me vlerën 2000 lekë/m^2 . Rezulton se megjithëse qytetari ka deklaruar se ka 2 ndërtime pa leje dhe zgjedh për legalizim si objekt të parë objektin për banim, janë legalizuar 2 objektet me të njëjtin akt, duke legalizuar me çmim favorizues edhe objektin social ekonomik, kjo ka sjellë favorizim lidhur me detyrimet që rrjedhin për konsiderimin si objekt i parë, konkretisht: taksa e infrastrukturës duhet të llogaritet (për objektin nr. 2) **në vlerën 52,200 lekë**, ndërsa vlera e parcelës ndërtimore të miratuar më tepër prej 200 m^2 , që i përket edhe objektit nr. 2 **është 4,197,000 lekë** [$200 * (22985 - 2000) \text{ lekë/m}^2$ (çmimi/m² duke zbritur pagesën e bërë)], që **përbëjnë shkelje të disiplinës financiare, si ardhur e munguar në buxhet;**

-Vendimi për legalizim nr. 801, datë 09.04.2021 për legalizimin e ndërtimit pa leje ka sjellë favorizimin lidhur me detyrimet që rrjedhin për objektin e dytë që legalizohet, konkretisht: taksa e infrastrukturës duhet të llogaritet (për objektin nr. 2) **në vlerën 80.282 lekë**; Vlera e parcelës ndërtimore parcela ndërtimore prej 122.6 m^2 , që i përket objektit nr. 2 **është 3,937,053**. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 20/20 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare pronësisë në RSH” dhe VKM nr. 1040 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit kritereve legalizimit dhe miratimin e modelit aktit legalizimit”.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 33-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana Veri, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara me Leje Legalizimi nr. 1233597 datë 30.10.2020; Vendimin e Legalizimit nr. 167, datë 11.02.2021; Vendimin e Legalizimit me nr. 2358 datë 15.12.2021; dhe Vendimin e legalizimit me nr. 801, datë 09.04.2021, si dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë deri shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse:

- në vlerën **3,536,800 lekë**, që i përket Lejes së Legalizimi nr. 1233597, datë 30.10.2020;
- në vlerën **4,139,600 lekë**, që i përket Vendimit për Legalizim nr. 167, datë 11.02.2021;
- në vlerën **4,249,200 lekë**, që i përket Vendimit për Legalizim nr. 2358, datë 15.12.2021;
- në vlerën **4,017,335 lekë** që i përket Vendimit për Legalizim nr. 801, datë 09.04.2021; detyrime në total prej $15,942,935 \text{ lekë}$ që rrjedhin nga shmangia e legalizimit si objekt i dytë, në favor të poseduesit të objektit përkatës.

Brenda datës 30.09.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrimit të pasurive sipas lejeve të legalizimit, rezultoi se: me referencë nr. 20120, është regjistruar objekti me sipërfaqe ndërtimi 879.2 m², truell me sipërfaqe 3985 m², tjetërsuar me referencë 20830, datë 20.09.2021, bazuar në Vendimin e Legalizimit nr. 1180 datë 23.04.2021, i cili ka miratuar legalizimin e “Objektit social ekonomik 1 kat”, në favor të subjektit “F.” Sh.A, parcelën ndërtimore me sipërfaqe 3985 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit (baza e objektit) 879.2 m². Rezulton se procedura e legalizimit është kryer me shkelje, pasi:

- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore prej 3985 m², është miratuar më e madhe se 3 fishi i bazës së objektit, **duke miratuar më tepër, sipërfaqen prej 1347.4 m²** (3985-2637.6(879.2*3)]. Kjo sipërfaqe i përket objektit të regjistruar më parë, i përfituar me kontratë privatizimi vetëm objekti, ndërsa trualli me sipërfaqe 3985 m², është dhënë në përdorim (marrëdhënie qiraje kontratë nr. 1616, datë 23.11.1994). *Përfshirja e truallit të objektit të privatizuar si pjesë e parcelës ndërtimore të miratuar, ka sjellë edhe mos evidentimin e dokumentacionit përkatës, për shlyerjen e detyrimeve të përdorimit të truallit me sipërfaqe 3985 m², që për periudhën e 10 viteve të fundit, llogaritet në vlerën **4,782,000 lekë**. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 111, datë 07.02. 2019 “Për Kadastrën”, ligjin nr. 10270, datë 22.04.2010, i shfuqizuar me ligjin nr. 20/20, datë 05.03.2020, neni 73 (Më hollësisht trajtuar në faqet 104-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të vendosë urdhër kufizimi mbi pasuritë që rezultojnë të regjistruara në emër të subjektit të subjektit “F.” Sh.A, deri në paraqitjen e dokumentacionit që vërteton shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga përdorimi i truallit në pronësi shtet, apo marrjen përsipër dhe shlyerjen e këtij detyrimi në vlerën **4,782,000 lekë** nga blerësi, që i përket periudhës 10 vjeçar (2010-2020).

Brenda datës 30.09.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrimit të pasurive sipas lejeve të legalizimit, nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri rezultoi se: në **2 raste** janë regjistruar objekte informale sipas lejeve të legalizimit ku referuar dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se:

- Sipas referencës nr. 08710, datë 25.09.2019, është regjistruar pasuria nr. 4/1035, Ndërtesë 79.3 m², në vol. 30, faqe 182 ZK 8340, një sipërfaqe e parcelës ndërtimore që tejkalon 3-fishin e bazës së ndërtimit me 156.6 m² [394.5-(79.3 x 3)]. Kjo sipërfaqe e tepërt është miratuar pavarësisht faktit që përfituesi i lejes së legalizimit nuk ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Për parcelat ndërtimore që kanë sipërfaqe më të madhe se trefishi i sipërfaqes së ndërtimit, diferenca e sipërfaqes totale me trefishin e ndërtimit duhet të llogaritet me vlerën e tregut të përcaktuar në VKM . **Kjo vlerë është 4,722,742 lekë** (156.6 m² x 30,158 lekë/m²), **dhe përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit**.

- Sipas referencës nr. 10092, 10093, datë 18.06.2021, është regjistruar pasuria nr. 1/1743, Ndërtesë 77 m², në vol. 33, faqe 222 ZK 8340, një sipërfaqe e parcelës ndërtimore që tejkalon 3-fishin e bazës së ndërtimit me 269 m² [500-(77 x 3)]. Kjo sipërfaqe e tepërt është miratuar pavarësisht faktit që përfituesi i lejes së legalizimit nuk ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet

një kërkesë me shkrim. Për parcelat ndërtimore që kanë sipërfaqe më të madhe se trefishi i sipërfaqes së ndërtimit, diferenca e sipërfaqes totale me trefishin e ndërtimit duhet të llogaritet me vlerën e tregut të përcaktuar në VKM. **Kjo vlerë është 8,112,502 lekë** (269 m² x 30,158 lekë/m²), **dhe përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.** Veprime në kundërshtim me: Nenet 23, 27, 53, të Ligjit nr. 111/2019 “Për Kadastrën”; VKM nr. 519, datë 31.10.1994, “Për miratimin e kartelës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a; Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999; Pikës 6.12, Kreu II, i Rregullores së Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999 (Më hollësisht trajtuar në faqet 104-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit në përputhje me nenin 76 “Kontrolli administrativ” të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020. Për pasuritë e regjistruar, Sipas referencës nr. 08710, datë 25.09.2019 dhe referencës nr. 10092, 10093, datë 18.06.2021, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor për likuidimin e detyrimit të pa paguar.

Brenda datës 30.09.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit, rezultoi se në **4 raste**, është kryer legalizimi i objekteve që janë në shkelje të lejeve të ndërtimit, por mungon dokumentacioni që vërteton se subjekti ka shlyer detyrimet financiare, që rrjedhin nga taksat urbanistike që i përkasin lejes së ndërtimit të përfituar, konkretisht:

- Me Vendimin nr. 2076, datë 27.10.2021 dhe Vendimin nr. 2076/1, datë 18.10.2021, miratuar me Vendimin e KRRT Bashkia Tiranë 32 datë 26.05.2001, me sipërfaqe totale ndërtimi **6838.1** m² për subjektin “G.” ShPK, **ndërsa** subjekti duhet të vërtetojë likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejes së ndërtimit **në shumën debitor në shumën 5,899,000 lekë [6838.1 m²(sip. totale me L. Ndert)*28756 lekë/m²(çmimi referencës viti 2005)*3% (niveli i taksës miratuar nga pushteti vendor)];**

- Me Vendimin e Legalizimit nr. 17066 datë 30.08.2021, është legalizuar objekti me shkelje të lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 47 datë 05.04.2006, të KRRT-së Bashkia Tiranë, me sipërfaqe totale ndërtimi **10159.3** m² miratuar për subjektin “A. B.” ShPK (“Gj.” ShPK), ndërsa subjekti duhet të vërtetojë likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejes së ndërtimit **në shumën 8,764,600 lekë[10159.3 m²(sip. totale me L. Ndert)*28756 lekë/m²(çmimi referencës viti 2005)*3%(niveli i taksës miratuar nga pushteti vendor)];**

- Me Vendimin e Legalizimit nr. 2177 datë 08.11.2021, është legalizuar objekti me shkelje të lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 5 datë 06.10.2001, të KRRT-së Bashkia Tiranë, me sipërfaqe totale ndërtimi **10159.3** m² miratuar për subjektin “P.” ShPK, **ndërsa** subjekti duhet të vërtetojë likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejes së ndërtimit **në shumën 11,493,900 lekë[13323.5 m²(sip. totale me L. Ndert)*28756 lekë/m²(çmimi referencës viti 2005)*3%(niveli i taksës miratuar nga pushteti vendor)].** Gjithashtu për këtë praktikë konstatohet edhe mungesë dokumentacioni, konkretisht, akti i kolaudimit, deklaratë e përbashkët mbikëqyrës, kolaudator, shoqëria zbatuese e punimeve;

- Me Leje Legalizimi nr. 118501 datë 17.02.2017, është legalizuar objekti me shkelje të lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin e KRRT Bashkia Tiranë viti 2001 me sipërfaqe totale ndërtimi **29012** m², për subjektin “T. E. 2” ShPK, **ndërsa** subjekti duhet të vërtetojë likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejes së ndërtimit **në shumën 25,028,072 lekë[29012**

m² (sip. totale me L. Ndert)*28756 lekë/m²(çmimi referencës viti 2005)*3%(niveli i taksës miratuar nga pushteti vendor)];

Në 4 rastet e mësipërme mungesa e dokumentit financiar që vërteton shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejeve të ndërtimit, konsiderohet **shkelje të disiplinës financiare, si ardhur e munguar në buxhet**. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, si dhe vendimet përkatëse të këshillave bashkiake (*Më hollësisht trajtuar në faqet 104-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

4.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana të kërkojë informacion nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve **në vlerën totale 51,185,500 lekë**, si taksa urbanistike që rrjedhin nga përfitimi i lejeve të ndërtimit **nga 4 subjektet si më sipër**, si dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara, sipas lejeve të legalizimit të mësipërme, deri në marrjen e konfirmimit nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga lejet e ndërtimit të përfituara nga këto subjekte. Gjithashtu të kryhet bashkimi i truallit me objektin e regjistruar me Leje Legalizimi nr. 118501 datë 17.02.2017, në një pasuri të vetme, si dhe të plotësohet dokumentacioni i konstatuar në mungesë që lidhet me Vendimin e Legalizimit nr. 2177 datë 08.11.2021.

Brenda datës 30.09.2023

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

2.6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kreun IV, neni 11, gërma d) dhe e), nenet 37, 144, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shfuqizuar me ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë: “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 5 punonjës dhe “Vërejtje” për 19 punonjës.

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e DP ASHK nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

2.7. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit dhe ankesat e administruara në KLSH.

Gjatë auditimit të ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug, është konstatuar se për gjetjen e grupit të auditimit nr. 22, dhe rekomandimin përkatës (*trajtuar gjerësisht në pikën B/3, nga faqe 84 deri në faqe 92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, përcjellë me shkresën “Dërgohet Raporti Përfundimtar mbi Zbatimin e Rekomandimeve”, sipas Programit të Auditimit 652/1 prot., datë 30.09.2022, në DV ASHK Tirana Jug*), zbatimi i këtij rekomandimi nuk mund të kryhet nga DV ASHK Tirana Jug.

DV ASHK Tirana Jug ka vendosur në dispozicion të grupit të auditimit Urdhrin nr. 470, datë 06.05.2019 për “Përcaktimin e kompetencës së disa drejtorive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”, ku ndër të tjera cilësohet se Zona Kadastrale 8380 kalon nën juridiksionin e DV ASHK Tirana Veri. Për këtë arsye, ky rekomandim nuk mund të zbatohet nga DV ASHK Tirana Jug.

Me qëllim zbatimin e tij, **ky rekomandim i ka kaluar për trajtim dhe zbatim DV ASHK Tirana Veri**, sipas shënimit në projektraportin e auditimit të dërguar në DV ASHK Tirana Jug (faqe 3) dhe në DV ASHK Tirana Veri (faqe 25). Nga DV ASHK Tirana Veri nuk është vendosur në dispozicion asnjë informacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

22. Gjetje nga auditimi: Në kartelën e pasurisë së paluajtshme, pasuria 5/107/ND me sipërfaqe 86.4 m², regjistruar në vol. 46, faqe 60, ZK 8380, në seksionin C - “Të Drejtat Reale” nuk ndodhet shënimi “Ndërtesa pozicionohet mbi pasurinë pa nr. dhe pa vol. dhe faqe të regjistruar në vol. dhe faqe”, ndërsa në seksionin D - “Kufizimet e Pronësisë” ndodhet shënimi “Vendoset hipotekë ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve për truallin e legalizuar”. (Më hollësisht trajtuar në pikën B/3, nga faqe 84 deri në faqe 92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, me urdhër të brendshëm të urdhërojë sektorin e kadastrës që të bëjë shënimin në kartelën e pasurisë së paluajtshme për pasurinë nr. 5/107/ND, me sipërfaqe 86.4 m², regjistruar në vol. 46, faqe 60, ZK 8380, në seksionin C - “Të Drejtat Reale”, se ku pozicionohet ndërtesa (ND), mbi çfarë pasurie dhe në çfarë vol. dhe faqe është regjistruar.

Menjëherë

Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

Tabela nr. 2: Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Lloji i masës	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	18 + 1	-	-	-	18 + 1
3E	4	-	-	-	4
Disiplinore	24	-	-	-	24
Totali	46 + 1	-	-	-	36 + 1

1. Shënim: Vlera totale monetare e rekomandimeve (të cilat nuk janë zbatuar) për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e pronës publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të pronës publike është **51,185,500 lekë**.

2. Shënim: (Vlera +1 ka të bëjë me rekomandimin që ka kaluar për trajtim dhe zbatim nga DV ASHK Tirana Jug në DV ASHK Tirana Veri).

Burimi i të dhënave DV ASHK Tirana Veri

Përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Tirana Rurale I:

2.1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, me nr. 241/48 prot., datë 15.12.2022, protokolluar në subjekt me nr. 1606/56 prot., datë 19.12.2022, sipas Programit të Auditimit 241/1 prot., datë 03.03.2022, janë rekomanduar për zbatim 52 rekomandime gjithsej, nga këto: 23 rekomandime për masa organizative, 6 rekomandime për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet, si dhe janë rekomanduar masa disiplinore për 23 punonjës.

Në vijim, nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 37/15 prot., datë 18.06.2024, protokolluar në subjekt me nr. 67/4 prot., datë 19.06.2024, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, nga i cili është konstatuar se:

- **Masa organizative:** Janë rekomanduar 23 masa, nga të cilat janë pranuar 22 masa, nga ku 13 rekomandime janë zbatuar, 4 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, 3 rekomandime janë në proces zbatimi, ndërsa 3 rekomandime rezultojnë të pa zbatuar;

- **Masa për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet:** janë lënë 6 rekomandime për shumën 74,778,700 lekë, nga të cilat, 1 rekomandim është në proces, 4 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 1 rekomandim nuk është zbatuar;

- **Masa disiplinore:** Janë rekomanduar në total 23 masa, nga të cilat: masa disiplinore “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 8 punonjës dhe masa disiplinore “Vërejtje” për 15 punonjës.

Nga informacioni i marrë në DV ASHK Tirana Rurale I rezulton se rekomandimi i është përcjellë për kompetence Drejtorisë së Përgjithshme, nga e cila është dërguar shkresë nr. 2389, datë 30.01.2023 në DV ASHK Tirana Rurale I, për vënien në dijeni lidhur me masat e propozuara nga KLSH. Nuk ka asnjë njoftim lidhur me marrjen e masave disiplinore.

Në vijim, në mënyrë të përmbledhur është paraqitur ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, referuar auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024:

Tabela nr. 1: Statusi i zbatimit të rekomandimeve, referuar auditimit me nr. 37/5, datë 11.01.2024

Lloji i masës	Rekomanduar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	23	22	13	4	3	3
3E	6	6	-	4	1	1
Disiplinore	23	23	-	-	-	23
Totali	52	51	13	8	4	27

Shënim: Vlera totale monetare e rekomandimeve (të cilat janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar) për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e pronës publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të pronës publike është **36,337,356 lekë**.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, referuar raportit përfundimtar të auditimit me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I”, përcjellë me shkresën “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 37/15 prot., datë 18.06.2024, protokolluar në subjekt me nr. 67/4 prot., datë 19.06.2024, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, ka rezultuar se **subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje** brenda

afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, gërma j), ku cilësohet se:

KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

- Gjithashtu, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, ku cilësohet se:

Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësime ligjore atëherë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, me nr. 241/48 prot., datë 15.12.2022, protokolluar në subjekt me nr. 1606/56 prot., datë 19.12.2022, sipas Programit të Auditimit 241/1 prot., datë 03.03.2022, janë rekomanduar për zbatim 23 rekomandime për masa organizative.

Referuar raportit përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, është konstatuar se, nga 23 rekomandime për masa organizative, janë pranuar 22 prej tyre (pranueshmëria e rekomandimeve ka qenë në masën 95.6%), nga ku:

- 13 rekomandime janë zbatuar;
- 4 rekomandime janë zbatuar pjesërisht;
- 3 rekomandime janë në proces zbatimi;
- 3 rekomandime rezultojnë pa zbatuar.

Grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim rekomandimet për masat organizative të cilat janë zbatuar pjesërisht (katër rekomandime), ato që nuk janë zbatuar (tre rekomandime), si dhe rekomandimet për masa organizative të cilat nuk janë pranuar nga subjekti (një rekomandim), të cilat janë si më poshtë vijon:

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, rezultoi se: Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në **2 raste** është miratuar legalizimi i

objekteve informale (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”) dhe ka miratuar kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore për sipërfaqen totale prej 800 m², ndërsa duke ju referuar kriterit të trefishit të sipërfaqes së bazës së objektit, duhet të miratohej sipërfaqja totale prej 612.6 m², veprime që kanë sjellë përfitim të padrejtë nga zotëruesit e lejeve të legalizimit përkatëse, për **sipërfaqen totale prej 187.4 m²**[800 (sip. e miratuar)- 612.6 (sip. takuese)]. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17 (pika 1), *ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*, neni 22, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2., faqet 31-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I të marrë masa, që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfituar më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”).

Brenda datës 31.12.2022

Koment nga DV ASHK Tirana Rurale I: Është proceduar me ngritjen e Grupit të Punes me Urdher Nr. 2 datë 28.12.2022(Urdher bashkelidhur) si me poshte:

-Per Subjektin Xh. S.,G. S., pajisur me Leje Legalizimi nr. 140158 datë 21.01.2021, referuar evidentimit faktik ne terren dhe ortofotos nder vite rezulton se poseduesi i Objtkit Informal ka ne posedim efektiv te tokes nepermjet kufijve faktik(rrethim)parcelen prej 700 m² ne zbatim te nenit 22,pika 3 germa a te ligjit 20/2020 ‘në rastin e ndërtimeve pa leje, me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, mund të jetë deri në masën e trefishit të bazës së ndërtimit, por, në çdo rast, jo më e madhe se 500 m²’ nga ana e D V Tirana Rurale Ieshte dhene 500 m² duke respektuar dhe kushtet e servitutit te kalimit ,konform ligjit ne fuqi.

Bashkelidhur MEMO nr. 9592 prot 30.12.2022 dhe Shkrese percjellese Sektorit te Kadastres per vendosjen e Hipotekes Ligjore deri ne shlyerjen e Detyrimeve

-Per Subjektin A. M. pajisur me Leje Legalizimi nr. 140918 datë 04.06.2021 parcela ndertimore e dhene nga DV ASHK Tirana Rurale I eshte 300m² pasi referuar evidentimit faktik ne terren dhe terrenit te pjerret ,parcela eshte dhene ne zbatim te Nennit 22,pik 3 germa a te ligjit 20/2020, ‘në rastin e ndërtimeve pa leje, me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, mund të jetë deri në masën e trefishit të bazës së ndërtimit, por, në çdo rast, jo më e madhe se 500 m²’. Bashkelidhur dhe MEMO nr .9590prot dt 30.12.2020.

Komenti i grupit të auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Rurale I, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në **14 raste**, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi:

- Në **5 raste**, janë kryer legalizime të objekteve sipas Lejeve të Legalizimit me nr. 139842, datë 31.09.2020; nr. 1400380, datë 27.11.2020; nr. 139179, datë 25.11.2019, nr. 139252, datë 23.12.2019; nr. 138730, datë 28.10.2019, dhe Vendimit për Kualifikim nr. 191, datë 04.03.2021, **pa respektuar distancat nga rrugët**, në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 39 “Përjashtimi nga legalizimi” me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e

kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b, -Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 18 “Kriteret për legalizim”; -VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimit e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” Kapitulli III. “Kriteret për legalizimin e objekteve pa leje jashtë zonave informale dhe zonave urbane”; Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara”, VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2; ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor,

Në 1 rast është kryer legalizim i objektit informal sipas Lejes së Legalizimit me nr. 139842, datë 31.09.2020, **jashtë fushës së zbatimit**, pasi sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, fotove të objektit dhe pamjes grafike të ASIG rezulton se objekti është i ndërtuar me objekte jo të qëndrueshme (llamarinë) dhe pa lidhur pazgjydhshmërisht me tokën në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar nenit 2; të ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020; VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016 pika 1 e 7.

- **Në 2 raste** është marrë Vendimi për kualifikim të objekteve informale sipas Vendimit nr. 191, datë 04.03.2021 dhe leje legalizimi nr. 138730, datë 28.01.2019, **buzë kanali e buzë dige** pasi nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk është përcaktuar statusi i kufitarit kjo në përputhje e zbatim me VKM 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimit e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, kreu III, pika 18, germa ë; si dhe të ligjit 24/2017, neni 46, pika ç dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacioni argumentues.

- **Në 5 raste**, janë kryer legalizime të objekteve sipas lejeve të legalizimit: nr. 139285, datë 17.01.2020; nr. 139350, datë 06.02.2020; nr. 140114, datë 31.12.2020; nr. 140211, datë 29.10.2020, dosja nr. 46, leje legalizimi nr. 138730, datë 28.10.2019, është kryer legalizimi i objektit informal, **duke miratuar kate më tepër, se sa lejon plani i përgjithshëm vendor i miratuar**,

- Në **1 rast** dosja nr. 46; nr. 138730, datë 28.01.2019; është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar në një zonë ku sipas planit të përgjithshëm vendor është përcaktuar si “**zonë për arsim**”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2., faqet 31-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të ushtrojë kontrollin administrativ dhe në bazë të nenin 18 të marrë masa për skualifikimin e objekteve informal të pajisura me leje legalizimi **në 5 raste** si me lart. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 5 raste të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Deri më 31.12.2022

Koment nga DV ASHK Tirana Rurale I: Është proceduar duke bere kontrollin administrativ te 5 rasteve te mesiperme:

-Per Lejen e Legalizimit me nr. 139842, datë 31.09.2020 ne favor te **V. I.** Sa i takon konstatimit "rezulton se objekti është i ndërtuar me objekte jo të qëndrueshme (llamarinë) dhe pa lidhur pazgjidhshmërisht me tokën dhe sa i takon sqarimit tonë se :Leja e Legalizimit me nr. 139842, datë 31.09.2020, objekti i legalizuar është i përbërë nga ndërtimi prej 19 m² me themel me gurë të vazhduar, me themel me mur dhe e mbuluar me çati me tjegulla, pjesa e mbuluar e verandës është e mbështetur mbi mur me tulla të plota, mur i cili gjithashtu është i mbështetur në themel të vazhdueshëm.(Pjesa në të cilën është e mbuluar me llamarinë nuk është objekti i lejes 139842, datë 31.09.2020)

-Per Lejen e Legalizimit me nr. 1400380 datë 27.11.2020 ne favor te **E. B.** Sa i takon konstatimit në aktin nr. 5 "rezulton se objekti ndodhet në buzë të rrugës "Sqarojmë se: Investimi i rrugës është i përfunduar në momentin kur është emëtuar Leja e Legalizimit, Objekti pozicionohet në njësinë strukturore TR/70, ku nuk ka Plan të Detajuar Vendor,

- Per Lejen e Legalizimit me nr. 139179, datë 25.11.2019 në favor të **C. B.** Sqarojmë se Objekti është i pozicionuar jashtë trupit të rrugës.

-Per Lejen e legalizimit me nr. 139252, datë 23.12.2019 në favor të **Sh. Sh.**,
Sqarojmë se: Leja e Legalizimit nr. 13952, në favor të subjektit Sh. Sh., është bërë për objektin "shtesë anësore dhe shtesë në lartësi në objektin e regjistruar" Bazuar ne VKM 280, dt 1.04.2015 pika 3e Kreut II. Objekti në fjalë ndodhet 4.5 m largësi nga trupi i rrugës.

- Per Lejen e Legalizimit me nr. 138730, datë 28.10.2019 ne favor te **bashkëpronarëve T.**, Sqarojmë se: në zbatim të VKM-së Nr. 280, dt. 1.04.2015, nuk përbën kusht ndalues, numri i kateve në zonat e ndara sipas PPV-së.

Sqarojmë se: Objekti ndodhet në zonën Informale të Miratuar nr. 1, Mullet, Nj.Adm. Petrelë konform pikës 1 të seksionit 1 të aktit të kualifikimit " Për zonat Informale. ... në këtë rast ndodhemi në kualifikimin e objektit afër rrugës të kategorisë C.... .

Komenti i grupit të auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Rurale I, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pa zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrimit të lejeve të legalizimit u konstatua se në 14 raste, në legalizimin e ndërtimeve pa leje, ka mangësi dokumentare dhe shkelje procedurave dhe afateve ligjore, ne ZK 3976 Shkoze dhe ZK 2460 Linzë, konkretisht:

- në 1 rast, miratimi i parcelës ndërtimore paraqet tejkalim mbi kufirin ligjor prej 500 m² dhe në 2 raste mbi 3-fish e bazës ndërtimit, ne kundërshtim me nenin 17, pika 1/c, nenin 3/f të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, përforcuar me nenin 3/d, 22/2,3/a te ligjit 20/20 datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare pronësisë ne RSH", përkatësisht: leje legalizimit 2623310 datë 15.09.2017, pasuria 111/102, godine banimi 2-kat+1-kat n/toke, parcela ndërtimore 537,8 m², sipërfaqe bazës ndërtesës 101,4 m², ZK 3976;

- në 1 rast, **ALIZNI ka legalizuar ndërtim pa leje mbi ndërtim pa leje** (legalizuar me pare), në kundërshtim me qëllimin e ALUIZNIT për legalizimin e ndërtimeve informale ekzistuese dhe frenimin e ndërtimeve pa leje ne vazhdim, me nenin 1 ligjit 9482, datë 03.04.2006 ndryshuar me ligjin 50/2014 dhe 62/2015, me piken 3/a te vendimit 1040 datë 25.11.2020. Shtesa pa leje paraqet sipërfaqe ndërtimi me te madhe (198 m²) se sipërfaqja ndërtimit ekzistues pa leje (168 m²), çka do te ishte e paligjshme edhe për lejet ndërtimit, përkatësisht:

- vendimi i legalizimit 913 datë 02.06.2021 Dajt, pasuria 58/10/1, ZK 3976,

- në 1 rast, **regjistrimi i ndërtimeve me leje legalizimi paraqet vonesa mbi 3 vjet nga zbardhja e tyre**, pa arsye te justifikuara, ne kundërshtim me vendimin nr. 1040 datë

25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit legalizimit, për ndërtimet pa leje”, kreu IV, pika 20, përkatësisht: leja legalizimit 2625589 datë 20.02.2019, pasuria 11/204/1, ZK 3976, Shkoze.

- **në 4 raste, dokumentacioni paraqet mangësi dhe parregullsi**, pasi: mungon dokumenti që vërteton vitin e përfundimit të shtesës pa leje, mungon certifikata e përbërjes familjare të poseduesit në momentin e aplikimit për legalizim në kundërshtim me VKM 1095 datë 25.12.2015 pika 10/ç, mungon bashkëpunimi me pushtetin vendor në kundërshtim me ligjin 111.2018 “Për Kadastrën” nenin 68 dhe me vendimin 1040 datë 25.11.2020, kreu I, pika 5. Vendimi i kualifikimit është plotësuar para shkresës në adrese bashkisë dhe pa u kthyer përgjigjja nga kjo e fundit është dhënë leja e legalizimit. Leja e legalizimit përfshin 2 ndërtime informale të ndara nga njëra-tjetra, në vend të 2 lejeve për secilin objekt 1-kat dhe tjetrin 3-kat. Akt ekspertiza shkurt 2020 nuk flet për gjendjen e objektit pas tërmetit 26 nëntorit 2019, i cili ka shkaktuar dëme, por flet për tërmetin e 21 shtatorit 2019 me pak dëme. Sa sipër, përkatësisht: vendimi i legalizimit 913 datë 02.06.2021 Dajt, pasuria 58/10/1, ZK 3976, Shkoze; leje legalizimit 2625589 datë 20.02.2019, pasuria 11/204/1, ZK 3976, Shkoze; leje legalizimit 138115 datë 22.01.2019, pasuria 80/329/1, ZK 3976, Shkoze leje legalizimit nr. 139335 datë 25.02.2020, pasurinë 195/817, ZK 2460, Linzë,Dajt.

- **në 3 raste, mungon dokumenti për pagesën e taksës infrastrukturës 2,130,678 leke** për vitin **2019 dhe 2020**, në kundërshtim me shkresën e Drejtorisë Përgjithshme AKSH Tiranë nr. 1130 datë 31.01.2019, e cila kushtëzon dhënien e lejes legalizimit me derdhjen e taksës infrastrukturës, me nenin 27, germa “ç të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar me ligjin 50/2014 dhe nr. 62/2015, si dhe me nenin 2 të ligjit nr. 10,146 datë 28.9.2009 “Për disa shtesa në ligjin 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore”, përkatësisht: leje legalizimit 2625589 datë 20.02.2019, pasuria 11/204/1, ZK 3976, Shkoze, sipërfaqe totale ndërtimi 536 m², taksa infrastrukturës **104,200 leke**; leje legalizimit 138115 datë 22.01.2019, pasuria 80/329/1, ZK 3976, Shkoze, sipërfaqe totale ndërtimi 295 m², taksa infrastrukturës **57,350 leke**; leje legalizimit nr. 139335 datë 25.02.2020, pasurinë 195/817, ZK 2460, Linzë,Dajt sipërfaqe totale ndërtimi 741,4 m², taksa infrastrukturës **1,969,128 leke**.

- **në 2 raste, nuk është respektuar afati prej 60 ditësh** nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit deri në marrjen e vendimit për kualifikimin të ndërtimit pa leje, për vitin 2020 dhe 2021, në kundërshtim me kreun IV, pika 20 të vendimit 1040 datë 25.11.2020, me ligjin 20/20 datë 05.03.2020, neni 21/1, konkretisht: vendimi për legalizim nr. 1527 datë 22.09.2021, pasuria 12/646, ZK 3976, Shkoze; leje legalizimit nr. 139335 datë 25.02.2020, pasurinë 195/817, ZK 2460, Linzë,Dajt,

- **në 2 raste, dokumentacioni i terrenit paraqet mangësi dhe korrigjime** si: akt evidentimi në terren, genplani dhe skicat fushore. Pamja vizuale nuk pasqyron datën e fotografimit, për efekt përfundimit të ndërtimit brenda afatit. Veprime në kundërshtim me ligjin 9482 datë 03.04.2006, me urdhrin 846 datë 11.10.2012 shfuqizuar 2, me nenin 36 udhëzimit 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe me vendimin nr. 1040 datë 25.11.2020 kreu I, pika 5, konkretisht: vendim legalizimi 139 datë 18.02.2021, pasuria 11/21/23, Dajt; leje legalizimit 139335 datë 25.02.2020, pasuria 195/817, ZK 2460, njësia administrative Dajt,

- **në asnjë rast, nuk paraqiten skualifikime për legalizim të ndërtimeve pa leje**, në vend që ASHK Tirana Rurale I të shprehej për mos-kualifikimin e ndërtimeve pa leje, për rastet që nuk plotësojnë kriteret, me qëllim që procedura e tyre të mbyllet, kërkesë kjo e kreut IV, pika 20 dhe kap. II, pika 15/a e b, të vendimit 1040 datë 25.11.2020 dhe nenit 21/2 të ligjit 20/20, datë 05.03.2020 “Për përfundimin proceseve kalimtare pronësisë RSH”.

- **në 1 rast, në mënyrë të paligjshme është legalizuar ndërtimi pa leje, në vend të aplikimit me leje ndërtimi**, pasi kompetent për dhënien e lejes ndërtimit është pushteti vendor, në rastin

konkret është vete pronari i ndërtimit informal, i cili brenda juridiksionit të territorit tij parandalon ndërtimet pa leje deri në prishjen e tyre nëpërmjet IMT në varësi të tij, konkretisht:

- leje legalizimit 139335 datë 25.02.2020, pasuria 195/817, ZK 2460, Linzë, Dajt,

- në 1 rast, shtesa pa leje e legalizuar ngjitur ndërtimit me leje qëndron mbi përrua dhe sipërfaqet ujore përreth tij në rrëpirën malit Dajtit, pra mbi pasuri publike e patjetërsueshme, në kundërshtim me nenin 4 pika 19 dhe 21 të ligjit 20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin proceseve kalimtare pronësisë RSH”, me VKM 271 datë 06.04.2006, neni 29/6, neni 30/ç. Gjithashtu objekti përveç kushteve të cenimit nga përmbajtjet e fuqisë natyrore, ndodhet ngjitur me rrugën kryesore, në kundërshtim me vendimin 1040 datë 25.11.2020, kreu II, pika 15/a, me kreun III, pika 18/dh, pika 24/a,b, me VKM 271 datë 06.04.2006 “Për miratimin rregullores zhvillimit territorit”, neni 30 pika ç (jo me pak se 6 metër), me neni 2 ligjit 8378 datë 22.07.1998 ndryshuar me VKM 153 datë 07.04.2000 “ Kodi Rrugor RSH” neni 25, pika 2 si dhe me VKM 756/2016 pika 2 /a/i, kapitulli II, konkretisht: vendim legalizimi 139 datë 18.02.2021, pasuria 11/21/23, Linzë, Dajt.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.3., faqe 63-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë:

Të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit nr. 13 datë 02.06.2021, nr. 2625589 datë 20.02.2019, nr. 138115 datë 22.01.2019 dhe nr. nr. 139335 datë 25.02.2020. Për pasurinë nr. 58/10/1, ZK 3976, nr. 11/204/1, ZK 3976, nr. 80/329/1, ZK 3976 dhe nr. 195/817, ZK 2460, e regjistruar, sipas lejes së legalizimit të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Deri 31.12.2022

Komenti i grupit të auditimit: Lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi, DV ASHK Tirana Rurale I nuk ka vendosur informacion në dispozicion as gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024, as gjatë auditimit tematik me nr. 421/2, datë 15.04.2025, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, për këtë arsye, rekomandimi do të konsiderohet:

Statusi: I pa zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për transaksionet dhe veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me vendime gjyqate dhe akte të tjera, rezultoi se me referencë nr. 2453, datë 16.07.2019, është depozituar shkresa nr. 1433/2, datë 02.07.2019, dërguar nga Prefekti i Qarkut Tiranë, bashkëlidhur është dërguar për zbatim Vendimi nr. 2340, datë 30.04.2015 i Gjykatës Administrative Shkalla Parë Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë. Ky vendim ka shfuqizuar pjesërisht AMTP pa numër datë 14.07.2003 për sipërfaqen 2000 m²(rezulton e regjistruar në kartelën e pasurive në volumin nr. 6, faqe 63, pasuria nr. 113/11), si dhe shfuqizimin e pjesëshëm të AMTP pa numër datë 22.09.1992 për sipërfaqen 1400 m² (rezulton e regjistruar në kartelën e pasurive në volumin nr. 5, faqe 226, pasuria nr. 91/27). Rezulton se nga punonjësit e Drejtorisë Rajonale 1 të ASHK Tiranë nuk është zbatuar vendimi i gjykatës së formës së prerë, për të ndarë dhe kaluar në pronësi “Shtet” pasuritë e llojit arë me sipërfaqe përkatëse 2000 m² dhe 1400 m², Veprime në kundërshtim me pikën 1 neni 24 ligji nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe pika 5 të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.3., faqe 63-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 113/11, volum 6, faqe 63 dhe pasurinë nr. 91/27, volum 5, faqe 226, ZK 2735,

duke njoftuar njëkohësisht poseduesin e këtyre pasurive, deri në kthimin me status në pronësi “Shtet”, të sipërfaqeve 2000 m² dhe 1400 m².

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Tirana Rurale I: Është proceduar me vendosjen e kufizimit në kartelat e pasurive nr. 91/27, ZK 2735 (kartela digjitale) dhe nr. 113/11, ZK 2735 (kartele fizike), kufizimi me ref 4011, (bashkëlidhur kartela digjitale).

Komenti i grupit të auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Rurale I, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I zbatuar pjesërisht

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për transaksionet dhe veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me vendime gjykate dhe akte të tjera, rezultoi se me referencë nr. 2874, datë 15.10.2020, është bërë kalimi i pronësisë për pasurinë nr. 314/47, volum 13 faqe 2, llojit “Pyll” me sipërfaqe 38000 m² me pronar “Shtet”, duke kaluar në pronësi të bashkëpronarëve “Metani”, bazuar në Vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 123, datë 17.06.2020. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ky vendim i gjykatës së apelit është me juridiksion fillestar, ndaj duke ju referuar Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë, në 2 vendimet e saj përkatësisht me numër 75/396, datë 13.05.2020 dhe nr. 112/489, datë 13.05.2020, ka arsyetuar se vendimet e gjykatës së apelit me juridiksion fillestar për çështjet e ligjit nr. 133/2015, nuk janë vendime të formës së prerë, për rrjedhojë ka kërkuar mos regjistrimin e tyre, si dhe anulim të certifikatave të pronësisë dhe korrigjim(fshirje) të gjithë vendimeve të tjera(të këtij lloji) të regjistruara më parë. Neglizhimi i zbatimit të kërkesës së Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si dhe paqartësia lidhur me zbatimin e këtyre vendimeve, duke mos bashkëpunuar edhe me Avokaturën e Shtetit, për procedurën që duhet të zbatohet në këto raste, ka sjellë kalimin e pronësisë për pasurinë e llojit “Pyll” me sipërfaqe 38000 m² nga pronësia shtet në pronësi të qytetarëve. Vepruar në kundërshtim me pikën 1 neni 24 ligji nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe Vendimet e Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë, përkatësisht me numër 75/396, datë 13.05.2020 dhe nr. 112/489, datë 13.05.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.3., faqe 63-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Rurale 1 të marrë masa, të kërkojë nga Avokatura e Shtetit konfirmimin mbi mënyrën e procedimit të mëtejshëm për rastin konkret e për raste të tjera lidhur me zbatimin e Vendimeve të Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë.

Deri me 31.12.2022

Komenti i grupit të auditimit: Lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi, DV ASHK Tirana Rurale I nuk ka vendosur informacion në dispozicion as gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024, as gjatë auditimit tematik me nr. 421/2, datë 15.04.2025, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, për këtë arsye, rekomandimi do të konsiderohet:

Statusi: I pa zbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në **1 rast**, pasuria 107/2, vol 1, faqe 86, ZK 2460, Linzë me sipërfaqe 5470 m² “arë” nuk është fshirë nga KPP, duke u mjaftuar me një kufizim në seksionin “E”, kjo në mos zbatim të vendimit të gjykatës dhe vendimit të KVVTP 160 datë 27.05.2016, për pavlefshmëri të AMTP 220 datë 25.02.2002.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.3., faqe 63-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, të marrë masa, që në përputhje e zbatim të Vendimit të Gjykatës dhe Vendimit të KVVTP 160 datë 27.05.2016 të regjistrojë me pronar “Shtet” pasurinë nr. 107/2, vol 1, faqe 86, ZK 2460, Linzë.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Tirana Rurale I: Është proceduar me vendosjen e kufizimit në kartelat e pasurive në ZK 2460, kufizimi me ref 25338 (bashkëlidhur kartelat dhe referenca).

Komenti i grupit të auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Rurale I, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I zbatuar pjesërisht

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se dokumentacioni i administruar nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, paraqet mangësi dhe parregullsi në dokumentacionin e pasurive për ZK 3976 Shkoze dhe ZK 2460 Linzë, 1170 “Bërzhitë”, 3550 “Surrel”, për vitin 2019-2021, konkretisht:

- 50 %, referencat nuk janë ngarkuar ne sistemin elektronik sipas numrit kronologjik, duke lënë jashtë sistemit shume referenca, çka ka ndikuar negativisht ne auditimin dhe riskun.

- Në 3 raste, referencat nuk janë në sistem, por mungojnë edhe fizikisht ne arkiv,

- 30 % e faqeve (KPP) janë te paplotësuara, volumi 55, ZK 2460, Linzë, ndërsa janë bosh 10 faqe (100 – 111) tek vol 8, ZK 2460.

- Në 2 raste, mungon 1 faqe KPP (250) dhe faqja 114 është plotësuar e pjesshme seksioni C, ndërsa A, B, D, E nuk janë plotësuar, ref. 16044 datë 15.03.2019, vol 55, Linzë.

- Në 1 rast, nuk pasqyrohet volumi se nga vjen pasuria, pra mungon origjina, pasuria 194/44, ZK 2460, vol 54, faqe 19, Linzë.

- Në 1 rast, janë kryer kalime te dubluara neper volume tjera për ndarjen e pasurisë nr. 603/8, vol 5, ZK 2460, Linzë, pasi ajo ka kaluar ne vol 8, faqe 114-115, por padrejtësisht ka kaluar edhe tek vol 5, faqe 245, 246 dhe 247.

- Në ZK nr. 1170, Bërzhitë, u konstatua se në arkivën dixhitale sipas numrit rendor të dokumentacionit dhe deklarimeve të sektorit të arkivës, mungojnë në arkivë 3 referenca: 1134, 1364, 1076, 1039.

Referencat nr. 1470,1471,1472, 1474, 1364, 1207, ZK nr. 1170 sipas deklarimit të sektorit të arkivit, nuk ishin regjistruar në arkivin digjital sepse nuk kishin ardhur për t`u digjitalizuar.

- Sipas rendit rritës kronologjik konstatohet se kishte kapërcime numra rendorë në 75 (shtatëdhjetë e pesë) raste ZK nr. 1170. në arkivën dixhitale sipas numrit rendor të dokumentacionit dhe deklarimeve të sektorit të arkivës, mungon në arkivë referenca nr. 1039, datë 29.07.2016.

- Në ZK 1170 “Bërzhitë”, mungojnë referencat nga 1328 deri 1353, pra mungojnë ose ka kapërcime në numrin rendor të referencave prej 25 (njëzetepesë) referenca .

Përsa u trajtua më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.3., faqe 63-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, të marrë masa, me grup pune sistemin dhe inventarizimin e arkivës digjitale dhe fizike si dhe:

- për kalimin ne sistemin elektronik sipas numrit kronologjik te referencave jashtë sistemit,

- për evitimin e faqeve (KPP) te paplotësuara dhe dispononim e 6 referencave te munguara,

- për sigurimin e faqes 250 të munguar te vol 55, Linzë KPP dhe plotësimin e te dhënave në faqen 114, referenca 16044 datë 15.03.2019 te këtij volumi,

- të pasqyrohet në volum se nga vjen pasuria 194/44, ZK 2460, vol 54, faqe 19, Linzë.
- të sistemohet kalimi i dubluar i pasurisë 603/8, vol 5, ZK 2460, Linzë, pasi ajo ka kaluar në vol 8, faqe 114-115, por edhe tek vol 5, faqe 245, 246 dhe 247.

Deri me 30.09.2022

Komenti i grupit të auditimit: Lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi, DV ASHK Tirana Rurale I nuk ka vendosur informacion në dispozicion as gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024, as gjatë auditimit tematik me nr. 421/2, datë 15.04.2025, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, për këtë arsye, rekomandimi do të konsiderohet:

Statusi: I pa zbatuar

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nuk janë rekomanduar masa për shpërblim dëmi ekonomik, si rrjedhojë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar.

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, me nr. 241/48 prot., datë 15.12.2022, protokolluar në subjekt me nr. 1606/56 prot., datë 19.12.2022, sipas Programit të Auditimit 241/1 prot., datë 03.03.2022, janë rekomanduar për zbatim 6 rekomandime për përdorimin e fondeve me efektivitet, efijencë dhe ekonomikitet, për shumën 74,778,700 lekë.

Referuar raportit përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, është konstatuar se, nga 6 rekomandime për përdorimin e fondeve me efektivitet, efijencë dhe ekonomikitet, janë pranuar 6 prej tyre (pranueshmëria e rekomandimeve ka qenë në masën 100%), nga ku:

- 4 rekomandime janë zbatuar pjesërisht;
- 1 rekomandim është në proces zbatimi;
- 1 rekomandim rezultoi i pa zbatuar.

Grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim rekomandimet për përdorimin e fondeve me efektivitet, efijencë dhe ekonomikitet, të cilat janë zbatuar pjesërisht (katër rekomandime) dhe ato që nuk janë zbatuar (një rekomandim), të cilat janë si më poshtë vijon:

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit, rezultoi se në **7 raste**, është kryer legalizimi i objekteve që janë në shkelje të lejeve të ndërtimit, por mungon dokumentacioni që vërteton se subjekti ka shlyer detyrimet financiare, që rrjedhin nga taksat urbanistike që i përkasin lejes së ndërtimit të përfituar, konkretisht:

- Me Vendimin nr. 1344, datë 23.08.2021, është legalizuar objekti me shkelje të lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin e KRRT Qarku Tiranë nr. 13, datë 25.02.2003, me sipërfaqe

totale ndërtimi 2260 m² miratuar për subjektin E. K., *ndërsa* subjekti duhet të vërtetohet në vlerën e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejes së ndërtimit *në shumën 1,820,300 lekë*[2260 m²(*sip. totale me L. Ndert*)*26848 lek/m²(çmimi referencës viti 2003)*3%(niveli i taksës miratuar nga pushteti vendor)].

- Me Leje legalizimi nr. nr. 139285 datë 27.01.2020, është legalizuar objekti me shkelje të lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 14, datë 29.12.2005, të KRRT-së Komuna Farkë, me sipërfaqe totale ndërtimi 4270 m², miratuar për subjektin “B.” ShPK, *ndërsa* subjekti duhet të vërtetohet në vlerën e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejes së ndërtimit *në shumën 3,683,643 lekë*[4270 m²(*sip. totale me L. Ndert*)*28756 lek/m²(çmimi referencës viti 2005)*3% (niveli i taksës miratuar nga pushteti vendor)];

- Me Leje Legalizimi me nr. 139350 datë 06.02.2020, është legalizuar objekti me shkelje të lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 530, datë 04.02.2006, të KRRT-së Bashkia Tiranë, me sipërfaqe totale ndërtimi 9384 m², miratuar për subjektin “Sh.” ShPK, *ndërsa* subjekti duhet të vërtetohet në vlerën e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejes së ndërtimit *në shumën 8,095,400 lekë*[9384 m²(*sip. totale me L. Ndert*)*28756 lek/m²(çmimi referencës viti 2006)*3%(niveli i taksës miratuar nga pushteti vendor)];

- Me Leje Legalizimi nr. 140114 datë 31.12.2020 është legalizuar objekti me shkelje të lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 5, datë 29.09.2011, të KRRT-së Komuna Farkë, me sipërfaqe totale ndërtimi 6520 m² miratuar për subjektin “AGI Konstruksion” ShPK, *ndërsa* subjekti duhet të vërtetohet në vlerën e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejes së ndërtimit *në shumën 6,701,200 lekë*[6520 m²(*sip. totale me L. Ndert*)*34260 lek/m²(çmimi referencës viti 2010)*3%(niveli i taksës miratuar nga pushteti vendor)];

- Me Leje Legalizimi nr. 139712 datë 19.07.2020 është legalizuar objekti me shkelje të lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin e KRRT-së Komuna Farkë, me sipërfaqe totale ndërtimi 1907 m² miratuar për subjektin “F.” ShPK, *ndërsa* subjekti duhet të vërtetohet në vlerën e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejes së ndërtimit *në shumën 1,960,000 lekë*[1907 m² (*sip. totale me L. Ndert*)*34260 lek/m²(çmimi referencës viti 2010)*3%(niveli i taksës miratuar nga pushteti vendor)];

- Me Vendimi i Legalizimit me nr. 666 datë 10.05.2021, është legalizuar objekti me shkelje të lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin nr. 8, datë 16.09.2010 Komuna Farkë, me sipërfaqe totale ndërtimi 2107 m² miratuar për subjektin “S. *. *. ” ShPK *ndërsa* subjekti duhet të vërtetohet në vlerën e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejes së ndërtimit *në shumën 2,165,600 lekë*[2107 m²(*sip. totale me L. Ndert*)*34260 lek/m²(çmimi referencës viti 2010)*3% (niveli i taksës miratuar nga pushteti vendor)];

- Për Leje legalizimi nr. 140211 datë 29.10.2020, dokumentit financiar, i paraqitur nga subjekti “M. K.” ShPK për *shumën 3,742,300 lekë* nuk është i lexushëm në specifikimet e faturës.

Në 7 rastet e mësipërme mungesa e dokumentit financiar që vërteton shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimi i lejeve të ndërtimit, konsiderohet **shkelje të disiplinës financiare, si ardhur e munguar në buxhet**. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, si dhe vendimet përkatëse të këshillave bashkiake.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.3., faqe 63-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të kërkojë informacion nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve **në vlerën totale 24,425,900 lekë**, si taksa urbanistike që rrjedhin nga përfitimi i lejeve të ndërtimit **nga 6 subjektet si më sipër**, si dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara, sipas lejeve të legalizimit të mësipërme, deri në marrjen e konfirmimit nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga lejet e ndërtimit të përfituara nga këto subjekte.

Deri më datën 31.12.2022

Koment nga DV ASHK Tirana Rurale I: është proceduar me 6 subjektet e mësipërme (E. K., B. ShPK, Sh. ShPK, A. K. ShPK, F. ShPK, S.*.* ShPK) nëpërmjet korrespondencës Shkresore me Bashkinë Tirane, Komunes se Farkes dhe Keshillit të Qarkut për venien në dispozicion të dokumentacionit që vërteton likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga perfitimi i lejes së Ndertimit. Bashkelidhur Kerkese nr. Prot 9593 datë 30.12.2022 dhe Kthim Pergjigje nga Drejtoria e Pergjithshme e taksave nr. prot. 1236/1 datë 03.02.2023.

Komenti i grupit të auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Rurale I, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I zbatuar pjesërisht

2.2. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, të marrë masa, të njoftojë subjektin “M. K.” ShPK për plotësimin e dokumentacioni që vërteton shlyerjen e detyrimit financiar, që rrjedhin nga taksat urbanistike dhe i përkasin lejes së ndërtimit *në shumën 3,742,300 lekë.*

Deri më datën 31.12.2022

Koment nga DV ASHK Tirana Rurale I: Është proceduar me subjektin e mesipërme (M. ShPK) nëpërmjet korrespondencës Shkresore me Bashkinë e Tiranës dhe Keshillit të Qarkut për venien në dispozicion të dokumentacionit që vërteton likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga perfitimi i lejes së Ndertimit. Bashkelidhur Kerkese nr. Prot 9593 datë 30.12.2022 dhe Kthim Pergjigje nga Drejtoria e Pergjithshme e taksave nr. prot. 1236/1 datë 03.02.2023.

Komenti i grupit të auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Rurale I, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, **në 1 rast, në ZK 3550 Surrel**, pasuria nr. 44/4, Truall Ndërtese, Truall 150 m², Ndërtesë 60 m², në emër të Q. T. Në listën e trojeve dhe ndërtesave, (00000001), të administruar nuk gjendet pasuri Truall Ndërtese, në emër Q. T., pra ndodhemi në kushtet e *mungesës së titullit të pronësisë për trojet dhe ndërtesat, Pra, pasuria Truall Ndërtese, Truall 150 m², Ndërtesë 60 m², mbetet “Shtet”.*

Duke kryer vlerësimin e truallit dhe ndërtesës, bazuar në çmimet e referencës dhe EKB, rezulton se *vlera e investimit së bashku me vlerën e truallit janë gjithsej 2,401,410 lekë (2,332,860+68,550), përbën dëm ekonomik (të ardhura të munguara) për buxhetin e shtetit, veprim në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, ndryshuar me nr. 7, datë 07.01.2000, Kreu IV, pika 13 (Më hollësisht trajtuar në pikën III.3., faqe 63-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të kufizojë pasurinë nr. 44/4, tokë truall 150 m² dhe sipërfaqja ndërtimore 60 m² deri në plotësimin e dokumentacionin përkatës nga autoriteti administrues shtetëror.

Deri më datën 31.12.2022

Koment nga DV ASHK Tirana Rurale I: Pasuria ka pësuar bashkim dhe transaksione në favor të palëve të treta duke u tjetërsuar, nuk është vendosur kufizimi pasi duke qene se ka

pesuar bashkim dhe transaksion në favor të palëve të treta nuk mund të evidentohet pjesa që i përket pasurisë 44/4.

Komenti i grupit të auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Rurale I, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pa zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohen **shkelje në regjistrimin e lejeve ndërtimit**, pasi dokumentacioni ardhur nga Komuna Dajt paraqet mangësi, konkretisht:

- në 2 rastet e lejeve ndërtimit është shmangur taksa ndikimit infrastrukturës për vlerën **3,637,068 leke**, pasi mungon dokumenti përkatës (MA), në kundërshtim me nenin 46 ligjit 107/2014 “Për planifikimin, zhvillimin urbanistik”, me nenin 2 ligjit 10146 datë 28.9.2009 “Për disa shtesa ligjin 9632 datë 30.10.2006 për sistemin taksave vendore”, me nenin 51 ligjit 8405 datë 17.09.1998 “Urbanistikën” ndryshuar, përkatësisht: subjekti **ShPK “BUSA” 1,667,940 leke (Besim Kuka) dhe 1,969,128 leke K. Q.**

- **leje ndërtimi 14 datë 27.07.2005, leje shtese 17 datë 16.12.2005, leje shfrytëzimi 2746 datë 19.12.2006, dhënë ShPK “BUSA”, pallati 8-kat, referencë 2920 datë 17.12.2021, për 1,667,940 leke, subjekti “B.” ShPK (B. K.), diference midis vlerës së preventivit dhe situacionit përfundimtar, pasi vlera e situacionit është me e madhe se preventivi**, mbështetur ne akt kolaudimin Dhjetor 2006 (385,700,000 - 330,102,010 = 55,598,010 x 3 %).

- **leje ndërtimi për objektin “4-kat+1-kat nëntoke+parkim+pishina”, pasuria 11/21/22-ND, vol 11, faqe 39 = plus “objekt informal 3-kat + 1-kat “social-ekonomik”, pasuria 195/817, ZK 2460, sipërfaqe totale ndërtimi 741,4 m² për aktivitet, verande 106 m² për diferencën 1, 969,128 leke (2,250,432-281,304), subjekti K. Q., shmangie në pagesën e taksës së infrastrukturës**, pasi me legalizim ajo aplikohet me tarifën 0,5 % për vlerën 281,304 leke, në vend të tarifës 4 % me leje ndërtimi për vlerën 2,250,432 leke (sipërfaqe totale ndërtimi = 741 m² + 106 m² verande = 1447 m² x 38,881 leke/m² = 56,260,807 leke x 4 % = 2,250,432 leke). (Më hollësisht trajtuar në pikën III.3., faqe 63-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Drejtorja Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, për 2 rastet, të kufizojë pasuritë deri në administrimin e mandat arkëtimeve për pagesën e taksës së ndikimit të infrastrukturës në vlerën 3,637,068 leke, për 2 lejet e ndërtimit.

Deri 31.12.2022

Koment nga DV ASHK Tirana Rurale I: Për pasurinë nr. 194/44, vol. 54, fq. 19, ZK 2460 në emër të K. Q. është vendosur kufizimi, ndërsa pjesa tjetër e rekomandimeve trajtuar nga Sektori i Legalizimeve.

Komenti i grupit të auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Rurale I, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I zbatuar pjesërisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrimit të lejeve të legalizimit u konstatua se në 3 raste, ne legalizimin e ndërtimeve pa leje, mangësi dokumentare dhe shkelje procedurave dhe afateve ligjore, ne ZK 3976 Shkoze dhe ZK 2460 Linzë, konkretisht:

- **ne 3 raste, mungon dokumenti për pagesën e taksës infrastrukturës 2,130,678 leke** për vitin **2019 dhe 2020**, në kundërshtim me shkresën e Drejtorisë Përgjithshme AKSH Tiranë nr. 1130 datë 31.01.2019, e cila kushtëzon dhënien e lejes legalizimit me derdhjen e taksës

infrastrukturës, me nenin 27, germa “ç të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 ‘‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’’ të ndryshuar me ligjin 50/2014 dhe nr. 62/2015, si dhe me nenin 2 të ligjit nr. 10,146 datë 28.9.2009 ‘‘Për disa shtesa në ligjin 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore’’, përkatësisht: leje legalizimit 2625589 datë 20.02.2019, pasuria 11/204/1, ZK 3976, Shkoze, sipërfaqe totale ndërtimi 536 m², taksa infrastrukturës **104,200 leke**; leje legalizimit 138115 datë 22.01.2019, pasuria 80/329/1, ZK 3976, Shkoze, sipërfaqe totale ndërtimi 295 m², taksa infrastrukturës **57,350 leke**; leje legalizimit nr. 139335 datë 25.02.2020, pasurinë 195/817, ZK 2460, Linzë, Dajt sipërfaqe totale ndërtimi 741,4 m², taksa infrastrukturës **1,969,128 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.3., faqe 63-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë:

- Të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit nr. 2625589 datë 20.02.2019, nr. 138115 datë 22.01.2019, nr. 139335 datë 25.02.2020, dhe regjistrimin e pasurive, nr. 11/204/1, ZK 3976, nr. 80/329/1, ZK 3976, nr. 195/817, ZK 2460.

- Në bashkëpunim me Njësinë Administrative të mare masa për administrimin e dokumentacionit për pagesën e taksës infrastrukturës në shumën 2,130,678 leke.

Deri 31.12.2022

Koment nga DV ASHK Tirana Rurale I: *Është proceduar nepermjet Korrespondences me Bashkine per konfirmimin e Takses se Ndikimit ne Infrastruktore. Bashkelidhur Korrespondenca me Bashkine Tirane.*

Komenti i grupit të auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Tirana Rurale I, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I zbatuar pjesërisht

2.6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 ‘‘Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit’’, Kreun IV, neni 11, gërma d) dhe e), nenet 37, 144, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 ‘‘Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë’’, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 ‘‘Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme’’, shfuqizuar me ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 ‘‘Për Kadastrën’’ dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë: ‘‘Vërejtje’’ deri në ‘‘Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna’’ për 8 punonjës dhe ‘‘Vërejtje’’ për 15 punonjës.

Koment nga DV ASHK Tirana Rurale I: *Rekomandimi i është përcjellë për kompetence Drejtorisë së Përgjithshme nga e cila është dërguar shkresë nr. 2389, datë 30.01.2023 në DV ASHK Tirana Rurale I, për vënien në dijeni lidhur me masat e propozuara nga KLSH. Nuk ka asnjë njoftim lidhur me marrjen e masave disiplinore.*

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK

Tirana Rurale I, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pa zbatuar

2.7. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit dhe ankesat e administruara në KLSH.

Referuar ankesave të qytetarëve (të paraqitura më poshtë), të administruara në KLSH, të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I”, përcjellë me shkresën “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 37/15 prot., datë 18.06.2024, protokolluar në subjekt me nr. 67/4 prot., datë 19.06.2024, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, ka rezultuar se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale I ***nuk janë marrë masa konkrete për zbatimin e rekomandimeve, ose së paku, ky informacion nuk është vendosur në dispozicion***. Ankesat për të cilat nuk ka informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit, janë si më poshtë vijon:

1. Ankesa me nr. 1013 prot., datë 15.11.2023, nga z. A. L., i cili ka bërë prezent kërkesën për heqje kufizimi mbi pasurinë nr. 496/406, ZK 2460 të vendosur mbi bazën e rekomandimeve të KLSH.

Nga verifikimet e bërë në DV ASHK Tirana Rurale I dhe dokumentacionin e sjellë nga ankimesi rezulton se kufizimi i vendosur nuk është mbi bazën e rekomandimeve të KLSH, por nga konstatimi i bërë nga DV ASHK Tirana Rurale I lidhur me mbivendosjen e pasurisë nr. 496/406 me pasurinë nr. 496/355 (për sipërfaqen prej 300 m²), pronë e regjistruar në emër të Repartit ushtarak nr. 6630. Kjo e konstatuar nga ish ZVRPP Tiranë gjatë ndarjes së pasurisë nr. 496/229 me sipërfaqe 2500 m², në pronësi të A. L.

Konkluzion: Lidhur me procedimin e mëtejshëm duhet të ndiqet procedura e përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën” dhe nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK, Tirana Rurale I, të vijojë procedurën lidhur me trajtimin e mbivendosjes së krijuar, për pasuritë nr. 496/406 me pasurinë nr. 496/355, në referencë të përcaktimeve ligjore në nenin 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën” dhe nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë

Komenti i DV ASHK Tirana Rurale I: Nuk ka koment

2. Ankesa me nr. 471 prot., datë 19.05.2023, nga z. A. S., z. V. S., z. Sh. S. dhe z. G. S., të cilët kanë bërë prezent kërkesën për heqje kufizimi të vendosur mbi bazën e rekomandimeve të KLSH.

Në lidhje me kërkesën e administruar në KLSH me nr. 471/4 prot, datë 10.11.2023 **depozituar nga shtetasi A. S.,**

Qytetari ka parashtruar kërkesën, për heqjen e kufizimeve të vendosura nga KLSH, mbi pasuritë: nr. 28/56 në emër të A. S.; nr. 28/57 në emër të V. S.; nr. 28/58 në emër të Sh. S.; nr. 28/65 në emër të G. S., të cilat ndodhen në Zonën Kadastale 3976, Shkozë.

Qytetarët parashetrojnë se kanë paraqitur në DV ASHK Tirana Rurale I, kërkesat përkatëse me datë 30.03.2023, për heqjen e Urdhrit të Kufizimit, të nxjerrë në zbatim të rekomandimeve të KLSH, për pasuritë: nr. 28/56, me sipërfaqe 5260 m²; nr. 28/57, me sipërfaqe 6450 m²; nr. 28/58, me sipërfaqe 2000 m²; nr. 28/65, me sipërfaqe 5800 m².

Në kërkesën e tij qytetari shprehet që KLSH-ja të procedojë me heqjen e kufizimit, gjë e cila rekomandohet edhe nga DVSHK Tirana Rurale I.

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës, rezulton se kërkesa e qytetarit është e përsëritur, pasi janë paraqitur më parë ankesat: nr. 471, datë 19.05.2023, së cilës KLSH i është përgjigjur me shkresën nr. 471/1, datë 23.05.2023 “Për kompetencë”, drejtuar DV ASHK Tirana Rurale I, për dijëni kërkesë nr. 471/2, datë 03.07.2023, së cilës KLSH i është përgjigjur me shkresën nr. 471/3, datë 31.07.2023 “Për kompetencë”, drejtuar DV ASHK Tirana Rurale I, për dijëni A. S., V. S., Sh. S., G. S. Në shkresat e sipërcituara KLSH bën dije se kompetencën për heqjen e kufizimit e ka institucioni përkatës që ka nxjerrë urdhrin e kufizimit, i cili pasi rivlerëson dokumentacionin e paraqitur procedon me heqjen e kufizimit.

Konkluzion: Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur kërkesës nr. 471/4, datë 10.11.2023, si dhe shkresës nr. 3375 Prot, datë 18.05.2023, relacion shpjegues lidhur me historikun që nga regjistrimi i pasurisë dhe në vijimësi, rezulton se dokumentacioni i paraqitur përmbush kërkesat ligjore për të proceduar nga ASHK Tirana Rurale I, me rivlerësimin e të gjithë dokumentacionit, me qëllim heqjen e kufizimit të pasurive sipas kërkesës së paraqitur nga qytetarët ankues. Gjatë këtij procesi ASHK duhet ti përmbahet përputhshmërisë së sipërfaqes takuese të secilës palë me sipërfaqen që përmban akti i fitimit të pronësisë, duke kaluar në pronësi shtet sipërfaqen e tepërt, që nuk mbulohet me Titull Pronësie.

Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK, Tirana Rurale I, të procedojë me rivlerësimin e të gjithë dokumentacionit, në lidhje me trajtimin e kufizimit të pasurive nr. 28/56 në emër të A. S.; nr. 28/57 në emër të V. S.; nr. 28/58 në emër të Sh. S.; nr. 28/65 në emër të G. S., të cilat ndodhen në Zonën Kadastrale 3976, Shkozë. Gjatë këtij procesi, DV ASHK Tirana Rurale I duhet ti përmbahet përputhshmërisë së sipërfaqes takuese të secilës palë, me sipërfaqen që përmban akti i fitimit të pronësisë, duke kaluar në pronësi shtet sipërfaqen e tepërt, që nuk mbulohet me Titull Pronësie.

Menjëherë

Komenti i DV ASHK Tirana Rurale I: Nuk ka koment

3. Ankesa me nr. 119 prot., datë 22.01.2024, nga z. E. K., i cili ka bërë prezent ankesën për veprime dhe mosveprime nga ana e DV ASHK Tirana Rurale I.

Pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit është bërë prezent ankesa për mos marrje shërbimi nga ana e DV ASHK Tirana Rurale I në lidhje me aplikimet e bërë për leje legalizimi pranë kësaj Drejtorie.

Nga verifikimet e kryera në DV ASHK Tirana Rurale I në bazë të dokumenteve që disponon kjo drejtori, rezulton se:

1. Aplikimi nr. prot., 20176, datë 21.09.2015 në emër të A. E. K. dhe nr. prot., 20175 datë 21.09.2015 në emër të H. K., administrohen nga DV ASHK Tirana Rurale I dhe referuar planit të punës së kësaj drejtorie, po trajtohen me prioritet aplikimet e kryera në vitet 2005-2006.

2. Aplikimi nr. prot., 376, datë 21.09.2015 në emër të K. E. K., nuk administrohet nga DV ASHK Tirana Rurale I.

Konkluzioni: Lidhur me mungesën e Aplikimi nr. prot., 376, datë 21.09.2015 në emër të K. E. K., duhet të njoftohet qytetari që të depozitojë aplikimin në DV ASHK Tirana Rurale I, për të vijuar më tej me procedurën e legalizimit të objektit informal. Lidhur me aplikimet: nr. prot., 20176, datë 21.09.2015 në emër të A. E. K. dhe nr. prot., 20175 datë 21.09.2015 në emër të H.

K., DV ASHK Tirana Rurale I duhet të vijojë me njëherë procedurat për legalizimin e objekteve informale, duke vënë njëkohësisht në dijeni aplikuesit lidhur me fazën në të cilën ndodhet procesi i legalizimit të objekteve që posedohen nga aplikuesit.

Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK, Tirana Rurale I, të njoftojë qytetarin K. E. K., lidhur me mungesën e Aplikimi nr. prot., 376, datë 21.09.2015, duke i kërkuar që të depozitojë aplikimin në DV ASHK Tirana Rurale I, për të vijuar më tej më procedurën e legalizimit të objektit informal. Lidhur me aplikimet: nr. prot., 20176, datë 21.09.2015 në emër të A. E. K. dhe nr. prot., 20175 datë 21.09.2015 në emër të H. K., duhet të vijojë menjëherë me procedurat për legalizimin e objekteve informale, duke vënë njëkohësisht në dijeni aplikuesit lidhur me fazën në të cilën ndodhet procesi i legalizimit të objekteve për të cilët është aplikuar.

Menjëherë

Komenti i DV ASHK Tirana Rurale I: Nuk ka koment

Tabela nr. 2: Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Lloji i masës	Rikërkuar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	7	7	-	3	-	4
3E	5	5	-	4	-	1
Disiplinore	23	23	-	-	-	23
Totali	35	35	-	7	-	28

Shënim: Vlera totale monetare e rekomandimeve (të cilat janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar) për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e pronës publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficecne dhe efektivitet të pronës publike është **36,337,356 lekë**.

Përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Duke marrë në konsideratë rekomandimet e lëna nga KLSH, në lidhje me trajtimin e ankesave të qytetarëve përgjatë auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, konstatohet se zbatueshmëria e rekomandimeve është si më poshtë vijon:

Tabela nr. 3: Statusi i zbatimit të rekomandimeve, duke përfshirë dhe rekomandimet e ankesave të qytetarëve të administruara në KLSH dhe të trajtuara gjatë auditimit tematik

Lloji i masës	Rikërkuar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	10	10	-	3	-	7
3E	5	5	-	4	-	1
Disiplinore	23	23	-	-	-	23
Totali	38	38	-	7	-	31

Shënim: Vlera totale monetare e rekomandimeve (të cilat janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar) për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e pronës publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficecne dhe efektivitet të pronës publike është **36,337,356 lekë**.

Përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

🚦 Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Tirana Rurale II:

2.1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, me nr. 242/18 prot., datë 01.03.2023, sipas Programit të Auditimit 242/1 prot., datë 03.03.2022, i ndryshuar, janë rekomanduar për zbatim 77 rekomandime gjithsej, nga këto: 31 rekomandime për masa organizative, 11 rekomandime për përdorim e fondeve me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet, si dhe janë rekomanduar masa disiplinore për 31 punonjës.

Në vijim, nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 37/16 prot., datë 18.06.2024, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, nga i cili është konstatuar se:

- **Masa për përmirësim ligjor:** Është rekomanduar një masë, e cila ka rezultuar e pazbatuar;
- **Masa organizative:** Janë rekomanduar 35 masa, nga të cilat janë pranuar të 30 masa, nga të cilat 3 rekomandime kanë rezultuar në proces zbatimi, ndërsa 32 rekomandime kanë rezultuar të pa zbatuar;
- **Masa për përdorimin e fondeve me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet:** janë lënë 11 rekomandime për shumën 76,742,500 lekë, nga të cilat, 11 rekomandime nuk janë zbatuar;
- **Masa disiplinore:** Janë rekomanduar në total 31 masa, nga të cilat: masa disiplinore “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 7 punonjës dhe masa disiplinore “Vërejtje” për 24 punonjës, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara.

Në vijim, në mënyrë të përmbledhur është paraqitur ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, referuar auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024:

Tabela nr. 1: Statusi i zbatimit të rekomandimeve, referuar auditimit me nr. 37/5, datë 11.01.2024

Lloji i masës	Rekomanduar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	35	30	-	-	3	32
Përm. ligjor	1	1	-	-	-	1
3E	11	11	-	-	-	11
Disiplinore	31	31	-	-	-	31
Totali	78	53	-	-	3	75

Shënim: Vlera totale monetare e rekomandimeve (të cilat janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar) për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e pronës publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të pronës publike është **76,742,500 lekë**.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, referuar raportit përfundimtar të auditimit me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II”, përcjellë me shkresën “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 37/16 prot., datë 18.06.2024, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, gërma j), ku cilësohet se:

KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

- Gjithashtu, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, ku cilësohet se:

Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, me nr. 242/15 prot., datë 01.03.2025, sipas Programit të Auditimit 242/1 prot., datë 03.03.2022, është lënë për zbatim një rekomandim për përmirësim të legjislacionit në fuqi, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Procedurat e zbatuara, lidhur me administrimin e të dhënave të pronës dhe plotësimin e kartelave të pasurive, nuk përmbush kriteret bazë të elementeve të sigurisë të pronës së regjistruar, pasi:

- Kartelat e Pasurive të Paluajtshme (KPP) të lidhura në volume, nuk plotësohen fizikisht, por vetëm në formë elektronike në sistem dixhital, kjo referuar VKM nr. 782, datë 07.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, paragrafi II, pikat 1 dhe 2. Në fakt kjo procedurë e ndjekur ka eliminuar dhe shmangur, ekzistencën e dokumentit fizik të regjistrimit të pronave, i cili është dokument tepër i rëndësishëm dhe me vlerë të pakufizuar në kohë. Kjo e ndikuar edhe nga sistemi dixhital “Multi Funkcional”, i cili rezulton me mungesë informacioni, pasi pasqyron vetëm transaksionin e fundit të kryer mbi pasurinë, duke mos përcaktuar të dhëna të plota lidhur me origjinën dhe historikun e pronës, dhe transaksionet e mëparshme të kryera. Në kushtet e mungesës së dokumentit fizik të regjistrimit të pronës (KPP) dhe përdorimi i sistemit dixhital që nuk pasqyron të dhëna të plota për pasuritë, shkelen parimet themelore mbi të cilat mbështet aktiviteti i ASHK-së, përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në mospërputhje me kërkesat ligjore përcaktuar në pikën 6 neni 3, dhe pikën 2 neni 13, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kreun II, pikat 1 dhe 4 të Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.6, faqet 138-143, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK-së Tirana Rurale II në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrë masa e të propozojë ndryshime ligjore në pikat 1 dhe 2 kreu II, të VKM-së 782, datë 07.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, ku të përcaktohet plotësimi i kartelës së pasurisë në mënyrë fizike (fletët e regjistrimit manual) dhe në mënyrë dixhitale, duke patur si prioritet parimet e sigurisë dhe mbrojtjes së pronës, dhe për të shmangur rreziqet që vijnë nga ngjarje dhe anomali të ndryshme.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, me nr. 242/15 prot., datë 01.03.2025, sipas Programit të Auditimit 242/1 prot., datë 03.03.2022, janë lënë për zbatim 35 rekomandime për masa organizative.

Referuar raportit përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, është konstatuar se, nga 35 rekomandime për masa organizative, janë pranuar 30 prej tyre (pranueshmëria e rekomandimeve ka qenë në masën 85.71%), nga ku:

- 3 rekomandime kanë rezultuar në proces zbatimi;
- 32 rekomandime kanë rezultuar të pa zbatuar.

Grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim rekomandimet për masat organizative të cilat nuk janë zbatuar (tridhjetë e dy rekomandime), ku përfshihen dhe rekomandimet që nuk janë pranuar nga subjekti, të cilat janë si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II (ish- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana Rurale II), rezultoi: Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në **5 raste** është miratuar legalizimi i objekteve informale (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”) dhe ka miratuar kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore për sipërfaqen totale prej 1990.1 m², ndërsa duke ju referuar kriterit të trefishit të sipërfaqes së bazës së objektit, duhet të miratohej sipërfaqja totale prej 1606.5 m², veprime që kanë sjellë përfitim të padrejtë nga zotëruesit e lejeve të legalizimit përkatëse, për **sipërfaqen totale prej 383.6 m²**. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17 (pika 1), ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 22, pika 3 (Më hollësisht trajtuar në pikën A/2, faqet 9-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Rurale II të marrë masa, që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfituar më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”).

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në **16 raste**, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi:

- Në **5 raste**, si vijon: Lejet e Legalizimit: nr. 171398, datë 20.10.2019 dosja nr. 305/2006; nr. 171498, datë 20.11.2019 dosja nr. 5298/2014; nr. 171672, datë 25.01.2020 dosja nr. 157/2006; nr. 1723099, datë 26.11.20 dosja nr. 1735/2006; Vendim legalizimi nr. 1630, datë 28.09.2021

dosja nr. 8721/2014; janë dhënë në zonën studimore në të cilën përfshihet dhe ndërtimi i legalizuar ku ka të përcaktuar: zonë “**IE Industri dhe Ekonomi**” dhe ka të ndaluara ndërtime të tjera.

Sipas “Plani Vendor i Përgjithshëm i Bashkisë Tiranë”, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin nr. 1, datë 14.04.2017, i ndryshuar;

- **Në 2 raste**, janë kryer legalizime të objekteve sipas lejeve të legalizimit: nr. 171792, datë 30.03.2020 dosja nr. 441; nr. 1723389, datë 30.12.2020 dosja nr. 663/2006, është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar **në buzë të kanaleve kulluese ujëmbledhëse, pa respektuar distancat** dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacioni argumentues.

- **Në 3 raste**, janë kryer legalizime të objekteve sipas Vendimit të legalizimit nr. 1531, datë 08.09.2021, dosja nr. 115/2006, ku rezulton se objekti ndodhet **në buzë të rrugës të rrugës nacionale kategoria “C”**, ndërsa **në 2 raste**, janë kryer legalizime të objekteve sipas Vendimit të legalizimit nr. 1618, datë 28.09.2021, dosja nr. 133/2006 dhe Vendimit të legalizimit nr. 1252, datë 09.07.2021, dosja nr. 129/2006, ku rezulton se **objekti i legalizuar ndodhet brenda rrugës në studim**, referuar PPV të Bashkisë Tiranë, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin nr. 1, datë 14.04.2017, i ndryshuar. Gjithashtu në rastin e objektit të miratuar më Vendimin e legalizimit nr. 1252, datë 09.07.2021, rezulton që objekti ndodhet në truall në pronësi të tretëve, ku PPV i Bashkisë Tiranë e ka përcaktuar si zonë urbane për ndërtime 8 kate, ky rast është në kushtet e përcaktuara në pikën 1 neni 29 i ligjit 20/20 datë 005.03.2020;

- **Në 1 rast**, sipas lejes së legalizimit nr. 171527, datë 29.12.2019 dosja nr. 1018/1, është legalizuar objekti informal, ku rezulton se ndodhet **në afërsi të trasesë hekurudhore, duke mos zbatuar kriteret e largësisë nga traseja e hekurudhës.**

- **Në 3 raste**, janë miratuar lejet e legalizimit: nr. 171947, datë 29.05.2020 dosja nr. 466/2006; nr. 172237, datë 21.09.2020 dosja nr. 537/2006 dhe nr. 1723019, datë 27.10.2020 dosja nr. 42/2020, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, Fotografitë e objektit informal, rezulton se objekti ndodhen **nën linjat e interkonjeksionit** dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej distancës nga linja,

- **Në 1 rast**, për lejen e legalizimit nr. 1723120, datë 27.11.2020 dosja nr. 1795/2014, është kryer legalizimi i objektit informal, i cili referuar dokumentacionit gjendje në dosjen e legalizimit, rezulton se **objekti është ndërtuar me materiale të paqëndrueshme dhe nuk është i lidhur pazgjydhshëmrisht me tokën, gjithashtu referuar Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, objekti ndodhet në zonë zhvillimi të përcaktuar për arsim.**

- **Në 1 rast**, për Vendimin e legalizimit nr. 405, datë 19.03.2021 dosja nr. 220, është kryer legalizimi i objektit informal, i cili referuar dokumentacionit gjendje në dosjen e legalizimit, rezulton është ndërtuar mbi objekt ekzistues, ndërsa nga aplikuesi nuk është bërë deklaratë për prishjen e objektit të mëparshëm.

Veprimet e mësipërme janë kryer ne kundërshtim me: ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”, të ndryshuar, ligjin nr. 20/20, datë 05.03.2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”, nenin 5, pika 9, me nenin 118, pika 2 ligjin 142/2016 “*Kodi hekurudhor në RSH*”, ligjin nr. 8518, datë 30.7.1999, “*Për ujtitjen dhe kullimin*”, të ndryshuar, ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “*Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 2 dhe neni 4 i tij dhe dispozitat nënligjore në zbatim të tyre. (*Trajtuar më hollësisht në pikën A/2, faqe 26-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të rivlerësojë procedurat e legalizimit për objektet informale të pajisura me leje legalizimi **në 16 raste**, si më lart dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e

lejes së legalizimit. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 16 raste, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Statusi: I pazbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II (ish-Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana Rurale II), rezultoi se: në **14 raste**, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi:

- Në **8 raste**, janë kryer legalizime të objekteve sipas Lejeve të Legalizimit me nr. 17173, datë 25.02.2020; nr. 172157, datë 29.07.2020; nr. 1723213, datë 20.12.2020; nr. 23121, datë 27.11.2020; nr. 1723072, datë 29.11.2020 dhe Vendimet e Kualifikimit me nr. 276, datë 24.02.2021; nr. 889, datë 24.08.2020; nr. 1250, datë 28.12.2020, **pa respektuar distancat nga rrugët.**

- Në **2 rast** është kryer legalizim i objektit informal sipas Lejes së Legalizimit me nr. 1723072, datë 29.11.2020; Vendimit nr. 1604, datë 27.09.2021, **jashtë fushës së zbatimit**, pasi sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, fotove të objektit dhe pamjes grafike të ASIG rezulton se objekti është i ndërtuar me objekte jo të qëndrueshme (llamarinë) dhe pa lidhur pazgjidhshmërisht me tokën, si dhe legalizuar objekt i vjetër;

- Në **1 rast** është marrë Vendimi për kualifikim të objekteve informale sipas Lejes së legalizimit me nr. 1723072, datë 29.11.2020 **buzë kanali e buzë dige** pasi nga DV ASHK Tirana Rurale II nuk është përcaktuar statusi i kufitarit kjo në përputhje e zbatim me ligjin nr. 8518, datë 30.7.1999, “Për ujitjen dhe kullimin”, të ndryshuar nr. 24/2017.

- Në **3 raste** rezulton se janë legalizuar objekte konkretisht sipas lejeve të legalizimit nr. 137801, datë 07.12.2018; nr171930, datë 28.05.2020; nr. 162, datë 25.08.2020, pasi sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, Fotografitë e objektit informal, rezulton se objekti ndodhen **nën linjat e interkonjeksionit** dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej distancës nga linja. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me: ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, ligjin nr. 20/20, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 5, pika 9, me nenin 118 , pika 2 ligjin 142/2016 “Kodi hekurudhor në RSH”, ligjin nr. 8518, datë 30.7.1999, “Për ujitjen dhe kullimin”, të ndryshuar, ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 dhe neni 4 i tij dhe dispozitat nënligjore në zbatim të tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A, faqe26-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, në përputhje me nenin 76 “Kontrolli administrativ” të ushtrojë kontrollin administrativ dhe në bazë të nenin 18 të marrë masa për skualifikimin e objekteve informal të pajisura me leje legalizimi në **14 raste** si me lart. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 14 raste të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II (ish-Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana Rurale II), rezultoi se: Në **5 raste**, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi:

Në 4 raste rezulton se janë legalizuar objekte konkretisht sipas lejeve të legalizimit nr. 171502, datë 27.12.2019; nr. 172806, datë 30.09.2020; nr. 173057, datë 30.10.2020; nr. 171904, datë 26.05.2020, pasi sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, Fotografitë e objektit informal, rezulton se objekti ndodhen **në shkelje të projektit të infrastrukturës publike**.

Në 1 rast rezulton se është legalizuar objekti konkretisht Leja e Legalizimit nr. 137801, datë 07.12.2018 pasi, sipas dokumentacionit të administruar në dosje Objekti “Një godinë banimi dhe 1 godinë shërbimi 1 kat me sipërfaqe bazës 91.6 + 32 m²”. është për objektin në të njëjtën parcelë ndërtimore me objektin e vjetër ndodhur ne pasurinë nr. 54/83, vol 7, faqe 69 ZK 2679 me ndërtesë me sipërfaqe 90 m², truall me sipërfaqe 250 m². Për të vazhduar procedurat e legalizimit në dosje duhet të administrohet edhe **deklarata noteriale e prishjes së objektit të vjetër**. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me:

ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”, të ndryshuar, ligjin nr. 20/20, datë 05.03.2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”, nenin 5, pika 9, me nenin 118 , pika 2 ligjin 142/2016 “*Kodi hekurudhor në RSH*”, ligjin nr. 8518, datë 30.7.1999, “*Për ujitjen dhe kullimin*”, të ndryshuar, ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “*Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 2 dhe neni 4 i tij dhe dispozitat nënligjore në zbatim të tyre (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A, faqe26-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Njësitë Administrative të Vetëqeverisjes Vendore për rastet e mësipërme të përcaktohen saktë pozicioni i objekteve të legalizuara në lidhje planet e përgjithshme e të detajuar vendore, si dhe të plotësohet dosjet e objekteve të legalizuara me dokumentacionin e kërkuar ligjor. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 4 raste të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit dhe regjistrimi i tyre nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, për vitin 2019-2021, në ZK 2105 Kashar dhe ZK 3321 Sharre, u konstatuan mangësi dhe shkelje të procedurave dhe afateve ligjore, konkretisht:

- **Në 5 raste, dokumentacioni paraqet mangësi dhe parregullsi, pasi:**

* dokumentacioni në sistemin elektronik paraqitet i ngarkuar me dokumente dubluara, në vend të 1 dokumenti, janë të palexueshme dhe me korrigjime, vepruar në kundërshtim me nenin 36 udhëzimit 30 datë 27.12.2011 në zbatim ligjit 10296 datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar e kontrollin*”, më Kreun II, neni 119 “*Pavlefshmëria e akteve*” të Kodit Procedurave Civile.

* HTR harta treguese regjistrimit është fotokopje, me korrigjime, e pa lexueshme, nuk përcakton me vijëzim me ngjyre të kuqe pozicionin gjeografik të pasurisë, në papajtueshmëri me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e ZRPP”, të ndryshuar.

* mungon dokumenti që vërteton vitin e përfundimit të ndërtimit pa leje,

* mungon bashkëpunimi me pushtetin vendor, në kundërshtim me ligjin nr. 111.2018 “Për kadastrën” nën 68, me vendimin 1040 datë 25.11.2020, kreu I, pika 5.

* mungon certifikata e përbërjes familjare të poseduesit në momentin e aplikimit për legalizim, në kundërshtim me VKM 1095 datë 25.12.2015 pika 10/ç,

Sa sipër, përkatësisht:

- Leja e legalizimit 171300 datë 30.08.2019, godinë banimi 1- kat, ZK 3866,

- Leja e legalizimit 130919 datë 22.05.2018, pasuria 1500/632, ZK 2105,

- Leja e legalizimit 2625671 datë 23.04.2019, pasuria 411/746, ZK 3321,

- Leja e legalizimit 2623422 datë 20.12.2016, pasuria 433/345, ZK 3321,

- Leja e legalizimit 171442 datë 25.11.2019, pasuria 64/100, ZK 3321,

- Leja e legalizimit 171496 datë 27.11.2019, pasuria 433/168, ZK 3321,

- Në 1 rast, mungon dokumentacioni për prishjen e objektit ekzistues (deklarate noteriale), mbi të cilin është ngritur ndërtimi pa leje, në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 dhe me vendimin nr. 1040 datë 25.11.2020, kreu IV, pika 38, konkretisht:

- Leja e legalizimit 131200 datë 28.06.2018 “godinë banimi 2- kat”, pasuria 231/18, ZK 3321, Njësia Vaqar Tiranë,

- Në 1 rast, ndërtimi pa leje ka qenë i pezulluar për legalizim, deri në paraqitjen e vendimit të formës prare gjykatës, sipas urdhrit 594 datë 07.12.2015 “Për pezullim të legalizimit, mbështetur në vendimin gjykatës Tiranë 13948 datë 13.11.2015, por është legalizuar nën mungesën e këtij vendimi dhe urdhri regjistruetit, konkretisht:

- Leja e legalizimit 171423 datë 30.10.2019, godinë banimi 2- kat, pasuria 232/44/1, ZK 3321, Vaqar Tiranë (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A, faqe 26-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II të marrë masa për 7 rastet e konstatuara e në vijim, për të plotësuar dokumentacionin e konstatuar me mangësi. Në rastin e mos plotësimit, të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë të Kadastrës Shtetërore për objektet informale të pajisura me leje legalizimi për të filluar procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 7 raste, të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Menjëherë e në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit dhe regjistrimi i tyre nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, u konstatuan mangësi dhe shkelje, pasi me Leje legalizimi nr. 171419 datë 29.10.2019, godinë banimi 2- kat, pasuria 297/200/1, ZK 3321, Vaqar Tiranë, ka legalizuar objektin informal, i cili cenon brezin mbrojtës të kanalit kullues dhe nuk është përcaktuar statusi i kufitarit, kjo në përputhje e zbatim me VKM 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, kreu III, pika 18, germa ë; si dhe të ligjit 24/2017, neni 46, pika ç dhe

në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A, faqe 26-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, në përputhje me nenin 76 “*Kontrolli administrativ*” të ushtrojë kontrollin administrativ dhe në bazë të nenit 18 të marrë masa për të vlerësuar procedurën e shfuqizimit të lejes së legalizimit nr. 171419, datë 29.10.2019. Gjithashtu për pasurinë e regjistruar sipas lejes së legalizimit konstatuar të lëshuara me shkelje, të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Statusi: I pazbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të pasurive, bazuar në vendimet e KKKP-ve dhe ATP-së dhe transaksionet e kryera, rezultoi se sipas referencave 13228, 13916, 13848; ZK 2679, janë kryer veprime për pasuri të regjistruara më parë me vendime të KKKP-së dhe AMTP, konkretisht:

Vendimi Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (Zyra rajonale Tiranë) nr. 113, datë 14.10.1997 i njuh dhe i kompenzon të gjithë sipërfaqen prej 50 dynym, si dhe i njuh të drejtën e parablerjes për privatizimin e serave. Duke ju referuar të dhëna në kartelat e pasurive rezultojn se me referencë nr. 0827 datë 11.09.2000, bazuar në AMTP nr. ska, pa datë vetëm viti (2000), ka përcaktuar sipërfaqen 29759 m² tokë bujqësore, e cila është lëshuar për ish pronarin L. A., rezultojn e regjistruar në 3 pasuri: nr. 120/2, volum 11, faqe 238, arë me sipërfaqe sipërfaqen 14500 m², nr. 121/1 volum 11, faqe 239, arë me sipërfaqe sipërfaqen 4309 m² dhe 123/2, volum 11, faqe 245, arë me sipërfaqe sipërfaqen 9460 m² sipërfaqja totale prej 29750 m².

Vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (Zyra rajonale Tiranë) nr. 105, datë 29.08.1997, i cili i njuh tokën me sipërfaqe 60 dynym ish pronarit Xh. A., përfitues 4 trashëgimtarët, e cila rezultojn e zënë nga serat diellore dhe në pikën tjetër shprehet për kompensimin e ish pronarit për 60 dynym si dhe i njuh të drejtën e parablerjes për privatizimin e serave.

Referuar gjendjes në dosjen me referencë nr. 0828 datë 11.09.2000, bazuar në AMTP nr. ska, pa datë vetëm viti (2000), ka përcaktuar sipërfaqen 43166 m² tokë bujqësore e cila është lëshuar për ish pronarin Xh. A., rezultojn e regjistruar për trashëgimtarët e tij (Sh., M., S. dhe L. Alla), në 4 pasuri, nr. 122/1 volum 11, faqe 241, arë me sipërfaqe sipërfaqen 9960 m², 122/3, volum 11, faqe 243, arë me sipërfaqe 14900 m² nr. 120/1, volum 11, faqe 237, arë me sipërfaqe sipërfaqen 14500 m², nr. 121/2 volum 11, faqe 240, arë me sipërfaqe sipërfaqen 4300 m² dhe sipërfaqja totale prej 43650 m². Gjithashtu sipas vendimit të KKKP-së janë përfituar edhe pasuritë nr. 431/1 truall me sipërfaqe 10000 m² dhe pasuria nr. 431/2 truall me sipërfaqe 6920 m².

Rezultojn se lëshimi i 2 akteve administrative (Akti i Marrjes së Tokës në pronësi dhe Vendimi i KKKP-së), ka sjell përfitim të padrejtë për ish pronarët, pasi megjithëse 2 vendimet e komisionit shprehen për kompensim të sipërfaqeve totale prej 50 dynym dhe 60 dynym, nga ana tjetër po këtë pronë e kanë regjistruar me aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, duke përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe totale 28200 m² dhe 43150 m² dhe trualli me sipërfaqe 16920 m².

Veprimet e mësipërme janë kryer ne kundërshtim me nenin 24/a i ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar me ligjin nr. 33, datë

20.03.2012 dhe aktet nënligjore (Trajtuar më hollësisht në pikën B/1, faqe 89-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas: *Vendimit të KKKP-së nr. 113, datë 14.10.1997, Vendimit të KKKP-së nr. 105, datë 29.08.1997, AMTP pa numër, pa datë viti(2000)*, lëshuar për ish pronaren L. A., *AMTP nr. ska, pa datë (viti 2000)*, lëshuar për ish pronarin Xh. A., deri në konfirmimin zyrtar nga ATP-ja, apo organet kompetente, lidhur me vlefshmërinë e këtyre akteve.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se, me shkresën nr. 497, datë 01.02.2024 është hartuar Urdhri nr. 51, datë 01.02.2024 **“Për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë e paluajtshme”**, ku janë vendosur kufizimet për pasuritë 120/2(Vol. 11, Fq, 238, ZK 2679) dhe 122/1(Vol. 11, Fq, 241, ZK 2679). Nuk është marrë masë për vendosjen e kufizimit për sa i përket pasurive 121/1, vol 11, fq 238; 123/2, vol 11, fq 245; 122/3, vol 11, fq 243; 120/1, vol 11, fq 237.

Statusi: I zbatuar pjesërisht

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të pasurive bazuar në procedurë privatizimi, rezultoi se, me referencë nr. 13916 datë 22.06.2020 ZK 2679, janë kryer veprime për pasurinë nr. 431/7 volum 12, faqe 14, truall me sipërfaqe 1900 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 200 m². *Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga referenca nr. 000476, viti 1999 dhe referencë nr. 00476, datë 09.05.2013*, regjistruar në volumnin nr. 10, faqe 168 pasuria nr. 431/1 truall me sipërfaqe 10000 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 1470 m² ka kaluar nga pronësia *“Shtet”* tek 4 bashkëpronarët *“A.”*. Më pas kjo pasuri është ndarë dhe tjetërsuar tek të tretë, ndërsa pasuria nr. 431/7 volum 12, faqe 114 dhe pasuria nr. 431/12, volum 12, faqe 176, pjesërisht vazhdon në bashkëpronësi të familjes *“A.”*. Origjina e pasurisë ndërtesë rrjedh nga kontrata e privatizimit nr. 2717/722, datë 22.05.1999.

Duke ju referuar dokumentacionit të privatizimit rezulton se regjistrimi i ndërtesës është kryer me shkelje dhe parregullsi, pasi dokumentacioni nuk është i plotë dhe nuk ka të përcaktuar sipërfaqen e ndërtesës që është privatizuar, kjo mbetet e paqartë edhe për shkak të mungesës së *genplanit bashkëlidhur kontratës së privatizimit*. Veprimet e mësipërme janë kryer ne kundërshtim me nenin 24/a i ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, i ndryshuar me ligjin nr. 33, datë 20.03.2012. (Trajtuar më hollësisht në pikën B/1, faqe 89-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë që vijnë nga ndarja e pasurisë nr. 431/1, volumni nr. 10, faqe 168, që rrjedhin nga kontrata e privatizimit nr. 2717/722, datë 22.05.1999, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor, të konstatuar në mungesë.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se me shkresën nr. 497, datë 01.02.2024 është hartuar Urdhri nr. 51, datë 01.02.2024 **“Për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë e paluajtshme”**, ku janë vendosur kufizimet për pasuritë nr. 431/7(Vol. 12, Fq. 114, ZK 2679) dhe 431/12 (Vol: 12, Fq: 176, ZK. 2679).

Statusi: I zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të tokave bujqësore dhe transaksioneve e veprimeve të kryera mbi këto pasuri, rezultoi se, në 2 raste,

janë kryer veprime mbi pasuri të përfituara me AMTP, duke mos zbatuar procedurat ligjore, konkretisht:

- **Me referencë nr. 12970**, datë 13.05.2019, janë kryer veprime mbi pasurinë nr. 12/31, volum 36 faqe 42, arë me sipërfaqe 1350 m². Duke ju referuar origjinës së regjistrimit të kësaj pasurie rezulton e regjistruar me referencë nr. 11300, datë 27.04.2018, bazuar në AMTP pa numër, datë 02.07.1994, lëshuar në emër të H. H. Duke ju referuar dokumentacionit gjendje në dosje (certifikatë e trungut familjar), rezulton se kjo familje me përbërje nga 7 anëtarë ka përfituruar 3 AMTP, konkretisht: AMTP nr. 299, datë 19.01.1994, AMTP nr. 298, datë 28.01.1994 dhe AMTP pa numër datë 02.07.1994, në total ka përfituruar tokë me sipërfaqe prej 9650 m², ndërsa në kartelat e pasurive për këtë familje bujqësore janë regjistruar në total 5 pasuri me sipërfaqe totale 14450 m², rezulton **se është regjistruar më tepër sipërfaqja prej 4800 m²(14450-9650)**

- **Me referencë nr. 13610**, bazuar në Urdhrin nr. 48, datë 31.01.2020, të Drejtorit të ASHK Rurale II, janë kryer veprime duke bërë saktësimin e pasurive në emër të bashkëpronarëve M. K., H. S. dhe Z. L. Duke ju referuar origjinës së regjistrimit të pasurive rezulton se 3 bashkëpronarët kanë përfituruar tokë me AMTP të lëshuara për secilin nga 2 akte, ku secili nga bashkëpronarët kanë përfituruar 4300 m² dhe në total kanë përfituruar 12900 m², ndërsa në total është regjistruar sipërfaqja 15400 m². Rezulton se 4 bashkëpronarët **kanë përfituruar më tepër se sipërfaqja e përcaktuar në aktet administrative, sipërfaqen prej 2500 m²(15400-12900)**. Veprimet e mësipërme janë kryer ne kundërshtim me nenin 25/a të ligjit nr. 33 datë 20.03.2012, i ndryshuar dhe VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “*Për mënyrën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi*”. (Trajtuar më hollësisht në pikën B/2, faqe 94-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Rurale II të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuar, të nxjerrë urdhrë kufizimi për pasuritë që rezultojnë në pronësi të familjes H. H. dhe në emër të bashkëpronarëve dhe bashkëpronarëve “S., K., L. dhe L.”, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë që shërben për regjistrimin e pasurisë, ose kalimin në pronësi “*Shtet*” të sipërfaqeve të përfituruar më tepër, prej 4800 m² dhe 2500 m², për të cilën mungon dokumentacioni i fitimit të pronësisë.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të tokave bujqësore dhe transaksioneve e veprimeve të kryera mbi këto pasuri, rezultoi se, në 2 raste, janë kryer veprime mbi pasuri të përfituara me AMTP, duke mos zbatuar procedurat ligjore, konkretisht:

- **Me referencë nr. 13427**, janë kryer veprime mbi pasurinë nr. 440/57, volum 11 faqe 17, arë me sipërfaqe 1000 m², regjistruar kontratë dhurimi nga Y. Sh. tek I. Sh. Duke ju referuar origjinës së regjistrimit të kësaj pasurie rezulton se kjo familje përbehej nga 4 anëtarë, ndërsa për këtë familje janë lëshuar në total 11 AMTP, duke përfituruar në total sipërfaqen 39400 m². Rezulton se me referencë nr. 4610, datë 05.03.2007, sipas AMTP pa numër, pa datë është regjistruar në volumn nr. 18, faqe 146, pasuria nr. 68/42, arë me sipërfaqe 3000 m² në pronësi të Y. Sh., e cila po me këtë referencë ka kaluar në pronësi të subjektit “P.*.*. A.” ShPK(kjo shoqëri ka blerë edhe pasuri të tjera të llojit “arë” brenda bllokut me numër 68). Gjithashtu referuar të dhënave në dokumentacionin me referencë nr. 7121, datë 06.07.2012, për pasurinë nr. 68/43, volum 18, faqe 147, arë me sipërfaqe 6000 m² në pronësi të A. Sh. (po me këtë referencë ka kaluar në pronësi të subjektit “P.*.*. A.” ShPK), është regjistruar një vendim gjyqate i formës së prerë i cili ka shfuqizuar AMTP, për këtë sipërfaqe prej 6000 m² për A. Sh.,

në fakt kjo pasuri ka qenë e tjetërsuar përpara daljes së vendimit të gjykatës, ndaj nuk ka gjetur zbatim lidhur me kthimin në pronësi shtet të kësaj sipërfaqeje.

- **Me referencë nr. 13610**, bazuar në Urdhrin nr. 48, datë 31.01.2020, të Drejtorit të ASHK Rurale II, janë kryer veprime duke bërë saktësimin e pasurive në emër të bashkëpronarëve M. K., H. S. dhe Z. L.

Referuar KPP, rezulton se pasuria nr. 67/11 , volum 12 faqe 105, arë me sipërfaqe 2495 m², me referencë 0991, viti 2001 ka kaluar në pronësi të 3 bashkëpronarëve, regjistruar sipas AMTP pa numër, viti 1998,(regjistruar dëshmi trashëgimie datë 08.01.2018). Kjo pasuri rrjedh nga pasuria nr. 67/85, volum 12, faqe 61 e llojit “*Truall*”. Gjithashtu në pronësi të bashkëpronarëve figurojnë të regjistruara edhe pasuritë me numër kadastral 68, nga të cilat janë tjetërsuar 3 pasuri, sipërfaqe totale 5400 m², tek shoqëria “P.*.*. A.” ShPK.

Duke ju referuar dokumentacionit gjendje në arkiv, rezulton se **Komisioni i Tokës së Këshillit të Qarkut Tiranë, me Vendimin nr. 4/2, datë 03.10.2002, ka vendosur të anulojë si të paligjshëm çdo akt të marrjes së tokës në pronësi apo në përdorim të lëshuar pas datës 27.12.1994, që është dhënë në parcelat nr. 62 e 68.**

Në këto kushte, nuk duhet të procedohej me regjistrimin dhe kryerjen e transaksioneve për këto pasuri, të cilat rezultojnë të përfituara me akte të paligjshme. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 “*Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës*”, Vendimin nr. 4/2, datë 03.10.2002 të Komisionit të Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë. (*Trajtuar më hollësisht në pikën B/2, faqe 94-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Rurale II të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuar, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në parcelat nr. 62 e 68, të përfituara me AMTP të lëshuara pas datës 27.12.1994, ndërsa për pasuritë e tjetërsuara të njoftohen palët(ish pronarë) për detyrimin e shlyerjes së vleftës monetare të përfituar nga tjetërsimi i këtyre pasurive, në të kundërt të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin në buxhetin e shtetit të vlerave monetare, për pasuri që konsiderohen të përfituara me akte të paligjshëm sipas Vendimit nr. 4/2, datë 03.10.2002 të Komisionit të Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se me Urdhër nr. 51 datë 01.02.2024 është vendosur kufizimi për Pasurinë me Nr. 440/57, regjistruar në Vol: 11, Fq: 176, ZK. 2679 dhe Pasurinë me Nr. 67/11, regjistruar në Vol: 12, Fq: 105, ZK. 2679.

Statusi: I zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të regjistrimit ë pasurive tokë bujqësore dhe transaksioneve të kryera, u konstatua se, **në 1 rast, në ZK 2119 “Katund i Ri”**, sipas referencës nr. 00004048, datë 17.04.2019, janë regjistruar pasuritë:

-Pasuria nr. 225/101/23, “Pemëtore”, sipërfaqe 2100 m², në emër të I. H., në vol. 13, faqe 74, certifikatë datë 17.04.2019.

-Pasuria nr. 225/106/4, “Ullishte”, sipërfaqe 540 m², në emër të I. H., në vol. 13, faqe 76, certifikatë datë 17.04.2019.

Regjistrimi është kryer sipas AMTP nr. s`ka , datë 15.11.1994, ku nga rakordimi midis të dhënave të pasurive “Pemëtore”, sipërfaqe 2100 m² dhe “Ullishte”, sipërfaqe 540 m² rezulton se poseduesit të AMTP-së i jepen 70 rrënjë pemë dhe 9 rrënjë ullinj, pra në AMTP-në përkatëse nuk është përcaktuar sipërfaqja në m² që i takon pronarit, të cili në fakt ka regjistruar 2100 m² pemishte dhe 540 “Ullishte”, sipas plan-rilevimit, por në mungesë të titullit të pronësisë me përcaktimin e sipërfaqes në metër/katror.

Vepruar në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme nr. 184, datë 08.04.1999 “Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, ndryshuar me nr. 7, datë 07.01.2000, Kreu IV, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën B.2 faqet 94-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë nr. 225/101/23 dhe nr. 225/106/4, të regjistruara sipas referencës nr. 00004048, datë 17.04.2019, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu të ngrihet grup pune për rivlerësimin e dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë regjistruar këto pasuri.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se me Urdhër nr. 51 datë 01.02.2024 është vendosur kufizimi për Pasurinë me Nr. 225/101/23, regjistruar në Vol: 13, Fq: 74, ZK. 2119 dhe Pasurinë me Nr. 225/106/4, regjistruar në Vol: 13, Fq: 76, ZK. 2119.

Statusi: I zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Janë kryer veprime për regjistrimin e kontratës së dhurimit me referencë nr. datë 08.02 2019, por rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore për regjistrimin e pasurisë nr. 1281/5, ZK 2105, vol 22, faqe 175, sipërfaqe 530 m², pasi origjina e saj vjen nga pasuria e llojit “kanal” në pronësi “Shtet” ndërsa është bërë kalimi i pronësisë me referencë nr. 2977 datë 11.09.2013, në mungesë të dokumentacionit argumentues për ndryshimin e zërit kadastral “kanal”. Veprime në kundërshtim me nenin 25/a të ligji nr. 33, datë 20.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. (Trajtuar më hollësisht në pikën C, faqe 143-157, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, të marrë masa që në bashkëpunim me Njësinë Administrative Kashar, të përcaktojë statusin e pronësisë së pasurisë nr. 1281/5, ZK 2105, vol 22, faqe 175, me sipërfaqe 530 m². Gjithashtu për pasurinë nr. 1281/5, konstatuar me shkelje, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në saktësimin e statusit të pronësisë.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të kryera sipas referencës 3865, datë 03.05.2019 dhe referencës 3874, datë 27.05.2019, rezulton se është kufizuar në seksionin D, pasuria 301/4,ZK 3321, vol 1, faqe 26, sipërfaqja 3200 m² “vresht”, sipas VKM 811 datë 26.12.2018 “Për shpronësimet” e cila preket nga projekti i landfillit për ndërtimin e tij ose te inceneratorit, rehabilitimin e vend depozitimeve ekzistuese dhe prodhimin energjisë elektrike. Kjo pasuri është regjistruar pa numër të aktit administrativ, pra **mungon dokumenti që shpreh titull pronësie (regjistrimi datë 20.01.1996)**. Pasuria nr. 301/4,ZK 3321, vol 1, faqe 26, sipërfaqja 3200 m² vresht, në emër B. Xh. nuk është mbyllur dhe nuk ka kaluar në pronësi të Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë, pasi **mbi këtë pasuri ndodhet landfilli i mbeturinave** ndryshe nga pasuritë tjera, te cilat kane kaluar ne pronësi te MIE. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.B, faqe 94-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, të marrë masa që, të regjistrojë pasurinë nr. 301/4 në pronësi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dukë bërë veprimet përkatëse në dokumentacionin e administruar.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Nisur nga referencat e periudhës nën auditim, në *I rast*, në origjinën e pasurive u konstatua zvogëlim dhe shtese sipërfaqe, konkretisht:

- Nisur nga referenca 4819 datë 01.09.2019, u krijua indice për verifikimin e pronës origjine. Janë përfituar 2 AMTP nga i njëjti person (A. M.). Kështu, pasuria e bashkuar 1152/25, vol 16, faqe 170 rezulton në fakt 5500 m² dhe jo 7340 m² are, pasi 2 pasuri bija janë shtuar për diferencën 1840 m² are (7340-5500=1840 m²) nëpërmjet korigjimit në seksionin B të KPP, konkretisht:

- pasuria 1152/20, vol 14, faqe 172, sipërfaqe 1900 m² are, e cila është shtuar tek seksioni “B” në KPP me korigjim nga 1100 m² në 1900, diferenca 800 m² (1900-1100).

- pasuria 1152/12, vol 14, faqe 174, sipërfaqe 2500 m² are, e cila është shtuar tek seksioni “B” në KPP me korigjim nga 1500 m² në 2500 m², diferenca 1000 m² (2500-1500).

Veprime në kundërshtim me Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.B, faqe 94-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, të rivlerësojë dokumentacionin që ka shërbyer për fitimin e pronësisë dhe për sipërfaqen e tepërt, që nuk argumentohet me dokument pronësie, të procedojë duke e kaluar në pronësi “Shtet”.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se, me Urdhër nr. 51 datë 01.02.2024 është vendosur kufizimi për Pasurinë me Nr. 1152/25, regjistruar në Vol: 16, Fq: 170, ZK. 2105. Nga DV ASHK Tirana Rurale II nuk janë marrë masa për të nisur procedurat për rivlerësim dokumentacioni, si dhe për të kaluar në pronësi “Shtet” sipërfaqet e tepërta.

Statusi: I zbatuar pjesërisht

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i transaksioneve të kryera mbi pasuri me origjinë “listat e trojeve 001”, në ZK Kashar dhe Sharre, u konstatua:

- **Në 25 raste**, listat e trojeve 0001 kanë të pasqyruara 2 troje për çdo kryefamiljar (20 raste ZK 2105) dhe sipërfaqe mbi normën 300 m² (5 raste ZK 3321), në kundërshtim me dekretin e Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978 dhe ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Pranimi i kësaj liste të parregullt është në kundërshtim me VKM 556 datë 23.10.2000 “Për dorëzimin e Dokumentacionit në ZVRPP”.

- **Ne 4 raste**, ZK 2105 “Kashar”, rezulton se AMTP-të padrejtësisht pasqyrojnë truall, i cili nuk është objekt i AMTP-së, por i “listës trojeve 001”. Përfitimi i truallit me AMTP, është në kundërshtim me dispozitat ligjore përcaktuar në ligjin nr. 7501 datë 19.7.1991 “Për tokën”, si dhe me ndryshimet ligjore të fundit, ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Veprime në kundërshtim me nenin 3/c, nenet 10 dhe 15 të ligjit 9948 datë 7.7.2008, me pikën 5 UKM 2 datë 12.09.2012 dhe 13.06.2013. (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 143-157, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, të marrë masa që në bashkëpunim me Njësinë Administrative të Vetëqeverisjes Vendore, të

rishikoje pasuritë e regjistruara sipas AMTP dhe trojeve tepërta, te cituara më sipër dhe të bëjë sistemimet përkatëse.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i transaksioneve të kryera mbi pasuri me origjinë të fitimit të pronësisë me Akt të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP), u konstatua se: regjistrimi i pasurisë 26/1 vol 5, faqe 220, ZK 2105, Kashar, është kryer bazuar në AMTP nr. 261 viti 1992, referuar kartelës së pasurisë, rezulton se kjo pasuri rezulton zëri kadastral “rrugë”, pasi është korigjuar zëri kadastral në “arë”, ka kaluar në pronësi të poseduesit të AMTP-së. Veprime në kundërshtim me nenin 193 të ligjit 7850 datë 29.7.1994 “Kodi Civil RSH” dhe akte të tjera nënligjore. (Më hollësisht trajtuar në pikën B/2, faqe 94-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, të rakordojë me pushtetin vendor lidhur me statusin e kësaj pasurie dhe më pas bazuar në konkluzionin e nxjerrë, të procedojë për sistemimin e pasurisë 26/1, vol 5, faqe 220, ZK 2105, Kashar

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të regjistrimit dhe transaksioneve të kryera mbi pasuritë, rezulton se me referencë nr. 95 datë 23.05.2002, është regjistruar pasuria nr. 1182/11, ZK 2105, vol 15, faqe 136, “are” me sipërfaqe 4700 m², ndërsa referuar AMTP 371 datë 01.07.1992, përcakton sipërfaqen 4470 m², duke regjistruar më tepër se sa përcakton akti administrativ(AMTP), sipërfaqen 230 m², kjo e konfirmuar edhe në plan rilevimin e hartuar. Gjithashtu pasuria nr. 1182/12, vol 15, faqe 109, ZK 2105, 1700 m² rrugë “Shtet” është mbyllur dhe sipas shënimit në kartelë ka kaluar tek pasuria e bashkuar 1182/13, vol 16, faqe 103, are me sipërfaqe 35682 m², por në fakt nuk ka kaluar te kjo pasuri, dhe nuk identifikohet se ku ka kaluar. Vepruar në kundërshtim me nenin 24/a i ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar me ligjin nr. 33, datë 20.03.2012.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B/2, faqe 94-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, bazuar në shkeljet e konstatuar, të njoftojë pronarin për të ndarë e kaluar në pronësi “Shtet”, sipërfaqen 230 m², e cila nuk argumentohet me dokument pronësie. Gjithashtu të vlerësojë dokumentacionin e origjinës, për të saktësuar dhe përcaktuar vijueshmërinë e pasurisë nr. 1182/12, vol 15, faqe 109, ZK 2105, 1700 m² rrugë “Shtet”. Deri në përfundim të këtyre procedurave të pezullohen veprimet mbi këto pasuri.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të pasurive sipas lejeve të ndërtimit dhe ligjeve urbanistike, rezultoi se, me referencë nr. 13892, datë

16.06.2020, është regjistruar transaksioni me kontratë dhurimi për pasurinë nr. 11/72, volum 36, faqe 85 arë + truall dhe ndërtesë, nga e cila truall me sipërfaqe 1255 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 1000 m². Origjina e regjistrimit të objektit rrjedh nga leje ndërtimi, regjistruar me referencë nr. 0515, 0514, viti 1999, në volumin 10, faqe 220, pasuria 11/34 truall me sipërfaqe 4500 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 1400 m², e cila më pas është ndarë në volum 36 faqe 84, pasuria nr. 11/71 dhe pasuria nr. 11/72 volum 36 faqe 85.

Duke ju referuar dokumentacionit urbanistik rezulton se objekti i ndërtuar, ka sipërfaqe më të madhe se sa përcaktuar në dokumentacionin e miratuar, konkretisht: plan vendosja e miratuar sipas lejes së ndërtimit dhe në aktin e kolaudimit, përcaktohet ndërtimi i objektit Magazinë me sipërfaqe ndërtimi 977 dhe Repart prodhimi me sipërfaqe ndërtimi 270 m², në total përcakton sipërfaqe ndërtimi totale 1247 m², ndërsa në fakt është regjistruar ndërtesë me sipërfaqe 1400 m². Rezulton se sipërfaqja e bazës së objektit është regjistruar më e madhe, se sa miratuar në dokumentacionin urbanistik, duke krijuar një diferencë **prej 153 m²** (1400-1247), për të cilën mungon dokumentacioni i argumentues. Veprime në kundërshtim me nenin 24/a, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar me ligjin nr. 33, datë 20.03.2012.

(Trajtuar më hollësisht në pikën B/3, faqe 106-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të pezullojë kryerjen e veprimeve mbi pasuritë deri në plotësimin dhe saktësimin e dokumentacionit urbanistik.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit dhe miratimit të lejeve të legalizimit, rezultoi se, me referencë nr. 13024, datë 29.01.2019, është regjistruar pasuria nr. 60/61-Nd, volum 37, faqe 147, “godinë banimi dhe shërbimi, 2, 7, 8 dhe 9 kate me 1 kat nëntokë”, ZK 2679, regjistruar në emër ALUIZNI (subjekti ndërtues “S.” ShPK). Objekti është regjistruar sipas Lejes së legalizimit nr. 137313, datë 20.10.2018, miratuar legalizimi i objektit në shkelje të lejes së ndërtimit. Sipas dokumentacionit disponibël në dosje dhe kornizës referuese gjeodezike, si dhe statusit të pasurive që zë ky objekt, rezulton se **objekti i ndërtuar pozicionohet mbi një kanal kullues** (pasuria nr. 98, regjistruar në volumin nr. 4, faqe 148), ndërsa nuk disponohet asnjë dokument sqarues apo argumentues lidhur me gjendjen funksionale të kanalit dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion i justifikues për këtë qëllim. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën B/4, faqe 108-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

21.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, të marrë masa që për këtë rast dhe në vijimësi, përpara se të kryej procedurat e miratimit dhe regjistrimit të akteve përkatëse, të kërkojë nga institucioni përgjegjës që ka në administrim rrjetin e kullimit (në këtë rast Bordi i Kullimit Tiranë), konfirmimin zyrtar lidhur me gjendjen aktuale të kanalit në raport me objektin e ndërtuar dhe ndikimin e tij, lidhur me funksionimin e kanalit.

Në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II rezultoi:

- Në 1 rast janë regjistruar objekte informale sipas lejeve të legalizimit ku referuar dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objekti ndodhen në buzë të rrugës dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej distancave nga rruga: Me referencën nr. 037016, datë 04.10.2019, është regjistruar pasuria nr. 272/21/1-ND, vol. 135, faqe 119, ZK 3866 Tirana Rurale II

- Në 1 rast janë regjistruar objekte informalë sipas lejeve të legalizimit ku referuar dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objekti ndodhen nën linjat e interkonjeksionit dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej distancës nga linja. Me referencë. 013314, datë 13.09.2019, është regjistruar pasuria nr. 54/83-ND1, vol. 38, faqe. 190, ZK 2679 -Mëzes, Tirana Rurale II. Veprime në kundërshtim me menin 53, pika 1 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” (Më hollësisht trajtuar në pikën B/4, faqe 108-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit në përputhje me nenin 76 “Kontrolli administrativ” të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020. Për pasuritë e regjistruar, sipas lejeve të legalizimit me nr. 272/21/1-ND, vol. 135, fq. 119, ZK 3866; nr. 54/83-ND1, vol. 38, fq. 190, ZK 2679-Mëzes, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të regjistrimit të pasurive të përfituara me leje legalizimi dhe transaksioneve të kryera, u konstatua se DV ASHK Tirana Rurale II, në 7 raste, në ZK 2119 “Katund i Ri”, sipas referencave:

- nr. 00003995, datë 30.01.2019, regjistruar pasuria nr. 223/35-ND;
- nr. 00004000, datë 04.02.2019, regjistruar pasuria nr. 225/51-ND;
- nr. 00004174, datë 17.01.2020, regjistruar pasuria nr. 544/1/61;
- nr. 00004284, datë 11.08.2020, regjistruar pasuria nr. 274/20-ND;
- nr. 00004559, datë 14.06.2021, regjistruar pasuria nr. 208/73;
- nr. 00004624, datë 23.08.2021, regjistruar pasuria nr. 645/392;
- nr. 00004638, datë 07.09.2021, regjistruar pasuria nr. 147/3-ND;

janë regjistruar pasuritë me leje legalizimi, ku rezulton se, sipas hartave treguese të regjistrimit (HTR), duke kryer azhurnimin e pozicionimit të ndërtesës së legalizuar në sistemin shtetëror dixhital Geoportal- ASIG dhe e-planifikimi, në bazë të dhënave koordinative, u konstatua se objektet e legalizuara bien në zona cilat nuk janë të rezervuara për banim, por vetëm për shërbime (social-ekonomike).

Sa sipër lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga ish-ALUIZNI dhe nuk duheshin regjistruar nga DV ASHK Rurale II Tiranë. Sa trajtuar, është vepruar në kundërshtim me vendimin e KKT nr. 1, datë 14.04.2017, “Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B/4, faqe 108-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara sipas referencave;

- nr. 00003995, datë 30.01.2019, regjistruar pasuria nr. 223/35-ND;

- nr. 00004000, datë 04.02.2019, regjistruar pasuria nr. 225/51-ND;
- nr. 00004174, datë 17.01.2020, regjistruar pasuria nr. 544/1/61;
- nr. 00004284, datë 11.08.2020, regjistruar pasuria nr. 274/20-ND;
- nr. 00004559, datë 14.06.2021, regjistruar pasuria nr. 208/73;
- nr. 00004624, datë 23.08.2021, regjistruar pasuria nr. 645/392;
- nr. 00004638, datë 07.09.2021, regjistruar pasuria nr. 147/3-ND;

deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu të ngrihet grup pune për rivlerësimin të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë regjistruar këto pasuri.

Deri më datën 31.12.2022

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se, me Urdhër nr. 51 datë 01.02.2024 është vendosur kufizimi për Pasurinë me Nr. 223/35-ND, regjistruar në Vol: 13, Fq: 35, ZK. 2119, Pasurinë me Nr. 544/61, regjistruar në Vol: 12, Fq:250, ZK. 2119. Nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhërave të kufizimeve për pasuritë:

- nr. 00004000, datë 04.02.2019, regjistruar pasuria nr. 225/51-ND;
- nr. 00004284, datë 11.08.2020, regjistruar pasuria nr. 274/20-ND;
- nr. 00004559, datë 14.06.2021, regjistruar pasuria nr. 208/73;
- nr. 00004624, datë 23.08.2021, regjistruar pasuria nr. 645/392;
- nr. 00004638, datë 07.09.2021, regjistruar pasuria nr. 147/3-ND.

Statusi: I zbatuar pjesërisht

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të regjistrimit ë pasurive të përfituara me leje legalizimi dhe transaksioneve të kryera, u konstatua se DV ASHK Tirana Rurale II, **në 10 raste**, në ZK 2119 “Katund i Ri” dhe ZK 2376 “Lalm” sipas referencave:

- nr. 00004284, datë 11.08.2020, regjistruar pasuria nr. 274/20-ND, Katund i Ri, ZK.2119
- nr. 00003983, datë 15.01.2019, regjistruar pasuria nr. 208/8, Katund i Ri, ZK.2119
- nr. 00004022, datë 07.03.2019, regjistruar pasuria nr. 275/4-ND, Katund i Ri, ZK.2119
- nr. 00004558, datë 11.06.2021, regjistruar pasuria nr. 275/4/ND+1-4/1, Katund i Ri, ZK.2119
- nr. 00004097, datë 30.07.2019, regjistruar pasuria nr. 275/4+1-8/1, Katund i Ri, ZK.2119
- nr. 00004470, datë 17.03.2021, regjistruar pasuria nr. 212/25-ND, Katund i Ri, ZK.2119
- nr. 00000859, datë 09.02.2019, regjistruar pasuria nr. 32/15, Lalm, ZK.2376
- nr. 00000932, datë 17.01.2020, regjistruar pasuria nr. 5/189, Lalm, ZK.2376
- nr. 00000939, datë 20.02.2020, regjistruar pasuria nr. 28/35, Lalm, ZK.2376
- nr. 00000975, datë 03.09.2020, regjistruar pasuria nr. 120/1-ND, Lalm, ZK.2376

janë regjistruar pasuritë me leje legalizimi për godina **me numër katesh më shumë se 2 (dy)**, ku nga auditimi, sipas hartave treguese të regjistrimit (HTR), duke kryer azhornimin e pozicionimit të ndërtesës së legalizuar në sistemin shtetëror dixhital Geoportal- ASIG dhe e-planifikimi, në bazë të dhënave koordinative, u konstatua se objektet e legalizuara **bien në zona të cilat janë të rezervuara për ndërtesa me numër katesh deri në 2 (dy)**.

Sa sipër lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga ish-ALUIZNI dhe nuk duheshin regjistruar nga DV ASHK Rurale II Tiranë.

Vepruar në kundërshtim me Vendimin e KKT nr. 1, datë 14.04.2017, “Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën B/4, faqe 108-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara sipas referencave dhe pasurive:

- nr. 00004284, datë 11.08.2020, regjistruar pasuria nr. 274/20-ND, Katund i Ri, ZK.2119
- nr. 00003983, datë 15.01.2019, regjistruar pasuria nr. 208/8, Katund i Ri, ZK.2119
- nr. 00004022, datë 07.03.2019, regjistruar pasuria nr. 275/4-ND, Katund i Ri, ZK.2119
- nr. 00004558, datë 11.06.2021, regjistruar pasuria nr. 275/4/ND+1-4/1, Katund i Ri, ZK.2119

- nr. 00004097, datë 30.07.2019, regjistruar pasuria nr. 275/4+1-8/1, Katund i Ri, ZK.2119
 - nr. 00004470, datë 17.03.2021, regjistruar pasuria nr. 212/25-ND, Katund i Ri, ZK.2119
 - nr. 00000859, datë 09.02.2019, regjistruar pasuria nr. 32/15, Lalm, ZK.2376
 - nr. 00000932, datë 17.01.2020, regjistruar pasuria nr. 5/189, Lalm, ZK.2376
 - nr. 00000939, datë 20.02.2020, regjistruar pasuria nr. 28/35, Lalm, ZK.2376
 - nr. 00000975, datë 03.09.2020, regjistruar pasuria nr. 120/1-ND, Lalm, ZK.2376
- deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu të ngrihet grup pune për rivlerësimin të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë regjistruar këto pasuri.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se, me Urdhër nr. 51 datë 01.02.2024 është vendosur kufizimi për Pasurinë me Nr. 274/20-ND, regjistruar në Vol: 13, Fq: 180, ZK. 2119, Pasurinë me Nr. 208/8, regjistruar në Vol: 4, Fq: 169, ZK. 2119, Pasurinë me Nr. 212/25-ND, regjistruar në Vol: 14, Fq: 24., ZK. 2119, Pasurinë me Nr. 32/15, regjistruar në Vol: 4, Fq: 226, ZK. 2376, Pasurinë me Nr. 5/189, regjistruar në Vol: 5, Fq: 189, ZK. 2376, Pasurinë me Nr. 120/1-ND, regjistruar në Vol: 5, Fq: 209, ZK. 2376. Nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhërave të kufizimeve për pasuritë:

- nr. 00004022, datë 07.03.2019, regjistruar pasuria nr. 275/4-ND, Katund i Ri, ZK.2119;
- nr. 00004558, dt. 11.06.2021, regjistruar pasuria nr. 275/4/ND+1-4/1, Katund i Ri, ZK.2119;
- nr. 00004097, datë 30.07.2019, regjistruar pasuria nr. 275/4+1-8/1, Katund i Ri, ZK.2119;
- nr. 00000939, datë 20.02.2020, regjistruar pasuria nr. 28/35, Lalm, ZK.2376.

Statusi: I zbatuar pjesërisht

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, u konstatua se, në **3 raste**, në ZK 2119 “Katund i Ri”, nuk janë zbatuar procedurat ligjore të legalizimit të objektit informal, konkretisht:

- Sipas referencës nr. 00004284, datë 11.08.2020, ka regjistruar pasurinë nr. 274/20-ND, ku pozicionimi i pronës në fjalë sipas shkresës nr. 578/2, datë 25.09.2019, parcela ndërtimore sipas lejes së legalizimit nr. 7004945, datë 23.11.2017, prek pasurinë 281/4, vol. 5, fq. 194, **lloji i pasurisë “Rrugë”**,

- Sipas referencës nr. 00004559, datë 14.06.2021, ka regjistruar pasurinë nr. 208/73 dhe sipas referencës nr. 00004624, datë 23.08.2021, ka regjistruar pasurinë nr. 645/392, bazuar në lejet e legalizimit përkatëse., ku origjina rrjedh nga pasuria nr. 543, regjistruar në vol. 5, faqe 245, “Kanal” me sipërfaqe 3750 m², pronë “Shtet”, ndërsa mungon dokumentacioni argumentues për ndryshimin e zërit kadastral kanal. Sa trajtuar, është vepruar në kundërshtim me Vendimin e KM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B/4, faqe 108-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë nr. 274/20-ND, sipas referencës nr. 00004284, datë 11.08.2020, nr. 208/73, sipas referencës nr. 00004559, datë 14.06.2021 dhe nr. 645/392 sipas referencës nr. 00004624, datë 23.08.2021, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu të ngrihet grup pune për rivlerësimin të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit është regjistruar kjo pasuri.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, u konstatua se, në **3 raste**, në ZK 2119 “Katund i Ri”, sipas referencave:

- nr. 00004022, datë 07.03.19, regjistruar pasuria nr. 275/4-ND, LL 130828, datë 16.05.2018;
- nr. 00004558, datë 11.06.21, regj. pas. nr. 275/4-ND+1-4/1, LL 130827, datë 16.05.2018;
- nr. 00004097, datë 30.07.19, regj. pas. nr. 275/4+1-8/1, LL 180809, datë 15.05.2018M

“Shtesë anësore 4 kat ne objektin ekzistues të hipotekuar 4 kate”, ku pozicionimi i pronës në fjalë, përsa i takon parcelës ndërtimore prek pasurinë 281/6, vol. 5, fq. 196, **lloji i pasurisë “Rrugë”**, në kundërshtim me Vendimin e KM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimit të modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B/4, faqe 108-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

26.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë: nr. 275/4-ND, nr. 275/4-ND+1-4/1, nr. 275/4+1-8/1, të regjistruara sipas referencave nr. 00004022, datë 07.03.2019, nr. 00004558, datë 11.06.2021, nr. 00004097, datë 30.07.2019, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu të ngrihet grup pune për rivlerësimin të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë regjistruar këto pasuri.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, u konstatua se, sipas referencës nr. 00004501, ZK 2119 “Katund i Ri”, është regjistruar pasuria nr. 276/41, në vol. 14, faqe 19, Objekt Social-Ekonomik 1 kat, bazuar në Vendimin nr. 195, datë 12.02.2021, me sipërfaqe ndërtimi 330 m², parcela me sipërfaqe 526 m², lëshuar certifikata datë 03.03.2021. Më pas sipas referencës 00004463, datë 03.03.2021, janë ndryshuar sipërfaqet referuar urdhrit nr. 180, datë 20.04.2021, të Drejtorit, ku regjistrohet sipërfaqja e ndërtimit 652.3 dhe parcela ndërtimore 848.3. Është korrigjuar kartela në mungesë të dokumentacionit që argumenton këtë ndryshim.

Veprime në kundërshtim me nenin 24/a të ligjit nr. 111, datë 08.02.2019 “Për Kadastrën” dhe ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B/4, faqe 108-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

27.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 276/41, sipas referencës 00004463, datë 03.03.2021, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se me Urdhër nr. 51 datë 01.02.2024 është vendosur kufizimi për Pasurinë me Nr. 276/41, regjistruar në Vol: 14, Fq: 19, ZK. 2119.,

Statusi: I zbatuar

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II konstatua se: Zbatimi i procedurave për transaksionet dhe veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me vendime gjykate dhe akte të tjera, rezulton se në **2 raste**, nuk janë zbatuar procedurat ligjore lidhur kufizimin e pasurive, konkretisht:

- Me referencë nr. 13694, datë 26.02.2020, është kryer transaksion mbi pasurinë nr. 20/45, volum 32, faqe 219, truall me sipërfaqe 3480 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 1280 m². Duke ju referuar kartelës së pasurive të paluajtshme rezulton se në seksionin “D” me referencë nr. 13660, datë 26.02.2020, është regjistruar kërkesë padia me objekt “Njohje bashkëpronar”, ndërsa është kryer transaksion mbi këtë pasuri në kushtet e kufizimit.

- Me referencë nr. 13952, datë 10.07.2020, është kryer transaksion mbi pasurinë nr. 60/92+2-9, volum 27, faqe 232, apartament me sipërfaqe 58.5 m². Duke ju referuar kartelës së pasurive të paluajtshme rezulton pasuria mëmë ndërtesë (pallat) është regjistruar në volumin 27, faqe 177, ndërsa njësitë janë regjistruar nga volumi 27, faqe 128 deri në volum 28, faqe 9. Me referencë nr. 11803, datë 28.03.2018, është dërguar nga përmbaruesi gjyqësor urdhër për vënien sekuestro në zbatim të Urdhër ekzekutimit nr. 75, datë 28.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Mat, dërguar për zbatim nga Studio Përmbarimore “D. C.”, ndërsa ASHK-ja me shkresën nr. 8320/1, datë 03.04.2018, i ka kthyer përgjigje ku i behët me dije për vendosje sekuestro për pasuritë në pronësi të “S. M.” ShPK. Në fakt ky kufizimi nuk është shtrirë në të gjitha pasuritë, pasi pasuria e sipërtrajtuar nuk ka qenë e kufizuar, duke krijuar mundësinë e tjetërsimit tek persona të tretë. Veprime në kundërshtim me pikën 1/a dhe pikën 3 të nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, nenin 59 të ligjit nr. 33, datë 20.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. (Trajtuar më hollësisht në pikën B/5, faqe 133-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa, **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë që rezultojnë në pronësi të subjekteve debitorë, për të cilat gjykata është shprehur me vendim përkatës për vendosje sekuestro konservative, deri në zgjidhjen e çështjeve dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se me Urdhër nr. 51 datë 01.02.2024 është vendosur kufizimi për Pasurinë me Nr. 20/45, regjistruar në Vol: 32, Fq: 219, ZK. 2679 dhe Pasurinë me Nr. 60/92+2-9, regjistruar në Vol: 27, Fq: 232, ZK. 2679.

Statusi: I zbatuar

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II u konstatua se veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me vendime gjykate dhe akte të tjera, rezulton se, nuk janë në përputhje me procedurat ligjore lidhur me zbatimin e vendimeve të gjykatës të cilët kanë marrë formë të prerë, konkretisht, Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë me Vendimin nr. 2474, datë 19.09.2019, ka vendosur shfuqizimin e AMTP nr. 382, viti 1996, për sipërfaqen 650 m², si dhe AMTP nr. 207, viti 1994 për sipërfaqen 4530 m², në emër të H. Sh. Nga verifikimi i KPP rezulton se në emër të këtij qytetari ka qenë regjistruar në total një sipërfaqe 6250 m² toke arë, nga ku rezulton se është tjetërsuar (para daljes së vendimit të gjykatës) sipërfaqja prej 5200 m², ndërsa rezultojnë akoma në pronësi të tij 2 pasuri: pasuria nr. 39/7-1, arë me sipërfaqe 650 m², për të cilën është vendosur kufizim dhe pasuria nr. 34/72, volum 15 faqe 11, arë me sipërfaqe 650 m², për të cilën nuk është vendosur asnjë kufizim.

Rezulton se nga punonjësit e Drejtorisë Rajonale 2 të ASHK Tiranë nuk është zbatuar vendimi i gjykatës së formës së prerë, për të ndarë dhe kaluar në pronësi “Shtet” pasuritë e llojit arë me sipërfaqe përkatëse 650 m² dhe 483.5 m². Gjithashtu për pasuritë e tjetërsuara nuk janë ndjekur hapat ligjorë deri në kthimin e vlerës së përfituar nga shitja e tyre, e konsideruar si përfitim i padrejtë nga poseduesi i AMTP-ve, të shfuqizuara me vendim gjykate të formës së prerë. Veprime në kundërshtim me pikën 1/a dhe pikën 3 të nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, datë

07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe Vendimin nr. 2474, datë 19.09.2019 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

(Trajtuar më hollësisht në pikën B/5, faqe 133-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

29.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa, **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 39/7-1, dhe pasurinë nr. 34/72, volum 15 faqe 11, ZK 2679, duke njoftuar njëkohësisht poseduesin e këtyre pasurive, si dhe kthimin në pronësi “Shtet”, të sipërfaqeve 650 m² dhe 483.5 m². Gjithashtu për pasuritë e tjetërsuara të ndiqen të gjitha rrugët ligjore, deri në kthimin e vlerës së përfituar nga shitja e tyre, si përfitim i padrejtë nga poseduesi i AMTP-ve.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se, me Urdhër nr. 51 datë 01.02.2024 është vendosur kufizimi për Pasurinë me Nr. 34/72, regjistruar në Vol: 15, Fq: 11, ZK. 2679. Nuk është marrë masë lidhur me vendosjen e kufizimit për pasurinë 39/7-1.

Statusi: I zbatuar pjesërisht

31. Gjetje nga auditimi: ASHK Tirana Rurale II paraqet mangësi dhe parregullsi në dokumentacionin e pasurive paluajtshme, për ZK 2105 Kashar ZK 3321, Sharre, për vitin 2019-2021, konkretisht:

- **54 % mos ngarkesë në sistemin elektronik të referencave** pasurive paluajtshme dhe mos respektimin e numrit kronologjik tyre, për ZK 2105 Kashar. Kështu janë ngarkuar në sistem 511 referenca, në vend 1111 referencave që duhej, pra nuk janë ngarkuar në sistem 600 referenca,

- **në 6 raste**, paraqiten KPP të grisura, vol 23, faqe 1, 2, 3, 4, 5, dhe vol 15, faqe 190, ZK 2105.

- **në 1 rast**, mungon 1 faqe e KPP, përkatësisht faqja 250, vol 23, ZK 2105, Kashar,.

- **në 19 raste**, pasqyrohen bosh KPP, përkatësisht: ZK 2105, Kashar 8 faqe (13, 14, 177, vol 22 dhe faqja 45, 161, 162, 168, 169, vol 23) dhe ZK 3321, Sharre 11 faqe (205 deri 215, vol 17).

- **në 2 raste**, paraqitet dublim faqesh te KPP, vol 15, ZK 2105, përkatësisht: 2 faqe me nr. 190 për pasuritë 1169/2/2 dhe 1205/9 dhe 2 faqe me nr. 191 për pasuritë 1169/2/3 dhe 1205/10,

- **në 1 rast**, KPP qëndron e hapur, në vend që të mbyllet, pasi ka dublim KPP, pasuria 1107/4, vol 16, faqe 189, ZK 2105, Kashar.

- **në 1 rast**, është korrigjuar lloji i pasurisë “Arë” në “Vresht”, në vend vijëzimit me të kuqe, pasuria 1178/24/3, sipërfaqe 400 m², vol 16, faqe 216, ZK 2105.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqet 143-157, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

31.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa:

- për ngarkimin në sistemin elektronik të 600 referencave në ZK 2105 Kashar;

- për plotësimin e 6 KPP te grisura, faqe 1, 2, 3, 4, 5, vol 23, dhe faqe 190, vol 15, ZK 2105;

- për rregullimin dhe sistemimin e 2 rasteve dublim KPP faqe 190 dhe 191;

- për mbylljen e KPP pasuria 1107/4, vol 16, faqe 189, ZK 2105, Kashar;

- për eliminimin e rasteve të lënies bosh të faqeve në mes të volumit pa numër kronologjik;

- për plotësimin e disponimin e KPP të munguar faqe 250, vol 23, ZK 2105, Kashar.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II konstatua se veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me vendime

gjykate dhe akte të tjera, rezulton se, nuk janë në përputhje me procedurat ligjore lidhur me zbatimin e vendimeve të gjykatës të cilët kanë marrë formë të prerë, konkretisht,

Në 1 rast, në ZK 2119 “Katund i Ri”, sipas referencës nr. 00004093, datë 23.07.2019, është regjistruar Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, nr. 676, datë 23.02.2017 lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 747, datë 12.03.2019, vendime të cilat kanë shfuqizuar AMTP nr. 164, datë 20.06.96, për sipërfaqen **1000 m², ndërsa është vepruar duke vendosur kufizim mbi pasurinë, por nuk është proceduar me zbatimin e vendimit të gjykatës së formës së prerë për kalimin në pronësi shtet të sipërfaqen 1000 m²**. Veprime në kundërshtim me pikën 1/a dhe pikën 3 të nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe Vendimin nr. nr. 747, datë 12.03.2019 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqet 143-157, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

32.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të kryejë regjistrimin “Shtet” për pasurinë nr. 225/101/19, “Pëmëtoje”, sipërfaqe 1000 m², regjistruar sipas referencës nr. 00004093, datë 23.07.2019.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II konstatua se, **në 1 rast, në ZK 2119 “Katund i Ri”**, me indicie, duke kaluar më periudhat e kaluara, sipas referencës nr. 2532, datë 20.01.20011 ka regjistruar pasurinë nr. 205/33, të përfituar me leje ndërtimi, ku konstatohet se nuk ndodhet asnjë dokument justifikues për lejen e ndërtimit, të tilla si: kontrate e shitjes se truallit midis Këshillit të Rrethit/Bashkisë dhe blerësit, leja për sheshin e ndërtimit e dhëne nga organi kompetent, leja e ndërtimit miratuar nga KRRT, akti i kolaudimit të objektit, leja e shfrytëzimit ose e banimit të objektit, planvendosja miratuar nga KRRT, si dhe dokumente të tjera qe përcaktojnë dhe individualizojnë objektin e ndërtuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqet 143-157, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

33.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Rurale II të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 205/33, regjistruar sipas referencës nr. 2532, datë 20.01.20011, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II konstatua se **në 1 rast, në ZK 2119 “Katund i Ri”**, me indicie, duke kaluar më periudhat e kaluara, sipas referencës nr. 460, datë 20.09.2011, pasuria nr. 34/2/1, e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 3418, viti 1997, bazuar në **vendimin e Gjykatës Rrethit Tiranë nr. 4453, datë 24.06.1997, për vërtetim fakti juridik të pronësisë, në emër të B. Xh. dhe B. Xh. dhe me kontratën e shit-blejes nr. 4846 rep dhe 1427 kol., datë 01.08.1997, pasuria i ka kaluar z. A. A., e cila më pas është prishur.**

Veprimi i kryer më sipër është në kundërshtim me germën h, neni 193, i ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqet 143-157, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

34.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr nr. 34/2/1, regjistruar sipas referencës nr. 460, datë 20.09.2011 (trualli i objektit), deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu të ngrihet grup pune për rivlerësimin të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit është regjistruar kjo pasuri.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ankesës së shtetasit K. L., u konstatua se: nuk është zbatuar afati i përcaktuar ligjërisht për shqyrtimin e dokumentacionit marrjen e vendimit të kualifikimit apo jo të objektit informal, si dhe lëshimin e lejes së legalizimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C, faqe 143-157, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

35.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II të marrë masa për të shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas deklaratës me nr. Prot. 3625, në datë 27.11.2014 brenda afateve të përcaktuara ligjërisht, duke mundësuar afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë duke rritur edhe transparencën për publikun.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nuk janë rekomanduar masa për shpërblim dëmi ekonomik, si rrjedhojë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar.

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, me nr. 242/18 prot., datë 01.03.2023, sipas Programit të Auditimit 242/1 prot., datë 03.03.2022, janë rekomanduar për zbatim 11 rekomandime për përdorimin e fondeve me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet, për shumën 76,742,500 lekë.

Referuar raportit përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, është konstatuar se, nga 11 rekomandime për përdorimin e fondeve me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet, janë pranuar 11 prej tyre (pranueshmëria e rekomandimeve ka qenë në masën 100%), nga ku:

- 11 rekomandim rezultojnë të pa zbatuar.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, rezultoi se:

- Me Vendimin e Legalizimit nr. 1457, datë 18.08.2021, është kryer legalizimi i objekteve që janë në shkelje të lejeve të ndërtimit, “kompleks banimi 5 & 6 kat”. Parcela ndërtimore 48826.5 m²(pronë e tij, pronë shtet dhe të tretë) sipërfaqja e ndërtimit 8690 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 43342 m²;

- Me Vendimin e Legalizimit nr. 1458, datë 18.08.2021, është kryer legalizimi i objekteve që janë në shkelje të lejeve të ndërtimit, “kompleks banimi dhe shërbimi 14 kat me 1 kat nëntokë”. Parcela ndërtimore 9156.8 m²(pronë e tij, pronë shtet dhe të tretë) sipërfaqja e ndërtimit 2792 m², sipërfaqe totale ndërtimi 30969 m²; vendimet e legalizimit janë lëshuar në favor të shoqërisë “K. D.” ShPK.

Rezulton se procedurat e legalizimit dhe miratimi i parcelës ndërtimore është kryer me shkelje dhe parregullsi, si vijon:

1- Objektet A₁, A₂, A₃, A₄, B₁, B₂, B₃, B₅, C₁ dhe C₂ me sipërfaqe ndërtimi kati përdhe 2717.06 m², për të cilën është lëshuar leje shfrytëzimi nuk duhet të përfshihej në procedurë legalizimi, pasi konsiderohet e miratuar në përputhje me lejen e ndërtimit dhe projektin përkatës;

2- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore, miratuar sipas 2 vendimeve të legalizimit, konkretisht sipërfaqja 48826 m² dhe 9157 m², rezulton më e madhe se 3 fish i bazës së objektit, **duke miratuar më tepër**, me vendimin nr. 1457, datë 18.08.2021, **sipërfaqen prej 21946 m²(48826-26880(8960*3))**, ndërsa me vendimin nr. 1458, datë 18.08.2021, **sipërfaqen prej 780.8 m² (9156.8-8376 (2792*3))**

3 - Referuar statusit të pasurive, rezulton se nga sipërfaqja totale e parcelave ndërtimore, prej 57983 m²(48826+9157), e miratuar me 2 vendimet e legalizimit, nga e cila sipërfaqja prej 34420 m² është pronë e vetë subjektit, sipërfaqja prej 4530 m² është pronë të tretëve (për të cilën do të miratohet VKM për shpronësim), ndërsa sipërfaqja prej 38950 m² është në pronësi “Shtet”. Për sipërfaqen në pronësi “Shtet”, rezulton se subjekti ndërtues ka patur një marrëdhënie qiraje për truallin, kjo bazuar në Para marrëveshje shitblerje dhe qiraje datë 01.11.1995, ndërmjet Këshillit të Rrethit Tiranë (shitësi) dhe shoqërisë “P. Sh. & C. S**.B**” (blerësi, shoqëri malajziane), ku më pas nga kjo kompani kanë kaluar të drejtat tek shoqëria “P.*.*. A.”, e cila ka ndryshuar emrin duke kaluar në “K. D.” ShPK. Kjo marrëveshje nuk e ka humbur fuqinë, pasi Këshilli i Qarkut Tiranë në takimin e me subjektin qiramarrës, me datë 25.09.2001, nuk e ka pranuar kërkesën për shfuqizimin e kësaj marrëveshje, duke i bërë të qartë që ky detyrim qiraje do të vazhdojë deri në marrjen e Lejes së shfrytëzimit të objektit të ndërtuar dhe blerjen e truallit përkatës. Kjo e konfirmuar edhe me auditimin e ushtruar nga qiradhënësi (Këshilli i Qarkut Tiranë), hartuar Memorandum datë 31.08.2008, ku bazuar në çmimin e qirasë për truallin 120 lek/m²/vit, është llogaritur vlera që duhet të paguaj qiramarrësi, për periudhën 01.12.1996 deri 10.01.2007. Bazuar në dokumentacionin gjendje në dosjen e legalizimit, nuk ka dokumentacion lidhur me shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga qiramarrja e sipërfaqes truall prej 38950 m², me pronar shtetin, ndërsa ASHK, para se të përfundonte procedurën e legalizimit, duhet ti kërkonte subjektit përfitues, paraqitjen e dokumentacionit, për shlyerjen e detyrimeve të qiramarrjes së truallit, nga subjekti përfitues “K. D.” ShPK, i cili **duhet të vërtetonte shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e qirasë**, që për këtë sipërfaqe truall prej 38950 m², për periudhën nga 01.08.2010(miratuar leja e shfrytëzimit) deri 01.08.2021, llogaritet në vlerën 51,414,000 lekë(38950*120 lek/m²/vit *11 vite), detyrim i cili mund të jetë shmangur, nga kalimi në proces legalizimi dhe përbën shkelje të disiplinës financiare, si ardhur e munguar në buxhet.

Veprime e mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17(pika 1), ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 22, pika 3, Akt marrëveshja për përcaktimin e marrëdhënies së

qirasë për truallin në pronësi shtet, lidhur ndërmjet shoqërisë ndërtimit dhe Këshillit të Rrethit Tiranë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën A/2, faqet 26-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Rurale II, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të kërkojë informacion nga institucionet shtetërore përkatëse, lidhur me shlyerjen e detyrimeve në vlerën totale **51,414,000 lekë**, si detyrim financiar, që rrjedh nga qiraja për truallin në pronësi shtet, i cili me procedurë legalizimi ka kaluar në pronësi të shoqërisë “K. D.” ShPK. Gjithashtu të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara, sipas lejeve të legalizimit të mësipërme, që rezultojnë të pa tjetërsuara nga shoqëria ndërtuese, deri në marrjen e konfirmimit zyrtar nga institucionet përkatëse, lidhur me shlyerjen e detyrimeve të mësipërme.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

1.2.Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Rurale II të marrë masa, që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfituar më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit, rezulton se, me Leje legalizimi nr. 137313, datë 20.10.2018, është legalizuar objekti në shkelje të lejes së ndërtimit miratuar me Vendimin e KRRT Komuna Kashar nr. 22 datë 27.12.2006, të KRRT-së Komuna Kashar, me sipërfaqe totale ndërtimi 18449 m², miratuar për subjektin ndërtues “S.” ShPK. *Rezultoni se mungon dokumentacioni që vërteton se subjekti ndërtues ka shlyer detyrimet financiare që rrjedhin nga miratimi i lejes së ndërtimit, lidhur me shlyerjen e detyrimit të taksës urbanistike miratuar me vendimin përkatës. Në mungesë të dokumentit financiar që vërteton shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga leja e ndërtimit, subjekti konsiderohet debitor në vlerën 15,973,144 lekë [18449 m² (sip. totale me L. Ndërtimi)*28860 lek/ m² (çmimi referencës viti 2006)*3%(niveli i taksës miratuar nga pushteti vendor)], e cila përbën shkelje të disiplinës financiare, si ardhur e munguar në buxhet.* Veprime e mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, si dhe vendimet përkatëse të këshillave bashkiak.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B/4, faqet 108-, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të kërkojë informacion nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve në vlerën totale **15,973,144 lekë**, si taksa urbanistike që rrjedhin nga përfitimi i lejeve të ndërtimit nga subjekti “S.” ShPK, si dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara në emër të këtij subjekti, deri në marrjen e konfirmimit nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga leja e ndërtimit të përfituar nga shoqëria ndërtuese.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II (ish-Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana Rurale II), rezultoi se: Për periudhën objekt auditimi, janë lëshuar 3587 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Nga 598 fatura të lëshuara, për parcela ndërtimore në total prej 687781 m² lejet e legalizimit 104 fatura për 119376 m² janë me shënimin “Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”, nisur nga çmimet e tokës truall për këto zona, sipas Vendimit të KM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe për sipërfaqet e parcelave ndërtimore, rezulton një shumë që duhej paguar prej subjekteve informale **prej 17,499,393 lekë.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A, faqe 16-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për parcelat ndërtimore prej 119376 m² të pajisur me Leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin të vleftës përkatëse prej 17,499,393 lekë të parcelave ndërtimore.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, ka legalizuar objektin informal, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi me Vendimin nr. 405, datë 19.03.2021, janë legalizuar 2 objekte duke i konsideruar si objekt i vetëm, kur në fakt janë 2 objekte të ndryshme, kjo ka sjellë favorizimin lidhur me detyrimet që rrjedhin për objektin e dytë që legalizohet, lidhur me likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe parcelën ndërtimore. Rezulton se janë shmangur detyrimet që rrjedhin nga legalizimi si objekt i dytë, **në vlerën 614,100 lekë**(89,000+525,100) konkretisht për objektin 1 kat, e cila **përbën shkelje të disiplinës financiare, si ardhur e munguar në buxhet.** Veprime e mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 20/20 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare pronësisë në RSH”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën A/2, faqet 26-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Rurale II, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara me Vendimin nr. 405, datë 19.03.2021, si dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë deri shlyerjen e detyrimeve financiare **në vlerën 614,100 lekë**, që rrjedhin nga shmangia e legalizimit si objekt i dytë për banesën 1 kat në favor të poseduesit të këtij objekti.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II konstatua se: për vitin 2019-2021, në ZK 2105 Kashar dhe ZK 3321 Sharre **në legalizimin e ndërtimeve pa leje, ka mangësi dhe shkelje procedurave e afateve ligjore,** konkretisht:

- Në 5 raste, mungon dokumenti për pagesën e taksës ndikimit infrastrukturës për vlerën **184,587 lekë** për vitin 2019, në kundërshtim me shkresën e Drejtorisë Përgjithshme AKSH Tiranë nr. 1130 datë 31.01.2019, e cila kushtëzon dhënien e lejes legalizimit me derdhjen e taksës infrastrukturës, me nenin 27, germa “ç të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 ‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’ të ndryshuar me ligjin 50/2014 dhe nr. 62/2015, si dhe me nenin 2 të ligjit nr. 10,146 datë 28.9.2009 “Për disa shtesa në ligjin 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore”, përkatësisht:

- Leja e legalizimit 171300 datë 30.08.2019, pasuria 314/172, ZK 3866, sipërfaqe ndërtimi 73.8 m², taksa infrastrukturës **14,347 leke** (73,8 m² x 38881 leke/m² x 0,5%), A. K.;

- Leja e legalizimit 130919 datë 22.05.2018, pasuria 1500/632, ZK 2105, sipërfaqe ndërtimi 135,7 m², taksa infrastrukturës **26,380 leke** (135,7 m² x 38881 leke/m² x 0,5%), L. Xh.;

- Leja e legalizimit 7030053 datë 02.10.2015, pasuria 14/11/1, ZK 2105, sipërfaqe ndërtimi 333 m², taksa infrastrukturës **64,737 leke** (333 m² x 38881 leke/m² x 0,5%), B. S.;

- Leja e legalizimit 76623 datë 11.01.2016, pasuria 435/145, ZK 3321, sipërfaqe ndërtimi 207 m², taksa infrastrukturës **40,242 leke** (207 m² x 38881 leke/m² x 0,5%), H. M.;

- Leja e legalizimit 2625671 datë 23.04.2019, pasuria 411/746, ZK 3321, sipërfaqe ndërtimi 200 m², taksa infrastrukturës **38,881 leke** (200 m² x 38881 leke/m² x 0,5%), N. C.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Njësitë Administrative të Vetëqeverisjes Vendore të marrë masa për njoftim e ndjekje në zbatim të gjitha procedurave, për arkëtimin vleftës përkatëse prej 184,587 lekë si taksë e ndikimit në infrastrukturë.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në 5 raste, ka legalizuar objektin informal, duke mos zbatuar kërkesat ligjore lidhur me miratimin e parcelës ndërtimore, konkretisht:

- Sipas referencës nr. 00004016, datë 15.07.2019, **ZK 2119 “Katund i Ri”**, ka regjistruar pasurinë nr. 976/9/27, e përfituar me leje legalizimi nr. 131154, datë 31.05.2018, ku sipërfaqja e parcelës ndërtimore e tejkalon 3-fishin e bazës së ndërtimit me 116,4 m² [500-(127,9 x 3)]. Kjo diferencë e sipërfaqes totale, të llogaritet me vlerën e tregut të përcaktuar në VKM nr. 514, datë 30.7.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me VKM nr. 89, datë 03.02.2016 në **vlerën prej 52,147 lekë** (116,4 m² x 448 lekë/m²), e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

- Sipas referencës nr. 00003995, datë 30.01.2019, **ZK 2119 “Katund i Ri”**, ka regjistruar pasurinë nr. 223/35-ND, e përfituar me leje legalizimi nr. nr. 7004669, datë 06.11.2017, ku sipërfaqja e parcelës ndërtimore e tejkalon 3-fishin e bazës së ndërtimit me **73 m²** [333.1-(86.7 x 3)]. Kjo diferencë e sipërfaqes totale, të llogaritet me vlerën e tregut të përcaktuar në VKM nr. 514, datë 30.7.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me VKM nr. 89, datë 03.02.2016 në **vlerën prej 32,704 lekë** (73 m² x 448 lekë/m²), e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

- Sipas referencës nr. 00000986, datë 08.10.2020, **ZK 0986 “Lalm”**, ka regjistruar pasurinë nr. 85/10, e përfituar me leje legalizimi nr. 7030355, datë 02.10.2015, ku sipërfaqja e parcelës ndërtimore e tejkalon 3-fishin e bazës së ndërtimit me **167.7 m²** [499.7-(110.5 x 3)]. Kjo diferencë e sipërfaqes totale, të llogaritet me vlerën e tregut të përcaktuar në VKM nr. 514, datë 30.7.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me VKM nr. 89, datë 03.02.2016 në **vlerën prej 12,900 lekë** (88,040-75,140), e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit. Veprime në kundërshtim me Ligjin

nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a, c.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B/4, faqet 108-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë, për shkeljet e konstatuara në **3 raste**, sipas referencave: nr. 00004016, datë 15.07.2019, nr. 00003995, datë 30.01.2019, ZK 2119 “Katund i Ri” dhe 00000986, datë 08.10.2020, ZK 0986 “Lalm”, deri në arkëtimin e **shumës totale prej 97,740 lekë** (52,147+32,704+12,900), në të kundërt të kthehet në pronësi “Shtet” sipërfaqja e përfituar padrejtësisht.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, ka legalizuar objektin informal, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi me referencën nr. 00004528, datë 09.10.2020, ZK 2119 “Katund i Ri”, ka regjistruar pasurinë nr. 272/11/1, sipas lejes së legalizimit nr. 171520, datë 12.12.2019. **Duke ju referuar kartelës së pasurisë, kjo pasuri e regjistruar në vol. 5, faqe 141, Truall 300 m², Ndërtesë 171 m², rezulton pronë “Shtet”, pra nuk kemi të bëjmë me një ndërtim informal, por është tjetërsuar prona “Shtet”, vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, të ndryshuar, si dhe me ligjin nr. 62/2015, neni 2. Në këtë rast tjetërsimi i pasurisë shtet ndërtesë me sipërfaqe 170 m², e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi për qytetin e Tiranës, llogaritet në vlerën 6,609,770 lekë (170 m² x 38,881 lekë/m²), **përbën të ardhura të munguara, dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.****

(Më hollësisht trajtuar në pikën B/4, faqet 108-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 272/11/1, referuar shkeljeve të konstatuara, sipas referencës nr. 00004528, datë 09.10.2020 deri në paraqitjen e dokumentacionit përkatës (të miratimit të prishjes së objektit) nga autoriteti administrues shtetëror, ose arkëtimin e **shumës totale prej 6,609,770 lekë**, që i përket vlerës së objektit të prishur, me pronar shtetin.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se me Urdhër nr. 51 datë 01.02.2024 është vendosur kufizimi për pasurinë me Nr. 272/11/1, regjistruar në Vol: 5, Fq: 141, ZK. 2119.

Statusi: I zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, ka legalizuar objektin informal, duke mos zbatuar kërkesat ligjore lidhur me regjistrimin e pasurisë nr. 107/8, Ndërtesë+ Truall, **trualli 1935 m²**, me referencë nr. 00000072, datë 05.02.2002, ZK 2376 Lalm, me origjinë regjistrimi, kontratë privatizimi të objekteve të ish-kooperativës bujqësore, ndërsa rezulton se në dosjen me këtë referencë mungon kontrata **për marrëdhëniet me truallin**. Në mungesë të dokumentit të fitimit të pronësisë mbi truallin, konsiderohet si regjistrim i parregullt, në favor të qytetarit që ka privatizuar ndërtesën, ndërsa vlera e truallit që duhet të privatizohet, sipas VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, llogaritet **në vlerën 1,015,875 lekë** (525x1935), vlerë e cila aktualisht i mungon buxhetit të shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B/4, faqet 108-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 107/8, referuar shkeljeve të konstatuara, sipas referencës nr. 00000072, datë 05.02.2002, deri në paraqitjen e dokumentacionit përkatës (të fitimit të pronësisë) nga subjekti posedues, ose arkëtimin e shumës totale prej **1,015,875 lekë**, që i përket vlerës së truallit të regjistruar në mungesë të dokumentacionit të pronësisë.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të legalizimit rezultoi se: në lëshimin e lejes së legalizimit **nuk është shlyer detyrimi prej 407,232 lekë** (32 m² x 3 fishin x 4242 lekë/m²) i parcelës ndërtimore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A, faqe 26-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa:

- Të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin e vleftës përkatëse prej 407,232 lekë të parcelës ndërtimore.

- Për pasuritë e regjistruar me nr. 54/83, vol 7, faqe 69 ZK 2679 të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në shlyerjen e detyrimit ligjor.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të legalizimit të shtesave në objektin me leje ndërtimi rezultoi se: nuk administrohet aplikimi i penaliteteve për shtesat në objektet me leje ndërtimi në Lejen e Legalizimit nr. 171794, datë 31.03.2020 për subjektin "F." në vlerën **426,460 lekë** (664 m² x 32,113 lekë/m² x 2 %). Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" neni 43 pika "1.a".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A, faqe 26-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin penalitetit prej 426,460 lekë, i pa aplikuar në lëshimin e Lejes së Legalizimit nr. 171794, datë 31.03.2020.

Brenda datës 31.03.2023

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Tirana Rurale II nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

2.6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Kreun IV, neni 11, gërma d) dhe e), nenet 37, 144, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë",

i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shfuqizuar me ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë: “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 7 punonjës dhe “Vërejtje” për 24 punonjës.

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DP ASHK nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

Tabela nr. 2: Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Lloji i masës	Rekomanduar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	32	30	5	5	-	22
Përm. ligjor	1	1	-	-	-	1
3E	11	11	1	-	-	10
Disiplinore	31	31	-	-	-	31
Totali	75	73	6	5	-	64

Shënim: Vlera totale monetare e rekomandimeve (të cilat janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar) për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e pronës publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të pronës publike është **66,09,770 lekë**.

Burimi i të dhënave DV ASHK Tirana Rurale II

Përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Kamëz - Vorë:

2.1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, janë rekomanduar për zbatim 50 rekomandime gjithsej, nga këto: 26 rekomandime për masa organizative, 1 rekomandim për përdorimin e fondeve me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet (me vlerë 2,191,200 lekë), janë rekomanduar masa disiplinore për 22 punonjës (“Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 9 punonjës dhe “Vërejtje” për 13 punonjës), si dhe është lënë një rekomandim për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, referuar raportit përfundimtar të auditimit me objekt “Auditim përputhshmërie mbi veprimtarinë e drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë”, sipas Programit të Auditimit nr. 1139/1, datë 18.12.2022, ka rezultuar se **subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje** brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, gërma j), ku cilësohet se:

KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre,

për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

- Gjithashtu, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, ku cilësohet se:

Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, referuar rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi, nga KLSH është lënë një rekomandim, përcjellë ky me raportin përfundimtar të auditimit me objekt “*Auditim përputhshmërie mbi veprimtarinë e drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë*”, sipas Programit të Auditimit nr. 1139/1, datë 18.12.2022. Ky rekomandim është si më poshtë vijon:

1.1. Rekomandim: Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamëz - Vorë në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrë masa e të propozojë ndryshime ligjore në VKM nr. 827, datë 30.9.2020 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim”, lidhur me përcaktimin e nivelit tavan të sipërfaqes së truallit funksional nga 300 m² - 500 m², duke patur si prioritet përcaktimet ligjore për **konceptin e truallit funksional**, me qëllim shmangien e zaptimeve të pasurive shtetërore dhe abuzimeve të mundshme në këtë drejtim.

Brenda datës 30.11.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: *Nuk ka komente për këtë rekomandim.*

Statusi: I pazbatuar

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “*Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet*”, sipas Programit të Auditimit nr. 1139/1, datë 18.12.2022, janë rekomanduar për zbatim 26 rekomandime për masa organizative.

Nga auditimi i grupit të auditimit është konstatuar se zbatueshmëria e rekomandimeve të lëna nga KLSH si më poshtë vijon:

Lloji i masës	Propozuar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pa zbatuar
Organizative	26	26	9	2	1	14

Më konkretisht, situata është paraqitur në vijim:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë (ish-Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t), rezultoi se për periudhën objekt auditimi, janë lëshuar gjithsej 6629 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Për këto objekte janë lëshuar 4971 fatura për parcela ndërtimore me sipërfaqe prej 1542738 m² dhe vlerë të faturave prej 958,625,691 lekë, nga e cila likuiduar vlera 616,160,727 lekë, duke mbetur për likuidim vlera prej **342,464,964 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17 (pika 5), si dhe ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A, faqe 19-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelave ndërtimore për objektet e pajisur me leje legalizimi, për likuidimin e vleftës prej **342,464,964 lekë** që i përket vlerës totale të parcelave ndërtimore që janë në pritje të kalimit të pronësisë.

Brenda datës 30.11.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Vazhdon puna për paisjen me fatura të parcelave ndërtimore e cila shoqërohet paralelisht me VKM për shpronësim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi në DV ASHK rezultoi se nuk është bërë likuidimi i vlerës 342,464,964 lekë, që i përket vlerës totale të parcelave ndërtimore që janë në pritje të kalimit të pronësisë sipas Rekomandimit 1.1, të lënë nga auditimi në DV ASHK Kamëz - Vorë, referuar Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022 . Duke qenë se është bërë likuidimi i vetëm një pjesë të kësaj vlere atëherë rekomandimi do të konsiderohet:

Statusi: I zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë rezultoi se: për periudhën objekt auditimi, në **2 raste** është miratuar legalizimi i objekteve informale (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”) dhe ka miratuar kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore për sipërfaqen totale prej 999.5 m², ndërsa duke ju referuar kriterit të trefishit të sipërfaqes së bazës së objektit, duhet të miratohej sipërfaqja totale prej 504 m², veprime që kanë sjellë përfitim të padrejtë nga zotëruesit e lejeve të legalizimit përkatëse, për **sipërfaqen totale prej 495.5 m²**. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17 (pika 1), ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 22, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A, faqe 19-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa, që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfituar më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”).

Brenda datës 31.12.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Në zbatim të pikës c, neni 17, të Ligjit 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin...” i ndryshuar, citohet se pavarësisht funksionit të ndërtimit pa leje përcaktuar në pikën a dhe b të nenit 17, për shkak të përmasave ose planvendosjes së parcelës ndërtimore, krijohen sipërfaqe të lira që nuk mund të shfrytëzohen më vehte për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me VKM. Kalimi i këtyre parcelave kryhet nëse poseduesi i ndërtimit pa leje shpreh vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim, ose në rastet ku kjo kërkesë nuk është paraqitur, me pranimin e faturave

dhe pagesës së parcelës ndërtimore sipas çmimit të referencës, subjekti në heshtje ka rënë dakord. Gjithashtu ju sqarojmë se, nuk janë bërë faturat për këto dy raste.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi rezultoi se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka lëshuar fatura për likuidimin me çmimin e tregut të sipërfaqes së parcelës ndërtimore përfituar më tepër nga subjektet që janë pajisur me leje legalizimi për këto sipërfaqe. Gjithashtu nuk është kryer kthimi i këtyre sipërfaqeve në gjëndjen e mëparshme juridike, referuar Rekomandimit 1.2, të lënë nga grupi i auditimit sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: I pazbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë, **në 15 raste**, legalizimi i objekteve informale është kryer me shkelje dhe parregullsi, pasi:

- **Në 3 raste**, janë kryer legalizime të objekteve sipas lejeve të legalizimit: nr. 702014514, datë 26.08.2020 dosja nr. 8775/2006; nr. 702014291, datë 30.06.2020 dosja nr. 4272/2006, është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar **në buzë të kanaleve kulluese ujëmbledhëse, pa respektuar distancat** dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacioni argumentues;

- **Në 9 raste**, për lejet e legalizimit me: nr. 702014329, datë 20.07.2020, dosja nr. 2/10; nr. 702014495, datë 25.08.2020 dosja nr. 12/6; Vendim legalizimi nr. 1870, datë 10.12.2021 dosja nr. 1986/2006; Vendim legalizimi nr. 1659, datë 18.10.2021 dosja nr. 3508/2006; nr. 702014012, datë 30.03.2020 dosja nr. 44/2006; nr. 702015185, datë 23.10.2020 dosja nr. 26/8; nr. 702013464, datë 19.10.2019 dosja nr. 312/2006; Vendim legalizimi nr. 150, datë 18.02.2021 dosja nr. 1/6; Vendim legalizimi nr. 1037, datë 24.06.2021 dosja nr. 797/2005; sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, Fotografitë e objektit informal, rezulton se objekti ndodhen **nën linjat e Tensionit të Lartë** dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej distancës nga linja. Nuk është marrë konfirmim zyrtar nga OST, lidhur me rrezikun dhe pasojat që mund të sjellë ky pozicionim, në jetën e banorëve të këtyre objekteve;

- **Në 2 raste**, janë kryer legalizime të objekteve sipas Lejes së legalizimit nr. 702013422, datë 30.09.2019, dosja nr. 1017/2005 dhe Lejes së legalizimit nr. 702014664, datë 22.09.2020, dosja nr. 4516/2006 ku rezulton se objekti ndodhet **në buzë të rrugës të rrugës nacionale kategoria "C"**, ndërsa **në 1 rast**, është kryer legalizimi i objektit sipas Lejes së legalizimit nr. 702012735, datë 27.02.2019, dosja nr. 861/2005, i cili **ndodhet brenda rrugës në studim**, referuar PPV të Bashkisë Kamëz", miratuar me Vendimin KKT-së nr. 8, datë 20.12.2012, i ndryshuar;

Veprimet e mësipërme janë kryer ne kundërshtim me: ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", të ndryshuar, ligjin nr. 20/20, datë 05.03.2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", nenin 5, pika 9, ligjin nr. 8518, datë 30.7.1999, "*Për ujitjen dhe kullimin*", të ndryshuar, ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar "*Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë*", neni 2 dhe neni 4 i tij, VKM nr. 280, datë 01.04.2015, VKM nr. 589, datë 10.9.2014, i ndryshuar, VKM nr. 153, datë 07.04.2000 "*Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë*" neni 25, pika 2; VKM nr. 1040 datë 25.11.2020 "*Për përcaktimin e rregullave të zbatimit kritereve legalizimit dhe miratimin e modelit aktit legalizimit, për ndërtimet pa leje*".

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.A, faqe 19-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrijë kontroll administrativ, për të rivlerësuar procedurat e legalizimit dhe marrjen e masave deri në

shfuqizimin e lejeve, për objektet informale të pajisura me leje legalizimi në 15 raste, si më lart. Gjithashtu për këto raste dhe në vijimësi, të kërkohet informacion nga institucionet përkatëse, sipas rasteve, lidhur me gjendjen dhe funksionimin e kanaleve kulluese ujëmbledhëse, apo lidhur me pozicionimin e objektit të legalizuar në raport me brezin e sigurisë dhe ndikimin që mund të ketë në sigurinë e jetës së banorëve, për të bërë të mundur mos legalizimin e objekteve me shkelje të dispozitave ligjore.

Brenda datës 31.12.2022

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: DV ASHK Kamëz - Vorë nuk mund të vijojë me anullimin e lejeve të legalizimit, ndodhur në kushtet se, këto akte janë rregjistruar në rregjistrin e pasurive të paluajtshme dhe janë pajisur me certifikatë pronësie.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi rezultoi se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka kryer rivlerësim të procedurave të legalizimit për objektet informale për 15 raste të cituara në Rekomandimin 1.3 të grupit të auditimit dhe nuk ka bërë anullimin e lejeve të legalizimit për këto raste. Nga sa më sipër, ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies së lejeve të legalizimit nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në 13 raste, nuk është respektuar afati 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren veprim në kundërshtim me: pikën 8 të VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 i ndryshuar, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" i ndryshuar; si dhe në 12 raste nuk është respektuar afati 30 ditor për lëshimin e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit, duke mos respektuar afatet e përcaktuara ligjorisht për shërbimin ndaj qytetarëve, duke krijuar premisa për vonesa në lëshimin e leje të legalizimit, referuar përcaktimeve ligjore pika 8 e VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 i ndryshuar; Pika 2 të VKM Nr. 954, datë 25.11.2015, si dhe me nenin 21 të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A, faqe 19-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë të marrë masa dhe të përgatisë plane konkrete, për të shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas zonave informale dhe brenda afateve të përcaktuara ligjorisht, duke mundur afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë duke rritur edhe transparencën për publikun.

Në vijimësi

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Nga ana e DV ASHK Kamëz - Vorë është mbajtur në konsideratë rekomandimi, me përjashtim të rasteve kur është kërkuar plotësim i dokumentacionit nga ana e vetëdeklaruesit.

Koment nga grupi i auditimit: Nga DV ASHK Kamëz - Vorë nuk janë shqyrtuar të gjitha kërkesat për legalizim në zonat informale, duke përgatitur plane konkrete sipas Rekomandimit 4.1 të grupit të auditimit, referuar Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I zbatuar pjesërisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për transaksionet dhe veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me privatizim, rezultoi se, me referencë nr. 24303, datë 02.12.2020, bazuar në Urdhrin nr. 825, datë 02.12.2020, të Drejtorit të ASHK Kamëz - Vorë, është hequr kufizimi mbi pasurinë e përfituara nga shkëmbimi me truallin mbi të cilin është ndërtuar objekti, konkretisht pasuritë 113/16-G1-G3 dhe pasuritë 113/16-G7-G8, regjistruar në

volum 58 faqe 25-27 dhe faqe 31-32, ZK 2066, duke kaluar pronësia nga subjekti ndërtues tek pronarët e truallit. Origjina e truallit vjen nga privatizimi, sipas kontratës nr. 7418/2302, datë 08.12.1994, ku përcaktohet shitja e truallit me sipërfaqe 5325 m², pas kalimit nga sistemi hipotekor në sistem regjistrimi fillestar, me referencë nr. 16438, datë 10.10.2016, është vendosur kufizim mbi pasuritë, pasi është konstatuar se dokumentacioni i privatizimit është me mungesa, konkretisht: Plan vendosja e pronës së privatizuar dhe mandati i arkëtimit, si dhe mungon kontrata e shkëmbimit ndërmjet pronarëve të truallit dhe shoqërisë ndërtuese. Rezultoni se heqja e kufizimit dhe kalimi i pronësisë të njërive nga subjekti ndërtues tek pronari i truallit janë kryer pa plotësuar kushtet për të cilat ishte vendosur kufizimi, duke kryer shkëmbimin truall-ndërtesë, në mungesë të kontratës së shkëmbimit, ndërmjet pronarit të truallit dhe shoqërisë ndërtuese, si dhe në mungesë të dokumentacionit, të përfituar me kontratë privatizimi. Veprimet e mësipërme janë kryer ne kundërshtim me ligjin nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999 “Për punën në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.1, faqe 49-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë, bazuar në shkeljet e konstatuara, të marrë masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit për pasuritë: nr. 113/16-G1-G3 dhe nr. 113/16-G7-G8, regjistruar në volum 58 faqe 25-27 dhe faqe 31-32, si dhe mbi pasurinë truall me sipërfaqe 5325 m², mbi të cilin është ndërtuar objekti, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda datës 31.12.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 113/16-G1-G3 dhe nr. 113/16-G7-G8, regjistruar në vol. 58, fq. 25-27 dhe fq. 31-32, si dhe mbi pasurinë truall me sipërfaqe 5325 m², mbi të cilin është ndërtuar objekti, referuar Rekomandimit 5.1 të grupit të auditimit, sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të tokave bujqësore dhe transaksioneve e veprimeve të kryera mbi këto pasuri, rezultoi se janë kryer veprime me referencë nr. 24194, 13.05.2020, duke regjistruar në volum 8 faqe 223, pasurinë nr. 190/10, arë me sipërfaqe 5600 m², në emër të 6 bashkëpronarëve “M.”, më pas është tjetërsuar me referencë nr. 28821, datë 27.07.2022. Kjo pasuri është regjistruar bazuar në dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Kamëz me shkresën nr. 1836, datë 02.03.2020, ku nga verifikimi i bërë nga punonjësit e ASHK Kamëz - Vorë, ka rezultuar se parcela nuk ka sipërfaqen 5600 m² (sipas AMTP), por sipërfaqja faktike është 4850 m², për këtë me shkresën nr. 3197/1, datë 14.04.2020, dërguar Bashkisë Kamëz dhe për dijeni aplikuesit, me anë të së cilës i vë në dijeni, që poseduesi të shprehet me deklaratë noteriale për tu pajisur më certifikate për sipërfaqen 4850 m². Bashkia Kamëz me shkresën nr. 2815/1, datë 05.05.2020, konfirmon se nga verifikimet e bëra sipërfaqja është 5600 m² dhe se qytetari nuk pranon të bëjë deklaratë për tu pajisur me certifikatë për sipërfaqen 4850 m². Duke ju referuar plan rilevimit të datës 27.02.2020 dhe atij datë 30.09.2020, si dhe hartës së punës së zyrës së ASHK-së, rezultoni se për tu plotësuar sipërfaqja 5600 m², përfshihet edhe kanali kullues dhe një pjesë deri në kufirin

e argjinaturës së lumit(sipas gjurmëve në hartë). Në këto kushte është regjistruar dhe certifikuar kjo pasuri, ndërsa më pas nga punonjësit e ASHK Kamëz - Vorë nuk është marrë informacion zyrtar nga institucionet përkatëse lidhur me gjendjen dhe funksionimin e kanalit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.2, faqe 52-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa, të kërkojë informacion zyrtar nga institucionet që kanë në administrim pasurinë kanal që është bërë pjesë e pasurisë së regjistruar nr. 190/10, ZK 2066, lidhur me gjendjen aktuale, nëse funksion si kanal apo është kthyer në tokë bujqësore me procedura ligjore. Gjithashtu deri në marrjen e konfirmimit zyrtar, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për këtë pasuri.

Brenda datës 31.10.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 190/10, ZK 2066, referuar Rekomandimit 6.1 të grupit të auditimit, sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të tokave bujqësore dhe transaksioneve e veprimeve të kryera mbi këto pasuri, rezultoi se, në 2 raste, janë kryer veprime mbi pasuri të përfituara me AMTP, duke mos zbatuar procedurat ligjore, konkretisht:

- **Me referencë nr. 27434**, datë 20.12.2021, janë kryer veprime mbi pasurinë nr. 345/32, volum 86 faqe 147, arë me sipërfaqe 3400 m², lëshuar certifikatë pronësie datë 20.12.2021.

Duke ju referuar origjinës së regjistrimit të këtyre pasurive rezultoi se janë regjistruar bazuar në AMTP nr. 528, pa datë, lëshuar në emër të M. M. Sipas këtij akti ka përfituar tokë arë me sipërfaqe 9000 m², ndërsa referuar kartelave të pasurive, rezultoi se për këtë familje bujqësore janë regjistruar në total 3 pasuri me sipërfaqe totale 13000 m², nga e cila zotëron pasurinë arë me sipërfaqe totale 6000 m² dhe ka tjetërsuar pasuritë arë me sipërfaqe 7000 m², pra regjistruar më tepër sipërfaqja prej 4000 m²(13000-9000), ndërsa nuk është bërë një bilanc i sipërfaqes që ka përfituar me akt pronësie me atë të regjistruar në fakt.

- **Me referencë nr. 565**, datë 13.08.2021, ZK 3319, janë kryer veprime për regjistrimin e pasurive bazuar në deklarata noteriale për heqje dorë, konkretisht: pasuria nr. 316/11, volum 1 faqe 126, arë me sipërfaqe 8400 m²; pasuria nr. 316/12, volum 1 faqe 123, arë me sipërfaqe 3690 m²; pasuria nr. 316/30, volum 1 faqe 105, arë me sipërfaqe 2060 m² korrigjuar në 2800 m² dhe pasuria nr. 316/10, volum 1 faqe 129, arë me sipërfaqe 3000 m². Të gjitha këto pasuri janë regjistruar në emër të H. D., bazuar në AMTP nr. 16, (e cila ka përcaktuar 5 pasuri me sipërfaqe totale 18870 m²), më pas të gjitha këto pasuri janë tjetërsuar tek të tretët. Gjithashtu për qytetarin H. D., bazuar në AMTP nr. 16 rezultojnë të regjistruara edhe këto pasuri: nr. 320/9, volum 1 faqe 39, arë me sipërfaqe 12000 m²(e tjetërsuar), nr. 173/9, volum 1 faqe 40, arë me sipërfaqe 4000 m², nr. 44, volum 2 faqe 68, pemëtores me sipërfaqe 1400 m², nr. 43/6, volum 3 faqe 13, ullishte me sipërfaqe 13400 m² (këto pasuri janë regjistruar referencë nr. 134, viti 2006). Rezultoi se në total në emër të poseduesit të AMTP-së nr. 16, është regjistruar sipërfaqja totale prej 29800 m², ndërsa referuar AMTP-së përcaktohet sipërfaqja totale prej 18870 m², ka përfituar më tepër, sipërfaqen prej 29800 m²(48700-18900). Veprimet e mësipërme janë kryer në

kundërshtim me Ligji nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të amtp-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.2, faqe 52-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë që rezultojnë në pronësi të familjes M. M. dhe në emër të familjes H. D., deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë që shërben për regjistrimin e pasurisë, ose kalimin në pronësi “Shtet” të sipërfaqeve të përfutuar më tepër, prej 4000 m² dhe 29800 m², se sa përcakton AMTP-ja përkatëse.

Brenda datës 31.12.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në pronësi të M. M. dhe në emër H. D. Këta individë kanë përfutuar sipërfaqe më tepër sesa përcakton AMTP-ja përkatëse, referuar Rekomandimit 7.1 të grupit të auditimit, sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të tokave bujqësore dhe transaksioneve e veprimeve të kryera mbi këto pasuri, rezultoi se, në 2 raste, janë kryer veprime mbi pasuri të përfuturara me AMTP, duke mos zbatuar procedurat ligjore, konkretisht:

- **Me referencë nr. 1231**, janë kryer veprime duke regjistruar pasurinë nr. 304/5, volum 6, faqe 141, arë me sipërfaqe 310 m², regjistruar për S. B. dhe 5 bashkëpronarët, sipas AMTP-së nr. 151/1, viti 1996. Me shkresën nr. 32528, datë 26.05.2022, DV ASHK Kamëz - Vorë, i ka kërkuar Bashkisë Vorë konfirmimin për AMTP-në, pasi AMTP-së nr. 151/1, nuk ndodhet në arkivin e ASHK-së. Bashkia Vorë me shkresën nr. 130, datë 04.07.2022, ka kthyer përgjigje, ku i referohet AMTP-së fotokopje që disponon qytetari, si përfutues i tokës me sipërfaqe 310 m².

Në këto kushte është kryer regjistrimi i pasurisë arë me sipërfaqe 310 m², në favor të qytetarit, ndërsa AMTP-ja nuk është origjinale, si dhe në mungesë të formularit nr. 6;

- **Me referencë nr. 4561**, datë 23.12.2022, janë kryer veprime duke regjistruar pasurinë nr. 133/34, volum 17, faqe 86, arë me sipërfaqe 5100 m², regjistruar për I. D., sipas AMTP-së nr. 484, viti 1996, e cila ka shënimin “dublikatë”. Gjithashtu në emër të këtij qytetari është regjistruar më parë edhe pasuria nr. 200/7, arë me sipërfaqe 8500 m², volum 3 faqe 44, bazuar në AMTP nr. 44. Në këto kushte është kryer regjistrimi i pasurisë arë me sipërfaqe 5100 m², në favor të qytetarit I. D., **i cili rezulton se zotëron 2 AMTP, dhe kjo që ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë nr. 133/34, ka shënimin dublikatë**, gjithashtu nuk është bërë konfirmimi referuar formularit nr. 6, i cili është dokumenti bazë që vërteton se qytetari ka përfutuar tokë, kur AMTP-ja nuk përmbush elementët e formës dhe përmbajtjes apo nuk është origjinal.

Veprimet e mësipërme janë kryer ne kundërshtim me VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të amtp-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.2, faqe 52-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë, bazuar në shkeljet e konstatuara të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 133/34, volum 17, faqe

86, arë me sipërfaqe 5100 m² dhe pasurinë nr. 304/5, volum 6, faqe 141, arë me sipërfaqe 310 m², deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda datës 30.11.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përçjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 133/34, volum 17, faqe 86, 'arë' me sipërfaqe 5100 m² dhe pasurinë nr. 304/5, volum 6, faqe 141, 'arë' me sipërfaqe 310 m², referuar rekomandimit 8.1 të grupit të auditimit, sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga ana e DV ASHK Kamëz - Vorë, për regjistrimin e AMTP-ve në kuadër të VKM nr. 1174 datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e Pronat shërbyese", pothuajse në të gjitha rastet, lista e përfituesve të tokës bujqësore nuk përfshihet si dokumentacion tekniko-ligjor në referencat e regjistrimit, e për rrjedhojë nuk identifikohet gjurma e auditimit sesi është realizuar procesi i konfirmimit se qytetari ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.2, faqe 52-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa për përfshirjen e listës së përfituesve të tokës bujqësore në çdo praktikë regjistrimi, duke e shoqëruar me një relacion ku të evidentohet i gjithë dokumentacioni i shqyrtuar për legjitimitetin e subjektit përkatës si përfitues i tokës bujqësore.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Për këtë proces janë bazuar në pikën 11, të VKM 1174, datë 24.12.2020 ku parashikohet se: a) Për familjet përfituese nga ish-kooperativat bujqësore, certifikata e gjendjes familjare të datës 1.8.1991 dhe e momentit të regjistrimit; b) Për familjet përfituese nga ish-ndërmarrjet bujqësore certifikatën e gjendjes familjare të datës 1.8.1991 me ndryshimet e ndodhura deri më 1.10.1992, si dhe ajo e momentit të regjistrimit; c) Për familjet që kanë përfituar tokën, për të cilën u është hequr pronësia atyre ose trashëgimlënësve të tyre, vërtetim/akt/dokument zyrtar për pronësinë e tokës, para vitit 1946, si dhe dëshmia e trashëgimisë, nëse është rasti.

Koment nga grupi i auditimit: Nga kontrolli i bërë në sistem në prani të punonjësit të DV ASHK Kamëz – Vorë, z. R. B., rezultoi se kjo drejtori ka përfshirë listën e përfituesve të tokës bujqësore në praktikën e regjistrimit, duke e shoqëruar me relacionin përkatës. Për arsyet më sipër, ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Me referencë nr. 2066, me numër 17122 aplikimi datë 25.08.2020 në emër të z. R. J., bazuar në AMTP me nr. 35 datë 11.09.1999 dhe në bazë të planit të rilevimit është kryer regjistrimi i një sipërfaqeje prej 1500m², e pozicionuar në pasurinë me nr. 10/16 e afishuar në vol.4 faqe 200 zk.1514-Domje me sipërfaqe 2880 m² arë në pronësi shtet. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në AMTP përkatëse është shënuar se "ngastra 160/16 është në përdorim", konfirmuar edhe në shkresën e Bashkisë Vorë me nr. 426 prot., datë 27.0.2019, nga ku rezulton edhe një fakt tjetër, se nga korrespondenca e bashkisë me Agjencinë e Trajtimit të Pronave, për këtë pasuri ka pretendime një qytetare tjetër. Sa më sipër, regjistrimi

i pasurisë me nr. 160/46, vol.11, fq.237 me sipërfaqe 1500m² në emër të z. J. është në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil dhe VKM nr. 994/2015 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve”. Me referencë nr. 2078 datë 29.09.2020 kjo pasuri ka pësuar transaksion te të tretët, përmes një deklarate për heqje dore.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.2, faqe 52-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë, bazuar në shkeljet e konstatuar, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë me nr. 10/16 e afishuar në vol.4 faqe 200 zk.1514-Domje, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu në vijimësi për rastet kur në AMTP konstatohet shënime se “ngastra është dhënë në përdorim”, të mos kryejë regjistrime të ngastrave përkatëse pa shqyrtuar në tërësi dokumentacionin e ndarjes së tokës.

Brenda datës 30.11.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë me nr. 10/16, e afishuar në vol. 4, faqe 200, ZK1514, Domje, referuar Rekomandimit 10.1 të grupit të auditimit, sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Me referencë 2884 datë 30.03.2021 në emër të znj. F. L. është bërë ndarja e pasurisë me nr. 800/7 me sipërfaqe 1700 m² arë në tre pasuri : nr. 800/10 me sipërfaqe 1085.1 m² arë; nr. 800/9 me sipërfaqe 420 m² arë; nr. 800/8 me sipërfaqe 194.9 m² arë. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se pasuria me nr. 800/10 me sipërfaqe 1085.1m² arë, e përfituar si pasuri “bijë” nuk përputhet nga ana hartografike me konfigurimin e pasurisë nr. 800/7 me sipërfaqe 1700 m², e për rrjedhojë është përfituar një pasuri me sipërfaqe 1085.1 m² arë, kufij të cilës janë jashtë konfigurimit të pasurisë “mëmë”. Kjo ka ndodhur për shkak se me aplikimin nr. 8183 të datës 26.03.2021 për shërbimin e lëshimit të kopjes së fragmentit të hartës kadastrale është ndryshuar konfigurimi i pasurisë nr. 800/7, duke u shtrirë në pasuri pa informacion.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.2, faqe 52-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa për kufizimin e pasurisë me nr. 800/10, me sipërfaqe 1085 m² deri në korigjimin e konfigurimit të pasurisë, në përputhje me konturet e pasurisë së origjinës.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë me nr. 800/10, me sipërfaqe 1085 m², referuar rekomandimit 11.1, të grupit të auditimit sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Me referencë nr. 557, datë 10.06.2021 në emër të z. H. D. është bërë regjistrimi i pasurisë në ZK Shargë me nr. 43/14 me sipërfaqe trualli 300 m² dhe sipërfaqe

ndërtimi 172.8 m². Dokumentacioni i administruar për realizimin e regjistrimit përfshin shkresën nr. 448 prot., datë 01.04.2000 të Bashkisë Vorë, sipas listave 01 të trojeve dhe ndërtesave. Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nga ana e hartografike ndryshon pozicionimi i objektit të regjistruar, konkretisht plani i rievimit ka një pozicion ndryshe me pozicionin që mbart në regjistrimin fillestar të pasurive.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.2, faqe 52-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa që të rivlerësojë dosjen përkatëse, duke verifikuar dhe konfirmuar nëse objekti është ndërtim i para vitit 1991 (në bazë të ortofotove), në të kundërt të vendoset kufizim për pasurinë.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka bërë rivlerësim të dosjes dhe nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë në emër të z. H. D., ndodhur në ZK Shargë, me nr. 43/14, me sipërfaqe trualli 300 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 172.8 m², referuar rekomandimit 12.1 të grupit të auditimit, sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Me referencë nr. 2846 datë 02.06.2021 në zonën kadastrale Muçaj në emër të z. N. P. është bërë regjistrimi i pasurisë nr. 482/3 me sipërfaqe 2270m² e llojit “arë”. Dokumentacioni i administruar për regjistrimin e kësaj pasurie është një AMTP nr. 274/1 datë 23.04.1995 me sipërfaqe totale 2470 m². Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se:

-Pasuria me nr. 482/3 është regjistruar përmes afishimit, pasi nuk ka patur kartelë. Sipas librit të tokë së ish-NB Vorë-Gjokaj, kjo pronë prek dy pasuri, konkretisht nr. 452, me sipërfaqe 1700 m², me zë kadastral “kullotë” dhe pasurinë me nr. 660 me zë kadastral “tokë pa fryt”, të cilat sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për Tokën” nuk kane qenë objekt i shpërndarjes së tokës bujqësore.

- Qytetari N. P. rezulton se posedon dy AMTP, konkretisht edhe një AMTP në Marqinet me sipërfaqe 11,000 m² arë.

Bazuar në VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shitesë e pronat shërbyese”, pikës 20, Kreu III Kur, gjatë procesit të regjistrimit, nga ASHK-ja konstatohet se për të njëjtin përfitues ka më shumë se një AMTP, në të cilat është disponuar për sipërfaqe të ndryshme toke, do të regjistrohet ajo, të dhënat e së cilës vërtetohen nga dokumentacioni i ndarjes së tokës. Përgjatë kësaj, ky kriter nuk aplikohet për përfituesit e AMTP-ve, të cilët kanë përfituar tokën, për të cilën u është hequr pronësia atij, ose trashëgimlënësit gjatë krijimit të ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore, rast në të cilin zbatohen parashikimet e shkronjës “c”, të pikës 7, të këtij vendimi.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.2, faqe 52-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa për kufizimin e pasurisë me nr. 482/3 me sipërfaqe 2270 m² e llojit “arë”, përfshirë pasuritë e regjistruara në Marqinet, në emër të N. P. deri në verifikimin dhe konfirmimin se cila nga dy AMTP që zotëron qytetari mbështetet me dokumentacionin e ndarjes së tokës.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë me nr. 482/3, me sipërfaqe 2270 m², e llojit “arë”, regjistruar në Marqinet, në emër të z. N. P., referuar rekomandimit 13.1 të grupit të auditimit, sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Me referencë nr. 1062, datë 25.03.2021, në zonën kadastrale Gjoka, në emër të z. M. S. është bërë regjistrimi i pasurisë me nr. 297/25, vol.6 faqe 55 me sipërfaqe 1000 m², sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 129 datë 20.10.1996. Nga auditimi i praktikës së regjistrimit të pasurisë rezultoi se mungon dokumentacioni i kërkuar nga VKM nr. 1174 datë 21.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”, si kërkesa e pikës 6.1 ku përcaktohet se subjekti përfitues i AMTP-së legjitimohej për të përfituar tokë sipas akteve ligjore dhe nënligjore të kohës për tokën bujqësore. Në kuptim të kësaj pike, legjitimohet përfituesi i AMTP-së, nëse ka qenë anëtar i ish-kooperativës bujqësore dhe banor në datën 1.8.1991, i fshatit ku gjendej ish-kooperativa bujqësore.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.2, faqe 52-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa për kufizimin e pasurisë me nr. 297/25, vol.6 faqe 55 me sipërfaqe 1000 m² deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, veçanërisht konfirmimin e legjitimitetit të AMTP-së, sipas listës së përfituesve të tokës bujqësore.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë me nr. 297/25, vol.6 faqe 55, me sipërfaqe 1000 m², regjistruar në Gjokaj, në emër të z. M. S., referuar rekomandimit 14.1 të grupit të auditimit, sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të pasurive sipas lejeve të ndërtimit dhe ligjeve urbanistike, rezultoi se **në 2 raste**, janë kryer veprime duke mos respektuar kërkesat ligjore, konkretisht:

Me referencë nr. 23172, datë 05.03.2020, ZK 2066, janë kryer veprime duke regjistruar pasurinë nr. 4/101, truall me sipërfaqe 3790 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 53 m². Origjina e regjistrimit të pasurisë rrjedh nga leje ndërtimi, dërguar për regjistrim nga Bashkia Kamëz me shkresën nr. 376, datë 08.03.2007, bashkëlidhur dokumentacioni urbanistik, ku përcaktohet se objekti i ndërtuar ka sipërfaqe 53 m², i cili është regjistruar sëbashku me sheshin e miratuar me sipërfaqe 3790 m². Në fakt regjistrimi i truallit në funksion të objekt duhet ti përmbahej koeficientit të shfrytëzimit të miratuar 26%, që i përket trualli me sipërfaqe 590 m², ndërsa

punonjësit e ASHK duhet të kërkonin konfirmim nga Bashkia Kamëz, përpara se të regjistronin si truall pjesën tjetër të sheshit me sipërfaqe 3200 m²(3790-590).

Me referencë nr. 27035, datë 20.10.2021, ZK 2066, janë kryer veprime duke regjistruar është regjistruar pasuria nr. 94/347/0+0, truall me sipërfaqe 700 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 176 m², lëshuar certifikatë pronësie datë 20.10.2021. Origjina e regjistrimit të objektit rrjedh nga leje ndërtimi, dërguar për regjistrim nga Bashkia Kamëz me shkresën nr. 535, datë 02.10.2003. Gjatë kalimit të zonës në sistem regjistrimi fillestar, ish ZVRPP e ka refuzuar regjistrimin e kësaj pasurie, me argumentin se “Mungon dosja fizike që përmban dokumentacionin”, për këtë është kërkuar rikonfirmim dhe ridepozitim i dosjes nga Bashkia Kamëz. Nga verifikimi i dokumentacionit gjendje në dosje rezulton se, dosja përmban dokumentacion urbanistik(të skanuar njehsur me vulën e Bashkisë Kamëz), i cili ka mospërputhje lidhur me sipërfaqen e sheshit dhe sipërfaqen e gjurmës së objektit, gjithashtu mungon shkresa përcjellëse nga Bashkia Kamëz, ku të konfirmohej dokumentacioni urbanistik i kërkuar, për të vazhduar procedurën e regjistrimit të kësaj pasurie. Veprime në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”; UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” dhe Rregullore nr. 184, datë 08.04.1999.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.3, faqe 62-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Kamëz - Vorë, të marrë masa, që në çdo rast ku konstatohen mos përputhje të dhënash në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim, të kërkojë rikonfirmim zyrtar nga institucioni që ka lëshuar aktin përkatës. Gjithashtu lidhur me përmbajtjen e dokumentacionit urbanistik që i përket referencës nr. 27035, të kërkohet rikonfirmim nga Bashkia Kamëz, deri në marrjen e konfirmimit zyrtar të pezullojë kryerjen e veprimeve mbi pasuritë përkatëse.

Brenda datës 30.11.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim, për pasurinë me nr. 94/347, ZK 2066 sipas referencës nr. 27035.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi apo pezullimi për pasurinë me nr. 4/101, truall me sipërfaqe 3790 m², ndërtesë me sipërfaqe 53 m² dhe pasurinë me nr. 94/347/0+0, truall me sipërfaqe 700 m², ndërtesë me sipërfaqe 176 m², dërguar për regjistrim nga Bashkia Kamëz, si dhe nuk ka konfirmim për këto pasuri, referuar rekomandimit 15.1 të grupit të auditimit, sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Me referencë nr. 4049, datë 27.05.2020, në zk. Marikaj në emër të z. N. S. është bërë regjistrimi i pasurisë nr. 43/31 me sipërfaqe 300 m² truall dhe 153 m² ndërtesë, me shënim “pikë shpërndarje karburanti, magazinë dhe banesë 2 kt”.Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se:

- Në akt-kontrollin përfundimtar përcaktohet se “meqenëse investitori nuk ka ndërtuar edhe objekte të reja si magazinë dhe banesë, objekte këto të miratuara në mbledhjen e KRRT-së, investitorit nga sipërfaqja e sheshit prej 1500 m² të miratuar, t’i kalojë për “leje shfrytëzimi” sipërfaqja prej 300m², e mjaftueshme kjo për funksionimin e pikës së karburantit”. Si konkluzion, regjistrimi i objektit “magazinë+ ndërtesë” nuk është në përputhje me aktin e kontrollit përfundimtar.

- Leja e shfrytëzimit është dhënë vetëm për pikën e karburantit, pa përfshirë magazinën dhe banesën.

- Leja e ndërtimit nuk ka të përcaktuar në rubrikën përkatëse sipërfaqen e ndërtesës.

- Planimetria e sheshit të ndërtimit nuk përputhet me gjurmën e plan-rilevimit të objektit të regjistruar. Me referencë nr. 4048 për këtë pasuri është realizuar transaksion te të tretët. Veprime në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”; UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruarit”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.3, faqe 62-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë, në çdo rast të refuzojë regjistrimin e lejeve të ndërtimit kur konstaton se ka ndryshime në lejen e shfrytëzimit dhe kur planimetria e sheshit të ndërtimit nuk përputhet me gjurmën e plan-rilevimit të objektit të regjistruar.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Në lidhje me rekomandimin Sektori i Regjistrimit është njohur me raportin për rastet analoge që do të përcillen për regjistrim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi i bërë në sistem në prani të punonjësit të DV ASHK Kamëz – Vorë, z. R. B., rezultoi se kjo drejtori i është referuar rekomandimit 16.1 të grupit të auditimit për rastet kur ka pasur ndryshime në lejen e shfrytëzimit dhe kur planimetria e sheshit të ndërtimit nuk përputhet me gjurmën e plan-rilevimit të objektit të regjistruar. Për sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I zbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Me referencë nr. 1422, aplikim nr. 12683 datë 29.06.2020 në zonën kadastrale Kodër-Vorë në emër të z. Xh. R. është bërë regjistrimi i pasurisë nr. 90/32-nd me sipërfaqe 100 m² ndërtesë. Nga verifikimi i dokumentacion rezultoi se dokumentacioni i lejes së ndërtimit nuk është konfirmuar nga institucioni përkatës që e ka lëshuar atë si dhe i mungon akti i kolaudimit. Në vendimin për sheshin e ndërtimit përcaktohet se leja është dhënë në emër të dy personave, pra z. Xh. R. dhe z. Q. M., ndërsa regjistrimi është kryer vetëm në emër të z. Xh. R. Veprime në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”; UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruarit”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.B.3, faqe 62-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Kamëz - Vorë, të marrë masa, të kërkojë konfirmim zyrtar nga Bashkia Vorë lidhur me përmbajtjen e dokumentacionit urbanistik, deri në marrjen e konfirmimit zyrtar të pezullojë kryerjen e veprimeve mbi pasuritë përkatëse.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi apo pezullimi për pasurinë me nr. 90/32-ND, me sipërfaqe 100 m², ndërtesë në emër të z. Xh. R., në ZK Kodër-Vorë. Nga Bashkia Vorë nuk ka konfirmim për këtë pasuri, referuar rekomandimit 17.1 të grupit të auditimit, sipas Programit të Auditimit 1139/1, datë 18.12.2022, në DV ASHK Kamëz - Vorë. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

18. Gjetje nga auditimi: Auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit dhe miratimit të lejeve të legalizimit, rezultoi se, me referencë nr. 26129, datë 03.06.2021, është regjistruar pasuria nr. 105/19, volum 83, faqe 133, truall me sipërfaqe 499.1 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 136.2 m², ZK 2066. Regjistrimi është kryer sipas Lejes së legalizimit nr. 70202163, datë 19.02.2016. Sipas dokumentacionit disponibël në dosje, hartave të punës, si dhe statusit të pasurive rezultoi se **objekti i ndërtuar pozicionohet pranë një kanali kullues**(pasuria nr. 314), ndërsa nuk disponohet asnjë dokument sqarues apo argumentues lidhur me gjendjen funksionale të kanalit, ndaj nuk duhet të procedohej me regjistrimin e lejes së legalizimit, por duhet të kushtëzohet me një konfirmim prej autoriteteve të ujit. Veprime në kundërshtim me nenin 47 të Ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe ligjin nr. 8518, datë 30.7.1999, “Për ujitjen dhe kullimin”, të ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në pikën B/4, faqe 68-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë të marrë masa ti kërkojë Bashkisë Kamëz, apo çdo institucioni tjetër përgjegjës (Bordi i Kullimit Tiranë), që ka në administrim kanalën kullues, konfirmimin zyrtar lidhur me gjendjen aktuale të kanalit në raport me objektin e ndërtuar dhe ndikimin e tij, lidhur me funksionimin e kanalit. Gjithashtu deri në marrjen e konfirmimit zyrtar të kufizohen veprimet mbi pasurinë e regjistruar me leje legalizimi.

Brenda datës 31.12.2023

<p>Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Në referencën nr. 26129 zona kadastrale 2066 ndodhet konfirmimi i Bashkisë Kamëz, e cila konfirmon se kanali kullues nuk ekziston aktualisht.</p>
--

Statusi: I zbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit të pasurive sipas të regjistrimit dhe miratimit të lejeve të legalizimit, rezultoi se **në 2 raste**, janë kryer veprime duke mos respektuar kërkesat ligjore, konkretisht:

- **Me referencë nr. 26124**, datë 03.06.2021 ZK 2066, janë kryer veprime duke regjistruar në volum 10 faqe 145, pasuria nr. 8/38 truall me sipërfaqe 430.1 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 104.5 m², sipas Vendimit të legalizimit nr. 313, datë 12.03.2021. Rezulton se *parcela ndërtimore, përbëhet nga pasuritë nr. 8/138*, volum 10, faqe 145, truall 410 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 78 m² në pronësi “Shtet”, kësaj pasurie i është shtuar sipërfaqja prej 20.1 m², e cila është shkëputur nga pasuria nr. 8/252 e llojit “rrugë”.

- **Me referencë nr. 23037** datë 05.03.2020, ZK 2066, janë kryer veprime duke regjistruar në volum 10 faqe 161, pasuria nr. 8/54 truall me sipërfaqe 436.5 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 94.3 m², sipas Lejes së legalizimit nr. 70209834, datë 17.04.201. Rezulton se *parcela ndërtimore, përbëhet nga pasuritë nr. 8/54*, volum 10, faqe 161, truall 410 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 96 m² në pronësi “Shtet”, kësaj pasurie i është shtuar sipërfaqja prej 26.5 m², e cila është shkëputur nga pasuria nr. 8/265 e llojit “rrugë”. Nga mos verifikimi i saktë i dokumentacionit hartografik, është regjistruar si pjesë e parcelës ndërtimore , pasuria e llojit “rrugë” për sipërfaqet respektive prej 20.1 m² dhe 26.5 m²;

Veprime në kundërshtim me pikën 2 të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrin të regjistruesit” dhe Rregullore nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën B/4, faqe 68-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Kamëz - Vorë, të marrë masa, të kërkojë rikonfirmim zyrtar nga Bashkia Kamëz që ka në administrim pasurinë rrugë, lidhur me, ekzistencën e projekteve apo studimeve, që përcaktojnë gjendjen dhe përmasat e rrugës funksionale, si dhe ndikimin që sjellë ky regjistrim. Gjithashtu deri në marrjen e konfirmimit zyrtar të kufizohen veprimet mbi pasurinë e regjistruar me leje legalizimi.

Brenda datës 31.12.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Në lidhje me referencën nr. 26124 është kërkuar konfirmim nga Bashkia Kamëz sipas shkresës nr. 3379 prot., datë 01.06.2023 e cila ka konfirmuar me shkresën nr. 4535/1 prot., datë 25.09.2023 se nuk ka projekt të miratuar. Në lidhje me referencën nr. 23037 është kërkuar konfirmim nga Bashkia Kamëz me shkresën nr. 4558 prot., datë 16.06.2023 e cila ka konfirmuar me shkresën nr. 4858/1 prot., datë 16.06.2023 se nuk ka projekt të miratuar.

Statusi: I zbatuar

20. Gjetje nga auditimi: Auditimi i zbatimit të procedurave të regjistrimit dhe miratimit të lejeve të legalizimit, rezultoi se, me referencë nr. 28084, ZK 2066, është regjistruar pasuria nr. 129/845 truall me sipërfaqe 243.2 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 96.6 m², sipas Vendimit së legalizimit nr. 1747, datë 04.11.2021. Rezulton se procedura e regjistrimit nuk është në përputhje me kërkesat dhe kriteret, pasi gjatë regjistrimit është konstatuar se objekti i legalizuar bie mbi objektin në pronësi shtet të regjistruar në KPP, për rrjedhojë i me shkresën pa nr. , datë 23.12.2021 DV ASHK Kamëz - Vorë, i ka kërkuar qytetarit që të depozitojë deklaratën noteriale për prishjen e objektit ekzistues të vjetër, është kërkuar, ndërsa me deklaratën noteriale nr. 1108/417, datë 25.02.22, qytetari ka deklaruar se nuk e ka prishur objektin ekzistues por mbi të ka ngritur shtesë kati. Në këto kushte në mungesë të një deklarimi apo akti tjetër për prishjen e tij, apo konfirmimi nga institucionet përkatëse lidhur me ekzistencën(ose jo) e këtij objekti para vitit 1990, janë kryer veprime duke e regjistruar pasurinë e përfituar me legalizim. Veprime në kundërshtim me ligjin nenin 47 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe ligjin nr. 20/20, datë 05.03.2020.

(Trajtuar më hollësisht në pikën B/4, faqe 68-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Kamëz - Vorë, të marrë masa, konfirmimin zyrtar nga institucionet kompetente, lidhur me ekzistencën e objekteve për periudhën para vitit 1991, apo ndërtimin pas këtij viti, si dhe të pezullojë veprimet për pasurinë nr. 129/845, ZK 2066, deri në marrjen e konfirmimit zyrtar.

Brenda datës 31.12.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Me shkresën nr. 542/2 datë 13.02.2024 është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës urdhëri me nr. 50 datë 08.02.2024 për vendosjen e kufizimit, pasi DV ASHK Kamëz - Vorë nuk kishte akses në sistemin multifunksional për vendosjen e kufizimit pa aplikim.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi apo pezullimi për pasurinë me nr. 129/845, ZK 2066, truall me sipërfaqe 243.2 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 96.6 m². Nga Bashkia Vorë nuk ka konfirmim për këtë pasuri. Nga sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave sipas VKM nr. 827/2020 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishtme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim” rezultoi se miratimi i dokumentit të pronësisë për objektet pa titull dhe trojet funksionale është bërë në emër të

aplikantit apo kryefamiljarit, duke mos zbatuar pikën 15 të Kreut I të vendimit përkatës e cila përcakton se subjekte përfituese të objektit pa titull janë personat kërkues që e posedojnë objektin pa titull pronësie, së bashku me ata që janë në bashkësi ligjore me këta të fundit, sipas dispozitave të Kodit të Familjes.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.A, faqe 19-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa për të korrigjuar kartelat e pasurive të paluajshme, duke vendosur pasuritë e përfituara me VKM nr. 827/2020 në emër të personave që janë në bashkëpronësi ligjore me aplikantët.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Në lidhje me rekomandimin është njohur Sektori i Legalizimit nëpërmjet raportit përfundimtar të auditimit.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi i bërë në sistem në prani të punonjësit të DV ASHK Kamëz – Vorë, z. R. B., rezultoi se kjo drejtori i është referuar Rekomandimit 21.1 të grupit të auditimit, duke vijuar me ndryshimet në kartelat e pasurive. Për sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I zbatuar

22. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste, është konstatuar se në kartelat e pasurive të paluajshme janë regjistruar gabim sipërfaqet e ndërtesave, konkretisht:

- Me referencë nr. 939 datë 12.11.2019 në zk.Gjokaj është bërë regjistrimi i leje së legalizimit në emër z. N. K., ku godina e legalizuar është regjistruar me një sipërfaqe prej 752 m² ndërtesë, ndërsa sipas lejes së legalizimit sipërfaqja është 512 m². Kjo ka ardhur për shkak se janë mbledhur të dyja sipërfaqet, të objektit të mëparshëm dhe atij të legalizuar.

-Me referencë nr. 2962 datë 10.12.2022 në emër të shoqërisë “S.” është bërë regjistrimi i lejes së ndërtimit, ku ndërsa është regjistruar me sipërfaqe 1702 m², sa sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit dhe jo 1442 m², sa sipërfaqe e gjurmës së ndërtimit. Veprime në kundërshtim me nenin 47 të Ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe pikën 2 të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën B B/4, faqe 68-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1. Rekomandimi: DV ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa të saktësojë sipërfaqen e ndërtimit të objektit, bazuar në dokumentacionin ligjorë, si dhe të kryejë korrigjimin e gabimeve, referuar të dhënave të aktit të fitimit të pronësisë.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Në lidhje me referencën nr. 939 ka ndryshuar sipërfaqja sepse është relizuar bashkimi i pasurive, të objektit ekzistues dhe atij të përfituar me lejen e legalizimit. Përsa i perket referencës me nr 2962 është korrigjuar kartela e pasurisë nga sipërfaqja me nr. 1702 m² në 1442 m².

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi i bërë në sistem në prani të punonjësit të DV ASHK Kamëz – Vorë, z. R. B., rezultoi se kjo drejtori i është referuar Rekomandimit 22.1, duke bërë ndryshimet përkatëse në kartelat e pasurive të cituara më lartë. Për sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I zbatuar

23. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Vendore e ASHK Kamëz - Vorë, nuk ka zbatuar procedurat ligjore, lidhur me administrimin e qarkullimin e dokumentacionit dhe arkivimin e tij, nga ku konstatohet:

- Administrimi i dokumentacionit nuk plotëson kërkesat dhe standardet e përcaktuara, pasi në shumë raste të konstatuara dokumentacioni me referencë përkatëse pas përfundimit të

procedurës së shqyrtimit dhe lëshimin e aktit të pronësisë, rezulton i pa arkivuar, duke qëndruar në ambientet e punës, kjo e konstatuar me mungesë në arkiv. Gjithashtu nga lëvizjet e shpeshta të punonjësve dhe largimet nga puna, nuk mbahet procesverbali i dorëzimit, ku të pasqyrohen të gjithë dokumentet që ka dorëzuar personi që largohet nga vendi i punës. Nga Drejtorët (ish Regjistruesit) marrës në dorëzim dhe dorëzues të detyrës, nuk rezulton të ketë dhe nuk u paraqitën akt-dorëzimet apo procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe dorëzimin e detyrës nga secili Drejtor (ish Regjistrues), përgjegjës sektorësh e specialist, nuk evidentohen.

Kjo gjendje ka sjellë mjaft probleme si vonesa në kthimin e përgjigjeve, humbjen e dokumentacionit dhe mosarkivimin e tyre, aq më tepër kur kemi të bëjmë dokumentacion pronësie. Gjithashtu ka një mungesë të theksuar të dokumentacionit të skanuar dhe ngarkimin në sistemin elektronik të tij, duke ndikuar negativisht në ofrimin e informacionit të kërkuar dhe mungesë transparence ndaj palëve të interesuara.

- Ruajtja dhe siguria e dokumentacionit nuk është konform rregullave dhe normave ligjore të përcaktuara, pasi ambientet e arkivës (ndodhen larg ambienteve të punës së institucionit që ndodhet më Rinas), nuk janë të përshtatshme, mungojnë hapësirat e nevojshme dhe sistemi i dokumentacionit në raftet, por rezulton që numër i madh referencash vendosen në dysheme, ***në formën e një magazinimi të mallrave pa vlerë***, duke mos plotësuar standardet minimale, të ruajtjes dhe administrimit të dokumentacionit që arkivohet. Gjendje e cila ndikon në uljen e sigurisë së ruajtjes së dokumentacionit dhe në uljen e efektivitetit të përdorimit të dokumenteve për të kryer shërbimet ndaj qytetarëve në kohë dhe me cilësi.

Veprime e mosveprime në kundërshtim me legjislacionin për periudhën e mëparshme dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me udhëzimin e Ministrisë Financiare nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.06.2007 “Qarkullimi dhe shfrytëzimi i dokumenteve tekniko ligjor në ZVRPP”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën B/5, faqe 75-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Kamëz - Vorë, të marrë masa për të kryer skanimin dhe ngarkimin në sistemin dixhital të dokumentacionit, si dhe të kryejë një inventarizim të plotë të dosjeve që ndodhen në arkiv, për të evidentuar me përgjegjshmëri gjendjen lidhur me mungesën e dosjeve sipas referencave përkatëse. Gjithashtu të marrë masa, që në rastet e largimit nga puna të punonjësve, apo ndërrimin e vendit të punës, të dorëzohet me procesverbal, me marrës në dorëzim, i gjithë dokumentacioni që ka në administrim në proces shqyrtimi punonjësi përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: DV ASHK Kamëz - Vorë i ka dhënë prioritet rekomandimit të sipërcituar dhe është vijuar me realizimin e inventarizimit të dokumentacionit tekniko ligjor.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi i kryer rezultoi se vijon inventarizimi i dosjeve dhe nuk ka përfunduar ende procesi i skanimit dhe ngarkimit të dokumentacionit në sistemin dixhital. Nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet:

Statusi: Në proces

24. Gjetje nga auditimi: Me kërkesën nr. 8 datë 05.07.2022 të z. I. P., znj. Q. P. administruar në KLSH, qytetarët kanë shprehur shqetësimin për kufizimin e pronës së tyre, nr. 618/1, vol.4, fq.94 me sipërfaqe 300m² truall dhe 60 m² ndërtesë, me datë lëshimi certifikate 25.01.2008, në emër të I. P. dhe Q. K. Për këtë pronë, rezulton se me referencë nr. 114 datë 2.03.2012 është vendosur kufizim me urdhër të regjistruesit, për shkak të mungesës së dokumentacionit tekniko-ligjor, në bazë të listave të trojeve të miratuara sipas vendimit nr. 432, datë 14.5.1995, të Këshillit të Ministrave, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në referencën me nr. 865, të regjistrimit fillestar të kësaj pasurie është administruar lista 01, ku në numrin rendor

112 figuron prona përkatëse. Bazuar në ndryshimet e reja ligjor, konkretisht VKM nr. 827/2020, pika 50, listat 01 të trojeve dhe ndërtesave në zonat urbane të fshatit merren të mirëqena nga ASHK-ja, edhe nëse prona nuk u ka kaluar të tretëve, pavarësisht mangësive të formës, procedurës ose përmbajtjes që mund të ketë akti, për rrjedhojë, kufizimet në regjistrin e pasurive të paluajtshme, që janë vendosur përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi mbi këto pasuri, hiqen, me përjashtim të rastit kur ka vendim gjyqësor për sigurimin e padisë ose kur kufizimi është vendosur për shkak të mbivendosjes së titujve.

(Trajtuar më hollësisht në pikën C, faqe 79-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë, Drejtori, të marrë masa për vlerësimin e dokumentacionit për të vijuar procedurën për heqjen e kufizimit të vendosur për pasurinë nr. 618/1, vol.4, fq.94, në emër të z. I. P. dhe Q. K.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: *Nuk ka koment*

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi i bërë në sistem në prani të punonjësit të DV ASHK Kamëz – Vorë, z. R. B., rezultoi se kjo drejtori i është referuar Rekomandimit 24.1 dhe ka vijuar procedurën për heqjen e kufizimit për pasurinë nr. 618/1, vol.4, fq.94. Për sa më sipër ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I zbatuar

25. Gjetje nga auditimi: Me kërkesën nr. 343 datë 11.04.2023 administruar në KLSH, z. E. P. shpreh shqetësimin për mos realizimin e legalizimit, me vetëdeklarim nr. 372 datë 24.11.2006. Nga korrespondenca me DV ASHK Kamëz - Vorë, rezultojnë faktet si mëposhtë: -objekti i vetëdeklaruar me nr. 372 prot, dt.24.11.2006 është i pozicionuar mbi parcelën me nr. 460/10 pasurie ZK.1066, vol.1 fq.100 me pronësi D. P., ndërkohë që plani i përgjithshëm vendor i komunës Paskuqan që ka qenë në fuqi deri në Nëntor 2022 parashikonte ndërtime me lartësi 7K, e për rrjedhojë nuk mund të legalizohej sipas nenit 29 ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të lpronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Pas ndryshimeve të reja ligjore (Miratimi i Planit të ri Vendor, Bashkia Kamez) lartësia e kateve ka rënë në 5K në këtë njësi strukturore gjë e cila e mundëson legalizimin e objektit vetëm për ndërtesën, derisa të saktësohet pozicioni i truallit ku bie ndërtesa.

(Trajtuar më hollësisht në pikën C, faqe 79-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë, në zbatim të dispozitave ligjore, të marrë masa të analizojë dokumentacionin tekniko ligjor dhe hartografik, për vijimin e procedurave të legalizimit të objektit informal në posedim të qytetarit Egi Prenga.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: *Është emetuar vendimi i legalizimit nr. 4839 datë 04.03.2024.*

Statusi: I zbatuar

26. Gjetje nga auditimi: Me kërkesën nr. 344 datë 11.04.2023 administruar në KLSH, z. S. P. është shprehur shqetësimi për mos marrjen e shërbimit të regjistrimit të lejes së ndërtimit, përcjelle me shkresë nr. 11964 prot, datë 22.12.2022 nga Bashkia Kamëz. Nga DV ASHK Kamëz - Vorë, për këtë rast është mbajtur akt-verifikim dhe qytetari përmes së cilës janë konstatuar se : -Plan rilevimit nuk është përcjellë sipas formatit të përcaktuar në VKM NR. 782 datë 07.10.2020. në shkallën 1:2500, -Qytetari duhet të aplikojë shërbimin R-9 “Regjistrimi i Lejes së ndërtimit”, ku si datë aplikimi duhet që të vendoset data 24.01.2023, pasi në bazë të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, pasi për çdo ditë vonesë duhet të paguajë edhe kamatëvonesë, të barabartë me 10 % e tarifës së regjistrimit.

(Trajtuar më hollësisht në pikën C, faqe 79-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

26.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë, të marrë masa për kryerjen e regjistrimit lejes së ndërtimit, duke e shoqëruar me shënim në seksion E, në rast të mospagesave të faturave të shërbimit.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Është regjistruar leja e rindërtimit në pasurinë me nr. 1254/nd, vol 37, faqe 55, zona kadastrale 1066.

Statusi: I zbatuar

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nuk janë rekomanduar masa për shpërblim dëmi ekonomik, si rrjedhojë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar me këtë shënim.

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, sipas Programit të Auditimit nr. 1139/1, datë 18.12.2022, është lënë për zbatim një rekomandim për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet, për shumën 2,191,200 lekë.

Referuar raportit përfundimtar të auditimit me objekt “Auditim përputhshmërie mbi veprimtarinë e drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë”, sipas Programit të Auditimit nr. 1139/1, datë 18.12.2022, është konstatuar se rekomandimi i lënë për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet, është pranuar nga subjekti, por ky rekomandim rezultoi i pa zbatuar.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të për transaksionet dhe veprimet e kryera për pasuri të regjistruara me privatizim, rezultoi se, me referencë nr. 23260, datë 18.09.2020, është regjistruar pasuria nr. 89/59, truell sipërfaqe 1826 m², e cila më pas është tjetërsuar. Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga privatizimi, sipas kontratës së shitjes nr. 1742/592, datë 08.04.2020, me palë shitëse Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike në Ministrinë e Financës, si truell funksional për objektin e privatizuar ne vitin 1993, me sipërfaqe 111.6 m² nga pala blerëse. Referuar dokumentacionit gjendje në arkiv, për objektin e privatizuar (hangarit nr. 6, 7 dhe 8), është privatizuar më parë truell funksional sipas kontratës nr. 423/74, datë 07.03.2000. Rezulton se sipërfaqja e totale e truallit të privatizuar, është shumë më e madhe se sipërfaqja që në fakt shërben si truell funksional. Gjithashtu rezultoi se në dokumentacionin e paraqitur të privatizimit të truallit mungon dokumentacioni që vërteton shlyerjen e detyrimit financiar, që rrjedh nga përdorimi i truallit në pronësi shtet, ku për 10 vitet e fundit llogaritet në **vlerën 2,191,200 lekë** (1826*120 lek/m²/vit*10 vite), duke mos plotësuar kërkesat ligjore përcaktuar në ligjin nr. 10270, datë 22.04.2010 “Për te drejtat e privatizimit te truallit shtetëror ne përdorim dhe taksa mbi te drejtën e përdorimit te tij”, nenin 73, i shfuqizuar me ligjin nr. 20/20, datë 05.03.2020, neni 73.

(Trajtuar më hollësisht në pikën B.1, faqe 49-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të vendosë urdhër kufizimi mbi pasuritë që rezultojnë të regjistruara në emër të qytetarëve R. D. dhe E. D., deri në paraqitjen e dokumentacionit që vërteton shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga përdorimi i truallit në pronësi shtet, apo marrjen përsipër të këtij detyrimi nga blerësi, që për periudhën 10 vjeçare, **llogaritet në vlerën 2,191,200 lekë.**

Brenda datës 31.12.2023

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: DV ASHK Kamëz - Vorë ka rregjistruar kontratën e privatizimit me palë shitëse Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike në Ministrinë e Financës. Është ky institucion që bën verifikimin për likuidimin e qirasë para se të lidhej kontrata e shitjes.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi është konstatuar se DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka nxjerrë urdhër kufizimi apo pezullimi për pasurinë me nr. 89/59, truall sipërfaqe 1826 m², në emër të z. R. D. dhe z. E. D. Nga DV ASHK Kamëz - Vorë nuk ka konfirmim nëse janë shlyer detyrimet për këtë pasuri. Nga sa më sipër, ky rekomandim është konsideruar:

Statusi: I pazbatuar

2.6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kreun IV, neni 11, gërma d) dhe e), nenin 37, 144, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shfuqizuar me ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë: “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 9 punonjës dhe “Vërejtje” për 13 punonjës.

Koment nga DV ASHK Kamëz - Vorë: Rekomandimi i është përcjellë për kompetencë Drejtorisë së Përgjithshme. Nuk ka asnjë njoftim lidhur me marrjen e masave disiplinore.

Koment nga grupi i auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit dhe argumentave të DV ASHK Kamëz – Vorë, është konstatuar se nuk janë marrë hapa të mëtjshëm për nxjerrjen e masave disiplinore, sipas rekomandimeve të KLSH.

Statusi: I pazbatuar

Tabela nr. 2: Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Lloji i masës	Rekomanduar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	26	26	9	2	1	14
Përm. ligjor	1	1	-	-	-	1
3E	1	1	-	-	-	1
Disiplinore	22	22	-	-	-	22
Totali	50	50	9	2	1	38

Shënim: Vlera e masës për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të pronës publike është **2,191,200 lekë.**

Burimi i të dhënave DV ASHK Kamëz - Vorë

Përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, janë paraqitur observacionet e dërguara nga DV ASHK Kamëz - Vorë me nr. 7900/1 prot., datë 24.12.2025, administruara në KLSH me nr. 421/16 prot., datë 30.12.2025.

Pretendimet e subjektit dhe qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i pretendimeve të paraqitura mbi Projekt Raportin e Auditimit rezultojnë observacionet e dërguara nuk kanë të bëjnë me ecurinë e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve dërguar me shkresën nr. 421/7 prot., datë 27.11.2025. Konstatohet se qëndrimet e paraqitura dhe të shprehura, lidhen me Projekt Raportin e Auditimit të hartuar nga grupi i auditimit i përbërë nga z. L. K., z. R. A. dhe z. F. Ç. Sa më sipër, sqarohet se qëndrimi juaj nuk është mbi statusin dhe ecurinë e rekomandimeve konkrete të paraqitura në PRA me shkresën e cituar më sipër.

Sa më lart, nuk janë paraqitur observacione që lidhen me ecurinë dhe statusin e rekomandimeve, për të cilat grupi i auditimit të vlerësojë dhe të mbajë një qëndrim nëse pranohen ose jo.

🚩 Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Shkodër:

2.1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër”, me nr. 1221/27 prot., datë 18.05.2022, sipas Programit të Auditimit nr. 1221/1 prot., datë 22.11.2021, janë rekomanduar për zbatim 33 rekomandime “Masa organizative” dhe masa disiplinore për 9 punonjës të DV ASHK Shkodër.

Në vijim, nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 37/20 prot., datë 18.06.2024, protokolluar në subjekt me nr. 7022 prot., datë 30.09.2024, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, nga i cili është konstatuar se:

- **Masa organizative:** Është rikërkuar zbatimi i dy rekomandimeve, të cilat janë pranuar nga subjekti, por rezultojnë të pa zbatuara;

- **Masa disiplinore:** Është rikërkuar zbatimi i 9 masave disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 9 punonjës, të cilat rezultojnë të pazbatuara.

Nga informacioni i marrë në DV ASHK Shkodër rezultojnë se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Në vijim, në mënyrë të përmbledhur është paraqitur ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, referuar auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024:

Lloji i masës	Propozuar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	2	2	-	-	-	2
Disiplinore	9	9	-	-	-	9
Totali	11	11	-	-	-	11

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, gërma j), ku cilësohet se:

KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

- Gjithashtu, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, ku cilësohet se:

Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësime ligjore, atëherë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër”, me nr. 326/7 prot., datë 26.07.2023, sipas Programit të Auditimit nr. 326 prot., datë 04.04.2023, janë rekomanduar për zbatim 26 rekomandime “Masa organizative”.

Referuar raportit përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër”, sipas Programit të Auditimit nr. 326, datë 04.04.2023, është konstatuar se, nga 33 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar të 33 prej tyre (pranueshmëria e rekomandimeve ka qenë në masën 100%), nga ku:

- 31 masa janë zbatuar;
- 1 masë është zbatuar pjesërisht;
- 1 masë rezulton e pa zbatuar.

Grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim rekomandimet për masat organizative të cilat nuk janë zbatuar (një rekomandim) dhe ato që janë zbatuar pjesërisht (një rekomandim), të cilat janë si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DV ASHK Shkodër, rezultoi se: -Me vendimin nr. 23, datë 30.01.2020, në emër të bashkëpronarëve T është miratuar kalimi i pronësisë për objektin magazinë shtetërore me sipërfaqe ndërtimi 238m² dhe sipërfaqe trualli funksional 238 m², në kundërshtim me kuadrin rregullator. Ky vendim vjen pas ndryshimit të vendimit të mëparshëm nr. 6 datë 23.07.2019 për të cilën ishte miratuar sipërfaqe e ndërtimit 371.4 m². Ky ndryshim ka ndodhur për arsyen se me shkresën nr. 101 prot, datë 29.01.2020 është kërkuar rishikimi i këtij vendimi për shkak se në planimetritë dhe genplanin e vendimit të trajtuar është konstatuar se një pjesë të ndërtesës, kërkuesit përkatës nuk e disponojnë dhe nuk kanë pretendim pronësie, duke kërkuar heqjen e kësaj pasurie nga trajtimi me vendim të kalimit në pronësi të objektit të ngritur para datës 10.08.1991 dhe truallit të tij funksional. Origjina e regjistrimit të pasurisë nr. 5/92 është vendimi i VKKP nr. 80 datë 12.09.1994, i cili rezulton të jetë objekt shtetëror (ish-magazinat e NTSH-së), nga e cila është privatizuar vetëm një pjesë e objektit me sipërfaqe 187 m². Godina rezulton magazinë shtetërore sipas hartës së VKKP-së dhe si e tillë nuk rezulton të jetë objekt i shqyrtimit në bazë të VKM nr. 442/2018, titulli pronësor i të cilës është përfituar me vendimin nr. 23 datë 30.01.2020 “Për kalimin në pronësi të objektit të ndërtuara para datës 10.08.1991”, pasi i përket sferës së shqyrtimit administrativ nga organet e privatizimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes” si dhe VKM nr. 442/2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 51-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: DV ASHK Shkodër të marrë masa për të anuluar vendimin nr. 23 datë 30.01.2020, në emër të bashkëpronarëve T, me sipërfaqe ndërtimi 238 m² dhe sipërfaqe trualli funksional 238 m², duke i orientuar qytetarët që për objektin përkatës t'i nënshtrohet procedurave të privatizimit përmes Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit: *Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Shkodër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Statusi: I pazbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Referuar informacionit të marrë nga auditimi i mëparshëm i kryer nga KLSH në ish-Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI Shkodër dhe nga informacioni i marrë nga Administrata e Zonave të Mbrojtura, Shkodër, ka rezultuar se janë ndërtuar objekte informale, por që nuk ka qenë i mundur verifikimi nëse këto subjekte kanë bërë kërkesën për përfshirje në procesin e legalizimit, janë legalizuar apo jo: - ndërtime pranë zonave dhe/ose nënzonave të mbrojtura, apo zonave të ruajtjes së veçantë, shkalla e mbrojtjes të së cilave nuk lejon ndërtime me funksion banimi apo social/ekonomik, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar; - ndërtime pranë brigjeve të lumenjve ose brenda sipërfaqeve të baseneve dhe rezervuarëve, të mbrojtura sipas ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; - ndërtime që mund të jenë ndërtuar mbi trupin e rrugëve ekzistuese sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe të akteve në zbatim të tij; - ndërtime që mund të jenë ndërtuar brenda vijës kufizuese të parcelës ndërtimore të ndërtesave publike (institucione shtetërore, shkolla e kopshte publike, spitale, qendra shëndetësore publike, kampuse studentore etj.); - ndërtime që mund të jenë ndërtuar brenda

zonës së sigurisë së centraleve prodhuese të energjisë elektrike, nënstationeve elektrike ose që shkelin brezin mbrojtës të sistemit të linjave ekzistuese të interkonjeksionit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; - ndërtime që mund të jenë ndërtuar pa miratimin paraprak të institucioneve përkatëse në zonën mbrojtëse të objekteve të trashëgimisë kulturore, të shpallura në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar; - ndërtime që mund të jenë ndërtuar brenda territorit/vijës kufizuese të parcelës ndërtimore të ndërtesave objekt kulturi, përveç rasteve kur posedues/ subjekt ndërtues është vetë institucioni fetar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 21-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Shkodër, duhet të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për të kryer verifikimet përkatëse, duke bashkëpunuar edhe me institucionet e tjera shtetërore, nëse për 517 objektet (të evidentuar nga institucionet e tjera si ndërtime pa leje, sipas aneksit përkatës bashkëngjitur këtij Projekt Raporti në Aneks nr. 1) janë bërë vetëdeklarimet për përfshirjen në procesin e legalizimit. Nëse këto subjekte kanë bërë vetëdeklarimin për legalizim të ndërtimeve informale, atëherë të merren masat për verifikimin në terren dhe ndjekjen e procedurës së legalizimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar në lidhje me kualifikimin apo skualifikimin e këtyre objekteve nga legalizimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se nga ana e DV ASHK Shkodër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: I pazbatuar

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nuk janë rekomanduar masa për shpërblim dëmi ekonomik, si rrjedhojë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar.

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nuk janë rekomanduar masa për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet, si rrjedhojë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar.

2.6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kreun IV, neni 11, gërma d) dhe e), nenin 37, 144, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shfuqizuar me ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe të kontratës

individuale të punës, i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë: **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”**, për 9 punonjës.

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e DP ASHK nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: Pa zbatuar

Tabela nr. 2: Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Lloji i masës	Propozuar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	2	2	-	-	-	2
Disiplinore	9	9	-	-	-	9
Totali	11	11	-	-	-	11

Burimi i të dhënave DV ASHK Shkodër

Përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

🚩 Në lidhje me auditimin e ushtruar në DV ASHK Durrës:

2.1. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës”, me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, protokolluar në subjekt me nr. 536 prot., datë 31.01.2023, sipas Programit të Auditimit nr. 202/1 prot., datë 03.03.2022, janë rekomanduar për zbatim 26 rekomandime për masa organizative, si dhe masa disiplinore për 15 punonjës të DV ASHK Durrës.

Në vijim, nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 37/20 prot., datë 18.06.2024, protokolluar në subjekt me nr. 7022 prot., datë 30.09.2024, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, nga i cili është konstatuar se:

- Masa organizative: Janë rekomanduar 26 masa, nga të cilat janë pranuar të 26 masa, nga ku 10 masa janë zbatuar, 5 masa janë zbatuar pjesërisht, 10 masa janë në proces zbatimi, ndërsa 1 masë rezulton e pa zbatuar;

- Masa disiplinore: Janë rekomanduar në total 15 masa, nga të cilat: 1 masë “Zgjidhje të kontratës së punës”; 1 masë “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, 13 masa “Vërejtje”.

Nga informacioni i marrë në DV ASHK Durrës rezulton se me Urdhrin nr. 1044 datë 28.02.2023 dhe është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” vetëm për 1 (një) punonjës, z. E. P. Ndërsa, me shkresën nr. 138 prot., datë 22.02.2023, është bërë njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore për znj. V. H.

Në vijim, në mënyrë të përmbledhur është paraqitur ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, referuar auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës”,

sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024:

Tabela nr. 1: Statusi i zbatimit të rekomandimeve, referuar auditimit me nr. 37/5, datë 11.01.2024

Lloji i masës	Propozuar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	26	26	10	5	10	1
Disiplinore	15	2	1	-	-	14
Totali	41	28	11	5	10	15

Nga auditimi ka rezultuar:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, gërma j), ku cilësohet se:

KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

- Gjithashtu, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, ku cilësohet se:

Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësime ligjore atëherë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga KLSH, me shkresën përcjellëse “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës”, me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, protokolluar në subjekt me nr. 536 prot., datë 31.01.2023, sipas Programit të Auditimit nr. 202/1 prot., datë 03.03.2022, janë rekomanduar për zbatim 26 rekomandime “Masa organizative”.

Referuar raportit përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, është konstatuar se, nga 26 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar të 26 prej tyre (pranueshmëria e rekomandimeve ka qenë në masën 100%), nga ku:

- 10 masa janë zbatuar;

- 5 masa janë zbatuar pjesërisht;
- 10 masa janë në proces zbatimi;
- 1 masë rezulton e pa zbatuar.

Grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim masat organizative të cilat janë zbatuar pjesërisht (pesë masa) dhe ato që nuk janë zbatuar (një masë), të cilat janë si më poshtë vijon:

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DV ASHK Durrës për praktikën e legalizimit, rezultoi se:

- Në 107 raste, për objektet e legalizuara janë dhënë parcela ndërtimore mbi 3-fishin e bazës ndërtimore, kjo bazuar mbi Vendimet e Këshillit të Ministrave të miratuara që në vitet 2008, 2009 dhe 2010, por në disa raste edhe pa dalë ende VKM-të përkatëse, dhe pa kërkesën me shkrim nga qytetari për të deklaruar që është dakord me përfitimin e sipërfaqes mbi 3-fishin kundrejt pagesës së vlerës së truallit të përcaktuar me VKM. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II-A, faqet 18-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës për rastet e mësipërme të marrë masa për të plotësuar dosjen me deklaratat përkatëse sipas përcaktimeve ligjore, në të kundërt korrigjojë sipërfaqen e parcelës ndërtimore për objektet e mësipërme duke i zbritur sipërfaqes totale truallin e llogaritur mbi 3-fishin e bazës ndërtimore.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Durrës: Me miratimin e urdhrit nr. 966, datë 15.02.2023, u ngrit grupi i punës për të bërë verifikimet përkatëse për rastin. Në përfundim të procedurës u konstatua se: Nga verifikimi i kryer, referuar pikës 7 të “Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin përpunueshmërisë se ushtruar ne Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës”, rezulton se në 107 raste nga të cilat janë evidentuar 81 raste (lista emërore bashkëlidhur këtij relacioni), ku në raportin e KLSH-së, janë konstatuar se për objektet e legalizuara janë dhënë parcela mbi trefishin e bazës ndërtimore, pa kërkesë me shkrim nga qytetari për të deklaruar që është dakord me përfitimin e sipërfaqes mbi 3-fishin kundrejt pagesës së vlerës së truallit të përcaktuar me VKM. Në përfundim u konstatua se kërkesa me shkrim nga qytetari për të deklaruar që është dakord me përfitimin e sipërfaqes së parcelës ndërtimore duhet për sipërfaqe mbi 500 m², pretendimet e paraqitura në raportin përfundimtar nuk qëndrojnë pasi bien ndesh me ndryshimet ligjore të ndodhura në ligjin nr. 9482/2015, neni 17, pika 1, dhe kuadri ligjor në fuqi, ligjit nr. 20/2020 datë 05.03.2020, neni 22, pika 3.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Durrës, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Durrës nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: Pa zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DV ASHK Durrës për praktikën e legalizimit, rezultoi se:

- Në 21 raste (vendimet: nr. 33515, datë 19.04.2021; nr. 33512, datë 19.04.2021; nr. 33513, datë 19.04.2021; nr. 33514, datë 19.04.2021; nr. 33734, datë 22.04.2021; nr. 33474, datë 19.04.2021; nr. 33991, datë 19.05.2021; nr. 33754, datë 23.04.2021; nr. 33326, datë 13.04.2021; nr. 32885, datë 19.03.2021; nr. 34018, datë 20.05.2021; nr. 33839, datë 23.04.2021; nr. 33989, datë 19.05.2021; nr. 33075, datë 02.04.2021; nr. 34342, datë

22.10.2021; nr. 34054, datë 21.05.2021; nr. 33515, datë 19.04.2021; nr. 33843, datë 30.04.2021; nr. 33940, datë 12.05.2021; nr. 33847, datë 06.04.2020; nr. 34099, datë 21.05.2021), DV ASHK Durrës ka legalizuar objekte që janë ndërtuar jashtë afatit ligjor;

- Në 1 rast (Vendimi nr. 34102, datë 21.05.2021), DV ASHK Durrës ka legalizuar një objekt që është ndërtuar pjesërisht jashtë afatit ligjor;

- Në 1 rast (Vendimi nr. 92879, datë 19.03.2021), nga verifikimi i pozicionimit të objektit rezulton se objekti i legalizuar ndodhet 20 m pranë Kullës Veneciane dhe 10 m nga muret rrethuese të Kalasë së Durrësit, në zonën arkeologjike A të qytetit të Durrësit, miratuar me VKM nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”;

- Në 1 rast (Vendimi nr. 32932, datë 25.03.2021) është legalizuar objekti “Godinë social ekonomike 6-7 kate”, por nga verifikimi i gjendjes ndërtimore rezulton se ai realisht është me 4 kate në pjesën e tij të përparme ose jug - perëndimore dhe me 3 kate në pjesën mbrapa ose veri - lindore. Ndër të tjera rezulton se objekti i legalizuar ndodhet rreth 40 m pranë Amfiteatrit të Durrësit, në zonën arkeologjike A të qytetit të Durrësit, miratuar me VKM nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”;

- Në 2 raste (Vendimi nr. 34233, datë 30.09.2021; Leja e legalizimit me nr. 278758, datë 25.04.2019), DV ASHK Durrës ka legalizuar objekte që janë ndërtuar me llamarinë (material i lehtë, i paqëndrueshëm dhe provizor);

- Në 1 rast (Vendimi nr. 32982, datë 26.03.2021), DV ASHK Durrës ka legalizuar objektin i cili është ndërtuar pranë bregut të detit, brenda distancës ku nuk lejohen ndërtime, sipas dokumentit të planifikimit të territorit;

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 1178, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje” dhe VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II-A, faqet 18-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës për rastet e mësipërme, të vendosë masë kufizimi sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit dhe të pasqyrojë këto veprime në kartelat (regjistrat) e pasurive të paluajtshme.

Menjeherë

Koment nga DV ASHK Durrës: Në zbatim të urdhrin nr. 967 datë 15.02.2023 u vendos kufizim me afat 30 ditor për vendimet/lejet e legalizimeve të cilat rezultojnë të regjistruara, konkretisht për pasuritë me;

1. Nr. 19/32 vol .19 fq. 186 zk. 3852, me Vendimi nr. 33474 dt 19.04.2021

2. Nr. 73/6 vol 10 fq 144 zk 3245, me Vendimi nr. 33847 dt 06.04.2021

3. Nr. 15/122/nd vol 58 fq 69 zk 8511, me Vendimi nr 33940 dt 12.05.2021

4. Nr. 73/9 vol 21 fq 56 zk 3339 me Vendimi nr 33989 dt 19.05.2021

5. Nr. 8/493/nd vol 86 fq 49, 50, 51, 59, 60, 61, 63,64, 70, 71, 72, 77, 78, vol 87 fq 1, 3, 4, 7, 12 zk 8513 me Vendimi nr 33326 dt 13.04.2021

6. Nr. 8/493/nd vol 39 fq 119 zk 8515 me Vendimi nr 32885 dt 19.03.2021

7. Nr. 106/16 vol 26 fq 190 zk 8517, me Vendimi nr 33075 dt 02.04.2021

8. Nr. 264/40/nd1 vol 22 fq 80 zk 3339 dhe nr 264/40/nd2 vol 22 fq 81zk 3339 me Vendimi nr. 34102 dt 21.05.2021 (Për subjektin “F.” ShPK, rezulton se është kufizuar dhe me datë 15.01.2024 është hequr kufizimi, duke regjistruar veprimin e vendosjes së hipotekës ligjore)

9. Nr. 15/31 vol 22 fq 144 zk 3339 dhe nr 15/32 vol 22 fq 145 zk 3339 me Vendimi nr 33991 dt 19.05.2021(M. ShPK i është vendosur kufizim datë 15.02.2023, e cila rezulton aktive. Me datë 09.01.2024 është vendosur hipotekë bankare).
10. Nr. 26/104 vol 17 fq 209 zk 8512, me Vendimi nr. 34054 dt 21.05.2021(Për subjektin “A* P: C.” është kufizuar me datë 16.02.2023 dhe është hequr me datë 13.10.2023)
11. Nr. 8/449 vol 25 fq 198 zk 8515, me Vendimi nr 33514 dt 19.04.2021
12. Nr. 73/9 vol 21 fq 56 zk 3339 me Vendimi nr. 33989 dt 19.05.2021
13. Nr. 22/18 vol 31 fq 28 zk 3385, Vendimi nr 34233 dt 30.09.2021
14. Nr. 1/846/nd vol 39 fq 175 zk 8515 me Vendimi nr 34099 dt 21.05.2021
15. Nr. 42/143/nd +1-1 vol 135 fq 38, nr 42/143/nd +1-2 vol 135 fq 69, nr 42/143/nd +1-2 vol 135 fq 71 zk 8517, vendimi nr 278758 dt 25.04.2019
16. Nr. 8/493/nd1 vol 39 fq 120 zk 8515 me Vendimi nr 33513 dt 19.04.2021
17. Nr. 4/343 vol 24 fq 42 zk 8516 me Vendimi nr 34342 dt 21.10.2021(Është vendosur me datë 16.02.2023 dhe është hequr me datë 13.10.2023)
18. Nr. 25/7/nd2 vol 22 fq 93 zk 3339 me Vendimi nr 33734 dt 22.04.2021
19. Nr. 98/13 vol 31 fq 81 zk 3385 me Vendimi nr 33839 dt 23.04.2021
20. Nr. 1/119 vol 8 fq 31 zk 8515 me Vendimi nr 33754 dt 23.04.2021
21. Nr. 24/658 vol 62 fq 163 zk 8512 me Vendimi nr 32879 dt 19.04.2021

Nga DV ASHK Durrës është përcjellë informacioni se për sa i përket vendimeve nr. 33512 dt 19.04.2021, nr. 34018 dt 20.05.2021 nr. 33515 dt 19.04.2021, nr 33843 dt 30.04.2021 dhe nr. 33983 dt 26.03.2021 nuk është vendosur kufizim, pasi nuk kanë qenë të regjistruara. Për shkak të mungesës së aksesit në sistem, grupi i auditimit nuk mund të verifikonte nëse këto pasuri janë regjistruar dhe janë shoqëruar me kufizim. Në lidhje me Vendimin nr 32932 dt 25.03.2021, në bazë të kërkesës së subjektit me nr. 2356 prot., datë 05.04.2023, me Urdhrin nr. 4128 datë 13.06.2023 është vendosur shfuqizimi i vendimit të legalizimit nr. 32932.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Durrës, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Durrës nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: Zbatuar pjesërisht

20. Gjetje nga auditimi: Me referencë nr. 1363, me nr. 7783 aplikimi, datë 08.04.2019, zona kadastrale nr. 1522, fshati Draç, nga veprimet e bashkimit është përfituar pasuria në volumnin 7, faqe 174, me nr. 211/9, me sipërfaqe 3330 m² arë, sipas çertifikatës së pronësisë së lëshuar në datë 28.04.2019, me ndryshim të zërit kadastral nga “kënetë” në “arë”, për sipërfaqen 3003 m². Kjo pasuri ka pësuar transaksion të subjektit P. F. I.

Po ashtu, nga veprimet rezulton se është fshirë regjistrimi i pasurisë në vol. 7, faqe 85, me sipërfaqe 2123 m², me datë regjistrimi 19.09.2018, i kryer me referencën nr. 1324, ku është administruar vendimi nr. 10-2018-1216/457, datë 12.06.2018, i cili ka vendosur ndër të tjera njohjen e të drejtës së pronësisë dhe kthimin në natyrë të trashëgimtarëve të subjekti të shpronësuar N. M., të sipërfaqes prej 3370 m², e ndodhur në pasurinë nr. 211 (Më hollësisht trajtuar në pikën II-B, faqet 58-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: DV ASHK Durrës të marrë masa për korrigjimin e zërit kadastral për çertifikatën e lëshuar ndaj personit të tretë, nga “arë” në “kënetë”, për sipërfaqen 3003 m², duke i plotësuar kartelat përkatëse me shënimin e kufizimit dhe rikthyer në gjendjen fillestare regjistrimin e pasurive në emër të z. N. M.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Durrës: *Nga ana e specialistëve E. S. dhe L. D., në zbatim të urdhrin nr 604 dt 02.02.2023; U vendos kufizimi ndaj pasurisë me nr. 211/9 vol 7 faqe 14 zk 1522. Është kryer njoftim mbi vendosjen e kufizimit ndaj pronarit "P. F. I." SHPK.*

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Durrës, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Durrës nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: Zbatuar pjesërisht

21. Gjetje nga auditimi: Me referencë nr. 01359, datë 22.02.2019, është bërë regjistrimi i një sipërfaqe 1,110,283 m² pyll, mes zonës Shetaj dhe Draç, e ndarë në disa pasuri, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr. 10-2018-2311(820), përcjellë me anë të shkresës me nr. 140 prot., datë 28.12.2018. Lidhur me aspektin hartografik, akti i ekspertimit nuk përputhet me sipërfaqet e kartelave të pasurive të paluajtshme të DV ASHK Durrës. Po ashtu, nga sipërfaqja prej 1,102,022 m² e përcaktuar në vendimin e gjykatës së apelit është regjistruar një sipërfaqe prej 1,110,283 m² ose 8261 m² më shumë. Sakaq, në bazë të dokumentacionit tekniko-ligjor referuar skicës së aktit të ekspertimit, konstatohet se është regjistruar një sipërfaqe prej rreth 39,719 m² më shumë sesa përcaktojnë kartelat e pasurive të paluajtshme, ku nga veprimet e ndarjes pasuritë "bija" janë hapur me sipërfaqe më të mëdha se pasuria "mëmë". Po ashtu, nuk është çelur kartela në pronësi shtet me sipërfaqe 9878 m² pyll, gjatë veprimeve të kryera mbi pasurinë me nr. 118/5, vol. 7, faqe 39, ZK1522, me sipërfaqe 286,158 m² pyll.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II-B, faqet 58-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1 Rekomandimi: DV ASHK Durrës të marrë masa për korigjimin e sipërfaqeve të regjistruara me vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës nr. 10-2018-2311 (820), për pjesët që mbartin mospërputhje me sipërfaqet e kartelave, duke zbritur edhe sipërfaqet shtesë mbi sipërfaqen e përcaktuar në këtë vendim, si dhe të bëjë shënimin në seksionin përkatës të kartelave se për këtë çështje është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Durrës: *Nga ana e specialistëve J. M. dhe A. K., në zbatim të urdhrin nr 604 dt 02.02.2023 janë vendosur kufizime ndaj pasurive si vijon:*

-Nr 118/7 vol 7 fq 146 zk 1522 sip 350m²

-Nr 118/78 vol 7 fq 147 zk 1522 sip 380m²

-Nr 118/79 vol 7 fq 148 zk 1522 sip 275550m²

-Nr 123/4 vol 7 fq 150 zk 1522 sip 288000m²

-Nr 127/3 vol 7 fq 152 zk 1522 sip 984m²

-Nr 127/4 vol 7 fq 153 zk 1522 sip 140m²

-Nr 129/58 vol 7 fq 155 zk 1522 sip 173178m²

Është kryer njoftim mbi vendosjen e kufizimit ndaj pronarëve E. M. dhe Ç. T.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Durrës, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Durrës nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: Zbatuar pjesërisht

23. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 562, datë 17.05.2021, është administruar në KLSH ankesa e z. A. Sh., i cili shpreh shqetësimin se "janë kryer veprime të paligjshme nga ZVRPP Durrës në lidhje me regjistrimin e një sipërfaqe trualli në lagjen e Plazhit të Durrësit. Pasuria

është regjistruar me datë 24.07.1995, me nr. 730 regjistri. Në vitin 2004 ish ZVRPP Durrës sipas urdhrimit të Drejtorit të Përgjithshëm të ZQRPP Tiranë pas bllokimit të dhënies së certifikatës së pronësisë u detyrua ta lëshojë atë por të ndryshuar nga 2868 m² që ishte në vitet 1995 në 2530 m² që do të thotë 338 m² truall më pak. E refuzova këtë dokument të ndryshuar dhe kërkova korrigjimin e tij por ishte e pamundur”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DV ASHK Durrës rezulton se:

- Me vendimin e komisionit të kthimit të pronave nr. 919, datë 22.06.1195 është e regjistruar me nr. hipotekor 730, datë 24.07.1995, për sipërfaqen e truallit 2,868.75 m², vol. 13, fq. 229;
- Me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë me nr. 1227, datë 07.07.2003, dhe vendimin e Gjykatës së Apelit me nr. 255, datë 22.04.2004, vendoset zhvendosja e pasurisë;
- Me vendimin e gjykatës së rrethit Durrës me nr. 1974, datë 18.07.2007, dhe me vendimin e Gjykatës së Apelit nr. 10-2008-162, datë 29.05.2008, me palë paditëse A. Sh. dhe E. Sh. dhe të paditur banorët e drejtorisë komunale, është vendosur anulimi pjesërisht i VKKP nr. 91, datë 22.06.1995, me pronar A. Sh. dhe E. Sh.;
- Me vendimin e Gjykatës së Lartë me nr. 255, datë 11.07.2008, është vendosur pezullimi i vendimit të gjykatës nr. 1974, datë 18.07.2007;
- Me vendim të formës së prerë, Gjykatë e Apelit Durrës me nr. 10-2017-79 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil nr. 1974, datë 18.07.2007, të Gjykatës së Durrësit me ndryshimin që sipërfaqja e zënë e truallit e ndërtim banesa nga 440.08 m² bëhet në 490.97 m².

(Më hollësisht trajtuar në pikën II-B, faqet 58-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 Rekomandimi: DV ASHK Durrës të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin në terren të pretendimit të z. Sh., duke e informuar përmes një shkresë, ku të arsyetohet në mënyrë ligjore dhe hartografike, mbi shkaqet e diferencës në sipërfaqe.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Durrës: Nga ana e specialistëve B. A. dhe H. V. në zbatim të urdhrimit nr. 605 dt 02.02.2023 u procedua me njoftim ndaj qytetarit me anë të së cilës u sqarua, se në zbatim të vendimit nr 17 dt 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese duhet ti drejtohet organeve gjyqësore për zgjidhjen e çështjes së mbivendosjes.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Durrës, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Durrës nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: Zbatuar pjesërisht

24. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 77, datë 12.07.2021, dhe nr. 396 prot., datë 11.04.2022, janë administruar ankesat e znj. L. M., ku shprehet shqetësim për tjetërsimin e një sipërfaqeje prej 890.66 m² të z. B. A., në të cilën është ndërtuar një pallat. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se:

- Në emër të z. B. A., me nr. 2/791, vol. 48, fq. 22, në ZK 8513, me sipërfaqe truall 792 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 568 m²;
 - Truallit i lejes së pallatit të ndërtuar nga Pavarësia 2007 sh.a është i pozicionuar në pasurinë me nr. 2/118, vol. 81, fq. 96, me sipërfaqe 2,039 m², në emër të vet subjektit ndërtues;
- Me shkresën nr. 6904 prot., datë 14.09.2021, nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe krimit të Organizuar është përcjellë vendimi i prokurorit nr. 13.09.2021, në kuadër të procedimit penal nr. 230/2021, ku nga hetimi i deritanishëm i këtij procedimi, dyshohet të jenë kryer veprime në kundërshtim me ligjin vetëm për lejen e legalizimit, për shtesat e kryera nga subjekti mbi lejen e ndërtimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II-B, faqet 58-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1 Rekomandimi: DV ASHK Durrës të marrë masa për të verifikuar pretendimet e znj. L. M., duke e informuar zyrtarisht, ku të arsyetohet në mënyrë ligjore dhe hartografike për pronësinë e pretenduar me sipërfaqe prej 890.66 m² në emër të z. B. A.

Menjëherë

Koment nga DV ASHK Durrës: *Nga ana e specialistëve E. M. dhe R. T., në zbatim të urdhrit nr. 605 datë 02.02.2023 u procedua me njoftim me atë të një relacioni shpjegues, lidhur me mos kompetencën për trajtimin e ankesës së shtetas L. M., kjo referuar nenin 36 paragrafi 3 i ligjit 8116 dt 29.03.1996 të Kodit Procedurës Civil, ku përcaktohet se: Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata.*

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Durrës, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Durrës nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: Zbatuar pjesërisht

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nuk janë rekomanduar masa për shpërblim dëmi ekonomik, si rrjedhojë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar.

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nuk janë rekomanduar masa për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet, si rrjedhojë kjo pikë e programit konsiderohet e ezauruar.

2.6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kreun IV, neni 11, gërma d) dhe e), nenet 37, 144, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shfuqizuar me ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës i kërkohet Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë: “Zgjidhje të kontratës së punës” për një punonjës; “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për një punonjës; “Vërejtje” për 12 punonjës.

Koment nga DV ASHK Durrës: *Nga informacioni i marrë në DV ASHK Durrës rezulton se*

me Urdhrin nr. 1044 datë 28.02.2023 dhe është vendosur masë disiplinore vetëm për 1 (një) punonjës, z. E. P. Ndërsa, me shkresën nr. 138 prot datë 22.02.2023 është bërë njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore për znj. V. H.

Koment nga grupi i auditimit: Komentet e mësipërme janë paraqitur nga subjekti DV ASHK Durrës, gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, të kryer nga data 15.01.2024 deri 07.02.2024. Gjatë këtij auditimi, nga DV ASHK Durrës nuk janë paraqitur argumenta të rinj për mos-zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye, ky rekomandim do të konsiderohet:

Statusi: Zbatuar pjesërisht

2.7. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit dhe ankesat e administruara në KLSH.

Referuar ankesave të qytetarëve (të paraqitura më poshtë), të administruara në KLSH, të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar të auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës”, përcjellë me shkresën “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 37/20 prot., datë 18.06.2024, protokolluar në subjekt me nr. 7022 prot., datë 30.09.2024, ka rezultuar se nga ana e DV ASHK Durrës **nuk janë marrë masa konkrete për zbatimin e rekomandimeve, ose së paku, ky informacion nuk është vendosur në dispozicion**. Ankesat për të cilat nuk ka informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit, janë si më poshtë vijon:

Ankesa nr. 1: Me shkresën nr. 105 datë 04.12.2023 është administruar në KLSH ankesa e z. P. D., pronar i pasurisë nr. 245/67, vol. 14 faqe 100, me sipërfaqe 1420 m² “arë”, zona kadastrale 3385, vërtetuar me certifikatën e pronësisë datë 27.12.2002.

Me aplikimin nr. 48036 datë 29.09.2023 z. D. ka aplikuar për ndarjen e kësaj pasurie, shërbim që i është refuzuar nga DV ASHK Durrës me arsyetimin se pasuria është kufizuar me urdhrin nr. 38112 datë 03.11.2014, në bazë të një raporti të KLSH-së.

Në kushtet e ndryshimeve të reja ligjore, të miratimit të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”, janë parashikuar dispozita mbi mënyrën sesi do të trajtohen kufizimet e vendosura mbi pasuri që rezultojnë të regjistruara me AMTP.

1.1. Rekomandim: DV ASHK Durrës, për rastin e z. P. D., duhet të vlerësojë heqjen e kufizimit sipas parashikimeve të VKM nr. 1174 datë 24.12.2020 e cila në pikën 34 përcakton se “Kufizimet e vendosura mbi pasuritë e regjistruara me AMTP, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si pasojë e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, shuhen/bien. Drejtoria vendore e ASHK-së, me urdhër të arsyetuar, konstaton rënien e kufizimit mbi pasurinë, kryesisht ose me kërkesë të subjektit të interesuar. Përfundimisht, kjo pikë nuk zbatohet në rastin e kufizimeve të vendosura mbi pasuritë e regjistruara me AMTP, për shkak se ajo nuk plotëson kriteret sipas nënpikës 6.3, të këtij vendimi”.

Ankesa nr. 2: Me shkresën nr. 785 datë 14.09.2023 është administruar në KLSH ankesa e znj. S. T., në të cilën shprehet për problematikën e ndeshur për regjistrimin e pasurisë të fituar me Vendimin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. 1100 datë 25.12.1995 në emër të subjektit R. H.

Vendimi përkatës është dërguar për regjistrim në ish-ZVRPP Durrës dhe trashëgimtarët e z. H. janë pajisur me vërtetim hipotekor nr. 952 datë 25.03.1996 për sipërfaqen 6500m², ku në pjesën

përshkruese “barrë për pasurinë” shoqërohet me shënimin “*sipërfaqja 2605 m² ka mbivendosje me pasurinë A. dhe L. C.*”. Për këtë mbivendosje, nga znj. S. T. janë përcjellë disa dokumente ku rezulton se për z. A. A. është marrë vendimi nr. 1429 datë 11.06.1996 që ka vendosur anulimin e vendimit nr. 986 datë 12.09.1995 për pronën e z. A. dhe është kërkuar ç’hipotekimi i kësaj pronë nga hipoteka e Durrësit.

I. Për pronën e z. A. A., nga auditimi konstatohet se:

- Me referencën nr. 799 datë 01.06.2013 në emër të z. A. A. nga projekti i regjistrimit fillestar është regjistruar pasuria nr. 54/42 vol.9 fq.49 me sipërfaqe 2525 m² në zonën kadastrale 8518, e cila shoqërohet me shënimin “*se pasuria është në proces fshirje*”. Ky shënim është bërë me referencën nr. 076, e cila nga informacioni i marrë nuk gjendet në arkivën e DV ASHK Durrës.

Pasuria e mësipërme është ndarë në dy pasuri:

- Me referencën nr. 0800 datë 01.06.2023 është hapur kartela për pasurinë me nr. 54/43 vol.9, fq.50 në emër të z. L. C. me sipërfaqe 500 m² truall, përfituar përmes kontratës së shitjes. Në këtë referencë mungon dokumentacioni i pronësisë, si kontrata e shitjes etj.
- Me referencën nr. 799 datë 01.06.2013 është hapur kartela për pasurinë me nr. 54/44, vol. 9 faqe 51 me sipërfaqe 2025 m² ku është mbartur shënimi se “*pasuria ndodhet në proces fshirje*”.

I.a. Në lidhje me pretendimin e znj. S. T. që të kryhet çregjistrimi i pasurisë së z. A. A., bazuar në vendimi e anulimit nr. 1429 datë 11.06.1996, rezulton se:

- Në shkresën nr. 2788 prot datë 05.12.2007, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave shprehet se në bazë të nenit 27/a të ligjit nr. 7698 datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave të ish-pronarëve”, Vendimi nr. 1429 datë 11.06.1996 për anulimin e vendimit që i kthen pronën z. A. A. është absolutisht i pavlefshëm me arsyetimin se, përveçse ankimit në gjykatë, komisioni nuk mund të revokojë një vendim që e ka marrë vet.
- Në zbatim të vendimit nr. 17 datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese, Regjistruesi (sot drejtori i DV ASHK) nuk ka të drejtë të kryejë çregjistrime të pronave nga regjistri i pasurive të paluajtshme, përveçse në zbatim të një vendimi gjyqësor.

II. Problematika e “Mbivendosjes”

Nga dokumentacioni i dërguar nga znj. S. T. dhe dokumentacioni i administruar në DV ASHK Durrës rezulton se për trashëgimtarët H., vendimi nr. 100 datë 05.12.1995, ka mbivendosje edhe me vendimin e Komisionit të Kthimit të Kompensimit të Pronave nr. 315 datë 03.0.1994, në favor të z. D. Xh., përveçse mbivendosjes me z. A. dhe z. L. C. Konkretisht;

- Sipas shkresës nr. 572/1 prot datë 23.01.2012 sipërfaqja prej 5000 m² e disponuar me VKKP Durrës nr. 315 datë 03.03.1994 në favor të familjes Xh. figuron e regjistruar në numrat hipotekorë, nga ku sipërfaqja prej 3600 m² krijon mbivendosje të plotë me sipërfaqen e kthyer prej 6500 m² në favor të trashëgimtarëve H., përfituar me VKKKP nr. 1100 datë 25.12.1995.
- Për problematikën e mbivendosjes H. – Xh. janë zhvilluar një sërë procesesh gjyqësore ku me vendimin nr. 180 datë 02.04.2001 të Gjykatës së Apelit Durrës është vendosur pranimi i pjesshëm i kundërpadisë duke zgjidhur mbivendosjen vetëm për sipërfaqen 1870 m² dhe duke e kompensuar familjen Xh. për këtë sipërfaqe.

Bazuar në dokumentacionin që DV ASHK Durrës i ka dorëzuar grupit të auditimit, rezulton se vendimi gjyqësor i mësipërm ka çuar në zgjidhjen e mbivendosjes vetëm për sipërfaqen 1870 m², ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes prej 3800 m² vazhdon të jetë e mbivendosur me trashëgimtarët Xh. Si rrjedhojë, trashëgimtarët H. vijnë në mbivendosje me z. A. A., me z. L. C. dhe trashëgimtarët Xh.

2.1. Rekomandim: Në bazë të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 65, DV ASHK Durrës, në bashkëpunim me

sektorin e përmirësimit përditësimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së duhet të marrë masa, por pa u kufizuar, për të vlerësuar:

- Saktësimin e sipërfaqeve që rezultojnë në mbivendosje mes vendimeve të kthimit të kompensimit të pronave të mësipërme H. – Xh. - A.
- Nëse mbivendosja buron nga gabime ose pasaktësi në pozicionimin e titullit të regjistruar në hartën kadastrale, etj.
- Nëse gabimi ose pasaktësia në hartën kadastrale kërkon ripozicionimin e shumë titujve të keqpasqyruar.
- Nëse gabimi ose pasaktësia qëndron tek elementet hartografike të vetë titujve të pronësisë, të cilat janë të korrigjueshme

Në varësi të problematikës së konstatuar, për pjesën që tejkalon tagrin e shqyrtimit administrativ nga ASHK, t'i adresojë palët për ndjekjen e një procesi gjyqësor.

Tabela nr. 2: Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Lloji i masës	Propozuar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	26	26	10	5	10	1
Disiplinore	15	2	1	-	-	14
Totali	41	28	11	5	10	15

Burimi i të dhënave DV ASHK Durrës

Përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Në lidhje me konstatimet e grupit të auditimit, është observuar nga drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, z. E. P., me anë të shkresës me nr. 6791/3 prot., datë 16.12.2025, administruar në KLSH me nr. 421/15 prot., datë 17.12.2025, si vijon:

Pretendimet e subjektit:

1. Për sa i përket rekomandimeve kryesore të lëna në pikën 1.2, faqe 4, lidhur me vendosjen e kufizimit ndaj regjistrimit të vendimeve të legalizimit, sqarojmë se ndaj të gjitha këtyre vendimeve është proceduar me vendosjen e kufizimit të pasurive dhe me njoftimin e palëve.

2. Për sa i përket rekomandimit 3.1, faqe 2, për korrigjimin e zërit kadastral nga “Arë” në “Kënetë” për sipërfaqen **3003 m²** dhe rikthimin e saj në gjendjen fillestare në pronësi të shtetasit **N. M.**, ju sqarojmë se ndaj kësaj pasurie është vendosur kufizim, por korrigjimi i sipërfaqes dhe kthimi në gjendjen fillestare nuk është kryer, për shkak se ndaj kësaj pasurie ka nisur një procedim penal me nr. **178/2023**, protokolluar pranë zyrës sonë me nr. **1096**, datë **20.01.2025**. Në mbështetje të nenit 36, paragrafi 3, të ligjit nr. **8116**, datë **29.03.1996**, “**Kodi i Procedurës Civile**”, përcaktohet se: “**Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata**”.

3. Për sa i përket rekomandimit pika 4.1, faqe 2, të lënë për korrigjimin e sipërfaqes së regjistruar me referencë nr. **01359**, datë **22.02.2019**, për vendimin e Gjykatës së Apelit nr. **10-2018-2311 (820)**, sqarojmë se ndaj pasurive është vendosur kufizim. Nga ana e pronarëve janë kryer aplikimet me nr. 56339, datë 21.11.2023; nr. 56335, datë 21.11.2023; si dhe nr. 17498, datë 20.03.2025, të shoqëruara me deklaratë noteriale nr. 5954/1309, datë 14.11.2023, për korrigjimin e sipërfaqeve sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH. Me anë të aplikimit me nr. 17498, datë 20.03.2025, dhe në bazë të urdhrin nr. 784, datë 20.03.2025, janë kryer korrigjimet e sipërfaqeve, konform rekomandimeve të lëna në raportin e KLSH-së.

4. Për sa i përket rekomandimit pika 5.1, faqe 2, lidhur me ngritjen e një grupi pune për verifikimin e pretendimit të z. A. Sh. për pasurinë e regjistruar me nr. hip. 730, datë 24.07.1995, nga grupi i ngritur për verifikimin e këtij dokumentacioni është kryer verifikimi dhe është arritur në përfundimin se kemi të bëjmë me mbivendosje pjesore të titujve të pronësisë, konkretisht të pasurisë nr. 25/72, familja Sh., me pasuritë nr. 2/156, 2/153 dhe 2/24.

Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me diferencë dokument–fakt. Për sipërfaqen e lirë, familja Sh. është pajisur me certifikatë pronësie. Në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 23.04.2010, zgjidhja e çështjeve të mbivendosjes është kompetencë e organeve gjyqësore dhe jo e ASHK-së.

5. Për sa i përket rekomandimit të lënë në pikën 6.1, faqe 2, për verifikimin e znj. L. M. për pasurinë me nr. 21791, ZK 8513, është kryer njoftimi me anë të një relacioni shpjegues, lidhur me moskompetencën për trajtimin e ankesës së shtetasës L. M., referuar nenit 36, paragrafi 3, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile”, ku përcaktohet se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata”.

6. Për sa i përket rekomandimit pika 1.1, faqe 2, për heqjen e kufizimit ndaj pasurisë me nr. 245/67, ZK 3385, ju bëjmë me dije se ky veprim nuk është kryer, pasi duhet të iniciohet me aplikim nga ana e pronarit, duke qenë se kërkohet ndarja e sipërfaqes së tepërt nga ajo e fituar me AMTP, dhe ky veprim aksesohet vetëm me aplikim nga vetë pronari.

Nga ana e Sektorit të Kadastrës, lidhur me rekomandimet e lëna në Raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, ju bëjmë me dije se, në bazë të urdhrave nr. 604 dhe 605, datë 02.02.2023, rastet e rekomanduara iu ndanë për trajtim specialistëve të këtij sektori dhe janë kryer veprimet përkatëse.

1. Rekomandimi i lënë në pikën 13, faqe 61, të raportit të KLSH-së me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, iu ngarkua për trajtim juristes B. D dhe hartografit R. T. Rekomandimi i lënë nga ana e KLSH-së për DV ASHK Durrës është: “Plotësimi i referencës 41249 me praktikën e privatizimit të objektit, e shoqëruar me një relacion nga subjekti përkatës që ka kryer privatizimin e objektit, për pjesën e truallit për të cilën ka vendim njohjeje nga K.K.K.P”. Nga ana e specialisteve B. D dhe R. T., në zbatim të rekomandimit të lënë, është dërguar shkresë drejtuar Agjencisë së Privatizimit, ku është kërkuar përcjellja e relacionit shpjegues.

2. Rekomandimi i lënë në pikën 14, faqe 63, të raportit të KLSH-së me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, iu ngarkua për trajtim juristit G. L. dhe hartografes L. Gj. Rekomandimi i lënë nga ana e KLSH-së për DV ASHK Durrës është: “Të merren masa për korigjimin e pasurive të përfituara nga ndarja e pasurisë me nr. 55/6, faqe 197, duke zbritur sipërfaqen prej 455 m². Nga ana e specialisteve G. L. dhe L. Gj., në zbatim të rekomandimit të lënë, është vendosur kufizim me afat të përcaktuar për pasuritë:

- pasuria nr. 55/114, vol. 138, faqe 192, ZK 8518, në pronësi të T. ShPK.
- pasuria nr. 55/134, vol. 141, faqe 41, ZK 8518, me sipërfaqe 3531 m²
- pasuria nr. 55/135, vol. 141, faqe 42, ZK 8518, me sipërfaqe 6001 m²
- pasuria nr. 55/136, vol. 141, faqe 43, ZK 8518, me sipërfaqe 1541 m², në pronësi të FT M ShPK.”

Është kryer njoftimi mbi vendosjen e kufizimit ndaj pronarëve T. ShPK., F* M. & E., si dhe ndaj kreditorit Banka A. e I.

3. Rekomandimi i lënë në pikën 15, faqe 63, të raportit të KLSH-së me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, iu ngarkua për trajtim juristes E. K. dhe hartografit A. P. Rekomandimi i lënë nga ana e KLSH-së për DV ASHK Durrës është: “Të merren masa për kufizimin e pasurisë me nr. 27/234, vol. 133, faqe 128, me sipërfaqe truall 500 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 162 m², deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, dokumenteve të aktit të pjesëtimit dhe planvendosjes së konfirmuar nga gjykata përkatëse”. Nga ana e specialisteve E. K. dhe A. P., në zbatim të rekomandimit të lënë, është vendosur kufizim pa afat të përcaktuar për pasuritë bijë të pasurisë nr. 171324, vol. 133, faqe 128, ZK 8518, për shkak të ndarjes së kësaj pasurie më 01.03.2019, konkretisht:

- pasuria nr. 171330, vol. 133, faqe 177, ZK 8518, në pronësi të N. N.;
 - pasuria nr. 271319, vol. 133, faqe 178, ZK 8518, në pronësi të S. R., P. R. dhe J. V.
- Është dërguar shkresë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, ku është kërkuar përcjellja e dokumentacionit të munguar. Gjithashtu, është kryer njoftimi mbi vendosjen e kufizimit ndaj palëve N. N., S. R., P. R. dhe J. V.
4. Rekomandimi i lënë në pikën 16, faqe 64, të raportit të KLSH-së me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, iu ngarkua për trajtim juristit E. Rr. dhe hartografit G. K. Rekomandimi i lënë nga ana e KLSH-së për DV ASHK Durrës është: *“Të merren masa për kufizimin e pasurisë vol. 134, faqe 23, e regjistruar me leje nr. 220620, datë 25.07.2016, në emër të shtetasve E. A. dhe R. H.”*. Nga ana e specialisteve E. Rr. dhe G. K., në zbatim të rekomandimit të lënë, është vendosur kufizim pa afat të përcaktuar për pasurinë me nr. 531126, vol. 134, faqe 23, ZK 8518. Është kryer njoftimi mbi vendosjen e kufizimit ndaj palëve E. A. dhe R. H.
5. Rekomandimi i lënë në pikën 17, faqe 64, të raportit të KLSH-së me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, iu ngarkua për trajtim juristes J. Q. dhe hartografit A. P. Rekomandimi i lënë nga ana e KLSH-së për DV ASHK Durrës është: *“Të merren masa për plotësimin e dosjes përkatëse me shkresën e EKB-së dhe tabelën përmbledhëse që shoqëron kontratat e shitjes, të cilat lidhin pjesët takuese të apartamenteve me truallin nën objekt”*. Nga ana e specialisteve J. Q. dhe A. P., në zbatim të rekomandimit të lënë, është vendosur kufizim pa afat të përcaktuar për pasurinë me nr. 5271350, vol. 140, faqe 23, ZK 8518, me sipërfaqe trualli 544.04 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 247.3 m², në pronësi të V. P. Është kryer njoftimi mbi vendosjen e kufizimit ndaj palës pronare V. P. Gjithashtu, është dërguar shkresë drejtuar Entit Kombëtar të Banesave, ku është kërkuar përcjellja e dokumentacionit të munguar (tabela përmbledhëse që shoqëron kontratat e shitjes).
6. Rekomandimi i lënë në pikën 18, faqe 66, të raportit të KLSH-së me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, iu ngarkua për trajtim juristes E. A. dhe hartografit G. K. Rekomandimi i lënë nga ana e KLSH-së për DV ASHK Durrës është: *“Të merren masa për kufizimin e pasurisë me nr. 54/106, vol. 137, faqe 17, ZK 8518, në pronësi të z. I. Xh.”*. Nga ana e specialisteve E. A. dhe G. K., në zbatim të rekomandimit të lënë, është vendosur kufizim pa afat të përcaktuar për pasurinë me nr. 541106, vol. 137, faqe 17, ZK 8518, në pronësi të z. I. Xh. Është kryer njoftimi mbi vendosjen e kufizimit ndaj palës pronare I. Xh. Gjithashtu, është dërguar shkresë drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave, ku është kërkuar përcjellja e dokumentacionit të munguar (VKKP dhe skica).
7. Rekomandimi i lënë në pikën 22, faqe 73, të raportit të KLSH-së me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, iu ngarkua për trajtim juristes B. D dhe hartografit L. Gj. Rekomandimi i lënë nga ana e KLSH-së për DV ASHK Durrës është: *“Të merren masa për kufizimin e pasurisë me nr. 6/Nd, vol. 12, faqe 246, me sipërfaqe ndërtimore 3480 m², deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor”*. Nga ana e specialisteve B. D dhe R. T., në zbatim të rekomandimit të lënë, është vendosur kufizim pa afat të përcaktuar për pasurinë me nr. 6/Nd, vol. 12, faqe 246, ZK 3184, në pronësi të Romano Prot. Është kryer njoftimi mbi vendosjen e kufizimit ndaj palës pronare Romano Prot. Gjithashtu, është dërguar shkresë drejtuar Njësisë Administrative Katund i Ri, ku është kërkuar përcjellja e dokumentacionit të munguar (akt kontrolli, leje shfrytëzimi, procesverbal kolaudimi, si dhe shkresa përcjellëse e dokumentacionit të regjistrimit fillestar).
8. Rekomandimi i lënë në pikën 24, faqe 87, të raportit të KLSH-së me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, iu ngarkua për trajtim juristes E. M. dhe hartografit R. T. Rekomandimi i lënë nga ana e KLSH-së për DV ASHK Durrës është: *“Të merren masa për verifikimin e pretendimeve të znj. L. M., duke e informuar zyrtarisht dhe duke arsyetuar në mënyrë ligjore dhe hartografike për pronësinë e pretenduar me sipërfaqe 890.66 m², në emër të B. A.”*. Nga ana e specialisteve E. M. dhe R. T., në zbatim të rekomandimit të lënë, është kryer njoftimi me anë të një relacioni

shpjegues lidhur me moskompetencën për trajtimin e ankesës së shtetases L. M., referuar nenit 36, paragrafi 3, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile”, ku përcaktohet se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata”.

9. Rekomandimi i lënë në pikën 23, faqe 86, të raportit të KLSH-së me nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023, iu ngarkua për trajtim juristit B. A. dhe hartografit H. V. Rekomandimi i lënë nga ana e KLSH-së për DV ASHK Durrës është: “Të merren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin në terren të pretendimit të z. Sh., duke informuar nëpërmjet një shkrese, ku të arsyetohet në mënyrë ligjore dhe hartografike, mbi shkaqet e diferencës në sipërfaqe”. Nga ana e specialistëve B. A. dhe H. V., në zbatim të rekomandimit të lënë është bërë verifikimi i dokumentacionit dhe është arritur në konkluzionin se kemi të bëjmë me një mbivendosje pjesore të titujve të pronësisë, konkretisht të pasurive me nr. 25/72 të familjes Sh., me pasuritë 2/156, 2/153, 2/24, pra nuk kemi të bëjmë me diferencë dokument – fakt. Për sipërfaqen e lirë familja Sh. është pajisur me certifikatë pronësie. Për sa i përket sipërfaqes së mbivendosur, në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese me nr. 17, datë 23.04.2010, zgjidhja e çështjeve së mbivendosjes është kompetencë e organeve gjyqësore, jo e ASHK-së.

Po kështu, nga ana e Sektorit të Legalizimit, referuar shkresës me nr. 202/32, datë 25.01.2023, “Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë së ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës”, dhe në zbatim të urdhrit nr. 966, datë 15.02.2023, është marrë në shqyrtim raporti i KLSH-së për zbatimin e rekomandimeve me nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 9 dhe nr. 10, për të cilat ju sqaroj si më poshtë:

Referuar pikës 1: Për përmbajtjen e procesverbalit të verifikimit në terren, në momentin që kryhet verifikimi nga të paktën dy punonjës–specialistë, sipas formatit ligjor, të plotësuar me saktësi dhe të nënshkruar nga të gjithë punonjësit e grupit të terrenit, si dhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit, Hartografisë dhe Çështjeve të Pronësisë.

Referuar pikës 2: Për përgatitjen e saktë të skicave fushore dhe për mbajtjen e fotografive në terren.

Për pikat e lartpërmendura, nga ana e Sektorit të Legalizimit, Hartografisë dhe Çështjeve të Pronësisë, si dhe nga ana ime si Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit, Hartografisë dhe Çështjeve të Pronësisë, u morën masat e duhura për zbatimin me përpikëri nga grupet e terrenit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, për pikat 1, 2 dhe 3 të raportit përfundimtar.

Gjithashtu, në zbatim të VKM-së nr. 1178, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të evidentimit të ndërtimeve pa leje”, çdo evidentim faktik që grupet e terrenit do të sjellin në sektor do të kalojë nën filtrin ligjor, në mënyrë që të mos përsëriten rastet e gjetura në raportin përfundimtar.

Referuar pikës 4.1: Marrjen e masave që të hartohen programe pune të mirëstudiuara, për të bërë të mundur që lejet e legalizimit të lëshohen brenda afateve ligjore. Ju informoj se u morën masa për hartimin e planit të punës, në mënyrë që të respektohen afatet sipas kuadrit ligjor në fuqi, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Sipas planit të punës, përparësi kanë zonat informale, kjo në zbatim të ligjit nr. 20/2020, neni 69, pika 5: “Ndërtimet pa leje, që gjenden në territoret e zonave informale, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk janë legalizuar ende, trajtohen me përparësi”. Të gjitha dosjet që do të nxirren për shqyrtim administrativ do të pajisen me Urdhër Pune, sipas dispozitave të kuadrit ligjor në fuqi, dhe do t’u ndahen grupeve të terrenit për evidentimin faktik në terren, në zbatim të VKM-së nr. 1178, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të evidentimit të ndërtimeve pa leje”. Pas përfundimit të procedurës së evidentimit, dosjet do të kalojnë nën

filtrin ligjor nga ana e Sektorit të Legalizimit. Dosjet që plotësojnë kriteret e legalizimit do të vijnë procedurën përkatëse, ndërsa dosjet që nuk plotësojnë kriteret e legalizimit do të konkludohen rast pas rasti me moslegalizim nga procesi i legalizimit. Në të gjitha rastet, subjektet e legalizimit do të njoftohen mbi vendimmarrjen, sipas afateve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

Referuar pikës 5: Për përgatitjen e inventarizimit të dosjeve të legalizimit, përfshirë procesin e numërimit të fletëve, si dhe përcaktimin e marrës–dorëzuesit për fletë. Ju informoj se u morën masa për fillimin e procesit të inventarizimit të dosjeve të legalizimit, përfshirë procesin e numërimit të fletëve dhe përcaktimin e marrës–dorëzuesit për fletë, me miratimin e Urdhrit nr. 966, datë 15.02.2023, sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Referuar pikës 6: Evidentimin e faktit nëse nga ana e subjekteve/qytetarëve janë bërë ose jo kërkesa për përfshirje në procesin e legalizimit për 1471 objekte të ndodhura në zona të mbajtura. Ju informoj se, me miratimin e Urdhrit nr. 966, datë 15.02.2023, u ngrit grupi i punës për kryerjen e verifikimeve përkatëse për rastin. Aktualisht janë në proces nxjerrjeje nga arkiva dosjet e përmendura në raportin e KLSH-së dhe, më pas, do të kryhen verifikimet përkatëse në bazë të rekomandimeve, si dhe evidentimi faktik në terren.

Referuar pikës 7: Për raportimin e zbatimit të rekomandimeve në kohë të menjëhershme dhe raportimin mujor mbi zbatimin e rekomandimeve. Me miratimin e Urdhrit nr. 966, datë 15.02.2023, u ngrit grupi i punës për kryerjen e verifikimeve përkatëse për rastin. Në përfundim të procedurës u konstatua se: Nga verifikimi i kryer, referuar pikës 7 të “Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve për Auditimin e Përputhshmërisë së ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës”, rezulton se në 107 raste, nga të cilat janë evidentuar 81 raste (lista emërore bashkëlidhur këtij relacioni), në raportin e KLSH-së është konstatuar se për objektet e legalizuara janë dhënë parcela ndërtimore mbi trefishin e hapsirës ndërtimore, pa kërkesë me shkrim nga qytetari për të deklaruar se është dakord me përfitimin e sipërfaqes mbi trefishin, kundrejt pagesës së vlerës së truallit të përcaktuar me VKM. Në përfundim u konstatua se kërkesa me shkrim nga qytetari, për të deklaruar se është dakord me përfitimin e sipërfaqes së parcelës ndërtimore, kërkohet vetëm për sipërfaqe mbi 500 m². Për rrjedhojë, pretendimet e paraqitura në raportin përfundimtar nuk qëndrojnë, pasi bien ndesh me ndryshimet ligjore të ndodhura në ligjin nr. 9482/2015, neni 17, pika 1, si dhe me kuadrin ligjor në fuqi, ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, neni 22, pika 3.

Pika 7.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për rastet e mësipërme, të marrë masa për plotësimin e dosjeve me deklaratat përkatëse, sipas përcaktimeve ligjore, ose, në të kundërt, të korrigjojë sipërfaqen e parcelës ndërtimore për objektet përkatëse, duke zbritur nga sipërfaqja totale truallin e llogaritur mbi trefishin e hapsirës ndërtimore. Nga ana e Sektorit të Legalizimit, Hartografisë dhe Çështjeve të Pronësisë, nga 107 rastet e gjetura në raport, u konstatuan 26 raste me sipërfaqe të parcelës ndërtimore mbi 500 m² (lista emërore bashkëlidhur këtij relacioni), për të cilat u morën masa për njoftimin e subjekteve që të depozitojnë pranë zyrave tona deklaratën noteriale, ku të shprehin vullnetin e tyre të lirë se janë dakord për përfitimin e sipërfaqes mbi 500 m², sipas çmimit të përcaktuar në Hartën e Vlerës së Pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Referuar pikës 8 dhe pikës 8.1: Për 1317 objekte të legalizuara ende nuk kanë dalë VKM-të përkatëse për miratimin e parcelës ndërtimore të objekteve informale, me sipërfaqe totale 502.341 m², në mospërputhje me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 (i ndryshuar), dhe rekomandimet e lëna në pikën 8.1. Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, në bashkëpunim me ASHK-në, Drejtorinë e Përgjithshme, ka marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave për kalimin në pronësi deri në daljen e VKM-së për 1317 dosjet e objekteve informale të pajisura me leje legalizimi, me qëllim mundësimin e likuidimit të vlerës

përkatëse të parcelës ndërtimore. Për sa më sipër, nga ana e DV ASHK Durrës janë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve, duke filluar procedurën e verifikimit të dosjeve sipas planit të punës, bazuar në kronologjinë e emetimit të lejeve të legalizimit. Më pas do të vijohet me përgatitjen e propozimit për miratimin e kalimit në pronësi të parcelës ndërtimore, për kompensimin e pronarëve joposedues, pasuritë e të cilëve janë zënë nga parcelat e ndërtimeve të legalizuara.

Referuar pikës 9: Marrjen e masave për ngritjen e grupit të punës për verifikimin dhe inventarizimin e dokumentacionit që ndodhet në DV ASHK Durrës, me qëllim ruajtjen dhe administrimin e saktë të dokumentacionit tekniko-ligjor. Ju informoj se u morën masa për fillimin e procesit të inventarizimit të dosjeve të legalizimit, sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH, me miratimin e Urdhrit nr. 966, datë 15.02.2023.

Referuar pikës 10: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DV ASHK Durrës për praktikën e legalizimit, janë konstatuar 21 raste për të cilat janë lënë rekomandime për vendosjen e masës kufizuese, sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018, “*Për Kadastrën*”, si dhe për fillimin e procedurave të shfuqizimit të lejeve të legalizimit dhe pasqyrimin e këtyre veprimeve në kartelat e pasurisë. Ju bëjmë me dije se institucioni ynë ka marrë në shqyrtim kërkesën e depozituar nga z. E. D. pranë DV ASHK Durrës, me nr. 2356 prot., datë 05.04.2023, ku informon se është pajisur me vendim legalizimi nr. 32932, datë 25.03.2021, për objektin Godinë Social-Ekonomike 6–7 kate, dhe se ky vendim përmban gabime në vëllim dhe në sipërfaqen e ndërtimit të objektit, duke kërkuar korrigjimin e tij nga ana e institucionit tonë. Nga verifikimet e kryera mbi vendimin e legalizimit të subjektit, u konstatua se për vendimin e legalizimit nr. 32932, datë 25.03.2021, për objektin Godinë Social-Ekonomike 6–7 kate, me përfitues z. E. D., janë lënë rekomandime në “Raportin Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë së ushtruar në Drejtorinë Vendore të ASHK-së Durrës” për vendosjen e masës kufizuese, sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018, “*Për Kadastrën*”, fillimin e procedurës për shfuqizimin e këtij vendimi legalizimi dhe pasqyrimin e këtij veprimi në kartelën e pasurisë së paluajtshme, pasi vendimi është në mospërputhje me përcaktimet e: Ligjit nr. 20/2020, “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”; VKM-së nr. 1178, datë 24.12.2020, “*Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të evidentimit të ndërtimeve pa leje*”; VKM-së nr. 1040, datë 25.11.2020, “*Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit për ndërtimet pa leje*”, pika 15/e, si dhe në bazë të vlerësimit të autoriteteve përgjegjëse sipas ligjit nr. 27/2018, “*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*”, pasi cenon integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, të shpallura sipas kategorive: i. Kompleks; ii. Ansambël arkitektonik/urban; iii. Qendër historike; iv. Zonë arkeologjike “A”. Në zbatim të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, nga ana e institucionit tonë u miratua Urdhri i Punës nr. 4025, datë 08.06.2023, me të cilin u ngrit grupi i punës për verifikimin e gjendjes faktike në terren. Nga relacioni i mbajtur prej grupit të punës në datë 08.06.2023, u konstatua se vendimi i legalizimit nr. 32932, datë 25.03.2021, përmban gabime, pasi, referuar gjendjes faktike në terren, genplanit dhe planimetrive të administruara në këtë praktikë, ekzistojnë mospërputhje ndërmjet tyre. Në këto kushte, nga ana e institucionit tonë u procedua me Urdhrit nr. 4128, datë 13.06.2023, “*Për shfuqizimin e Vendimit të Legalizimit nr. 32932, datë 25.03.2021, Godinë Social-Ekonomike 6–7 kate, në posedim të z. E. D.*”, Lagjja nr. 1, Bashkia Durrës, në zbatim të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve për Auditimin e Përputhshmërisë së ushtruar në DV ASHK Durrës, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 536 prot., datë 31.01.2023.

Për sa më sipër, ju informojmë se për 26 rastet e përmendura në raportin e KLSH-së do të merren të gjitha masat për shqyrtimin e tyre, në zbatim të ligjit nr. 20/2020, “*Për përfundimin*

e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, si dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Qëndrim i grupit të auditimit:

Në lidhje me argumentimet Tuaja, shprehemi se:

- Në lidhje me pikën 1, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i mbështetur me prova (kopje të kartelave të pasurive apo njoftimeve), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 2, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i mbështetur me prova (kopje të kartelës së pasurisë apo dokumentacionin mbi procedimin penal), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 3, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i mbështetur me prova (kopje të kartelave të pasurive), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 4, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i mbështetur me prova (relacion sqarues për mbivendosjen e konstatuar dhe dokumentacion shoqërues), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 5, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i mbështetur me prova (relacion shpjegues apo informacion mbi procesin gjyqësor në proces), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 6, duke qenë se DV ASHK Durrës nuk ka njoftuar ankimesin për të vendosur në dijeni të tij se aplikimi duhet të kryhet nga ana e këtij të fundit, shprehemi se argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me argumentimet Tuaja (që kanë të bëjnë me Sektorin e Kadastrës), shprehemi se:

- Në lidhje me pikën 1, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i shoqëruar me prova (shkresa drejtuar Agjencisë së Privatizimit), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 2, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i shoqëruar me prova (kopje të kartelave të pasurive apo njoftimeve), nuk merret në konsideratë. Gjithësesi, rekomandimi ka të bëjë me korrigjimin e pasurive. Edhe pse është vendosur kufizim mbi pasuritë, procesi i korrigjimit nuk ka nisur dhe nuk është përfunduar.
- Në lidhje me pikën 3, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i shoqëruar me prova (kopje të kartelave të pasurive apo njoftimeve), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 4, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i shoqëruar me prova (kopje të kartelave të pasurive apo njoftimeve), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 5, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i shoqëruar me prova (kopje të kartelave të pasurive, njoftimeve apo shkresës drejtuar EKB-së), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 6, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i shoqëruar me prova (kopje të kartelave të pasurive, njoftimeve apo shkresës drejtuar ATP-së), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 7, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i shoqëruar me prova (kopje të kartelave të pasurive, njoftimeve apo shkresës drejtuar Nj. Adm. Katund i Ri), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 8, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i shoqëruar me prova (relacion shpjegues apo informacion mbi procesin gjyqësor në proces), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 9, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i shoqëruar me prova (relacion shpjegues për mbivendosjen apo njoftimin e ankimesit), nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me argumentimet Tuaja (që kanë të bëjnë me Sektorin e Legalizimit), shprehemi se, rekomandimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, janë shqyrtuar gjatë auditimit tematik me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës”, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024. Në përfundim të këtij auditimi, zbatimi i këtyre rekomandimeve është vlerësuar “I zbatuar / Në proces zbatimi”. Për këtë arsye, nuk është rikërkuar zbatimi i tyre. Në lidhje me argumentimet e pikës 7 dhe 10, shprehemi se:

- Në lidhje me pikën 7, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i shoqëruar me prova (njoftimet e dërguara), nuk merret në konsideratë.
- Në lidhje me pikën 10, duke qenë se argumentimi juaj nuk është i shoqëruar me prova (rezultatet e verifikimeve në terren; kopje e kartelës së pasurisë pas vendosjes së kufizimit; urdhrin e ngritjes së grupit të punës dhe rezultatet e verifikimeve; urdhrin për shfuqizimin e vendimit të legalizimit), nuk merret në konsideratë. Gjithësesi, rekomandimi i KLSH ka të bëjë me kryerjen e verifikimeve për 21 raste të lejeve të legalizimeve, ndërkohë që nga ana e DV ASHK Durrës janë paraqitur argumente për vetëm dy prej tyre.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

I. NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHETËRORE TË KADASTRËS TIRANA JUG:

Konkluzimi i auditimit:

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug, “Për zbatimin e rekomandimeve”, përcjellë me shkresën nr. 908/3 prot., datë 10.07.2024, rezulton se:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, referuar raportit përfundimtar të auditimit me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2023, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug”, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, gërma j);
- Në lidhje me raportimin që DV ASHK Tirana Jug duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve;
- Për përmirësimin e gjendjes është rikërkuar zbatimi i 20 masave organizative, nga të cilat nga subjekti janë pranuar 20 masa, ndërsa zbatimi tyre rezulton: është zbatuar plotësisht 1 rekomandim, janë në proces zbatimi 2 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 5 rekomandime, ndërsa rezultojnë të pazbatuara 12 rekomandime;
- Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 12 punonjës dhe masa disiplinore “Zgjidhje të kontratës së punës” për 6 punonjës, të cilat rezultojnë të pazbatuara.

Për sa më sipër, rikërkojmë që Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug, brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026 të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara, në proces zbatimi dhe pjesërisht të zbatuara, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të bëjë ndryshimet e të dhënave të kalimit të pronësisë mbi 3-fishin e sipërfaqes të bazës të ndërtimit, duke kthyer një sipërfaqe prej 1105.6 m², parcelë ndërtimore tej kufirit ligjor në gjendjen juridike “Shtet”. Sektori i kadastrës të pasqyrojë në seksionin e pronësisë së kartelës të pasurive të paluajtshme, aktin e ndryshimit të

lejes së legalizimit për sipërfaqen e parcelës ndërtimore mbi 3-fishin e sipërfaqes të bazës të ndërtimit.

Brenda datës 30.06.2026

2.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrisë kontrollin administrativ dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e Vendimit të Legalizimit nr. 2625600, datë 22.2.2019. Gjithashtu, për pasurinë e regjistruar sipas këtij vendimi të merret masë për të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procedurave të vlerësimit për shfuqizimin e vendimit.

Brenda datës 30.06.2026

3.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të rikthejë formularin e lejes së legalizimit nr. 124853, datë 11.12.2019 për objektin: “Godinë banimi 3 kat”, në sipërfaqen fillestare të miratuar për parcelës ndërtimore në 255 m², bazuar në genplanin fillestar të miratuar nga sektori i hartografisë dhe nga Sektori i Çështjeve të Pronësisë, për sipërfaqen e parcelës ndërtimore 255 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 85 m².

Brenda datës 30.06.2026

4.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të marrë masa në vijimësi, për të gjitha rastet për përjashtim nga legalizimi, ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje që cenojnë veprat kryesore të infrastrukturës publike, akset rrugore kombëtare, territorin e institucioneve publike, integritetin e monumenteve të kulturës etj.

Në vijimësi

5.1. Rekomandimi: Të gjithë ndërtimet që janë të ndërtuara para datës 10.08.1991 të mos konsiderohen ndërtime informale dhe të mos përfshihet në procedurat e legalizimit, DV ASHK Tirana Jug të miratoj kërkesat për kalimin e pronësisë të objektit pa titull pronësie me truallin funksional dhe oborret në përdorim për ndërtimet të ndërtuara para datës 10.08.1991.

Në vijimësi

6.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrisë kontrollin administrativ dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e vendimit të legalizimit nr. 2625593, datë 21.02.2019; nr. 127080, datë 24.11.2020; nr. 24768, datë 22.11.2019; nr. 123162, datë 10.07.2019 dhe lejes së legalizimit nr. 124704, datë 25.09.2019. Gjithashtu për pasurinë e regjistruar sipas këtyre vendimeve të merret masë për të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procedurave të vlerësimit për shfuqizimin e vendimit.

Brenda datës 30.06.2026

7.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrisë kontrollin administrativ dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e Vendimit të Legalizimit nr. 48, datë 26.01.2021. Gjithashtu, për pasurinë e regjistruar sipas këtij vendimi të merret masë për të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procedurave të vlerësimit për shfuqizimin e vendimit.

Brenda datës 30.06.2026

11.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të marrë masa që ne vijim të plotësojë “Proces verbalin e verifikimit në terren të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, me të dhënat e kërkuara edhe me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij. Për rastet kur këto të dhëna identifikohen si numra pasurie, të bëhet verifikimi në sistemet apo hartat e DV ASHK për plotësimin e saktë të kufitarëve.

Në vijimësi

12.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK, të fillojë kontrollin administrativ, duke proceduar me anulimin e lejeve të legalizimit nr. 124633, datë 14.08.2019, për pasurinë nr. 400/1277 në ZK 8190 dhe lejen e legalizimit nr. 122544, datë 22.07.2019, për pasurinë nr. 11/585, në ZK 8190.

Brenda datës 30.06.2026

14.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug të marrë masa, që për çdo rast moskualifikimi, ose kualifikimi për legalizim, të dalë me vendim për legalizimin ose jo të ndërtimit pa leje, brenda afatin ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug, të marrë masa për anulimin e legalizimit me Vendim nr. 269, datë 16.03.2021, duke ri shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës dhe qartësuar faktin nëse pjesa ekzistuese e objektit me leje ndërtimi i takon legalizimit sipas VKM nr. 442, datë 18.07.2018 “*Për kalimin në pronësi të objektit të ngritur para datës 10.08.1991 dhe truallit të tij funksional*” dhe në përfundim të vijojë me procedurat e legalizimit vetëm për shtesën mbi objekt me leje.

Brenda datës 30.06.2026

16.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrisë kontrollin administrativ dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e vendimit nr. 40, datë 29.05.2020 dhe nr. 131, datë 05.02.2021. Gjithashtu, për pasurinë e regjistruar sipas këtij vendimi të merret masë për të nxjerrë urdhër kufizimi deri në përfundimin e procedurave të vlerësimit për shfuqizimin e vendimit.

Brenda datës 30.06.2026

17.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të plotësojë 5 dosjet me mungesë të dokumenteve që duhej të ishin administruar në dosje. Si dhe të marrë masa për mirë organizimin e grupeve të punës në funksion të përballimit të fluksit të aplikimeve sipas afateve dhe prioriteteve të secilës hallkë të procedurave të ndjekura deri në përmbylljen e regjistrimit të pronësisë, duke shmangur zvarritjen e procesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Jug të marrë masa për rishqyrtimin e dokumentacionit dhe certifikatës familjare për rastin e S. M., duke anuluar Vendimin nr. 49, datë 13.07.2020 për kalimin në pronësi të objektit vetëm ndaj aplikantes dhe marrjen e Vendimit në zbatim të regjimit pasuror martesor.

Brenda datës 30.06.2026

20.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, me urdhër të brendshëm të urdhërojë Sektorin e Kadastrës, kthimin në gjendjen e mëparshëm pasurinë nr. 3/527, regjistruar në vol. 34, faqe 126, me sipërfaqe 86 m² ZK 8180. në pronësi “Shtet”.

Brenda datës 30.06.2026

24.1. Rekomandimi: Nga sektori i Kadastrës pranë DV ASHK-së, pas mbylljes të procedurës së regjistrimit për çdo kërkesë për shërbimet kadastrale, të behet skanimi i gjithë dokumentacionit dhe të transferohet në llogarinë File - Server 192.168.1.16.

Në vijimësi

25.1. Rekomandimi: Në funksion të garantimit të transparencës, Titullari i DV ASHK dhe specialistët përkatës, të marrin masa për përmbushjen e të gjithë hallkave hierarkike konfirmuese për mbylljen dhe inventarizimin e dosjeve që trajtohen, si dhe përcjelljen e tyre në vijim nëpërmjet shkresave përcjellëse përkatëse nga titullari dhe dokumentacionit të plotë që kërkohet nga kuadri ligjor, duke bërë të mundur kështu edhe evidentimin e afateve të dërgimit dhe punimit të dosjeve nga një sektor në tjetrin.

Në vijimësi

26.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, të nxjerrë urdhër të brendshëm “Për korrigjimin e hartës kadastrale dhe kartelës së pasurisë së paluajtshme”, për pasurinë nr. 5/155 me sipërfaqe 2215 m² regjistruar në vol.16, faqe 123, në dy pasuri, njëra pasuri me sipërfaqe 717 m² në llojin e pasurisë “Përrua” në pronësi “Shtet” dhe sipërfaqja tjetër prej 1498 m² në llojin e pasurisë “Truall” të kaloj në pronësi të “Të tretëve”.

Brenda datës 30.06.2026

29.1. Rekomandimi: DV ASHK Tiranë Jug në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për dosjet e objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin të vlerës përkatëse të parcelave ndërtimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga 18 masa disiplinore, nga DV ASHK Tirana Jug nuk është zbatuar asnjë masë. Konkretisht, për 12 punonjës është rekomanduar marrje e masës “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*”, ndërsa për 6 punonjës është rekomanduar “*Zgjidhje të kontratës së punës*”.

1.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në bashkëpunim me Drejtorin e DV ASHK Tirana Jug, të rivlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për 18 punonjës që vijnë të jenë në marrëdhënie pune, sipas shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit, përcjellë me shkresën nr. 650/18 prot., datë 03.05.2023.

Menjëherë

II. NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHETËTËRORE TË KADASTRËS TIRANA VERI:

Konkluzimi i auditimit:

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, “Për zbatimin e rekomandimeve”, përcjellë me shkresën nr. 908/3 prot., datë 10.07.2024, rezulton se:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, referuar raportit përfundimtar të auditimit me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri”, përcjellë me shkresën “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 908/17 prot., datë 04.03.2025, sipas Programit të Auditimit nr. 908/3, datë 10.07.2024, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, gërma j);
- Në lidhje me raportimin që DV ASHK Tirana Veri duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve;
- Për përmirësimin e gjendjes është rikërkuar zbatimi i 18 rekomandimeve për masa organizative, ndërsa zbatimi i tyre rezulton: rezultojnë të pazbatuar 18 rekomandime;
- Për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet është rikërkuar zbatimi i 4 rekomandimeve, të cilat rezultojnë të pazbatuara;
- Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar 24 masa disiplinore konkretisht, “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 5 punonjës; “Vërejtje” për 19 punonjës, të cilat rezultojnë të pazbatuara.

Për sa më sipër, rikërkojmë që Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026 të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara, në proces zbatimi dhe pjesërisht të zbatuara, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për parcelat ndërtimore prej 198,282 m² të pajisur me Leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin të vleftës përkatëse prej 385,201,173.8 lekë të parcelave ndërtimore.

Brenda datës 30.06.2026

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri të marrë masa për 10 rastet e konstatuara e në vijim, për të plotësuar “Proces verbalin e verifikimit në terren të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, dhe 3 raste akt evidentimi në terren me të dhënat e kërkuara edhe me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimit në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij. Në rastin e mos plotësimit, të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë të Kadastrës Shtetërore

për objektet informale të pajisura me leje legalizimi për të filluar procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit.

Brenda datës 30.06.2026

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri të marrë masa dhe të përgatisë plane konkrete, për të shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas zonave informale dhe brenda afateve të përcaktuara ligjërisht, duke mundësuar afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë duke rritur edhe transparencën për publikun.

Në vijimësi

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrë masa të rivlerësojë procedurat e legalizimit për objektet informale të pajisura me leje legalizimi në 25 raste: nr. 14233233; datë 21.09.2020; nr. 1233650, datë 27.10.2020; nr. 1233779, datë 26.11.2020; nr. 1231532, datë 24.10.2019; nr. 1233257, datë 22.09.2020; nr. 1231678, datë 27.11.2019; nr. 18043, datë 30.10.2020; nr. 689, datë 02.04.2021; nr. 1234089, datë 23.12.2020; nr. 1232708, datë 26.06.2020; nr. 1234113, datë 24.12.2020; nr. 1231159, datë 29.05.2019; nr. 1566, datë 29.07.2021; nr. 931, datë 16.04.2021; me nr. 53 datë 27.01.2021; nr. 1234206, datë 30.12.2020; nr. 1233093, datë 25.08.2020; nr. 1412, datë 30.06.2021; nr. 2392, datë 21.12.2021; nr. 1271, datë 31.05.2021; nr. 1908, datë 21.12.2021; nr. 1232237, datë 27.03.2020; nr. 1667 datë 19.08.2021; nr. 1302, datë 03.06.2021; nr. 1303 datë 03.06.2021. Në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi apo Vendimeve të legalizimit konstatuar të lëshuara me shkelje në 25 raste, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

4.2. Rekomandimi : Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa të njoftojë qytetarët përfitues të lejeve të legalizimit, për të paraqitur deklaratat e shembjes së objektit dhe plotësimin e dosjeve përkatëse. Gjithashtu në vijimësi të procedura e legalizimit ti referohet përcaktimeve në hartën e Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar.

Brenda datës 30.06.2026

5.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfituar më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme (sipas 4 Vendimeve të legalizimit dhe tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”, në 7 raste).

Brenda datës 30.06.2026

6.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa për të njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave e Tarifave Vendore Bashkia Tiranë dhe bëjë konfirmimin për pagesën e diferencës së detyrimeve të taksës së infrastrukturës për rreth 273,570 lekë nga subjekti “U. ShPK. + Lista e bashkëpronarëve”.

Menjëherë

7.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të kërkojë informacion nga institucionet përkatëse, lidhur me procedurën e privatizimit të pronës së shtetit trull me sipërfaqe 131967 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 27,847 m².

Brenda datës 30.06.2026

8.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të vendosë urdhër kufizimi mbi pasuritë që rezultojnë të regjistruara në emër të qytetarit P. S., deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për **pasurinë ndërtesë me sipërfaqe 615 m², si dhe** paraqitjen e dokumentacionit që vërteton shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga përdorimi i truallit në pronësi shtet, apo marrjen përsipër të këtij detyrimi nga blerësi, në vlerën **16,800,000 lekë**.

Brenda datës 30.06.2026

9.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të vendosë urdhër kufizimi mbi pasurinë pasuria nr. 12/307, volum 59, faqe 213, e formuar nga bashkimi i pasurive: nr. 12/17, volum 8, faqe 208, nr. 12/250, volum 33, faqe 156, nr. 12/251, volum 33, faqe 157, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjorë të fitimit të drejtës së pronësisë, në të kundërt **trualli me sipërfaqe 678.5 m² (110+568.5), të kthehet në pronësi “Shtet”**.

Brenda datës 30.06.2026

10.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, për truallin me sipërfaqe 7645.5 m², që i përket pasurisë nr. 8/1022, volum 59, faqe 36, të kërkojë konfirmim zyrtar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, lidhur me përfshirjen ose jo në skemën e kompensimit të pronarëve.

Brenda datës 30.06.2026

11.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të vendosë urdhër kufizimi mbi pasurinë nr. 7/143, truall me sipërfaqe 500 m² volum 10 faqe 61, dhe ndërtesë me sipërfaqe 64 m², deri në plotësimin e dokumentacionit ligjorë të fitimit të drejtës së pronësisë.

Brenda datës 30.06.2026

12.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit në përputhje me nenin 76 “Kontrolli administrativ” të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020. Për pasurinë e regjistruar, sipas lejeve të legalizimit nr.pas. 1/1667, vol. 30, fq. 87, ZK 3340; nr. 2/974, Nd vol. 32, faqe 68, ZK 8340, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

13.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa që: Të administrojë dokumentacionin e rivlerësimit të pasurisë nr. 3/189 ND; Të vendosë kufizimin për pasurinë nr. 3/189 ND, në vol. 53, faqe 118, ZK 8330, deri në posedimin zyrtar të Vendimit Gjyqësor (të administruar kopje) në referencën 013703, ZK 8330; Në bazë të dokumentacionit të administruar të veprorë në ndryshimin e përmbajtjes së regjistrit për këtë pasuri.

Brenda datës 30.06.2026

14.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa të vendosë kufizimin për pasurinë nr. 1/386 vol 10, faqe 243 ZK 8330, deri në administrimin e dokumentacionit sipas inventarit të referencës nr. 39638, datë 05.07.2021.

Brenda datës 30.06.2026

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa të vendosë kufizimin për pasurinë nr. 1/386 vol 10, faqe 243 ZK 8330, deri në administrimin e dokumentacionit sipas inventarit të referencës nr. 39638, datë 05.07.2021.

Menjëherë

16.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa të njoftojë subjektin për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar ligjor, për regjistrimin e truallit. Në të kundërt të njoftohet qytetari të aplikojë për regjistrimin e pronës së pretenduar në zbatim të procedurave të përcaktuara në nenin 61/b dhe nenin nr. 63, pika 1/a të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020, si dhe VKM nr. 329, datë 22.05.2019.

Menjëherë

19.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor për regjistrimin e lejes së ndërtimit nr. 757, datë 03.08.2000 duke plotësuar kartelën e pasurisë nr. 5/366 vol. 19, faqe 163, ZK 8370 dhe pasqyruar marrëdhëniet me truallin të ndërtesës dhe njësive individuale.

Menjëherë

22.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Tirana Jug, me urdhër të brendshëm të urdhërojë sektorin e kadastrës që të bëjë shënimin në kartelën e pasurisë së paluajtshme për pasurinë nr. 5/107/ND, me sipërfaqe 86.4 m², regjistruar në vol. 46, faqe 60, ZK 8380, në seksionin C - "Të Drejtat Reale", se ku pozicionohet ndërtesa (ND), mbi çfarë pasurie dhe në çfarë vol. dhe faqe është regjistruar. (***Shënim:** Ky rekomandim ka kaluar për zbatim nga DV ASHK Tirana Jug në DV ASHK Tirana Veri*)

Menjëherë

B. MASA DISIPLINORE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga 24 masa disiplinore, nga DV ASHK Tirana Veri nuk është zbatuar asnjë masë. Konkretisht, për 5 punonjës është rekomanduar marrje e masës "**Vërejtje**" deri në "**Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna**", ndërsa për 19 punonjës është rekomanduar "**Vërejtje**".

1.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në bashkëpunim me Drejtorin e DV ASHK Tirana Veri, të rivlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për 24 punonjës që vijojnë të jenë në marrëdhënie pune, sipas shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit, përcjellë me shkresën nr. 651/23 prot., datë 15.12.2022.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË PRONËS PUBLIKE

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana Veri, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara me Leje Legalizimi nr. 1233597 datë 30.10.2020; Vendimin e Legalizimit nr. 167, datë 11.02.2021; Vendimin e Legalizimit me nr. 2358 datë 15.12.2021;

dhe Vendimin e legalizimit me nr. 801, datë 09.04.2021, si dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë deri shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse:

në vlerën 3,536,800 lekë, që i përket Lejes së Legalizimi nr. 1233597, datë 30.10.2020;

në vlerën 4,139,600 lekë, që i përket Vendimit për Legalizim nr. 167, datë 11.02.2021;

në vlerën 4,249,200 lekë, që i përket Vendimit për Legalizim nr. 2358, datë 15.12.2021;

në vlerën 4,017,335 lekë që i përket Vendimit për Legalizim nr. 801, datë 09.04.2021, detyrime në total prej 15,942,935 lekë që rrjedhin nga shmangia e legalizimit si objekt i dytë, në favor të poseduesit të objektit përkatës.

Brenda datës 30.06.2026

2.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Veri të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të vendosë urdhër kufizimi mbi pasuritë që rezultojnë të regjistruara në emër të subjektit të subjektit “F.” Sh.a, deri në paraqitjen e dokumentacionit që vërteton shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga përdorimi i truallit në pronësi shtet, apo marrjen përsipër dhe shlyerjen e këtij detyrimi në **vlerën 4,782,000 lekë** nga blerësi, që i përket periudhës 10 vjeçar (2010-2020).

Brenda datës 30.06.2026

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit në përputhje me nenin 76 “Kontrolli administrativ” të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020. Për pasuritë e regjistruar, Sipas referencës nr. 08710, datë 25.09.2019 dhe referencës nr. 10092, 10093, datë 18.06.2021, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor për likuidimin e detyrimit të pa paguar.

Brenda datës 30.06.2026

4.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana të kërkojë informacion nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve **në vlerën totale 51,185,500 lekë**, si taksa urbanistike që rrjedhin nga përfitimi i lejeve të ndërtimit **nga 4 subjektet si më sipër**, si dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara, sipas lejeve të legalizimit të mësipërme, deri në marrjen e konfirmimit nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga lejet e ndërtimit të përfituara nga këto subjekte.

Gjithashtu të kryhet bashkimi i truallit me objektin e regjistruar me Leje Legalizimi nr. 118501 datë 17.02.2017, në një pasuri të vetme, si dhe të plotësohet dokumentacioni i konstatuar në mungesë që lidhet me Vendimin e Legalizimit nr. 2177 datë 08.11.2021.

Brenda datës 30.06.2026

III. NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHETËRORE TË KADASTRËS TIRANA RURALE I:

Konkluzimi i auditimit:

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I, “Për zbatimin e rekomandimeve”, përcjellë me shkresën nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, rezulton se:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, referuar raportit përfundimtar të auditimit me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I”, përcjellë me shkresën “Dërgohet Raporti

Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 37/15 prot., datë 18.06.2024, protokolluar në subjekt me nr. 67/4 prot., datë 19.06.2024, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH*”, gërma j);

- Në lidhje me raportimin që DV ASHK Tirana Rurale I duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH*”, pika 2, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve;

- Për përmirësimin e gjendjes është rikërkuar zbatimi i 7 masa organizative, nga të cilat nga subjekti janë pranuar 7 masa, ndërsa zbatimi tyre rezulton: janë zbatuar pjesërisht 3 rekomandime, ndërsa rezultojnë të pa zbatuar 4 rekomandime;

- Për përdorimin e fondeve me efektivitet, efizienz dhe ekonomikitet është rikërkuar zbatimi i pesë rekomandimeve për shumën 36,337,356 lekë, nga të cilat: 4 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 1 rekomandim nuk është zbatuar;

- Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore “*Vërejtje*” deri në “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*” për 8 punonjës dhe masa disiplinore “*Vërejtje*” për 15 punonjës, të cilat nuk janë zbatuar.

Për sa më sipër, rikërkohet që Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I, brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026 të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara, në proces zbatimi dhe pjesërisht të zbatuara, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

3.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I të marrë masa, që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfituar më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”).

Brenda datës 30.06.2026

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të ushtrojë kontrollin administrativ dhe në bazë të nenin 18 të marrë masa për skualifikimin e objekteve informal të pajisura me leje legalizimi në 5 raste si me lart. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 5 raste të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

12.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë: Të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit nr. 13, datë 02.06.2021; nr. 2625589, datë 20.02.2019; nr. 138115, datë 22.01.2019; nr. 139335, datë 25.02.2020. Për pasurinë nr. 58/10/1, ZK 3976; nr. 11/204/1, ZK 3976; nr. 80/329/1, ZK 3976; nr. 195/817, ZK 2460; e regjistruar sipas lejes së legalizimit të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

15.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale I, të marrë masa, **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 113/11, volum 6, faqe 63 dhe pasurinë nr. 91/27, volum 5, faqe 226, ZK 2735, duke njoftuar njëkohësisht poseduesin e këtyre pasurive, deri në kthimin me status në pronësi “Shtet”, të sipërfaqeve 2000 m² dhe 1400 m².

Brenda datës 30.06.2026

16.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Rurale 1 të marrë masa, të kërkojë nga Avokatura e Shtetit konfirmimin mbi mënyrën e procedimit të mëtejshëm për rastin konkret e për raste të tjera lidhur me zbatimin e Vendimeve të Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë.

Brenda datës 30.06.2026

17.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, të marrë masa, që në përputhje e zbatim të Vendimit të Gjykatës dhe Vendimit të KVVTP 160 datë 27.05.2016 të regjistrojë me pronar “Shtet” pasurinë nr. 107/2, vol 1, faqe 86, ZK 2460, Linzë.

Brenda datës 30.06.2026

18.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, të marrë masa, me grup pune sistemimin dhe inventarizimin e arkivës digjitale dhe fizike si dhe:

- për kalimin në sistemin elektronik sipas numrit kronologjik të referencave jashtë sistemit,
- për evitimin e faqeve (KPP) të paplotësuara dhe dispononim e 6 referencave të munguara,
- për sigurimin e faqes 250 të munguar të vol 55, Linzë KPP dhe plotësimin e të dhënave në faqen 114, referenca 16044 datë 15.03.2019 të këtij volumi,
- të pasqyrohet në volum se nga vjen pasuria 194/44, ZK 2460, vol 54, faqe 19, Linzë.
- të sistemohet kalimi i dubluar i pasurisë 603/8, vol 5, ZK 2460, Linzë, pasi ajo ka kaluar në vol 8, faqe 114-115, por edhe tek vol 5, faqe 245, 246 dhe 247.

Brenda datës 30.06.2026

Rekomandime të lëna, referuar trajtimit të ankesave të qytetarëve:

1.1. Rekomandimi: Drejtorja Vendore e ASHK, Tirana Rurale I, të vijojë procedurën lidhur me trajtimin e mbivendosjes së krijuar, për pasuritë nr. 496/406 me pasurinë nr. 496/355, në referencë të përcaktimeve ligjore në nenin 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën” dhe nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Drejtorja Vendore e ASHK, Tirana Rurale I, të procedojë me rivlerësimin e të gjithë dokumentacionit, në lidhje me trajtimin e kufizimit të pasurive nr. 28/56 në emër të A. S.; nr. 28/57 në emër të V. S.; nr. 28/58 në emër të Sh. S.; nr. 28/65 në emër të G. S., të cilat ndodhen në Zonën Kadastrale 3976, Shkozë. Gjatë këtij procesi, DV ASHK Tirana Rurale I duhet të përmbahet përputhshmërisë së sipërfaqes takuese të secilës palë, me sipërfaqen që përmban akti i fitimit të pronësisë, duke kaluar në pronësi shtet sipërfaqen e tepërt, që nuk mbulohet me Titull Pronësie.

Menjëherë

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK, Tirana Rurale I, të njoftojë qytetarin K. E. K., lidhur me mungesën e Aplikimi nr. prot., 376, datë 21.09.2015, duke i kërkuar që të depozitohet aplikimin në DV ASHK Tirana Rurale I, për të vijuar më tej me procedurën e legalizimit të objektit informal. Lidhur me aplikimet: nr. prot., 20176, datë 21.09.2015 në emër të A. E. K. dhe nr. prot., 20175 datë 21.09.2015 në emër të H. K., duhet të vijojë menjëherë me procedurat për legalizimin e objekteve informale, duke vënë njëkohësisht në dijeni aplikuesit lidhur me fazën në të cilën ndodhet procesi i legalizimit të objekteve për të cilët është aplikuar.

Menjëherë

B. MASA DISIPLINORE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga 23 masa disiplinore, nga DV ASHK Tirana Rurale I nuk është zbatuar asnjë masë. Konkretisht, për 8 punonjës është rekomanduar marrje e masës **“Vërejtje”** deri në **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”**, ndërsa për 15 punonjës është rekomanduar **“Vërejtje”**.

1.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në bashkëpunim me Drejtorin e DV ASHK Tirana Rurale I, të rivlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për 23 punonjës që vijojnë të jenë në marrëdhënie pune, sipas shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit, përcjellë me shkresën nr. 241/48 prot., datë 15.12.2022.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË PRONËS PUBLIKE:

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të kërkojë informacion nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve **në vlerën totale 24,425,900 lekë**, si taksa urbanistike që rrjedhin nga përfitimi i lejeve të ndërtimit **nga 6 subjektet si më sipër**, si dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara, sipas lejeve të legalizimit të mësipërme, deri në marrjen e konfirmimit nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga lejet e ndërtimit të përfituara nga këto subjekte.

Brenda datës 30.06.2026

2.2. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, të marrë masa, të njoftojë subjektin “M. K.” ShPK për plotësimin e dokumentacioni që vërteton shlyerjen e detyrimit financiar, që rrjedhin nga taksat urbanistike dhe i përkasin lejes së ndërtimit **në shumën 3,742,300 lekë**.

Brenda datës 30.06.2026

3.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të kufizojë pasurinë nr. 44/4, **tokë truall 150 m² dhe sipërfaqja ndërtimore 60 m²** deri në plotësimin e dokumentacionin përkatës nga autoriteti administrues shtetëror.

Brenda datës 30.06.2026

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, për 2 rastet, të kufizojë pasuritë deri në administrimin e mandat arkëtimeve për pagesën e taksës së ndikimit të infrastrukturës në vlerën 3,637,068 leke, për 2 lejet e ndërtimit.

Brenda datës 30.06.2026

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale I, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë:

- Të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit nr. 2625589 datë 20.02.2019, nr. 138115 datë 22.01.2019, nr. 139335 datë 25.02.2020, dhe regjistrimin e pasurive, nr. 11/204/1, ZK 3976, nr. 80/329/1, ZK 3976, nr. 195/817, ZK 2460.

- Në bashkëpunim me Njësinë Administrative të mare masa për administrimin e dokumentacionit për pagesën e taksës infrastrukturës në shumën 2,130,678 leke.

Brenda datës 30.06.2026

IV. NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS TIRANA RURALE II:

Konkluzimi i auditimit:

Nga auditimi i ushtuar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, “Për zbatimin e rekomandimeve”, përcjellë me shkresën nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, rezulton se:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, referuar raportit përfundimtar të auditimit me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II”, përcjellë me shkresën “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, me nr. 37/16 prot., datë 18.06.2024, sipas Programit të Auditimit nr. 37/5, datë 11.01.2024, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, gërma j);

- Në lidhje me raportimin që DV ASHK Tirana Rurale II duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve;

- Për përmirësimin e gjendjes është rikërkuar zbatimi i 32 rekomandimeve për masa organizative, nga të cilat rezulton se: janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 5 rekomandime, ndërsa rezultojnë të pa zbatuar 22 rekomandime;

- Për përdorimin e fondeve me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet janë lënë 11 rekomandime për shumën 76,742,500 lekë, nga të cilat, 1 rekomandim është zbatuar, ndërsa 10 rekomandim nuk janë zbatuar;

- Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 7 punonjës dhe masa disiplinore “Vërejtje” për 24 punonjës, nga të cilat 31 rekomandime nuk janë zbatuar.

Për sa më sipër, rikërkojmë që Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026 të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara, në proces zbatimi dhe pjesërisht të zbatuara, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Rurale II të marrë masa, që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfutur më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga

personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”).

Brenda datës 30.06.2026

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të rivlerësojë procedurat e legalizimit për objektet informale të pajisura me leje legalizimi në 16 raste, si më lart dhe në referencë të akteve ligjore e nënligjore, të vlerësojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 16 raste, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, në përputhje me nenin 76 “Kontrolli administrativ” të ushtrijë kontrollin administrativ dhe në bazë të nenin 18 të marrë masa për skualifikimin e objekteve informal të pajisura me leje legalizimi në 14 raste si më lart. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 14 raste të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Njësitë Administrative të Vetëqeverisjes Vendore për rastet e mësipërme të përcaktohen saktë pozicioni i objekteve të legalizuara në lidhje planet e përgjithshme e të detajuar vendore, si dhe të plotësohet dosjet e objekteve të legalizuara me dokumentacionin e kërkuar ligjor. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 4 raste të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II të marrë masa për 7 rastet e konstatuara e në vijim, për të plotësuar dokumentacionin e konstatuar me mangësi. Në rastin e mos plotësimit, të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë të Kadastrës Shtetërore për objektet informale të pajisura me leje legalizimi për të filluar procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit. Gjithashtu për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkelje në 7 raste, të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Menjëherë e në vijimësi

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, në përputhje me nenin 76 “Kontrolli administrativ” të ushtrijë kontrollin administrativ dhe në bazë të nenit 18 të marrë masa për të vlerësuar procedurën e shfuqizimit të lejes së legalizimit nr. 171419, datë 29.10.2019. Gjithashtu për pasurinë e regjistruar sipas lejes së legalizimit konstatuar të lëshuara me shkelje, të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas: *Vendimit të KKKP-së nr. 113, datë 14.10.1997, Vendimit të KKKP-së nr. 105, datë 29.08.1997, AMTP pa numër, pa datë viti(2000)*, lëshuar për ish pronaren L. A., *AMTP nr. ska, pa datë (viti 2000)*, lëshuar për ish pronarin Xh. A., deri në konfirmimin zyrtar nga ATP-ja, apo organet kompetente, lidhur me vlefshmërinë e këtyre akteve.

Brenda datës 30.06.2026

11.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Rurale II të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuar, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë që rezultojnë në pronësi të familjes H. H. dhe në emër të bashkëpronarëve dhe bashkëpronarëve “S., K., L. dhe L.”, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë që shërben për regjistrimin e pasurisë, ose kalimin në pronësi “*Shtet*” të sipërfaqeve të përfutur më tepër, prej 4800 m² dhe 2500 m², për të cilën mungon dokumentacioni i fitimit të pronësisë.

Brenda datës 30.06.2026

14.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, të marrë masa që në bashkëpunim me Njësinë Administrative Kashar, të përcaktojë statusin e pronësisë së pasurisë nr. 1281/5, ZK 2105, vol 22, faqe 175, me sipërfaqe 530 m². Gjithashtu për pasurinë nr. 1281/5, konstatuar me shkelje, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në saktësimin e statusit të pronësisë.

Brenda datës 30.06.2026

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, të marrë masa që, të regjistrojë pasurinë nr. 301/4 në pronësi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, duke bërë veprimet përkatëse në dokumentacionin e administruar.

Brenda datës 30.06.2026

16.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, të rivlerësojë dokumentacionin që ka shërbyer për fitimin e pronësisë dhe për sipërfaqen e tepërt, që nuk argumentohet me dokument pronësie, të procedojë duke e kaluar në pronësi “*Shtet*”.

Brenda datës 30.06.2026

17.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, të marrë masa që në bashkëpunim me Njësinë Administrative të Vetëqeverisjes Vendore, të rishikojë pasuritë e regjistruara sipas AMTP dhe trojeve tepërta, të cituara më sipër dhe të bëjë sistemimet përkatëse.

Brenda datës 30.06.2026

18.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, të rakordojë me pushtetin vendor lidhur me statusin e kësaj pasurie dhe më pas bazuar në konkluzionin e nxjerrë, të procedojë për sistemimin e pasurisë 26/1, vol 5, faqe 220, ZK 2105, Kashar.

Brenda datës 30.06.2026

19.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale II, bazuar në shkeljet e konstatuar, të njoftojë pronarin për të ndarë e kaluar në pronësi “*Shtet*”, sipërfaqen 230 m², e cila nuk argumentohet me dokument pronësie. Gjithashtu të vlerësojë

dokumentacionin e origjinës, për të saktësuar dhe përcaktuar vijueshmërinë e pasurisë nr. 1182/12, vol 15, faqe 109, ZK 2105, 1700 m² rruge “Shtet”. Deri në përfundim të këtyre procedurave të pezullohen veprimet mbi këto pasuri.

Brenda datës 30.06.2026

20.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të pezullojë kryerjen e veprimeve mbi pasuritë deri në plotësimin dhe saktësimin e dokumentacionit urbanistik.

Brenda datës 30.06.2026

21.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, të marrë masa që për këtë rast dhe në vijimësi, përpara se të kryej procedurat e miratimit dhe regjistrimit të akteve përkatëse, të kërkojë nga institucioni përgjegjës që ka në administrim rrejtin e kullimit (në këtë rast Bordi i Kullimit Tiranë), konfirmimin zyrtar lidhur me gjendjen aktuale të kanalit në raport me objektin e ndërtuar dhe ndikimin e tij, lidhur me funksionimin e kanalit.

Në vijimësi

22.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të ushtrojë kontroll administrativ për lëshimin e lejeve të legalizimit në përputhje me nenin 76 “*Kontrolli administrativ*” të ligjit 20/2020, datë 05.03.2020. Për pasuritë e regjistruar, sipas lejeve të legalizimit me nr. 272/21/1-ND, vol. 135, fq. 119, ZK 3866; nr. 54/83-ND1, vol. 38, fq. 190, ZK 2679-Mëzes, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

23.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara sipas referencave;

nr. 00003995, datë 30.01.2019, regjistruar pasuria nr. 223/35-ND

nr. 00004000, datë 04.02.2019, regjistruar pasuria nr. 225/51-ND

nr. 00004174, datë 17.01.2020, , regjistruar pasuria nr. 544/1/61

nr. 00004284, datë 11.08.2020, , regjistruar pasuria nr. 274/20-ND

nr. 00004559, datë 14.06.2021, regjistruar pasuria nr. 208/73,

nr. 00004624, datë 23.08.2021, regjistruar pasuria nr. 645/392,

nr. 00004638, datë 07.09.2021, regjistruar pasuria nr. 147/3-ND

deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu të ngrihet grup pune për rivlerësimin të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë regjistruar këto pasuri.

Brenda datës 30.06.2026

24.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara sipas referencave dhe pasurive:

-nr. 00004284, datë 11.08.2020, regjistruar pasuria nr. 274/20-ND, Katund i Ri, ZK.2119

-nr. 00003983, datë 15.01.2019, regjistruar pasuria nr. 208/8, Katund i Ri, ZK.2119

-nr. 00004022, datë 07.03.2019, regjistruar pasuria nr. 275/4-ND, Katund i Ri, ZK.2119

-nr. 00004558, datë 11.06.2021, regjistruar pasuria nr. 275/4/ND+1-4/1, Katund i Ri, ZK.2119

-nr. 00004097, datë 30.07.2019, regjistruar pasuria nr. 275/4+1-8/1, Katund i Ri, ZK.2119

-nr. 00004470, datë 17.03.2021, regjistruar pasuria nr. 212/25-ND, Katund i Ri, ZK.2119

-nr. 00000859, datë 09.02.2019, regjistruar pasuria nr. 32/15, Lalm, ZK.2376

-nr. 00000932, datë 17.01.2020, regjistruar pasuria nr. 5/189, Lalm, ZK.2376

-nr. 00000939, datë 20.02.2020, regjistruar pasuria nr. 28/35, Lalm, ZK.2376
-nr. 00000975, datë 03.09.2020, regjistruar pasuria nr. 120/1-ND, Lalm, ZK.2376
deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu të ngrihet grup pune për rivlerësimin të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë regjistruar këto pasuri.
Brenda datës 30.06.2026

25.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë nr. 274/20-ND, sipas referencës nr. 00004284, datë 11.08.2020, nr. 208/73, sipas referencës nr. 00004559, datë 14.06.2021 dhe nr. 645/392 sipas referencës nr. 00004624, datë 23.08.2021, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu të ngrihet grup pune për rivlerësimin të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit është regjistruar kjo pasuri.

Brenda datës 30.06.2026

26.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë: nr. 275/4-ND, nr. 275/4-ND+1-4/1, nr. 275/4+1-8/1, të regjistruara sipas referencave nr. 00004022, datë 07.03.2019, nr. 00004558, datë 11.06.2021, nr. 00004097, datë 30.07.2019, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu të ngrihet grup pune për rivlerësimin të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit janë regjistruar këto pasuri.

Brenda datës 30.06.2026

29.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa, **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 39/7-1, dhe pasurinë nr. 34/72, volum 15 faqe 11, ZK 2679, duke njoftuar njëkohësisht poseduesin e këtyre pasurive, si dhe kthimin në pronësi “Shtet”, të sipërfaqeve 650 m² dhe 483.5 m². Gjithashtu për pasuritë e tjetërsuara të ndiqen të gjitha rrugët ligjore, deri në kthimin e vlerës së përfituar nga shitja e tyre, si përfitim i padrejtë nga poseduesi i AMTP-ve.

Brenda datës 30.06.2026

31.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa:

- për ngarkimin në sistemin elektronik 600 referencave ZK 2105 Kashar,
- për plotësimin e 6 KPP të grisura, faqe 1, 2, 3, 4, 5, vol 23, dhe faqe 190, vol 15, ZK 2105,
- për rregullimin dhe sistemimin e 2 rasteve dublim KPP faqe 190 dhe 191,
- për mbylljen e KPP pasuria 1107/4, vol 16, faqe 189, ZK 2105, Kashar,
- për eliminimin e rasteve të lënies bosh të faqeve në mes të volumit pa numër kronologjik,
- për plotësimin e disponimin e KPP të munguar faqe 250, vol 23, ZK 2105, Kashar.

Brenda datës 30.06.2026

32.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të kryejë regjistrimin “Shtet” për pasurinë nr. 225/101/19, “Pemëtore”, sipërfaqe 1000 m², regjistruar sipas referencës nr. 00004093, datë 23.07.2019.

Brenda datës 30.06.2026

33.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 205/33, regjistruar sipas referencës nr. 2532, datë 20.01.20011, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

34.1. Rekomandimi: DV ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr nr. 34/2/1, regjistruar sipas referencës nr. 460, datë 20.09.2011 (trualli i objektit), deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu të ngrihet grup pune për rivlerësimin të dokumentacionit tekniko ligjor mbi bazën e të cilit është regjistruar kjo pasuri.

Brenda datës 30.06.2026

35.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II të marrë masa për të shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas deklaratës me nr. Prot. 3625, në datë 27.11.2014 brenda afateve të përcaktuara ligjërisht, duke mundësuar afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë duke rritur edhe transparencën për publikun.

Brenda datës 30.06.2026

B. MASA DISIPLINORE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga 31 masa disiplinore, nga DV ASHK Tirana Rurale II nuk është zbatuar asnjë masë. Konkretisht, për 7 punonjës është rekomanduar marrje e masës *“Vërejtje”* deri në *“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”*, ndërsa për 24 punonjës është rekomanduar *“Vërejtje”*.

1.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në bashkëpunim me Drejtorin e DV ASHK Tirana Rurale II, të rivlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për 31 punonjës që vijojnë të jenë në marrëdhënie pune, sipas shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit, përcjellë me shkresën nr. 242/18 prot., datë 01.03.2023.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË PRONËS PUBLIKE:

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Rurale II, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të kërkojë informacion nga institucionet shtetërore përkatëse, lidhur me shlyerjen e detyrimeve në vlerën totale **51,414,000 lekë**, si detyrim financiar, që rrjedh nga qiraja për truallin në pronësi shtet, i cili me procedurë legalizimi ka kaluar në pronësi të shoqërisë “K. D.” ShPK. Gjithashtu të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara, sipas lejeve të legalizimit të mësipërme, që rezultojnë të pa tjetërsuara nga shoqëria ndërtuese, deri në marrjen e konfirmimit zyrtar nga institucionet përkatëse, lidhur me shlyerjen e detyrimeve të mësipërme.

Brenda datës 30.06.2026

1.2.Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Rurale II të marrë masa, që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfutur më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme.

Brenda datës 30.06.2026

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të kërkojë informacion nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve në vlerën totale **15,973,144 lekë**, si taksa urbanistike që rrjedhin nga përfitimi i lejeve të ndërtimit nga subjekti “S.” ShPK, si dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara në emër të këtij subjekti, deri në marrjen e

konfirmimit nga pushteti vendor, lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga leja e ndërtimit të përfituar nga shoqëria ndërtuese.

Brenda datës 30.06.2026

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për parcelat ndërtimore prej 119376 m² të pajisur me Leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin të vleftës përkatëse prej 17,499,393 lekë të parcelave ndërtimore.

Brenda datës 30.06.2026

4.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Rurale II, të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e regjistruara me Vendimin nr. 405, datë 19.03.2021, si dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë deri shlyerjen e detyrimeve financiare **në vlerën 614,100 lekë**, që rrjedhin nga shmangia e legalizimit si objekt i dytë për banesën 1 kat në favor të poseduesit të këtij objekti.

Brenda datës 30.06.2026

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Njësitë Administrative të Vetëqeverisjes Vendore të marrë masa për njoftim e ndjekje në zbatim të gjitha procedurave, për arkëtimin vleftës përkatëse prej 184,587 lekë si taksë e ndikimit në infrastrukturë.

Brenda datës 30.06.2026

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë, për shkeljet e konstatuara në **3 raste**, sipas referencave: nr. 00004016, datë 15.07.2019, nr. 00003995, datë 30.01.2019, ZK 2119 “Katund i Ri” dhe 00000986, datë 08.10.2020, ZK 0986 “Lalm”, deri në arkëtimin e **shumës totale prej 97,740 lekë** (52,147+32,704+12,900), në të kundërt të kthehet në pronësi “Shtet” sipërfaqja e përfituar padrejtësisht.

Brenda datës 30.06.2026

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale II, të marrë masa të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 107/8, referuar shkeljeve të konstatuara, sipas referencës nr. 00000072, datë 05.02.2002, deri në paraqitjen e dokumentacionit përkatës (të fitimit të pronësisë) nga subjekti posedues, ose arkëtimin e **shumës totale prej 1,015,875 lekë**, që i përket vlerës së truallit të regjistruar në mungesë të dokumentacionit të pronësisë.

Brenda datës 30.06.2026

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa:

- Të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin e vleftës përkatëse prej 407,232 lekë të parcelës ndërtimore.

- Për pasuritë e regjistruar me nr. 54/83, vol 7, faqe 69 ZK 2679 të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në shlyerjen e detyrimit ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin penalitetit prej 426,460 lekë, i pa aplikuar në lëshimin e lejes së legalizimit nr. 171794, datë 31.03.2020.

Brenda datës 30.06.2026

V. NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHETËRORE TË KADASTRËS KAMËZ - VORË:

Konkluzimi i auditimit:

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë, “*Auditim përputhshmërie mbi veprimtarinë e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë*”, sipas programit të auditimit nr. 1139/1 prot., datë 18.12.2022, rezulton se:

- Në lidhje me hartimin e “*Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH*” dhe dërgimin e tij në KLSH, referuar raportit përfundimtar të auditimit me objekt “*Auditim përputhshmërie mbi veprimtarinë e drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë*”, sipas Programit të Auditimit nr. 1139/1, datë 18.12.2022, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH*”, gërma j);

- Në lidhje me raportimin që DV ASHK Kamëz – Vorë duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH*”, pika 2, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve;

- Për përmirësimin e gjendjes është rikërkuar zbatimi i 26 rekomandimeve për masa organizative, nga ku 9 rekomandime janë zbatuar, 2 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, 1 rekomandim është në proces zbatimi, ndërsa 14 rekomandime rezultojnë të pa zbatuar;

- Për përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet është lënë 1 rekomandim për shumën 2,191,200 lekë, i cili nuk është zbatuar;

- Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore “*Vërejtje*” deri në “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*” për 9 punonjës dhe masa disiplinore “*Vërejtje*” për 13 punonjës, të cilat nuk janë zbatuar;

- Për propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi është lënë 1 rekomandim, i cili nuk është zbatuar.

Për sa më sipër, rikërkojmë që Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz – Vorë, brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026 të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara, në proces zbatimi dhe pjesërisht të zbatuara, si vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1.1. Rekomandim: Drejtoria Vendore e ASHK-së Kamëz - Vorë në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrë masa e të propozojë ndryshime ligjore në VKM nr. 827, datë 30.9.2020 “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim*”, lidhur me përcaktimin e nivelit tavan të sipërfaqes së truallit funksional

nga 300 m²-500 m², duke patur si prioritet përcaktimet ligjore për **konceptin e truallit funksional**, me qëllim shmangien e zaptimeve të pasurive shtetërore dhe abuzimeve të mundshme në këtë drejtim.

Brenda datës 30.06.2026

B. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelave ndërtimore për objektet e pajisur me leje legalizimi, për likuidimin e vleftës prej **342,464,964 lekë** që i përket vlerës totale të parcelave ndërtimore që janë në pritje të kalimit të pronësisë.

Brenda datës 30.06.2026

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa, që sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfituar më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme (sipas tabelës “*Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore*”).

Brenda datës 30.06.2026

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të marrë masa të ushtrijë kontroll administrativ, për të rivlerësuar procedurat e legalizimit dhe marrjen e masave deri në shfuqizimin e lejeve, për objektet informale të pajisura me leje legalizimi **në 15 raste**, si më lart. Gjithashtu për këto raste dhe në vijimësi, të kërkohet informacion nga institucionet përkatëse, sipas rasteve, lidhur me gjendjen dhe funksionimin e kanaleve kulluese ujëmbledhëse, apo lidhur me pozicionimin e objektit të legalizuar në raport me brezin e sigurisë dhe ndikimin që mund të ketë në sigurinë e jetës së banorëve, për të bërë të mundur mos legalizimin e objekteve me shkelje të dispozitave ligjore.

Brenda datës 30.06.2026

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë të marrë masa dhe të përgatisë plane konkrete, për të shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas zonave informale dhe brenda afateve të përcaktuara ligjërisht, duke mundësuar afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë duke rritur edhe transparencën për publikun.

Në vijimësi

5.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë, bazuar në shkeljet e konstatuara, të marrë masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit për pasuritë: nr. 113/16-G1-G3 dhe nr. 113/16-G7-G8, regjistruar në volum 58, faqe 25 - 27 dhe faqe 31 - 32, si dhe mbi pasurinë truall me sipërfaqe 5325 m², mbi të cilin është ndërtuar objekti, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

6.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa, të kërkojë informacion zyrtar nga institucionet që kanë në administrim pasurinë kanal që është bërë pjesë e pasurisë së regjistruar nr. 190/10, ZK 2066, lidhur me gjendjen aktuale, nëse funksion si kanal apo është kthyer në tokë bujqësore me procedura ligjore. Gjithashtu deri në marrjen e konfirmimit zyrtar, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për këtë pasuri.

Brenda datës 30.06.2026

7.1. Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë që rezultojnë në pronësi të familjes M. M. dhe në emër të familjes H. D., deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë që shërben për regjistrimin e pasurisë, ose kalimin në pronësi “Shtet” të sipërfaqeve të përfituar më tepër, prej 4000 m² dhe 29800 m², se sa përcakton AMTP-ja përkatëse.

Brenda datës 30.06.2026

8.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë, bazuar në shkeljet e konstatuara të marrë masa, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 133/34, volum 17, faqe 86, arë me sipërfaqe 5100 m² dhe pasurinë nr. 304/5, volum 6, faqe 141, arë me sipërfaqe 310 m², deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda datës 30.06.2026

10.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë, bazuar në shkeljet e konstatuar, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë me nr. 10/16 e afishuar në vol.4 faqe 200 zk.1514-Domje, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu në vijimësi për rastet kur në AMTP konstatohet shënime se “ngastra është dhënë në përdorim”, të mos kryejë regjistrime të ngastrave përkatëse pa shqyrtuar në tërësi dokumentacionin e ndarjes së tokës.

Brenda datës 30.06.2026

11.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa për kufizimin e pasurisë me nr. 800/10, me sipërfaqe 1085 m² deri në korrigjimin e konfigurimit të pasurisë, në përputhje me konturet e pasurisë së origjinës.

Brenda datës 30.06.2026

12.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa që të rivlerësojë dosjen përkatëse, duke verifikuar dhe konfirmuar nëse objekti është ndërtim i para vitit 1991(në bazë të ortofotove), në të kundërt të vendoset kufizim për pasurinë.

Brenda datës 30.06.2026

13.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa për kufizimin e pasurisë me nr. 482/3 me sipërfaqe 2270 m² e llojit “arë, përfshirë pasuritë e regjistruara në Marqinet, në emër të N. P. deri në verifikimin dhe konfirmimin se cila nga dy AMTP që zotëron qytetari mbështetet me dokumentacionin e ndarjes së tokës.

Brenda datës 30.06.2026

14.1. Rekomandim: DV ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa për kufizimin e pasurisë me nr. 297/25, vol.6 faqe 55 me sipërfaqe 1000 m² deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, veçanërisht konfirmimin e legjitimitetit të AMTP-së, sipas listës së përfituesve të tokës bujqësore.

Brenda datës 30.06.2026

15.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Kamëz - Vorë, të marrë masa, që në çdo rast ku konstatohen mos përputhje të dhënash në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim, të kërkojë rikonfirmim zyrtar nga institucioni që ka lëshuar aktin përkatës. Gjithashtu lidhur me përmbajtjen e dokumentacionit urbanistik që i përket referencës nr. 27035, të kërkohet rikonfirmim nga Bashkia Kamëz, deri në marrjen e konfirmimit zyrtar të pezullojë kryerjen e veprimeve mbi pasuritë përkatëse.

Brenda datës 30.06.2026

17.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Kamëz - Vorë, të marrë masa, të kërkojë konfirmim zyrtar nga Bashkia Vorë lidhur me përmbajtjen dokumentacionit urbanistik, deri në marrjen e konfirmimit zyrtar të pezullojë kryerjen e veprimeve mbi pasuritë përkatëse.

Brenda datës 30.06.2026

20.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Kamëz - Vorë, të marrë masa, konfirmimin zyrtar nga institucionet kompetente, lidhur me ekzistencën e objekteve për periudhën para vitit 1991, apo ndërtimin pas këtij viti, si dhe të pezullojë veprimet për pasurinë nr. 129/845, ZK 2066, deri në marrjen e konfirmimit zyrtar.

Brenda datës 30.06.2026

23.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Kamëz - Vorë, të marrë masa për të kryer skanimin dhe ngarkimin në sistemin dixhital të dokumentacionit, si dhe të kryejë një inventarizim të plotë të dosjeve që ndodhen në arkiv, për të evidentuar me përgjegjshmëri gjendjen lidhur me mungesën e dosjeve sipas referencave përkatëse. Gjithashtu të marrë masa, që në rastet e largimit nga puna të punonjësve, apo ndërrimin e vendit të punës, të dorëzohet me procesverbal, me marrës në dorëzim, i gjithë dokumentacioni që ka në administrim në proces shqyrtimi punonjësi përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga 22 masa disiplinore, nga DV ASHK Kamëz - Vorë nuk është zbatuar asnjë masë. Konkretisht, për 9 punonjës është rekomanduar marrje e masës **“Vërejtje”** deri në **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”**, ndërsa për 13 punonjës është rekomanduar **“Vërejtje”**.

1.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në bashkëpunim me Drejtorin e DV ASHK Kamëz - Vorë, të rivlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për 22 punonjës që vijojnë të jenë në marrëdhënie pune, sipas shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit, përcjellë me shkresën nr. 650/18 prot; datë 14.07.2023.

Menjëherë

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË PRONËS PUBLIKE:

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Kamëz - Vorë të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të vendosë urdhër kufizimi mbi pasuritë që rezultojnë të regjistruara në emër të qytetarëve R. D. dhe E. D., deri në paraqitjen e dokumentacionit që vërteton shlyerjen e detyrimit që rrjedh nga përdorimi i truallit në pronësi shtet, apo marrjen përsipër të këtij detyrimi nga blerësi, që për periudhën 10 vjeçare, **llogaritet në vlerën 2,191,200 lekë.**

Brenda datës 30.06.2026

VI. NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS SHKODËR:

Konkluzimi i auditimit:

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër, “Për zbatimin e rekomandimeve”, përcjellë me shkresën nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, rezulton se:

- Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, gërma j);
- Në lidhje me raportimin që DV ASHK Shkodër duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve;
- Për përmirësimin e gjendjes është rikërkuar zbatimi i dy masave organizative, të cilat janë pranuar nga subjekti, por nuk janë zbatuar;
- Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 1 punonjës; masa disiplinore “Vërejtje” për 8 punonjës, të DV ASHK Shkodër, të cilat rezultojnë të pazbatuara.

Për sa më sipër, rikërkohet që Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër, brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026 të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara, në proces zbatimi dhe pjesërisht të zbatuara, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi: DV ASHK Shkodër të marrë masa për të anuluar vendimin nr. 23 datë 30.01.2020, në emër të bashkëpronarëve T., me sipërfaqe ndërtimi 238 m² dhe sipërfaqe truall funksional 238 m², duke i orientuar qytetarët që për objektin përkatës t’i nënshtrohet procedurave të privatizimit përmes Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Drejtori i DV ASHK Shkodër, duhet të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për të kryer verifikimet përkatëse, duke bashkëpunuar edhe me institucionet e tjera shtetërore, nëse për 517 objektet (të evidentuar nga institucionet e tjera si ndërtime pa leje, sipas aneksit përkatës bashkëngjitur këtij Projekt Raporti në Aneks nr. 1) janë bërë vetëdeklarimet për përfshirjen në procesin e legalizimit. Nëse këto subjekte kanë bërë vetëdeklarimin për legalizim të ndërtimeve informale, atëherë të merren masat për verifikimin në terren dhe ndjekjen e procedurës së legalizimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar në lidhje me kualifikimin apo skualifikimin e këtyre objekteve nga legalizimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

B. MASA DISIPLINORE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga 9 masa disiplinore, nga DV ASHK Shkodër nuk është zbatuar asnjë masë. Konkretisht, për 1 punonjës është rekomanduar marrje e masës **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”**, ndërsa për 8 punonjës është rekomanduar **“Vërejtje”**.

1.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në bashkëpunim me Drejtorin e DV ASHK Shkodër, të rivlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për 9 punonjës që vijnë të jenë në marrëdhënie pune, sipas shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit, përcjellë me shkresën nr. 1221/27 prot., datë 18.05.2022.

Menjëherë

VII. NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHETËRORE TË KADASTRËS DURRËS:

Konkluzimi i auditimit:

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, **“Për zbatimin e rekomandimeve”**, përcjellë me shkresën nr. 37/5 prot., datë 11.01.2024, rezultoi se:

- Në lidhje me hartimin e **“Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”** dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 **“Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”**, gërma j);
- Në lidhje me raportimin që DV ASHK Durrës duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 **“Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”**, pika 2, ka rezultuar se subjekti i audituar nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve;
- Për përmirësimin e gjendjes është rikërkuar zbatimi i gjashtë rekomandimeve për masa organizative, të cilat janë pranuar nga subjekti, ndërsa zbatimi tyre rezultoi: janë zbatuar pjesërisht 5 rekomandime, ndërsa rezultoi i pa zbatuar 1 rekomandim.
- Për shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa disiplinore **“Zgjidhje të kontratës së punës”** për 1 punonjës, **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”** për 1 punonjës dhe **“Vërejtje”** për 13 punonjës, nga ku rezultoi se nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës është marrë masa disiplinore **“Vërejtje”** për 1 punonjës, ndërsa për 1 punonjës nuk është konkluduar në masë përfundimtar, por është bërë vetëm njoftimi për fillimin e procedurës disiplinore, për rrjedhojë konsiderohen të pa zbatuara 14 masa disiplinore.

Për sa më sipër, rikërkohet që Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026 të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara, në proces zbatimi dhe pjesërisht të zbatuara, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Rekomandime të lëna, referuar gjetjeve të grupit të auditimit:

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës për rastet e mësipërme të marrë masa për të plotësuar dosjen me deklaratat përkatëse sipas përcaktimeve ligjore, në të kundërt korrigjojë sipërfaqen e parcelës ndërtimore për objektet e mësipërme duke i zbritur sipërfaqes totale truallin e llogaritur mbi 3-fishin e bazës ndërtimore.

Brenda datës 30.06.2026

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës për rastet e mësipërme, të vendosë masë kufizimi sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit dhe të pasqyrojë këto veprime në kartelat (regjistrat) e pasurive të paluajtshme.

Brenda datës 30.06.2026

20.1 Rekomandimi: DV ASHK Durrës të marrë masa për korrigjimin e zërit kadastral për çertifikatën e lëshuar ndaj personit të tretë, nga “arë” në “kënetë”, për sipërfaqen 3003 m², duke i plotësuar kartelat përkatëse me shënimin e kufizimit dhe rikthyer në gjendjen fillestare regjistrimin e pasurive në emër të z. N. M.

Brenda datës 30.06.2026

21.1 Rekomandimi: DV ASHK Durrës të marrë masa për korrigjimin e sipërfaqeve të regjistruara me vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës nr. 10-2018-2311 (820), për pjesët që mbartin mospërputhje me sipërfaqet e kartelave, duke zbritur edhe sipërfaqet shtesë mbi sipërfaqen e përcaktuar në këtë vendim, si dhe të bëjë shënimin në seksionin përkatës të kartelave se për këtë çështje është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Brenda datës 30.06.2026

23.1 Rekomandimi: DV ASHK Durrës të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin në terren të pretendimit të z. Sh., duke e informuar përmes një shkresë, ku të arsyetohet në mënyrë ligjore dhe hartografike, mbi shkaqet e diferencës në sipërfaqe.

Brenda datës 30.06.2026

24.1 Rekomandimi: DV ASHK Durrës të marrë masa për të verifikuar pretendimet e znj. L. M., duke e informuar zyrtarisht, ku të arsyetohet në mënyrë ligjore dhe hartografike për pronësinë e pretenduar me sipërfaqe prej 890.66 m² në emër të z. B. A.

Brenda datës 30.06.2026

Rekomandime të lëna, referuar trajtimit të ankesave të qytetarëve:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e ASHK Durrës duhet të vlerësojë heqjen e kufizimit për pasurinë nr. 245/67, vol. 14 faqe 100, me sipërfaqe 1420 m² “arë”, ZK 3385, në emër të P. D., në referencë të përcaktimeve ligjore të VKM nr. 1174 datë 24.12.2020 e cila në pikën 34 përcakton se “Kufizimet e vendosura mbi pasuritë e regjistruara me AMTP, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si pasojë e procesit të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, shuhen/bien. Drejtoria vendore e ASHK-së, me urdhër të arsyetuar, konstaton rënien e kufizimit mbi pasurinë, kryesisht ose me kërkesë të subjektit të interesuar. Përfundimisht, kjo pikë nuk zbatohet në rastin e kufizimeve të vendosura mbi pasuritë e regjistruara me AMTP, për shkak se ajo nuk plotëson kriteret sipas nënpikës 6.3, të këtij vendimi”.

Brenda datës 30.06.2026

2.1. Rekomandimi: Në bazë të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 65, DV ASHK Durrës, në bashkëpunim me sektorin e përmirësimit përditësimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së duhet të marrë masa, për të vlerësuar:

- Saktësimin e sipërfaqeve që rezultojnë në mbivendosje mes vendimeve të kthimit të kompensimit të pronave të mësipërme Hersi-Xhafa-Arifi.
 - Nëse mbivendosja buron nga gabime ose pasaktësi në pozicionimin e titullit të regjistruar në hartën kadastrale, etj.
 - Nëse gabimi ose pasaktësia në hartën kadastrale kërkon ripozicionimin e shumë titujve të pasqyruar jo saktësisht.
 - Nëse gabimi ose pasaktësia qëndron tek elementet hartografike të vetë titujve të pronësisë, të cilat janë të korigjueshme
- Në varësi të problematikës së konstatuar, për pjesën që tejkalon tagrin e shqyrtimit administrativ nga ASHK, t'i adresojë palët për ndjekjen e një procesi gjyqësor.

Brenda datës 30.06.2026

B. MASA DISIPLINORE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga 14 masa disiplinore, nga DP ASHK dhe DV ASHK Durrës është marrë masë disiplinore **“Vërejtje”** vetëm për një punonjës, ndërkohë që nuk është zbatuar asnjë masë tjetër. Konkretisht (referuar masave disiplinore të pazbatuara), për 1 punonjës është rekomanduar marrje e masës **“Zgjidhje të kontratës së punës”**, **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”** për 1 punonjës dhe **“Vërejtje”** për 11 punonjës.

1.1 Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në bashkëpunim me Drejtorin e DV ASHK Durrës, të rivlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për 13 punonjës që vijojnë të jenë në marrëdhënie pune, sipas shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit, përcjellë me shkresën nr. 202/32 prot., datë 25.01.2023.

Menjëherë

Shënim: Numrat rendor të rekomandimeve të mësipërme përputhen me numrat rendor të rekomandimeve në raportet përfundimtare respektivë të përputhshmërisë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT